

Universiteti i Europës Juglindore
Универзитет на Југоисточна Европа
South East European University

Fakulteti Juridik
Правен факултет
Law Faculty



STUDIMET PASDIPLOMIKE – CIKLI I DYTË

TEZA:

“Kriteret për përcaktimin e dëmshpërblimit për dëmin e shkaktuar në komunikacionin rrugor në Rëpublikën e Maqedonisë Veriore me theks të veçantë në teritorin e Gjykatës Civile në Shkup nga viti 2015 e këndej”

Kandidati:
Jehona Asani

Mentori:
Prof.Dr.Adnan Jashari

Tetovë, 2019

HYRJE

E drejta e detyrimeve është dëgë e veçantë e së drejtës dhe bën pjesë në grupin e lëndëve civile. Në kuptimin objektiv, ajo përfshin normat juridike të cilat rregullojnë marrëdhënjet juridike të detyrimeve. E drejta e detyrimeve si degë e së drejtës, përfshin normat juridike të cilat rregullojnë marrëdhënjet e detyrimeve si marrëdhënjet pasurore midis personave. Në aspektin objektiv e drejta e detyrimeve paraqet grupin e rethanave me anën e të cilave rregullohen qëndrimet e pjesëmarrësve në marrëdhënjet e tyre të ndërvetëshme të detyrimeve.

E drejta e detyrimeve rregullon institute të ndryshme të cilat janë burim i marrëdhënjeve obligatore edhe atë, dëmin dhe shpërblimin e dëmit, marrëdhënjet detyrimore që dalin nga kontratat, pasurimi i pa pabazë etj.

Dinamika e jetës të cilën e jetojmë, nevojat e njerëzve të cilë kohëve të fundit janë të rritura që të udhëtojnë me mjete udhëtimi jashtë qytetit, ose brenda në qytet, dhe në atë mënyrë të bëhen pjesëmarrës në komunikacionin rrugor rrit edhe rrezikun që të jenë pjesëmarrës në ndonjë aksident trafiku i cili ndodh për shkaqe të ndryshme. Në këtë mënyrë paraqitet edhe dëmi i cili personit apo personave të caktuar ju shkaktohet nga aksidenti në komunikacionin rrugor dhe me atë edhe nëvoja apo e drejta e cila i takon çdo qytetari që dëmi i shkaktuar në komunikacionin rrugor ti shpërblehet. Për këtë arsye si dhe për shkak të arsyes së rritjes së numrit të lëndëve civile me bazë juridike - shkaktimi i dëmit nga aksidenti rrugor në këtë punim në mënyrë të detajuar do të elaboroj dhe do të shfaq kriteriumet për përcaktimin e dëmshpërblimit për dëmin e shkaktuar në komunikacionin rrugor me theks të veçantë në gjykatën civile Shkup duke filluar nga viti 2015 e këndej.

Dëmi është burim i rëndësishëm nga shkaktimi i të cilit krijohen detyrime. Dëmi paraqet zvogëlim të pasurisë së dikujt-dëmi i thjeshtë ose ndalesë që ajo pasuri të rritet-fitimi i humbur si dhe cenim i të drejtavë personale-dëmi jomaterial. Dëmi paraqitet në lloje të ndryshme të cilat në mënyrë të detajuar do ti elaboroj në këtë punim. Me vetë shkaktimin e dëmit paraqitet edhe nevoja e shpërblimit të dëmit të shkaktuar i cili mund të jetë si dëm material poashtu edhe dëm jomaterial.

Problematicë kryesore në praktikën gjyqësorë haset në atë se cilat janë kriteriumet për përcaktimin e lartësisë së dëmshpërblimit. Kështu në mënyrë të detajuar do të elaboroj kriteriumet për përcaktimin e lartësisë së dëmit të shkaktuar në komunikacionin rrugor në Gjykatën civile Shkup ku edhe jam e punësuar. Vlen si fillim të theksohet se kriteriumet për përcaktimin e dëmshpërblimit janë të shumta ndër të cilat: shkalla e fajit, sa ka kontribuar i dëmtuari që dëmi të shkaktohet apo të mos shkaktohet, sa ka kontribuar dëmtuesi me veprimet e tija që dëmi i caktuar të shkaktohet apo të mos shkaktohet si dhe faktorë të shumtë të cilët në këtë punim do të jenë të përpunuara.

PËRMBAJTJA

HYRJE.....	2
PËRMBAJTJA.....	4
KREU I.....	7
I.NË PËGJITHËSI PËR DËMIN(SI BURIM I DETYRIMEVE).....	7
1.KUPTIMI I DËMIT.....	7
1.1.Kuptimi i dëmit në aspektin juridik.....	15
1.2.Kuptimi i dëmit në aspektin ekonomik.....	16
2.LLOJET E DËMIT.....	17
2.1.Dëmi material.....	22
2.2.Dëmi jomaterial.....	23
3.SHKAQET PËW SHKAKTIMIN E DËMIT.....	24
KREU II.....	37
II. SHPËRBLIMI I DËMIT.....	37
1.KUPTIMI.....	37
2.SHPËRBLIMI I DËMIT MATERIAL.....	38
2.1.Mënyrat e realizimit të shpërblimit të dëmit material.....	39
2.2.Procedura e realizimit të shpërblimit të dëmit material.....	41
3. SHPËRBLIMI I DËMIT JOMATERIAL.....	45
3.1. Kushtet.....	46
3.2. Qëllimi.....	47
4.KRITERET PËR CAKTIMIN E LARTËSISË SË DËMIT MATERIAL.....	53
4.1.Lartësia e dëmit.....	54
4.2.Vlerësimi i dëmit sipas vlerës së posaçme individuale.....	56
4.3.Shkalla e fajit.....	59
4.4.Gjendja pasurore e dëmtuesit dhe të dëmtuarit.....	71

KREU III	72
III. RASTET E VEÇANTA TË SHPËRBLIMIT TË DËMIT.....	72
1. RASTET E VEÇANTA TË REALIZIMIT TË SHPËRBLIMIT TË DËMIT MATERIAL.....	72
1.1.Shpërblimi i dëmit material për shkak të lëndimit trupor dhe dëmtimit të shëndetit	72
1.2.Shpërblimi i dëmit material për shkak të shkaktimit të vdekjes.....	73
1.3.Shpërblimi i dëmit material të shkaktuar me cënimin e dinjitetit dhe përhapjes së fakteve të pavërteta	74
1.4.Shpërblimi i dëmit material kur dëmin e shkaktojnë shumë subjekte.....	75
2. RASTET E VEÇANTA TË REALIZIMIT TË SHPËRBLIMIT TË DËMIT JOMATERIAL.....	75
2.1. Shpërblimi i dëmit jomaterial gjatë shkaktimit të dhimbjeve fizike.....	75
2.2. Shpërblimi i dëmit jomaterial gjatë shkaktimit të frikës.....	76
2.3. Shpërblimi i dëmit jomaterial gjatë shkaktimit të vuajtjeve psikike.....	77
2.4. Shpërblimi i dëmit jomaterial gjatë shkaktimit të shëmtimit.....	78
 KREU – IV	
IV. TË DHËNA STATISTIKORE NË LIDHJE ME SHPËRBLIMIN E DËMIT NGA PRAKTIKA GJYQESORE NË GJYKATËN CIVILE-SHKUP	79
1. Regjistrat ku bëhet regjistrimi i lëndëve	79
2. Të dhëna statistikore në lidhje me realizimin e instituteve të ndryshme juridiko civile në vitin 2015.....	86
3. Të dhëna statistikore në lidhje me realizimin e instituteve të ndryshme juridiko civile në vitin 2016.....	90
4. Të dhëna statistikore në lidhje me realizimin e instituteve të ndryshme juridiko civile në vitin 2017.....	95
5. Të dhëna statistikore në lidhje me realizimin e instituteve të ndryshme juridiko civile në vitin 2018.....	98
6. RASTE NGA PRAKTIKA GJYQESORE KU ËSHTË VENDOSUR PËR SHPËRBLIMIN E DËMIT TË SHKAKTUAR NË KOMUNIKACIONIN RRUGOR.....	101

6.1. Rasti i parë-Aktgjykim i shpallur në vitin 2016.....	101
6.2. Rasti i dytë-Aktgjykim i shpallur në vitin 2017.....	115
6.3. Rasti i tretë-Aktgjykim i shpallur në vitin 2018.....	131
PËRFUNDIMI.....	145
BIBLIOGRAFIA.....	147

KREU I

NË PËRGJITHËSI PËR DËMIN (SI BURIM I DETYRIMEVE)

1.KUPTIMI I DËMIT

Historikisht shikuar marrëdhënjet detyrimore me shkaktimin e dëmit nuk kanë egzistuar në forma dhe përmbajtje siç i njohim në të drejtën civile bashkëkohore ose thënë më preciz si pjesë e veçantë e të drejtës së detyrimeve. Në fillimet e civilizimit këto marrëdhënie kanë qenë ngusht të lidhura me marrëdhënjet penale juridike. Kjo është kështu pasi që mes tyre nuk është bërë dallim në lidhje me përgjegjësinë. Për deliktin e shkaktuar ashtu si edhe për dëmin e shkaktuar dënimi ka qenë i njëjtë. Bëhet fjalë për përgjegjësinë e njohur në atë kohë ose më mirë thënë për dënimin i njohur si *talion(nga fjala latine talis-i tillë)*. Në legjislaturën hebreje (ligjet e Mojsit) talioni është bazuar në principin sy për sy - dhëmb për dhëmb.¹

Me zhvillimin e shoqërisë si në marrëdhënjet ekonomike poashtu dhe në marrëdhënjet tjera të përgjithshme, gradualisht, por sigurt është shfaqur nevoja për njohjen e tyre më të përafërt dhe prej këtui në bazë të kësaj shfaqet nevoja për zhvillimin e rendit ligjor që do të përshtatet me natyrën e këtyre marrëdhënjëve. Kështu në zhvillim të mëtejme të marrëdhënjëve të shkaktimit të dëmit ka sjellë deri tek ajo që këto marrëdhënie të fillojnë të dallohen nga marrëdhënjet penale juridike dhe në rendin ligjor parimi i tallonit fillon të ndryshojë me element ekonomik ekuivalent. Kjo domethënë se akcenti i përgjegjësisë në anën e shkaktuesit të dëmit për veprën e caktuar të palejuar fillon të transferohet në pronën e tij. Besohet se në fillimet e ndarjes së delikteve civilo-juridike nga deliktet penale -juridike ekuivalenti ekonomik për dëmin e pësuar juridikisht është kompensuar me ndonjë lloj marrëdhënie detyrimore kontraktuese. Që të pranohet ndryshimi nga talloni me ekuivalent material adekuat ka qenë e domosdoshme ndonjë marrëdhënie detyrimore kontraktuese. Nga kontraktimi ka qenë e mundur që të pritet *“armiqësia të shëndrohet në miqësi, mosmarrëveshja të zgjidhet, kurse gjaku me ndonjë të mirë-staisfacion material”*

Përrjashtimi i përgjegjësisë së dëmit nga parimi i tallonit “sy për sy dhëmb për dhëmb” dhe shprehja e një ekuivalenti të caktuar ekonomik ka çuar ndryshimin e hakmarjes me pajtesë që në thelb don të thonë kontraktim. Nga gjithë që thamë vijmë në përfundim se e drejta e

¹ G.Galev,Obligaciono parvo, Skopje, 2012, fq. 611.

detyrime në fillimet e zhvillimit të saj ka qenë unike, kjo për shkak të asaj se kontrana- marëveshja është burim i vetëm i pajtimit të vullnetit të palëve (marëdhënjeve detyrimore), në të cilat kanë qenë të absorbuara edhe ata që janë paraqitur me shkaktimin e dëmit. Prej këtu edhe bëhet fjalë për sundimin e monizmit në të drejtën e detyrimeve në atë kohë (nga fjala greke “monos”-i vetëm, vetë). Por, nëse kjo në fillimet e të drejtës detyrimore ka qenë e bollshme, më vonë me ritjen e zhvillimit të marëdhënjeve tregtare, në njërën anë, dhe gjithashtu janë ritur edhe rastet e shkaktimit të dëmit në marëdhënjet e të drejtës në anën tjetër, fillon të shfaqet nevoja e paraqitjes së sistemit juridiko civil dualistik (nga fjala latine “duo” - dy): njëra për të regulluar marëdhënjet detyrimore lidhur me mallrat dhe shërbimet (e drejtë e kontraktuar- (ligjin e kontratës)) dhe tjetra për regullimin e marëdhënjeve që paraqiten me rastin e shkaktimit të dëmit (e drejta jashtëkontraktuese). Në kohën e Gajusit dhe më vonë Justinianit, do të thuheshte se bëhet regull pa përjashtim. I njëjtë është rasti edhe me kodifikimet e të drejtës civile të shekullit 19, shekullit 20 e deri te shekulli 21, gjegjësisht deri tek përilimi i Ligjit mbi marëdhënjet detyrimore të Republikës së Maqedonisë Veriore të vitit 2001.²

Dëmi është burim i marëdhënjeve detyrimore juridike i cili paraqitet me veprimet e paligjshme të një personi (delikt), kurse përbëhet nga zvogëlimi i pasurisë së dikujt (dëmi i zakonshëm) dhe ndalimi i zmadhimit të saj (fitimi i humbur), si dhe shkaktimi i dhimbjeve fizike apo vuajtjes psikike dhe frika (dëmi jomaterial). Do me thënë dëmi paraqet shkelje të së drejtës subjektive të një personi ose interesit ligjor.

Dëmi paraqet një ndër kushtet e përgjithshme dhe më të rëndësishme të përgjegjesisë deliktore civile. Në kuptimin e ngushtë, ai ka të bëjë me çdo cënim të pasurisë, me çdo humbje të pasurisë, kurse në kuprimin e gjërë dëmi paraqet cënimin e pasurisë së ndonjë subjekti, cënimin e të drejtave ose personalitetin e tij.

Cënimi i interesit juridik paraqet të ashtuquajturën gjendje juridike në bazë të të cilës, pas paraqitjes së ndonjë fakti, i dëmtuari do të bëhej bartës i ndonjë të drejte subjektive.³

Cënim të intersit juridik ka edhe atëherë kur del ndonjë shansë nga e cila i dëmtuari ka mundur të ketë ndonjë interes, p.sh. I dëmtuari është pronar i ndonjë sendi nga i cili ka pritur që kur të shfaqet dhe ekspozohet, të fitojë shpërblim të madh. Vlerësimi në rast të tillë

² G.Galev, Obligaciono parvo, Skopje, 2012, fq. 612.

³ K. Çavdar, K. Çavdar, Komentar na ZOO, Akademik, Shkup, 2012. fq. 248.

duhet të jetë i tillë që shkalla e pritshmërisë se do të fitohet ndonjë e mirë të jetë e pritur. Humbja e shansit paraqet lëndim të tillë nga i cili të dëmtuarit i humbet përsosja e mëtejshme dhe përmirsimi, ose humbja e ndihmës nga personi i vdekur.⁴

Sipas Ligjit mbi marrëdhënjet detyrimore të Rëpublikës së Maqedonisë veriore – Dëmi është zvogëlim i pasurisë së dikujt (dëm i thjeshtë) dhe ndalim i zmadhimit të saj (fitimi i humbur), si dhe shkaktimi i lëndimit të të drejtave personale (dëmi jomaterial).⁵

Kur do të paraqitet dëmi, duhet të vërtetohet a e pranon e drejta atë lloj të dëmit apo jo, domethënë duhet të vërtetohet a e pranon e drejta atë shkelje pronësie ose shkelje të së drejtës, gjegjësisht intereset e mbojtura juridiko-civile, me të cilat do të mund të vijë deri të shkelja e të drejtave absolute dhe relative. Me ligj interesi i mbrojtur paraqet fitimin e humbur, e cila mund të paraqitet si në sferën kontraktuese, poashtu edhe në sferën jokontraktuese.

Palët në marrëdhënjet detyrimore që shfaqen me shkaktimin e dëmit janë dëmtuesi dhe i dëmtuari.

Dëmtuesi, qoftë person fizik apo person juridik, është pala në marrëdhënjen detyrimore që përgjigjet për dëmin e shkaktuar. Që të mund të themi për një person se është shkaktues i dëmit-dëmtues është e nevojshme përveç aftësisë juridike të ketë edhe aftësi deliktore. Aftësia deliktore, si dhe aftësia juridike gjegjësisht aftësia për të vepruar e këtyre personave është kategori e veçantë, gjegjësisht paraqet aftësi që të përgjigjet për dëmin e shkaktuar. Aftësia që të përgjigjet për dëmin e shkaktuar duhet të dallohet nga aftësia e dëmtuesit për të bërë ndonjë delikt juridiko-civil, pasojë e të cilit do të ishte që tjetrit ti shkaktohet dëm. Kjo posaçërisht për faktin se këto dy lloje aftësish mbulojnë dy fusha të ndryshme. Te e fundit theksi bie në aftësinë e dëmtuesit që ti shkaktojë dëm dikujt (rast me fëmijët e moshës 7 vjeçare ose personave të moshës madhore që iu është marrë aftësia për të vepruar), por jo edhe përgjegjsia për dëmin e shkaktuar. Te aftësia deliktore nuk është me rëndësi a ka pasur dëmtuesi aftësi që vetë ta shkaktojë dëmin apo dëmi të jetë i shkaktuar nga dikush tjetër, ose është shkaktuar nga sendi i rezikshëm ose nga puna e rezikshme, por është me rëndësi kush do të përgjigjet për dëmin e shkaktuar. Në rast se dikush ka shkaktuar dëm, por nuk përgjigjet për dëmin e shkaktuar, ai është dëmtues vetëm faktikisht por jo edhe juridikisht. Dëmtues në kuptimin juridik të fjalës është

⁴ K. Çavdar, K. Çavdar, Komentar i LMD, Akademik, Shkup, 2012. fq.248-249.

⁵ LMD, Neni 142.

vetëm ai që përgjigjet për dëmin e shkaktuar ose thënë me fjalë tjera personi që ka aftësi deliktore. Aftësia deliktore jo vetëm që çon në përfundim se dallohet dhe është më e madhe nga aftësia faktike, por ajo është e ndryshme edhe nga aftësia për të vepruar, kuptuar si një tipar i veçantë, subjektëve të së drejtës ju mundëson hyrje vetanake në marrëdhënjet detyrimore. Përkaj kësaj, ajo jo gjithmonë është e lidhur me fajin, kuptuar si kusht themelor dhe një nga kushtet bazë për përgjegjësinë subjektive të dëmtuesit për dëmin e shkaktuar.⁶

Aftësia deliktore e personave fizik: Personat fizik aftësinë deliktore - aftësinë që të përgjigjen për dëmin e shkaktuar e arrijnë në atë moment kur i mbushin 14 katërmbëdhjetë vjet të jetës së tyre. Personat e tillë llogaritet se janë të pjekur mjaftueshëm psiko-fizikisht që të mund ta kuptojnë domethënjen e veprave të tyre si dhe pasojat që mund të dalin nga veprat e tyre. Me fjalë të tjera llogaritet se kanë vullnet dhe vetëdije të mjaftueshme të zhvilluar. Për dallim prej kësaj, ata arrijnë përgjegjsi të plotë për të vepruar me mbushjen e moshës madhore gjegjësisht 18 vjeçare. Në këtë rast aftësia deliktore e këtyre personave, e cila është ngushtë e lidhur me fajin - supozohet. Prandaj ky supozim është pajtues, kush e pretendon të kundërtën duhet edhe ta vërtetojë.⁷ I tillë është rasti p.sh me personat që janë të sëmurë psiqikisht apo me personat që kanë ngecje në zhvillim ose për çfarëdo qoftë arsyeje nuk janë të aftë për të gjykuar. Nëse ajo te ata vërtetohet, edhe pse e kanë aritur moshën e caktuar për tu përgjigjur për dëmin e shkaktuar, nuk kanë aftësi deliktore, që domethënë nuk përgjigjen për dëmin e shkaktuar. Personat që do ti shkaktojnë dëm dikujt në gjende të paaftësisë kalimtare p.sh personat e dehur, apo nën ndikimin e narkotikëve, juridikisht ato kanë përgjegjsi deliktore dhe si të tillë përgjigjen për dëmin e shkaktuar. Personat e tillë mund të lirohen nga përgjegjsia deliktore vetëm nëse e vërtetojnë se në situatë të tillë janë gjendur pa fajin e tyre. Në rast të tillë do të përgjigjet personi i cili i ka sjellë në situatë të tillë.⁸ Radhazi, kjo nuk don të thotë tjetër veç se përcimi i aftësisë deliktore nga dëmtuesi real në personin i cili, këtë dëmtues e ka çuar në gjendje të aftësisë kalimtare për të gjykuar. Raporti mes këtyre dy subjektëve të së drejtës gjegjësisht dëmtuesit real dhe atij i cili e ka prurë në gjendje paaftësie për të gjykuar shikuar në aspekt të përgjegjsisë për dëmin e shkaktuar shkon si vijon: i pari nga ata të paraqitet si dëmtues faktik, kurse i dyti si dëmtues real, i cili në këtë rast e ka fituar aftësinë deliktore dhe në bazë të saj bëhet palë përgjegjëse për dëmin e

⁶ G. Galev, J. D. Anastasovska, Obligaciono pravo, Shkup, 2012, fq.614-615.

⁷ Përfundim nga kjo paraqet aftësia për të vepruar e personave fizik në bazë të emancipimit (rast kur me mbushjen e 16 vjetëve do të lidhin martesë e cila do të jetë lejohet me vendim gjyqsor).

⁸ Shih nenin 146 të LMD.

shkaktuar dhe është i obliguar ta kompenzohet dëmi që e ka shkaktuar me veprimin e dëmshëm të shkaktuar me veprimet e dëmtuesit faktik.

Fëmijët deri në moshën shtatë vjeçare janë absolutisht të papërgjegjshëm për dëmin e shkaktuar. Ata në asnjë rast nuk mund të kenë aftësi deliktore. Sipas Ligjit mbi marrëdhënjet detyrimore të Republikës së Maqedonisë veriore është paraparë se: I mituri deri në moshën shtatë vjeçare nuk përgjigjet për dëmin që do ta shkaktojë. I mituri nga mosha shtatë vjeçare deri në moshën katërmëdhjetë vjeçare nuk përgjigjet për dëmin, vetëm nëse vërtetohet se në momentin kur e ka shkaktuar dëmin nuk ka qenë i aftë për të vepruar. I mituri që ka mbushur katërmëdhjetë vjet përgjigjet sipas rregullave të përgjithshme për përgjegjësinë e dëmit.⁹ Prandaj ata janë vetëm dëmtues faktik por jo edhe juridik. Dëmtues juridik (tek përgjegjësia për tjetrin) është personi i cili përgjigjet për dëmin që e ka shkaktuar dëmtuesi faktik. Duhet të theksohet se aftësia deliktore e këtyre personave në asnjë mënyrë nuk është e lidhur me fajin e fëmijës (ai asesi nuk e ka), as po nuk ekziston tek personi përgjegjës. Në rast të tillë, qartë shihet se përgjegjësia e dëmtuesit në kuptimin juridik të fjalës, në këtë rast është përgjegjësia pa faj (ajo është përgjegjësia objektive). Kur bëhet fjalë për sendet e rezikshme ose veprimet e rezikshme si bazë për përgjegjësinë objektive të dëmtuesit, gjithashtu, faji (por edhe aftësia për të vepruar) nuk kanë asnjë ndikim mbi aftësinë deliktore të personave që përgjigjen për dëmin e shkaktuar nga këto sende ose veprime. Kjo është rast edhe me drejtshmërinë si bazë për përgjegjësinë për dëmin e shkaktuar. Kështu, kur bëhet fjalë për përgjegjësinë në bazë të principit të drejtshmërisë, çdo person kur atë e kërkon drejtshmëria ka aftësi deliktore dhe është përgjegjës që ta kompenzojë dëmin e shkaktuar të dëmtuarit.

Ligji mbi marrëdhënjet detyrimore të Republikës së Maqedonisë veriore parasheh që – Ai që me faj do të shkaktojë dëm tjetrit është i obligueshëm që ta kompenzojë dëmin e shkaktuar. Për dëmin e shkaktuar me sende ose veprimtari nga të cilat del reziku i zmadhuar për dëm për rethin, përgjigjet pa marrë parasysh faji. Për dëmin pa mara parasysh fajin përgjigjet edhe në raste të caktuara të parapara me ligj.¹⁰

Sipas nenit 152 të Ligjit mbi marrëdhënjet detyrimore (1) Prindët përgjigjen për dëmin që do t'ia shkaktojë tjetrit fëmija i tyre deri në moshën shtatë vjeçare, pa marrë parasysh

⁹ LMD Neni 147.

¹⁰ LMD Neni 141.

fajin. (2) Ato lirohen nga përgjegjsia nëse ekzistojnë arsye për përjashtimin e përgjegjsisë sipas rregullave të përgjegjsisë pa marrë parasysh fajin. (3) Ata nuk përgjigjen për dëmin e shkaktuar nëse fëmija i është dhënë në përkujdesje ndonjë personi tjetër dhe nëse ai person është përgjegjës për dëmin e shkaktuar. (4) Prindët përgjigjen për dëmin që e ka shkaktuar fëmija i tyre i mitur që ka aritur vitin e shtatë të jetës, vetëm nëse vërtetohet se dëmi është shkaktuar pa fajin e tyre.

Sipas nenit 153 të Ligjit mbi marrëdhënjet detyrimore të Republikës së Maqedonisë veriore thuhet - Nëse përveç prindërve për dëmin përgjigjet edhe fëmija, atëherë përgjegjsia e tyre është solidare.

Sipas nenit 154 të Ligjit mbi marrëdhënjet detyrimore të Republikës së Maqedonisë veriore (1) Për dëmin që i mituri do t'ia shkaktjë tjetrit, i cili është nën kujdestari, shkollë ose institucion tjetër, përgjigjet kujdestari, shkolla, gjegjësisht institucioni, vetëm nëse vërtetojnë se kujdesin e kanë kryer në mënyrë në të cilën janë të obliguar, ose se dëmi do të shkaktoheshte edhe nën përkujdesin e tyre. (2) Nëse për dëmin përgjigjet edhe i mituri, përgjegjsia është solidare.

Aftësia deliktore e personave juridik: Kur bëhet fjalë për aftësinë deliktore, ajo sa është e rëndësishme si për personat fizik poashtu edhe për personat juridik. Personat juridik që të mund të përgjigjen për dëmin e shkaktuar duhet të posedojnë aftësinë deliktore. Ata duke pasur parasysh mënyrën e krijimit-themelimit të tyre, aftësinë deliktore e fitojnë në momentin e themelimit ose regjistrimit të tyre në shtetin amë. Karakteristike për këto është se përgjegjsia e tyre haset tek dëmi që të punësuarit e personit juridik ose organet që kryejnë verimtari të caktuar, personit të tretë i shkaktajnë dëm.¹¹ Kështu aftësia deliktore dhe në bazë të saj edhe përgjegjsia për dëmin e shkaktuar e personave juridik rrjedh nga përgjegjsia (aftësia) deliktore dhe përgjegjsia e punëtorit gjegjësisht organit në korniza të kryerjes së obligimeve gjatë punës së caktuar i shkaktajnë dëm personave tjerë qoftë personave fizik ose personave tjerë juridik me të cilët bashkëpunojnë. I njëjtë është rasti edhe me fajin të personat juridik. Në teorinë juridike hasim edhe në atë se personat juridik nuk mund të kenë faj. Prandaj të personat juridik ajo kompenzohet me fajin e organit gjegjësisht njësisë organizative. Kështu përgjegjsia e personave juridik do të matet sipas fajit të organeve të tij gjegjësisht njësisë organizative.¹² Në raste të caktuara të parapara me ligj ose me vendime gjyqësore, status të personit juridik mund tju jepet edhe njësisë

¹¹ Shih nenin 157-158 të LMD.

¹² G. Galev, J. D. Anastasovska, Obligaciono pravo, Shkup, 2012, fq.617.

organizative ose organeve të ndara të personave juridik. Në rastin konkret bëhet fjalë për status të fituar special të një personi juridik i cili fitohet nga aftësia deliktore lidhur me përgjegjësinë e një subjekti për kompenzimin e dëmit të shkaktuar nga ana e tij. Mirëpo kur, dhe në cilat raste do të jetë e lejuar kjo, është e lënë në vlerësim të ligdhënësit dhe gjyqit. Më këtë rast bëhet fjalë për dispizita ligjore lex specialis ose vendimit konkret të caktuar gjyqësor lidhur me zgjedhjen e rastit të caktuar nga ana e tij. Përgjegjësia e duhur është e paraparë edhe për themeluesit e kompanive tregtare për dëmin që do ta shkaktojnë personave të tretë nga momenti i themelimit të kompanisë tregtare. Por, ky është rast kur ky lloj i dëmit nuk do të jetë i marur nga ana e kompanisë tragtare të pathemeuar.¹³

-Dëmtuesi si palë e dëmtuar në marrëdhënjet detyrimore me shkaktimin e dëmit: Dëmtuesi mund të jetë një person (palë e thjeshtë) mirëpo në raste të caktuara dëmi mund të jetë i shkaktuar nga më shumë persona (pala e komplikuar). Në vazhdim do të sqaroj për palën e komplikuar në anën e dëmtuesit. Për dëmin që do ta shkaktojnë më tepër persona për atë ata do të përgjigjen bashkarisht. Me atë bashkarisht përgjigjen edhe nxitësit, ndihmësit, si dhe ata që ndihmojnë që të mos zbulohen kryesit e vërtetë të dëmit. Kur nuk ka dyshim se dëmin e kanë shkaktuar dy ose më tepër persona të cilët në ndonjë farë mënyre janë të lidhur me njëri tjetrin, dhe nuk do të mund të zbulohet saktësisht se cili prej tyre e ka shkaktuar dëmin, në atë rast ata persona gjithashtu përgjigjen bashkarisht për dëmin e shkaktuar.¹⁴ Përgjigjen bashkarisht edhe kontraktori edhe kontraktuesi i kryerjes së punëve në patundësinë në të cilën dëmi do të shkaktohet personit të tretë gjatë kryerjes së punëve.¹⁵ I njëjtë është rasti edhe kur dy ose më tepër persona i kanë shkaktuar dëm dikujt duke punuar punë të pamvarur nga njëra tjetra. Në këtë rast, përgjegjësia solidare mund të jetë e ndruar me përgjegjësi të ndarë e cila posaçërisht do ta prek çdo person veç e veç. Ky do të jetë rast kur do të mund të vërtetohen kontributet e tyre në dëmin e shkaktuar.¹⁶

Debitori i përbashket i cili do të paguaj më tepër se sa është pjesa e tij e kompenzimit të dëmit, ka të drejtë nga secili nga debitorët e përbashkët ta kërkojë pjesën që e ka paguar për atë (e drejta në regres-mbështetje). Sa është pjesa që duhet ta paguaj çdonjëri nga

¹³ Kjo posaçërisht në Ligjin për kompanitë tregtare.

¹⁴ LMD, Neni 195.

¹⁵ LMD, Neni 196.

¹⁶ LMD, Neni 195, alinea 3.

debitorët solidar (në rast kontesti) përcakton gjygi, në bazë të shkallës së fajshmërisë dhe rëndësisë së pasojave që janë shkaktuar nga sjellja e tij. Kjo mund të cedohet, ose ndryshe të vendoset, vetëm nëse atë e kërkon drejtshmëria.¹⁷

I dëmtuar është pala në mardhënjen detyrimore që lind me shkaktimin e dëmit. Nga këtu ai është edhe bartës i të drejtës që nga ajo marrëdhënie të kërkojë në natyrë ose në vlerë ti kompenzohet dëmi i shkaktuar. Duke e pasur këtë të drejtë, i dëmtuari është edhe në anën e kreditorit në mardhënjen detyrimore. Ana e të dëmtuarit mund të jetë si personi fizik ashtu edhe personi juridik, dhe nga këta të dy, pa përjashtim mund të jetë i dëmtuar si personi fizik poashtu edhe personi juridik, dhe kusht është që dëmi ti jetë shkaktuar. Çfarë ka të bëjë me llojin e aftësisë, se në cilët kufij të aftësisë mund të paraqiten si palë e dëmtuar, mjafton që të kenë aftësinë juridike. Nga këtu, si pronë e posaçme juridike, e cila këtyre personave ju mundëson që të jenë bartës të të drejtave dhe detyrimeve, në të cilat ato hyjnë, personat fizik e fitojnë në momentin e lindjes, kurse personat juridik e fitojnë në atë ditë kur themelohen gjegjësisht kur pranohen si të tillë nga shteti. Ata kur e fitojnë aftësinë juridike e posedojnë gjithë kohën deri sa ekzistojnë kështu që në çdo moment mund të paraqiten si palë e dëmtuar.¹⁸

I ngjizuri (NASCITURUS-I) si i dëmtuar: Përveç personave fizik dhe personave juridik, mbrojtje adekuate nga dëmet evantuale si dhe mbrojtje nga pasojat e dëmshme ligjdhënësi ka paraparë edhe për të ngjizurin (nasciturusi-in - atë që do të lind). Në këtë rast bëhet fjalë për frutin që është ngjizur dhe i cili akoma nuk e ka statusin njeri (person fizik). Nasciturus-i që nga koha e të drejtës romake, po edhe në ditën e sotme, juridikisht gëzon mbrojtje juridike në të drejtën penale, detyrimore si dhe në të drejtën trashëgimore. Kjo për shkak të asaj se mundësia është e madhe se pas kalimit të kohës së caktuar për zhvillim do të lindë fëmijë. Duke e pritur këtë, qëllimi i ligjdhënësit është që të posalindurit ti sigurohen disa të drejta (edhe atë në të drejtën detyrimore: e drejta e kompenzimit të dëmit të shkaktuar p.sh me lëndimin e trupit të tij akoma pa lindur, kurse në të drejtën trashëgimore: e drejta për të trashëguar). Në raste të caktuara, një lloj mbrojtje nga dëmi është paraparë edhe për pasardhësit e ardhshëm të cilët nuk janë as në formë të ngjizjes gjegjësisht fëmijë i ardhshëm i lindur nga nënë-baba, të cilët në ndërkohë përveç dëmeve somatike (trupore) kanë pësuar edhe dëme gjenetike të shkaktuara si rezultat i rezeatimit radioaktiv nga burim i caktuar i energjisë atomike.

¹⁷ LMD, Neni 197.

¹⁸ G. Galev, J. D. Anastasovska, Obligaciono pravo, Shkup, 2012, fq.619.

Dëmi gjenetik paraqitet si mutacion i gjeneve trashëguese nga nëna e rezatuar, e cila në anën e saj ka shprehje negative në gjenet e frytit të ardhshëm që do të ngjizet (nasciturus-om). Në të dy rastet gjegjësisht si të ngjizja si të pasardhësit e ardhshëm që do të mund të paraqiten si palë të dëmtuara duhet të plotësohen dy kushte: e para është që dëmi t'iu jetë shkaktuar direkt dhe e dyta është që të lindin të gjallë. Sipas disa autorëve i posalinduri duhet të ketë edhe pamje njeriu (mos të jetë i shëmtuar). Kur janë të përmbushura kushtet e lartëpërmendura fëmija i posalindur është në anën e të dëmtuarit dhe në bazë të kësaj i takon e drejta e kompensimit të dëmit. E kundërta e kësaj është kur fetusin “fëmija” lind i vdekur dhe në këto raste llogaritet se e dëmtuar është nëna e cila e ka pasur fetusin në bark, që praktikisht do të thotë se dëmshpërblimi i këtij fetusit paraqet dëmshpërblim fizik për mbajtësin e fetusit (nënë).

1.1. Kuptimi i dëmit në aspektin juridik

Në kuptimin juridik konsiderohet se dëmi është humbje e të mirave të cilat juridikisht janë të mbrojtura.

Dëmi si fakt juridik paraqet rethanë të caktuar që sjell deri tek shkaktimi apo ndrimi i mardhënjeve detyrimore. Më shpesh paraqitet në cilësinë e faktit juridik që sjell deri tek shkaktimi i këtij lloji të mardhënjeve detyrimore. Dëmi si rethanë e caktuar, që është shkaktuar apo ka ndodhur, si i tillë nuk është i mjaftueshëm që të ndikojë në shfaqjen apo ndryshimin e mardhënjeve detyrimore. Po të ishte ashtu e drejta objektive do ta kishte pranuar si të tillë. Pa atë, dëmi edhe pse në realitet është shkaktuar, shikuar juridikisht ngel pa asnjë ndikim shkaktimi, ndryshimi apo ndërprerja e mardhënjeve detyrimore. Juridikisht është e pranuar si fakt juridik dëmi që i është shkaktuar një personi me veprim të kundërligjshëm të personit tjetër (ia ka thyer veturën, xhamin e banesës, gabimisht e ka kryer obligimin e vet ose është vonuar me përmbushjen e detyrimit). Në të gjitha këto raste dëmi i shkaktuar njihet si fakt juridik, edhe atë në rastin e parë (prishja e veturës, dhe thyerja e dritares së banesës) dëmi sjell deri tek shkaktimi i përgjegjësisë për dëmtuesin që ta kompenzije dëmin e shkaktuar, kurse për të dëmtuarin e drejta që të kërkojë që dëmi i shkaktuar ti kompenzohet. Në dy rastet tjera (përmbushja e gabuar si dhe vonesa në përmbushjen e detyrimit) sjell deri tek ndryshimi i përmbajtjes së detyrimit të obliguar më parë të kontraktuar. Në këtë aspekt, pala e kontraktuar që i ka bërë këta shkelje të kontratës, përsëri

obligimit kryesor që duhet ta plotësojë, do të duhet që palës tjetër tia kompenzojë edhe dëmin që e ka pësuar nga veprimet e dëmshme.¹⁹

Në kuptimin juridik konsiderohet se dëmi është humbje e të mirave të cilat juridikisht janë të mbrojtura.

1.2. Kuptimi i dëmit në aspektin ekonomik

Në kuptimin ekonomik dëmi është humbje e pasurisë, pa marrë parasysh mënyrën e humbjes p.sh. dëmi i shkaktuar nga vërshimet, zjari, tërmeti. Ajo si pasojë, shikuar në aspekt të palëve, godet pasurinë e të dëmtuarit si dhe pamjen.

Cënimi i këtillë në aspektin juridik, për atë-të dëmtuarin paraqitet si e drejtë obligatore subjektive, përkundër obligimit të palës tjetër-dëmtuesit, si kryes i veprimit të dëmshëm si bartës i pasojave juridike për atë veprim. E drejta dhe obligimi në këtë rast janë ngushtë të lidhura njëra me tjetrën në të cilën në njëër anë është i dëmtuari kurse në anën tjetër i dëmtuari, dhe së bashku paraqesin përmbajtjen e saj. Nga këtu del edhe autorizimi i të dëmtuarit të kërkojë që dëmi ti kompenzohet dhe obligimi i dëmtuesit që ta kompenzojë dëmin e shkaktuar. Qëllimi i fundit që duhet të vëndohet në realizim të përmbajtjes së kësaj marrëdhënje është kthimi në gjendjen e mëparshme në pronësi gjegjësisht sferën personale në anën e të dëmtuarit. Kështu më poshtë në temë do të sqarohet se kur me kompenzim të dëmit arihet kompenzim natyror ose i vlefshëm – siç është rasti të dëmi material, dhe me anë të satisfakcionit moral ose material tek dëmi jomaterial.

Në kuptimin ekonomik dëmi është humbje e pasurisë, pa marrë parasysh mënyrën e humbjes. p.sh. zjari, tërmeti, vërshimet etj.

¹⁹ G. Galev, J. D. Anastasovska, Obligaciono pravo, Shkup, 2012, fq.639.

2. LLOJET E DËMIT

Në teorinë juridikë hasim disa mënyra të ndryshme të klasifikimit të dëmit. Dëmi mund të jetë disa llojesh edhe atë:

- Varësisht prej faktit se çfarë është dëmtuar dëmi mund të jetë
 - Dëm material dhe
 - Dëm jomatërial (moral)

-Dëmi material (i pasurisë) dhe dëmi moral (jomaterial): Kjo ndarje është bërë në bazë të kriteriumit sipas të cilit shfaqet rezultati i veprimit të dëmshëm të dëmtuesit: në të drejtat pasurore dhe interesave të mbrojtura ligjërisht apo të drejtave personale (të mirave personale) të të dëmtuarit. Nëse e definojmë në bazë të kësaj atëherë dëmi material mund të themi se është ai dëm që paraqitet si rezultat i shkaktimit të dëmit në të drejtat pasurore dhe interesave të mbrojtura ligjërisht të të dëmtuarit. Dëmi moral (jomaterial) paraqet rezultatin e pafavorshëm të veprimit të dëmshëm i cili paraqitet në të mirat personale të të dëmtuarit (dhembja fizike, dëmtimet e nderit, lirisë, shendetit, shkaktimi i dhimbjes fizike etj.) gjegjësisht reputacionit, dinjitetit etj. te personat juridik.²⁰ Për ekzistimin e dëmit jomatërial mjaftueshëm është të ketë një cënim të të mirave të njeriut, gjegjësisht të drejtave personale te personat juridik.²¹ Kur jemi këtu duhet të potencojmë se përveç dëmit jomatërial, me lëndim të të drejtave personale mund të shkaktohet edhe dëm material (siç janë harxhimet për mjekim, në rast të lëndimeve trupore të personit të caktuar, fitimin e humbur të lënduarit, humbja e mbajtjes nga familjarët e afërm etj).²² si dhe kompenzimin e dëmit material të cilin e pësojnë personat e afërm.²³

Nënllaje të dëmit material janë:

- dëmi i vërtetë (damnum emergens) dhe
- fitimi i humbur (lucrum cessans)

-Dëmi i vërtetë (damnum emergens) dhe fitimi i humbur (lucrum cessans): dëmi i vërtetë apo i thjeshtë (damnum emergens) paraqet dëmtim të pasurisë së të dëmtuarit që e

²⁰ G. Galev, J. D. Anastasovska, Obligaciono pravo, Shkup, 2012, fq.644-645.

²¹ Shif nenin 182 dhe nenin 183 të LMD.

²² Shih nenin 182 të LMD.

²³ LMD, neni 190 dhe neni 189.

posedon (dëmtimi i shtëpisë, veturës, librit në tërësi), dhe kështu nënkupton zvogëlimin e pasurisë së të dëmtuarit në atë vlerë sa kushton gjegjësisht sa e ka vlerën sedni që është dëmtuar, ose për aq sa i është dëmtur sendi të dëmtuarit. Thënë ndryshe, ajo është dallimi negativ që paraqitet ndërmjet vlerës së pasurisë së të dëmtuarit që e ka pasur para se të meret veprimi i dëmshëm dhe vlera që ajo pasuri e ka pas veprimit të tillë. Pjesë së dëmit të thjeshtë paraqet edhe harxhimi që bëhet nga pala e dëmtuar në lidhje me marjen e veprimeve dhe masave të caktuara që të hiqet reziku që të mos shkaktohet dëmi. Sipas kësaj mund të thuhet së dëmi i thjeshtë është vlera e pasurisë për të cilën i dëmtuari është varfëruar pas marjes së veprimeve të dëmshme në pjesë ta pasurisë së tij. Tek ky lloj i dëmit material vjen deri te lëndimi, kurse me atë edhe deri te zvogëlimi i të drejtave subjektive pronësore të të dëmtuarit të cilët kanë ekzistuar në momentin e marjes së veprimit të dëmshëm nga ana e dëmtuesit.

Fitimi i humbur (*lucrum cessans*) paraqet shkelje të së drejtës sendore në mënyrë që të dëmtuarit i pamundësohet që të përfitoj nga sendi i dëmtuar. Nga këtu mund të përfundohet se ky lloj i fitimit të humbur të cilin i dëmtuari nuk ka mund ta përfitojë, është për shkak të veprimit të dëmshëm që është bërë në pasurinë e tij. Prandaj mund të përfundojmë se për dallim nga dëmi i vërtetë tek fitimi i humbur në vend të pasurisë që e ka në pronësi i dëmtuari dëmtohet edhe pasuria që do ta kishte në pronësi po të mos i ishte shkaktuar dëmi. Kështu veprimi i dëmshëm jo vetëm se e zvogëlon pasurinë që e ka i dëmtuari por edhe parandalon që ajo pasuri në të ardhmën të shtohet. Për të ekzistuar ky lloj dëmi nuk është e mjaftueshme që i dëmtuari vetëm të kishte aritur rritje të pasurisë së tij (kriterium subjektiv) por “sipas rjedhës së regullt të punëve ose sipas rethanave të veçanta” të ketë qenë e dukshme se deri te ajo do të vijë (kriteriumi objektiv). Thënë me fjalë tjera akcenti te përfitimi i humbur nuk vendohet është tek raporti subjektiv i të dëmtuarit me atë, por mbi mundësinë e dhënë objektive që të vijë deri te realizimi i saj në mungesë të veprimit të dëmshëm.²⁴

- Në bazë të kriteriumit kohor dëmi mund të jetë:

- Dëm ekzistues
- Dëm i ardhshëm dhe
- Dëm eventual²⁵

²⁴ G. Galev, J. D. Anastasovska, *Obligaciono pravo*, Shkup, 2012, fq.645-646.

²⁵ K. Çavdar, K. Çavdar, *Kommentar i LMD*, Akademik, Shkup, 2012, fq.248.

Dëmi ekzistues (i tashëm), dëmi i ardhshëm dhe dëmi eventual: Ekzistues është ai dëm i cili si pasojë e veprimit të dëmshëm veç ka ndodhur (ekziston), pa marrë parasysh se çfarë lloj i dëmit është, kryesore është se dëmi ka ndodhur dhe e zgjidh. Në plotësim të kushteve të lartpërmendura, pa marrë parasysh se cili lloj i dëmit është ajo paraqitet si dëm ekzistues. Për dallim prej kësaj dëmi i ardhshëm është ai dëm i cili ende nuk ka ndodhur, por sugjeron se një lloj i dëmit do të ndodhë është e sigurt por nuk dihet çasti se kur do të ndodhë si dhe mënyra se si do të ndodhë. Paralajmërimi për ndodhjen e tij është i lidhur ngushtë me veprimin e dëmshëm më të cilën i është cënuar ndonjë e mirë të dëmtuarit, tek i cili, në bazë të dëmit që i është shkaktuar dihet se në të ardhmen do të pësojë dëm (pasuria e tij apo ndonjë e mirë tjetër) tek e cila sipas llojit të dëmtimit, pritët paraqitja e dëmit plotësues. I tillë do të ishte rasti kur personit të caktuar i shkaktohen lëndime të rënda trupore tek të cilat duhet kohë më e gjatë për tu shëruar, paraqitja e invaliditetit (amputimi i dorës ose këmbës) humbja e aftësisë për të punuar ose zvogëlimi i saj etj.²⁶ E gjithë kjo paraqitet në një periudhë më të gjatë kohore në të cilin hap pas hapi gjenerohet lloj i caktuar i dëmit material ose jomaterial, të kuptuar si dëm i ardhshëm. Prandaj ligjdhënësi ka paraparë kompenzim të dëmit edhe në këto raste. Kështu sipas Ligjit mbi marrëdhënjet detyrimore të Republikës së Maqedonisë veriore është paraparë se -Gjyqi në kërkesë të të dëmtuarit, do të përcaktojë lartësinë adekuate të kompenzimit të dëmit të ardhshëm material, nëse vërtetohet se edhe në të ardhmen do të ketë pasojë²⁷.

Dëm eventual është lloj dëmi tek i cili shkaktimi ka ndodhur, por shfaqja e pasojave të dëmshme është e pasigurt meqë nuk dihet a do të paraqiten apo jo.

- Duke pasur parasysh parashikueshmërinë, dëmi mund të jetë:

- Dëm i parashikueshëm
- Dëm i paparashikueshëm

Dëmi i parashikueshëm dhe i paparashikueshëm: Dëm i parashikueshëm është ai lloj dëmi për të cilin dëmtuesi ka mund ta parashikojë gjegjësisht e ka pasur medoemos ta parashikojë në momentin kur ka marrë një veprim të caktuar ose nuk ka dashur të veprojë në ndonjë mënyrë të caktuar se me veprimin ose mosveprimin e tij dëmi do të shkaktohet, në bazë të fakteve që i ka pasur të njohura. Shembull për dëm të tillë paraqet dëmi i paraqitur me zjarin që

²⁶ Për më tepër shih LMD neni 182-186 dhe neni 177.

²⁷ LMD, Neni 192.

shkakohet në pasurinë e tjetrit deri te i cili ka ardhur me djegjen e kashtës së vetë në kohë të temperaturave të larta, pa e djegur reth tij kashtën e cila kufizohet me pasurine e të dëmtuarit. Raste të ngjashme janë edhe dëmet e tilla që shkaktohen gjatë periudhës së verës në viset malore nga zjaret e shpeshta të shkaktuara nga faktori njeri. Nëse bëhet fjalë për marrëdhënje kontraktuese dëm i parashikueshëm i cili do të ishte paraqitur nga vonesa e kryerjes së veprimit në të cilën bartësi i cili është obliguar gjatë periudhës së verës të bart mall lehtë të prishëm (qumësht i jopasterizuar, mish, pemë, ndonjë lloj ëmbëlsire etj) nga njëri në destinacion tjetër Ligji mbi marrëdhënjet detyrimore në të e përfshin pos dëmin e thjeshtë edhe fitimin e humbur. Dëmi i paparaparë është ai lloj dëmi paraqitja e të cilit në bazë të rethanave në të cilat veprohet në mënyrë të caktuar është marrë ndonjë veprim i dëmshëm gjegjësisht në rethanat në të cilat është lidhur ndonjë marrëdhënjë kontraktore, nuk është mundur të parashihet. Kështu, kur bëhet fjalë për marrëdhënje kontraktore, nuk ka domethënie se debitori nuk ka ditur për rethanat që kanë sjellur deri tek paraqitja e dëmit të paparashikueshëm, nëse ai pala tjetër (i dëmtuari) e ka mashtuar ose me qëllim dhe pa vëmendje të duhur e ka shkelur marrëdhënjen kontraktore. Në atë rast dëmtuesi përgjigjet plotësisht për dëmin e shkaktuar.²⁸

- Duke pasur parasysh mënyrën e paraqitjes dëmi mund të jetë:
 - Dëm i drejtpërdrejtë – dëm direkt
 - Dëm i tërthortë- dëm indirekt

Dëmi i drejtpërdrejtë dhe dëmi i tërthortë: Dëmi i drejtpërdrejtë paraqitet me veprim të drejtpërdrejtë të veprimit të dëmshëm gjegjësisht lëshimit të ndonjë veprimi që duhet të ndërmeret (p.sh. thyerjen e dritares, derës, veturës etj. ose me shkaktimin e zjarrit në shtëpi, banesa). Te dëmi direkt veprimi i dëmshëm dhe dëmi i shkaktuar si pasojë e veprimit të dëmshëm janë arsye direkte (veprimi i dëmshëm) dhe pasojë direkte (dëm direkt). Dëmi i tërthortë paraqitet nëpërmjet paraqitjes së dëmit të drejtpërdrejtë. Kushtimisht thënë te dëmi i tërthortë si një lloj “veprimi i dëmshëm paraqitet si dëm direkt”. Dëmi i drejtpërdrejtë si veprim i dëmshëm është shkaku, kurse dëmi i tërthortë është pasoja nga ai shkak. Marrëdhënje të tillë, në të drejtë, ka mes dëmit të zakonshëm, si dëm i shkaktuar, e cila më pas e generon fitimin e humbur, si pasojë e saj. Prej këtu siç është përmendur edhe më lartë në shembujt e fitimit të humbur si dëm i zakonshëm, vlejné edhe si shembuj për dëmin e tërthortë, prandaj nuk do të ketë nevojë për të elaboruar edhe

²⁸ Shih Nenin 255, LMD.

shëmbuj tjerë. Megjithatë fitimi i humbur gjithmonë paraqitet si dëm i tërthortë kurse dëmi i zakonshëm është gjithmonë edhe dëm direkt. Mirëpo, dëmi i zakonshëm, përveç se dëm direkt mund të jetë edhe dëm indirekt. Dëmi i zakonshëm është dëm indirekt kur është shfaqur si pasojë e dëmit të shkaktuar më parë si dëm i zakonshëm. Kështu rast të tillë kemi kur një person do ta thejë dritaren e kuzhinës të ndonjë personi tjetër (dëm direkt i zakonshëm), më të cilën mundësohet hyrja e ajrit të ftohtë në dhomë, dhe si pasojë e saj vjen deri tek ngirja e sendeve që janë ruajtur në të (dëm indirekt i zakonshëm). Kështu në këtë rast kemi të dy llojet e dëmit të zakonshëm, por ajo dallohet se njëri është dëm direkt i thjeshtë kurse tjetri është dëm i tërthortë i thjeshtë.²⁹

- Duke pasur parasysh vëllimin e tij, dëmi mund të jetë:

- Dëm pozitiv
- Interes i kontraktuar negativ dhe
- Dëm negativ

Dëmi pozitiv, interesi i kontraktuar negativ dhe dëmi negativ: Dëmi pozitiv është ai dëm i cili është shkaktuar me mospërbushje ose përbushje të tërthortë-jo të drejtë të detyrimit (në të cilin detyrim hyjnë edhe vonesa) obligativ që del nga obligimi kontraktues që është në fuqi. Ky lloj dëmi në teorinë juridike njihet si interes pozitiv kontraktues (pozitiv në atë kuptim se është i lejueshëm). Dëm negativ është ai dëm që është shkaktuar me lidhjen e kontratës që nuk është i vlefshëm. Në këtë rast njëra prej palëve-i dëmtuar ka menduar se kontrata është e plotëfuqishme, kurse pala tjetër kontraktuese – dëmtuesi e ka ditur ose ka mund ta dijë se kontrata e tillë e lidhur ka mangësi gjegjësisht nuk është e plotëfuqishme. Njëra prej këtyre palëve është e vetëdijshme kurse pala tjetër është e pavetëdijshme. Pala e cila nuk është e vetëdijshme në këto raste është pala e dëmtuar, kurse pala tjetër është pala që e ka shkaktuar dëmin gjegjësisht dëmtuesi. Ky lloj i dëmit në teorinë juridike është interes i kontraktuar negativ.³⁰

- Në bazë të mënyrës së vërtetimit dhe krijimit, dëmi mund të jetë:

- Dëm konkret dhe
- Dëm abstrakt

²⁹ G. Galev, J. D. Anastasovska, Obligaciono pravo, Shkup, 2012, fq.649.

³⁰ G. Galev, J. D. Anastasovska, Obligaciono pravo, Shkup, 2012, fq.649.

Dëmi konkret dhe abstrakt: Dëm konkret është ai dëm i cili vërtetohet në mvarshmëri prej rethanave konkrete dhe rastit të dhënë dhe kompensohet në sumën e vërtetuar. Dëm abstrakt është ai dëm tek i cili suma vërtetohet më parë, pa marrë parasysh se sa realisht kushton. Rast i tillë është për shëmbull thyerja e gotave në restorant, thyerja e dritares në tren etj. Ky lloj dëmi është më parë i caktuar me tarifë të veçantë ose me rregullore të veçantë. Këto dy lloje të dëmit, në bazë edhe nuk paraqesin dëm, por dy lloje të ndryshme të kompensimit të caktuar më parë për llojet e dëmeve të shkaktuara.³¹

2.1. Dëmi material

Dëmi material nënkupron zvogëlimin e pasurisë së dikujt (dëmi i thjeshtë) apo ndalimi i zmadhimit të saj (fitimi i humbur). Dëmi material ekziston kur dëmtohen sendet personale e ndonjë subjekti p.sh. kur dikujt i thehet dera, vetura, kur çënohet dinjiteti dhe përhapja e fakteve të pavërteta që pasqyrohen përmes faktit se i dëmtuari nuk ka mundur të punojë, ka humbur klientët, ose nuk ka mundur të punëshet.

Dëmi material shkaktohet edhe me vepër penale. Shpërblimi i dëmit material mund të realizohet para gjykatës civile, ku inicohet procedurë e veçantë. Nëse dëmi shkaktohet me vepër penale, këtë mund ta shqyrtojë gjykata penale. Ka dy mënyra me të cilat mund të realizohet dëmshpërblimi material: dëmshpërblimi në natyrë dhe dëmshpërblimi me para.

Dëmshpërblimi në natyrë nënkupton kthimin në gjendjen e mëparshme (restitutio in integrum in natura), në pasurinë e të dëmtuarit. Ky shpërblim bëhet me kthimin e sendit në atë gjendje që ka qenë para se të shkaktohet dëmi. Në rastin e dëmtimit të shëndetit, kthimi në gjendje të mëparshme bëhet me përmirësimin e shëndetit të të dëmtuarit ose aftësimin e tij për punën që e ka kryer më parë. Në disa raste shpërblimi i dëmit material në natyrë nuk mund të realizohet p.sh. kur sendi i caktuar është individualisht i përcaktuar (res in specie), ose kur sendi nuk mund të riparohet as të zëvendësohet.

Dëmshpërblimi me para nënkupton që të dëmtuarit në vend të sendit të asgjësuar të marrë një sumë të caktuar parash për të blerë sendin e llojit të njëjtë. Kjo ndodh pasi shpërblimi i dëmit në natyrë nuk është i mundshëm. Duke pasur parasysh natyrën e dëmit të shkaktuar, në disa raste shpërblimi i dëmit caktohet në formë rente. Lëndimet trupore ose dëmtimi i shëndetit,

³¹ G. Galev, J. D. Anastasovska, Obligaciono pravo, Shkup, 2012, fq.650.

shkaktojnë pasoja të shumta, të kohëpaskohshme dhe sukcesive por edhe të përhershme, që manifestohen te i dëmtuari në formë dhembjesh fizike, vuajtjesh psiqike, si humbje të aftësive të punës, zvogëlim të mundësisë për tu punësuar. Renta në të holla jepet si mjet për sigurimin e ekzistencës së të dëmtuarit.

2.2. Dëmi jomaterial

Siç përmendëm edhe më lartë dëmi jomaterial shfaqet si lëndimi të drejtave personale, me çka jepet mundësi ligjore për mbrojtjen e të drejtave personale të qytetarëve dhe personave juridik si një përfitim civil. Dëmi material ekziston atëherë kur dëmtuesi i ka shkaktuar tjetrit dhimbje fizike, vuajtje psiqike ose frikë. Ligji mbi marrëdhënjet detyrimore nismën e ka nga ajo se natyra e dëmit nuk është automatikisht e përcaktuar sipas llojit të të mirës së atakuar që të bëhet klasifikim i dëmit. Dëmi jomaterial mund të jetë i shkaktuar me lëndim të të drejtavë të personit edhe atë e drejta e lirisë, jetës, trupit, sfera intime, nderi dhe reputacioni, nderimin e personalitetit dhe të mirat tjera jopasurore të cilat personit ia garanton rendi ligjor, më zhdukjen e sendeve, dhe me lëndim të persnave të afërm. Me lëndim të këtyre të mirave mund të paraqitet edhe dëmtim pasuror, dhe prandaj ai dëm çdo herë në raste të tilla mund të jetë edhe dëm material edhe dëm jomaterial.³²

Shpërblimi i dëmit jomaterial kryhet me shpalljen e aktgjykimit ose ndryshimin d.m.th. në rast të lëndimit të të mirave personale të personit gjygi mund të urdhërojë në harxhim të dëmtuesit të shpallet aktgjykimi ose mund të urdhërojë që dëmtuesi ta tërheqë deklaratën me të cilën është shkaktuar lëndimi ose diçka tjetër më të cilën do të mund të ariheshte qëllimi me të cilin arihet kompenzimi (satisfakcioni). Megjithatë si shpërblim i dëmit jomaterial mund të gjykohet edhe shpërblim në të holla. Për dhembjet fizike të pësuarat si dhe për dhembjet shpirtërore për aftësi të zvogëluar jetësore, shëmtim, cenim të reputacionit, nderit dhe të drejtave personale, vdekje të personit të afërm, si dhe frikë, gjygi nëse e gjen se rethanat e rastit e arsyetojnë atë, e sidomos duke pasur parasysh intenzitetin e dhimbjeve dhe frigës si dhe kohëzgjatjen e tyre do të gjykojë shërbim të arsyeshëm në të holla, pa marrë parasysh shpërblimin e dëmit jomaterial, por edhe në mungëse të dëmit jomaterial. Gjatë vendosjes për kërkesën për shpërblim të dëmit jomaterial, si dhe për lartësinë e kompenzimit të saj, gjygi do të ketë llogari për

³² Nematerijalna shteta, seminarski material, Agencija AKADEMIK, Skopje, 2006, fq.9.

domethënjën e të mirës së lënduar si dhe për qëllimin për të cilin shërben ai kompenzim, por edhe për atë që kjo mos të ndikojë në aspiratat që nuk kanë lidhshmëri me natyrën e tillë.

Në rast të vdekjes së ndonjë personi, gjygi iu gjykon anëtarëve më të ngushtë të familjes së tij (bashkëshort, fëmijë, prind) kompenzim të arsyeshëm në të holla, për dhembje shpirtërore. Kompenzimi i tillë mundet t’iu gjykohet edhe vëllezërve dhe motrave nëse ata me të vdekurin kanë bashkëjetuar. Në rast të invaliditetit të rëndë të ndonjë personi, gjygi mundet që ti gjykojë bashkëshortit të tij, fëmijevë si dhe shokut që jetojnë në bashkësi jashtëmartesore kompenzim të arsyeshëm në të holla për dhembje shpirtërore.³³

Nëse për shkak të cenimit të nderit ose përçimit ose deklarimit të fakteve të pavërteta për të kaluarën e një personi, për dijeninë, për aftësitë e personit tjetër ose për diçka tjetër, me çka ai që i ka përçarë e ka ditur ose ka qenë i obliguar ta dijë se të thënat e tilla janë të pavërteta dhe me veprimet e tilla ai shkakton dëm material dikujt, dëmtuesi është i obliguar që atë dëm ta kompenzojë.

3.Shkaqet për shkaktimin e dëmit

Shkaktimi i dëmit paraqet një nga kushtet themelore për paraqitjen e marëdhënjeve obligatore.

Një nga kushtet themelore për shkaktimin e marëdhënjeve detyrimore me shkaktimin e dëmit është ekzistimi i dëmit si i tillë, si dhe është e nevojshme që të plotësohen dy kushte edhe atë: veprimi të jetë i kundërligjshëm dhe të sjellë deri te shkaktimi i dëmit. Kundërligjshmëria që kërkohet si kusht për ekzistimin e veprimit të dëmshëm në mënyrë të pandashme është i lidhur me vetë dëmin. Ato si dy kuste pa njëri tjetrin edhe nuk mund të ekzistojnë. Aty ku shfaqet dëmi, në kuptimin juridiko obligativ, e kemi edhe kundërligjshmërinë e veprimeve të dëmshme më të cilat është shkaktuar dëmi. Me fjalë të tjera nënkuptojmë se pa ekzistimin e veprimeve të kundërligjme nuk është e mundur të shkaktohet dëm dhe e kundërta, pa ekzistimin e dëmit nuk kemi edhe veprime të kundërligjshme. Arsyeja është gjithmonë veprimi të jetë i kundërligjshëm (veprimi i dëmshëm), kurse dëmi është pasoja. Në radhitjen e ekzistimit të tyre në radhë të parë vjen veprimi i kundërligjshëm, dhe më pas vjen dëmi i shkatuar nga ai veprim. Nëse e shohim në këtë mënyrë mund të konkludojmë se veprimi këtu paraqet supozim se

³³ Për më tepër shih LMD, neni 190.

dëmi është shkaktuar. Dëmi në anën tjetër është supozim për përgjegjisi, kurse përgjegjësia më tej supozim për kompensimin e dëmit të shkaktuar si pasojë e veprimit të dëmshëm.

Për paraqitjen e marëdhënjeve detyrimore ku shkaktohet dëmi duhet të ekzistojnë tre kushte të përgjithshme:

- veprimi i dëmshëm,
- dëmi si dhe
- lidhja kauzale (kauza).

Këto kushte janë kushte kumulative dhe duhet ato të ekzistojnë njëkohësisht. Përveç kushteve themelore për paraqitje të potë të marëdhënjeve detyrimore duhet të ekzistojë edhe një kusht i veçantë sipas të cilit përcaktohet lloji dhe përgjegjësia për dëmin e shkaktuar.³⁴

Veprimi i dëmshëm: I dëmshëm është ai veprim me të cilin tjetrit i shkaktohet dëm. Dëmi mund të jetë i shkaktuar me ndonjë veprim ose lëshim, ose me ndonjë send ose me kryerjen e veprimtarisë që paraqet burim reziku. Veprimi si pasojë paraqet aktivitet të caktuar si rezultat i të cilit të dëmtuarit i shkaktohet dëm i caktuar. Rast i tillë është për shembull kur me gurrë dikush e then dritaren e banesës së tjetrit ose dikujt i dëmtohet vetura. Mosveprimi ose lëshimi për dallim nga veprimi paraqet lloj të caktuar të mosveprimit të cilin dëmtuesi ka qenë i obliguar ta bëjë. Shembull për sjelljen e tillë kemi tek mospërbushja ose vonesa në përmbushje të obligimit të kontraktuar nga ana e kreditorit në marëdhënjen obligative.

Kemi edhe lloje tjera të veprimit, të cilat janë ngushtë të lidhura me shkaktuesin nga të cilat posaçërisht do të përmendim: veprimet me të cilat çënohet integriteti personal ose jeta personale dhe familjare si dhe të drejta tjera të cilat gëzon, dhe vepra me të cilat çënohet nderi i ndonjë personi ose vepra të shprehjes verbale ose shpërndarjes së fakteve të paverteta për të kaluarën, për diturinë, për aftësinë e një personi ose diçka tjetër.³⁵ Në mënyrë të caktuar dhe në rastet kur dëmi shkaktohet nga sendi ose veprimtaria të cilat janë burim reziku, dëmtuesi është në marëdhënje aktive ose pasive me ta, sa ato në bazë të posedimeve që kanë të jenë shkaku i paraqitjes së pasojës së dëmshme. Nëse nuk do të ishte ashtu, atëherë rëndë do të mund të sqarohet përgjegjësia e poseduesit të këtyre sendeve ose veprimeve për dëmin që shfaqet për tjetrin

³⁴ G. Galev, J. D. Anastasovska, Obligaciono pravo, Shkup, 2012, fq.620.

³⁵ G. Galev, J. D. Anastasovska, Obligaciono pravo, Shkup, 2012, fq.621.

– të dëmtuarin. Kështu nëse bëhet fjalë për veturën, aeroplanin si sende jashtëzakonisht të rezikshme, deri sa nuk janë në përdorim nuk janë të mjaftueshme që të sjellin deri te shkaktimi i dëmit. Që të jenë të tilla poseduesi i tyre do të duheshite që ti vendojë në qarkullim, mënyrë në të cilën ai krijon marrëdhënje ndaj tyre. Kur bëhet fjalë për sende pa energji vetanake (p.sh. gurët, thasët me çimento) të venduara në tokë qoftë në hapsirë të hapur apo të mbyllur, rëndë është të vërtetohet se në bazë të cilësisë së tyre paraqesin sende të rezikshme. Por do të ishte e kundërta nëse pronari i tyre i vëndon në lartësi të caktuar (p.sh. në skele të objektit në ndërtim). Në këtë rast i dukshëm është raporti ndërmjet sendit të rezikshëm dhe poseduesit, i cili me veprimet e veta këto sende i shëndron në sende të rezikshme, për shkak se nëse bien mund të lëndojnë ndonjë nga punëtorët ose kalimtarët e rastit, por mund t’ju shkaktojë edhe vdekje.

I njëjtë është rasti edhe me sendet që paraqesin burim të rezikut (eksplozivët e ndryshme, gasi, etj) të cilat mund të jenë në pronësi të një personi ose mbajtësit i cili i kontrollon ato. Shembujt e mësipërm janë për të ashtuquajturat sende të “vdekura”, por i ndryshëm është rasti me sendet e “gjalla” në grupin e të cilave hyjnë kafshët shtëpiake siç janë qeni, kali, kope dhensh, lopë etj. si dhe kafshët e egra mishngrënëse, por jo vetëm ata në objekte të mbyllura ose në parqet safari sic janë luani, tigri, leopardi, arusha, ujku etj. E gjithë kjo botë e kafshëve është nën komandën e njeriut. Kjo përkatësisht sillet edhe me veprimtarië e dëmshme siç janë punonjësit në gurotore, prodhimtari të hemikaljeve të ndryshme të cilat prodhojnë materije helmuese dhe gase. Këta dhe veprimtari të ngajshmë kryhen në suaza të personave juridik në të cilët kryesi direkt i punëve është njeriu. E gjithë kjo na çon në konkludim se dëmi është gjithmonë i lidhur me veprim të caktuar. Në rastin e parë kemi veprimin e njeriut, i cili paraqitet si verim ose mosveprim kurse në tjetrin, ajo del nga sendet e dëmshme ose veprimtaritë e dëmshme, pas të cilave çdo herë ka posedues gjegjësisht kryesi – njeriu.

Si veprim i dëmshëm paraqitet edhe reziku nga dëmi i cili ka burimin e vet nga i cili kanoset shkaktimi i dëmit edhe më të madh, si dhe kryerja e veprimtarisë së caktuar nga e cila del shqetësimi ose reziku i dëmit për një njeri ose për numër të caktuar njerëzish.³⁶ Te këta, edhe pse një kusht që të paraqiten si të dëmshme mungon, duke u nisur nga shkalla e rezikshmërisë dhe kanosja, e cila nga ata paraqitet për shkaktim të dëmit, ata paraqesin lloj të caktuar të veprimit të dëmshëm. Përveç se te verimet e tilla te të cilat nuk kërkohet paraqitja e dëmit, te të gjithë verimet

³⁶ Shih nenin 143 dhe 144 të LMD (kërkesa që të mënjanohet reziku nga dëmi, gjegjësisht të ndalojë me venim të drejtës personale).

tjera që të konsiderohet si të dëmshme duhet të paraqitet kundërligjshmëria dhe të sjellin deri te shkaktimi i dëmit për të dëmtuarin.

Kundërligjshmëria e veprimit: Veprim i kundërligjshëm është veprim i tillë ose delikt me të cilin lëndohet normë e caktuar imperative me të cilën ndalohet ose urdhërohet, gjegjësisht është në kundërshtim me zakonet e mira, të kuptuara si regulla morale të sjelljes në shoqëri të caktuar. Imperativat morale dhe ligjore të cilat mund të jenë nën sulm të veprimeve të dëmshme, më shpesh janë të natyrës juridiko-civile.

Parim themelor imperativ i tillë në legjislaturën e Republikës së Maqedonisë Veriore është paraparë në Ligjin mbi Marëdhënjet detyrimore ku thuhet: Çdokush është i obliguar të përmbahet nga veprimi me të cilën tjetrit mund ti shkaktohet dëm.³⁷ Gjithashtu në ligjin mbi marëdhënjet detyrimore është e paraparë se – Çdo person fizik dhe juridik, përkaj mbrojtjes së të drejtës pronësore, gëzon edhe mbrojtjen e të drejtave personale sipas ligjit. Si të drejta personale në bazë të këtij ligji konsiderohen e drejta në jetë, shëndet fizik dhe shpirtëror, nder, reputacion, dinjitet, emër personal, privatësi të jetës personale dhe familjare, liri, krijim intelektual, dhe të drejta tjera personale. Personat juridik i gëzojnë të gjitha të drejtat e lartëpërmendura, përveç atyre që janë të lidhura me thelbin biologjik të emrit fizik, posaçërisht të drejtat në emër të mirë dhe dinjitet, emër të firmës, të fshehurat zyrtare, liria e sipërmarrësve dhe të drejta tjera personale të këtyre personave.³⁸

Ne kontekst të të lartëpërmendurës Ligji mbi marëdhënjet detyrimore parasheh se – Pjesëmarësit në marëdhënjet detyrimore janë të obliguar që ta plotësojnë obligimin e tyre dhe përgjegjës për përmbushjen e tyre, ky parim është parim i përgjithshëm për pjesëmarësit në marëdhënjet detyrimore.³⁹ Kur jemi këtu nuk duhet të harojmë edhe betimet që dalin nga parimi i ndershmërisë dhe ndërgjegjshmërisë, ndalimi i keqpërdorimit të të drejtave, ndalimi i sjelljes monopolistike në treg, standardet e kërkuara të sjelljes në kryerjen e obligimeve dhe realizimin e të drejtave, të gjitha të regulluara me Ligjin mbi marëdhënjet detyrimore.⁴⁰

Përkaj shkeljeve të këtyrev imperativeve ligjore, mund të vijë edhe në shkeljen e imperativave tjerë të tillë të ligjit mbi marëdhënjet detyrimore, edhe atë të dispozitave të posaçme

³⁷ LMD, neni 9.

³⁸ LMD, neni 9-a.

³⁹ LMD, neni 10, alinea 1.

⁴⁰ Shih nenin 5, 6, 7 dhe 11 të LMD.

si dhe të dispozitave të veaçta nga sfera e mallrave dhe shërbimeve, por edhe më gjërë. Në të gjitha këto raste, veprimi me të cilin ka ardhur deri tek shkelja e këtyre dispozitave paraqet veprim të kundërligjshëm.

Veprimi i kundërligjshëm kuptuar si veprim kundër normës juridike imperative, edhe pse më shpesh haset në të drejtën civile, edhe pse jo në shkallë të njëjtë haset edhe në fushat tjera të së drejtës objektive. Kjo është kështu sepse veprimet e dëmtuesit mund të jenë edhe shkelje të dispozitave penalo-juridike, administrative-juridike, të drejtën në punë, të drejtat finansiare, të drejtat ekonomike, kundërvajtjet etj. Prandaj, varësisht nga natyra dhe lloji i dëmtimit, të ndryshme do të jenë edhe pasojat juridike të lëndimit. Ato në një rast do të paraqiten si vepra penale, në rast tjetër si lloj tjetër i cënimit, në të tretin si kundërvajtje etj. Paralelisht me këtë do të vijë edhe në lloje të caktuara të përgjegjsive: përgjegjsi penale, përgjegjsi ekonomike dhe lloj tjetër i shkeljes, përgjegjsi për kundërvajtje etj, duke mos e përfshirë edhe përgjegjësinë për dëmin e shkaktuar nga veprimet e njëjta, me të cilat është shkaktuar vepër e caktuar penale, ekonomike, kundërvajtje ose shkelje tjetër e së drejtës. Mirëpo nuk don të thotë se çdo veprim më të cilin është shkaktuar vepër penale bart në vete edhe përgjegjësinë juridiko-civile. Kështu për shembull përpjekja për të kryer vrasje e cila nuk ka çuar deri te pasoja përfundimtare: vrasja në të drejtën penale paraqet vepër penale, kurse në të drejtën obligatore nuk paraqet veprim të dëmshëm.⁴¹

Raporti i kundërligjshërisë me fajin: Në teori ka një pikëpamje sipas së cilës i kundërligjshëm llogaritet vetëm ai veprim i cili mund të shkruhet si faj i kryesit. Kjo pikëpamje qëndron në perceptimin se përgjegjësia juridiko civile çdo herë duhet të bazohet në fajin e kryesit. Në raste të tilla vjen edhe përfundimi se nëse ka faj në anën e kryesit të veprës së dëmshme ka edhe përgjegjsi për atë, dhe kjo më tej domethënë se ka kundërligjshmëri në veprimet e tij. Përkundër kësaj: mosekzistimi i fajit domethënë edhe mosekzistim i përgjegjesisë, dhe nga këtu edhe mosekzistim i veprimit të kundërligjshëm. Duke e parë në këtë mënyrë kundërligjshmëria tregon anën e kundërligjshmërisë së veprimit ë dëmshëm. Kjo mund të pranohet nëse në fajin shihet si bazë e vet, e cila çon në përgjegjësinë për dëmin e shkaktuar, e njohur si përgjegjsi subjektive. Përvëç përgjegjesisë subjektive kemi edhe lloj tjetër të përgjegjesisë edhe atë: përgjegjësinë objektive e cila ka për bazë shkaktimin e dëmit në send, gjegjësisht nga veprimtari të

⁴¹ G. Galev, J. D. Anastasovska, Obligaciono pravo, Shkup, 2012, fq.624.

cilat paraqesin burim të rezikut të dëmit si dhe përgjegjsi në bazë të drejtshmërisë (te të cilat faji nuk ka asnjë rëndësi), atëherë rëndë mund të pranohet, e lartëpërmendura për karakterin subjektiv të kundërligjshmërisë të veprimeve të dëmshme. Në gjendje të tillë, mund të përfundojmë se kundërligjshmëria përsosmërisht e parë është më e përhapur se sa që është rasti më i dëmit, marrë si bazë për paraqitjen e përgjegjshmërisë subjektive për dëmin e shkaktuar. Duke e analizuar kundërligjshmërinë e veprimit të dëmshëm mund të përfundojmë se nga natyra e saj paraqet kategori objektive.⁴²

Duke e kuptuar karakterin subjektiv të veprimit të dëmshëm, në atë kuptim se ekziston çdo herë kur në atë veprim është shkelur ndonjë normë imperative ligjore, e pritshme është se kur do të vijë deri të shkelja e dispozitave ligjore kryesi i asaj vepre të përgjigjet për dëmin e shkaktuar të dëmtuarit. Parashtrihet pyetja: a është çdo herë kështu në këtë rast? Përgjigja është Jo. Ekzistojnë veprime të caktuara, të cilat edhe pse janë rreptësisht ligjore, paraqesin veprime të kundërligjshme, por duke e pasur parasysh mënyrën se si janë kryer dhe rethanat në të cilat është kryer, kundërligjshmëria të këto është përjashtuar.

Përjashtimi i kundërligjshmërisë nga veprimi i dëmshëm: Në rendin e veprimeve në të cilat përjashtohet kundërligjshmëria, në teorinë juridikë dhe të drejtën objektive janë veprimet në vijim:

- Pëlqimi i të dëmtuarit të shkaktohet dëmi nga personi i tretë,
- Mbrojtja e nevojshme,
- Kryerja e të drejtës së vetë,
- Vetëndihma e lejuar,
- Veprimi sipas detyrës zyrtare, dhe
- Nevoja përfundimtare.

Pëlqimi i të dëmtuarit: Duke nisur nga parimi i disponimit të lirë, çdo pjesëmarës në të drejtën civile, përkaj mundësive tjera juridike të cilat ia jep ky parim, mundet me pëlqimin e vet të pranojë nën kushte të caktuara që të shkaktohet dëm nga ana e dikujt tjetër (dëmtuesit). Duke e pranuar këtë, njëkohësisht e pranon edhe rezikun e dëmit në barë të veten, për të cilën përderisa nuk do të kishte pëlqim, nga ana e tij do të kërkonte që dëmi të kompenzohet

⁴² G. Galev, J. D. Anastasovska, Obligaciono pravo, Shkup, 2012, fq.623-624.

nga dëmtuesi. Pëlqimi i dëmtuesit në këto raste çon deri tek marja e kundërligjshmërisë për veprimin e dëmshëm të dëmtuesit- *volenti non fit iniuria*.⁴³

Bazë ligjore e tillë parashihet edhe në Ligjin mbi marrëdhënjet detyromore ku thuhet - Ai i cili në dëm të vetin do ti lejojë tjetrit që të marrë ndonjë veprim, nuk do të mund të kërkojë nga ai kompensim për dëmin e shkaktuar më atë veprim. E pavlefshme është deklarata me të cilën i dëmtuari është pajtuar që dëmi ti shkaktohet me vepër e cila është e ndaluar me ligj.⁴⁴

Këtu hyjnë edhe ndalesat kushtetuese si dhe zakonet e mira të kuptuara si regulla morale të sjelljes, të cilat së bashku me dispozitat ligjore paraqesin kufij të përgjithshëm nga të cilat subjektët në marrëdhënjet detyromore i rregullojnë raportet e tyre.⁴⁵

Është e rëndësishme të përmendet se gjatë dhënjes së pajtimit dhënësi duhet të ketë qenë i vetëdijshëm për rezikun, gjegjësisht për dëmin që mund të shkaktohet me veprimet e caktuara në lidhje me atë (si personalitet) ose në pasurinë e tij. Si moment i dhënjes së pëlqimit llogaritet momenti në të cilin dhënësi i pëlqimit dhe realisht është ekspozuar me pasojat (rezikun) e veprimit të dëmshëm. I tillë do të ishte rasti nëse dhënësi i pëlqimit i lejon mjeshtrit i cili ka përvojë ose i cili nuk ka dijeni profesionale që tia rregullojë veturën e cila është ndaluar përdërisa ka qenë në lëvizje. Rast tjetër do të ishte kur dikush pranon të vozitet nga një vend në vend tjetër me person i cili nuk e ka lejen e vozitjes, por mbi të gjitha e vozitën veturën në gjendje të dehur. Veçanërisht karakteristike është pëlqimi që e japin sportistët gjatë lojrave edhe atë qoftë futbollistët, hendbollistët apo basketkollistët. Ato me vetë faktin se pranojnë të luajnë gjegjësisht të meren me sport të caktuar llogaritet se e pranojnë se mund edhe të lëndohen gjatë boksit, skijimit, lojrave reli etj. Rast i njëjtë është edhe me pajtimin që personi i caktuar do ta japë që mjeku i caktuar t'ia bëjë intervenimin kirurgjik. Në të gjitha këto raste pëlqimi i dhënë nuk e përjashton kundërligjshmërinë e veprimit të caktuar të organizuesit të lojrave, të garave reli, të mjekut etj. Kjo domethënë se ai në raste të caktuara mund të meret në përgjegjësi. I tillë është rasti kur kryesi i veprimit e ka humbur vëmendjen të cilën e kërkojnë rregullat e lojës gjegjësisht profesionit (vëmendje e personit të kualifikuar-vëmendje profesionisti). Në raste tjera lëshimi mund të silllet në vëmendjen që i kërkohet posaçërisht personit të rregullt dhe përgjegjës (vëmendje e shtëpiakut të mirë, gjegjësisht poseduesit të mirë). Kur jemi te dhënja e pëlqimit që të meret

⁴³ G. Galev, J. D. Anastasovska, Obligaciono pravo, Shkup, 2012, fq.625.

⁴⁴ LMD, Neni 150.

⁴⁵ Shih nenin 3 të LMD.

intervenim mjeksor, ekziston fikcion i pëlqimit të dhënë nga pacienti, nëse ai është në gjendje të pavetëdijshme (në rast të aksidentit të rëndë automobilistik ose nëse ka marrë plagë nga armë zjari etj), dhe njëherit i kanoset rezik për vdekje. Në rast të tillë në bazë të fikcionit të lartëpërmendur, ekziston detyrë profesionale e mjekut që të ndërmeret intervenim mjeksor, edhe po të mos ekzistojë garancion i mjaftueshëm se fundi do të jetë i suksesshëm. E vetmja gjë që kërkohet këtu është që të aplikohet dija profesionale dhe veprimi sipas regullave të profesionit (vëmendje e personit profesionist).⁴⁶

Mbrojtja e nevojshme si institut juridik në bazë është i natyrës penalo-juridike, duke u nisur nga ajo se mbrojtje e tillë çdo herë paraqitet si pasojë e veprimit inkriminues nga ana e një shkaktuesi të veprës penale. Në të drejtën penale më mbrojtje të nevojshme nënkupohet akt i nevojshëm që duhet të ndërmeret në moment të caktuar që të ndërpritet veprimi i kundërligjshëm i kryesit tjetër. Në pikëpamje juridike, ai i cili e ndërmer sulmin, kryen paligjshmëri të caktuar, kurse ai i cili me kundërveprim e refuzon sulmin, kryen të drejtë të caktuar. Nga këtu mund të themi se kur ekziston mbrojtja e nevojshme kemi ballafaqim të paligjshmërisë me ligjshmërinë. Duke pasur parasysh se duke e ndërmarë kundëratakun, me qëllim që të ndërpritet ataku (kjo don të thotë edhe të nalohe kryerja e veprës penale) shumë shpesh vjen dëri tek shkaktimi i dëmit për atakuesin, kështu që parashtrohet pyetja e përgjegjesisë së kundëratakuesit për atë dëm. Në të drejtën bashkëkohore, ekziston regulli i përgjithshëm sipas të cilit për shkak të ballafaqimit të kundërligjshmërisë me ligjshmërinë, për dëmin e shkaktuar në mbrojtje të domosdoshme nuk përgjigjet. Kështu në Ligjin mbi marëdhënjet detyrimore është paraparë - Ai i cili gjatë mbrojtjes së domosdoshme i ka shkaktuar dëm tjetrit nuk është i obliguar që ta kompenzojë dëmin e shkaktuar, përveç se në rastet kur e ka tejkaluar mbrojtjen e nevojshme.⁴⁷ Vendimi i tillë në bazë paraqet lloj të veçantë të vetëmbrojtjes, dhe shikuar në aspekt juridik, është bazë juridike e cila në veprimin e marrë gjatë mbrojtjes së nevojshme, për mbrojtje të së drejtës së vet ose të tjetrit, ia mer kundërligjshmërinë. Për shkak të kësaj edhe ndërmarësi i këtyre veprimeve nuk është i obliguar të kompenzojë dëmin. Në çdo rast dhe në çfarë do lloj kushtesh vjen dëri tek përjashtimi i kundërligjshmërisë së veprimit të marrë gjatë mbrojtjes së nevojshme dhe prej këtu edhe deri tek lirimi i dëmit të shkaktuar në rethana të tilla. Që të vije deri te ajo është e nevojshme që të plotësohen tre kushte: Kushti i parë është që ataku që e ka shkaktuar kundëratakun nga natyra e tij

⁴⁶ Shif nenin 11 të LMD.

⁴⁷ LMD, Neni 148, alinea 1.

të jetë i kundërligjshëm. Nëse rasti nuk është i tillë, atëherë kundërataku i marë ngel si akt i kundërligjshëm, dhe kur plotësohen kushtet tjera atëherë për atë përgjigjet. Kushti i dytë është që ataku dhe kundërataku i shkaktuar nga ai të paraqiten njëkohësisht, që domethënë se nuk egziston mbrojtja e nevojshme, nëse kemi dallim kohor përmes atakut i cili vjen nga kryesi i cili kryen veprim të caktuar të dëmshëm dhe kundërataku të cilin e mer personi i caktuar që të mbrojë të drejtën e vet nga pasoja e dëmshme. Kusht i tretë është të ekzistojë qëndrueshmëri mes atakut dhe kundëratakut. Në këtë rast mendohet për mjet të caktuar me të cilin kryhet ataku dhe refuzohet kundërataku (përdorimi nga ana e të dy palëve lloj të njëjtë të armëve të ftohta) fuqia e atakut dhe kundëratakut (rahja me shuplaka nga të dy palët, ose lloj tjetër ataku).

Kryerja e të drejtës së vet: Kur bëhet fjalë për këtë pyetje, që në fillim duhet të thuhet se duhet ta kemi parasysh mënyrën e kryerjes së të drejtës subjektive e cila realizohet në kufijtë e veta. Prandaj, kur bartësi e mer kryerjen e të drejtës së vet ai atë e bën për shkak të kryerjes së qëllimeve të veta të cilat i janë të pranuar me ligj. Përderisa bartësi i të drejtave në kryerjen e të drejtës së tij në kufijtë e qëllimeve të veta nuk përgjigjet për pasojat e dëmshme që do të dalin nga ky lloj i kryerjes së asaj të drejte, për shkak të asaj se veprimi i tillë nuk ka karakteristikë të veprimit kundërligjor. Veprim i tillë do të ishte p.sh. kryerja e veprimtarisë së caktuar e cila shkakton nivel të tolerueshëm të pasojave ekologjike (ndotje të tokës me hemikalje të caktuara) ose lëshim të gazrave shkarkuese në atmosferë nga veturat në qarkullim të komunikacionit, gjegjësisht lëshimin e tymit nga oxhaqet e fabrikave në procedurën e punës së fabrikës etj. Nëse me këta ose veprime të ngjashme ose në raste në ndryshme, ajo nuk do të ishte e lejuar, atëherë rëndë është e pritshme se është e mundur realizimi i qëllimeve nga të drejtat e themeluara dhe të pranuar të tyre. Ajo thjesht do të ishte në kundërshtim jo vetëm për interesat e bartësve të të drejtave subjektive. Pamvarësisht se dikush mund të pësojë edhe dëm të caktuar, për të cilën ekziston si arsyetim individual edhe arsyetim i përgjithshëm që të mos ti kompenzohet dëmi. Ose thënë thjeshtë ekziston interes individual dhe i përgjithshëm që veprimi i këtillë i kryesit të së drejtës subjektive ti jetë marur papranueshmëria, dhe me të të jetë i liruar nga përgjegjsia për dëmin që del nga ajo. Në konotacion me këta kemi edhe dispoazitat ligjore të nenit 6 të Ligjit mbi marrëdhënjet detyrimore ku thuhet: E ndaluar është kryerja e të drejtës nga

marëdhënjet obligative që është në kundërshtim me qëllimin i cili me ligj është i rregulluar dhe pranuar.⁴⁸

Vetëndihma e lejuar: Përveç kryerjes së të drejtës së vet, ekziston edhe një lloj e drejte për të cilën mund të thuhet se, në mënyrë të caktuar, paraqet njëjt kryerje të së drejtës së vet. Në këtë rast bëhet fjalë për kategorinë e njohur si vetëndihma e lejuar. Këtu punohet për marrjen e veprimit të caktuar nga ana e bartësit të së drejtës së caktuar me qëllim që ta hjek cënimin e të drejtës së vet, kur direkt, nga jashtë i kanoset rezik. Vetëndihmën e lejuar e ka paraparë edhe ligjdhënsi në dispozitat ligjore të ligjit mbi marrëdhënjet detyrimore të Republikës së Maqedonisë Veriore ku thuhet: (1) Ai i cili në rast të vetëndihmës së lejuar, do të shkaktojë dëm atij i cili e ka paraqitur nevojën për vetëndihmë, nuk është i obliguar që ta kompenzojë. (2) Me nocionin vetëndihmë e lejuar nënkuptojmë të drejtën e çdo personi që ta hjek cënimin e të drejtës kur drejtpërdrejt i kanoset rezik, nëse mbrojtja e tillë është e domosdoshme si dhe mënyra e hjekjes së cënimit të së drejtës i'u përgjigjet shanseve nga të cilat paraqitet reziku.⁴⁹

Nga citimi i nenit të lartpërmendur mund të konkludojmë se edhe te vetëndihma e lejuar ashtu si edhe te mbrojtja e nevojshme kemi ballafaqim të drejtshmërie me padrejtshmërinë. E drejta është në anën e kryerjes së vetëndihmës së lejuar kurse e padrejta është nga ana e personit i cili e ka shkakuar nevojën që të paraqitet vetëndihma e lejuar. Prandaj që të kemi gjendje kur kërkohet që të ndërmeret vetëndihma e lejuar (e kuptuar si e drejtë) është e nevojshme të plotësohen tre kushte:

- 1) Kushti i parë është që ajo të jetë e ndërmarë me qëllim që të hiqet lëndimi i të drejtës i kryesit të saj, kur asaj të drejte i cënohet rezik i caktuar (deri te shkaktimi i dëmit)
- 2) Kushti i dytë është që mënyra e tillë e mbrojtjes të jetë e domosdoshme në kushte të caktuara; dhe
- 3) Kushti i tretë i cili kërkohet është mënyra me të cilën kryhet mënjanimi i cënimit të së drejtës t'u përgjigjet rethanave në të cilat është paraqitur reziku.

⁴⁸ G. Galev, J. D. Anastasovska, Obligaciono pravo, Shkup, 2012, fq.628-629.

⁴⁹ LMD, neni 149.

Nëse gjatë vetëndihmës njëri nga këta kushte mungon, atëherë humbet cilësia e të drejtës së lejuar dhe nga këtu paraqitet obligimi që kryesi i vetëndihmës së tillë t'ia kompenzojë dëmin tjetrit që do ta pësojë nga ajo. E kundërta nëse të gjitha kushtet e lartpërmendura janë të plotësuara kur bëhet fjalë për lejueshmërinë e të drejtës, nëse ai që i shkakton dëm personit që e ka paraqitur nevojën e vetëndihmës, nuk është i obliguar t'ia kompenzojë dëmin.⁵⁰ Rast tipik të tillë paraqet rasti kur dikush pa bazë valide e then bravën e banesës së personit të caktuar (pronarit të banesës) dhe fillon të shpërngulet aty. Në rast të tillë, çdo procedurë legale për kthimin e posedimit të qetë dhe të papenguar të banesës nga ana e pronarit të saj, duke pasur parasysh kohëzgjatjen e saj, do të nënkuptonte mbrojtje të vonueshme të posedimit dhe njëkohësisht për atë do të paraqiteshin edhe harxhime të paplanifikuara nga pagesa e qirasë për banesën të cilën përkohësisht e ka marrë në shfrytëzim. Kushti i tretë në rastin tonë do të paraqiteshte nëse pronari në ndërmarrjen e vetëndihmës mer masa që posedimin ta kthejë në atë mënyrë si i është marrë, gjegjësisht ta ndrojë mbylljen e derës me mbyllje të re që e ka ble vet sikur edhe ta prishe mbylljen dhe sendet që janë sjellur nga ana e shpërngulësit jolegal në banesë ti nxjerë jashtë.⁵¹ Rast tjetër të vetëndihmës së lejuar do të përmednim kur shfaqet vetëndihma e lejuar nëse mes dy vetura në kundërvajtje të caktuar vjen deri në ndeshje të mjeteve motorike. Gjatë kësaj, i padyshimtë është fakti se kundërvajtja ka ndodhur për shkak të mospërmbajtjes së rregullave të komunikacionit për vozitje nga ana e njërit nga pjesëmarrësit në komunikacion. Ai ka vozitur pa leje për vozitje por edhe i dehur. Ai, i vetëdijshëm për atë ka tentuar ta lëshojë vendin e ngjarjes në mënyrë që e ka vënduar veturën në lëvizje dhe ka vazhduar të shkojë. Shoferi tjetër me qëllim që të sigurojë mbrojtje më të sigurtë të së drejtës për dëmshpërblim mer veprim me të cilin e ndalon atë. Atë e bën në atë mënyrë që ia lëshon njëren gomë veturës dhe e paaftëson për lëvizje. Qëllimi i dy personave këtu është i qartë: i pari në mënyrën e përshkruar më lartë, don ti ikë përgjegjësisë për dëmshpërblim, dhe i dyti në mbrojtje të tij mer veprime të caktuara dhe e ndalon atë.⁵²

Veprimi sipas detyrës zyrtare: Ky lloj veprimi, përfshin kryerjen e detyrës zyrtare. Në rastin konkret bëhet fjalë për kompetenca të ndërmara në korniza të të drejtave të përcaktuara për kryerjen e detyrës zyrtare. Nga këtu, pa marrë parasysh që mund të paraqiten

⁵⁰ G. Galev, J. D. Anastasovska, Obligaciono pravo, Shkup, 2012, fq.630.

⁵¹ Në lidhje me këtë flasin edhe dispozitat ligjore të Ligjit për strehim.

⁵² G. Galev, J. D. Anastasovska, Obligaciono pravo, Shkup, 2012, fq.631.

pasoja të padëshiruara nga veprimet e mara gjatë kryerjes së obligimeve në shërbim, ai i cili i ka marë këto veprime, gjeëgësisht subjekti më urdhër të të cilit janë marë veprimet në fjalë, nuk përgjigjet për këta pasoja. Ligjërisht, kompetencat për kryerjen e veprimtarisë publike, për çka këtu bëhet fjalë, është rethanë e cila në këtë rast i'a mer kundërligjshmërinë veprimit të ndërmarë nga kryesi i vet. Prandaj është e qartë dhe e kuptueshme se pse kryesi nuk përgjigjet për dëmin e shkaktuar me veprimet e tij. Megjithatë, këtu duhet të theksohet se është fakt shumë i rëndësishëm vlerësimi se veprimi i marë gjatë kryerjes së detyrës zyrtare a ka qenë i përshtatshëm me rethanat e dhëna në të cilat është marë ose rasti nuk është i tillë. Ai fakt është shumë i rëndësishëm për arsye se vetëm nga ajo rethanë mvaret se a do ti hiqet kundërligjshmëria veprimit apo jo. Nëse vlerësimi nuk çon nga ajo se personi kompetent i ka tejkaluar kompetencat e veta gjatë veprimit në rast të caktuar, atëherë në pjesën e tejkallimit të kompetencave ngel kundërligjshmëria, dhe nga këtu edhe obligimi i personit përgjegjës për ta kompenzuar dëmin e shkaktuar. Duhet potencuar se bëhet fjalë për pyetje faktike e cila nga rasti në rast vërtetohet (rast të tillë kemi kur organet e mbrojtjes publike kryejnë obligimin e vet p.sh.policet, zjarfikësit etj.).

Nevoja përfundimtare: Në jetën reale kemi raste kur domosdoshmërisht shfaqet nevoja që dikush të sakrifikojë të drejtën e tjetrit, me qëllim që të mbrojë ndonjë të drejtë të veten ose ndonjë të drejtë që i takon dikujt tjetër. Nevoja përfundimtare si edhe mbrojtja e nevojshme ligjërisht janë të vërtetuara në të drejtën penale. E drejta civile, duke u nisur nga ajo se si është nocioni i ndarë në të drejtën, vetëm i regullon pasojat juridike gjatë kryerjes së tyre. Duke u nisur nga e drejta penale nevoja përfundimtare paraqitet kur vepra e kryer për kryesin të hjek nga vetja ose nga tjetër rezik të pafshehur të njëkohshëm, e cila në mënyrë tjetër do të mund të hiqeshte dhe gjatë heqjes e keqja e bërë mos të jetë më e madhe se nga e keqja e cila ka pasur rezik të ndodh. Që të ekzistojë nevoja përfundimtare duhet të plotësohen tre kushte:

- Ekzistim i njëkohshëm i rezikut nga dëmi dhe marjes së veprimeve që ai rezik të mënjanohet
- Ai rezik të mos mund të mënjanohet në mënyrë tjetër
- Dëmi i shkaktuar më atë veprim të mos jetë më i madh se dëmi që do të paraqiteshte si pasojë e rezikut të dëmshëm

Ekzistimi i njëkohshëm i rezikut nga dëmi dhe marja e masave që ai rezik të mënjanohet është i domosdoshëm për shkak të asaj se pa atë edhe nuk është i mundur ekzistimi i

nevojës përfundimtare. Gjegjësisht, nëse rezi­ku nga dëmi nuk ndalohet në të njëjtin moment kur shfaqet edhe nuk do të jetë e mundur që ti iket dëmit si dhe pasojës së dëmshme.

Sic përmendëm edhe më lartë një nga kushtet themelore për shkaktimin e marëdhënjëve obligative me shkaktim të dëmit, gjegjësisht për ekzistimin e dëmit si të tillë duhet të plotësohen dy kushte edhe atë: kushti i parë është që ajo të jetë e kundërligjshme dhe kushti i dytë është që të sjell deri te shkaktimi i dëmit.

Rezi­ku nga dëmi që të jetë i tillë që përveç marjes së masave të njëkohshme, në mënyrë tjetër nuk do të mund të hiqeshte dëmi. Kjo është gjendje në të cilën vetëm ajo që ka qenë e mundur të bëhet që të pengohet shkaktimi i dëmit të caktuar, qoftë të meret veprim i përshtatshëm i rezi­kut nga dëmi.

Dëmi i shkaktuar nga veprimi i caktuar të mos jetë më i madh nga dëmi që do të shkaktoheshte si pasojë e rezi­kut të caktuar nga dëmi, të thuhet ashtu, është kusht i kuptueshëm. Do të ishte e pakuptimtë, pa asnjë arsytim, po edhe jomoralisht ose pa paragjykim, ti lejohet dikujt të dëmtojë të drejtën e dikujt më të madhe për mbrojtje të së drejtës së vet më të vogël.

Kreu II

SHPËRBLIMI I DËMIT

1. KUPTIMI

Shpërblimi i dëmit paraqet mënjanimin e pasojave të dëmshme që i dëmtuari i ka pësuar nga shkaktimi i dëmit. Si rezultat i paraqitjes së marrëdhënjëve obligatore me pasojë shkaktimin e dëmit, kuptohet, duke i plotësuar kushtet e përgjithshme si dhe kushtin e veçantë, për të dëmtuarit paraqitet e drejta që të kërkojë që dëmi i pësuar ti kompenzohet, kurse për dëmtuesin obligimi që dëmin që e ka shkaktuar ta kompenzojë. Obligimi që të kompenzohet dëmi i shkaktuar paraqitet në përputhshmëri me rregullat e të drejtës objektive dhe në princip nuk mvaret nga vullneti i personit përgjegjës, por as nga vullneti i personit të dëmtuar. Me përjashtim, dëmtuesi dhe i dëmtuari mund të meren vesh se për dëmtuesin nuk do të ketë obligim që dëmin e shkaktuar ta kompenzojë ose ai obligim nuk do të kryhet (p.sh. falja e borxhit).⁵³

Parashtrohet pyetja se në cilin moment paraqitet obligimi i shpërblimit të dëmit. Në shkencën juridike ekzistojnë mendime të ndryshme për këtë pyetje. Sipas njërit mendim, ajo paraqitet në momentin e shkakimit të dëmit. Sipas teorisë tjetër obligimi për shpërblimin e dëmit paraqitet në kohën kur sillet vendimi i plotëfuqishëm gjyqësor në procedurën civile për dëmshpërblim. Teoria jonë, si edhe legjislatura, e pranojnë mendimin e parë. Kështu sipas Ligjit mbi marrëdhënjet detyrimore - Obligimi për shpërblim të dëmit llogaritet se ka aritur që në momentin kur është shkaktuar dëmi.⁵⁴ Kjo pikëpamje arsyetohet me faktin se që nga momenti i shkakimit të dëmit deri në momentin kur sillet vendimi i plotëfuqishëm gjyqësor mund të paraqiten rethana si rezultat i të cilave edhe dëmtuesi përgjegjës nuk do të përgjigjet. (p.sh. nëse i dëmtuari vdes, për shkak të trashëgimisë së kërkesës as ai as familja e tij nuk do të fitojnë dëmshpërblim).

Roli i gjyqit përbëhet në atë që ta konstatojë ekzistimin e përgjegjësisë dhe përcaktimin e lartësisë së dëmshpërblimit. Por ky rol i gjyqit nuk është çdoherë i domosdoshëm. Personat e interesuar d.m.th i dëmtuari dhe dëmtuesi mundën vetë ta kontraktjnë lartësinë e dëmshpërblimit dhe kjo në praktikë është rast i rallë, kuptohet nëse ekzistimi i kësaj përgjegjësie

⁵³ G.Galev, J. D. Anastasovska – Obligaciono parvo, Shkup, 2012, (fq.744)

⁵⁴ LMD, Neni 175.

nuk është i kontestueshëm, ose nuk del diçka tjetër nga ligji. Kur lartësinë e dëmshpërblimit e përcakton gjygyji, këtë ai e bën në bazë të dispozitave të ligjit mbi marrëdhënjet detyrimore, por nuk përjashtohet mundësia që të vendoset edhe sipas ligjeve të veçanta, nëse për raste të caktuara përmban dispozita të ndryshme. Regullat se si gjygyji në rast të caktuar do të veprojë, mvaret nga lloji i dëmit që duhet të kompenzohet.

2. SHPËRBLIMI I DËMIT MATERIAL

Shpërblimi i dëmit material paraqet mënjanimin e pasojave të dëmshme të shkaktuara nga veprimi i dëmshëm i dëmtuesit në pasurinë e të dëmtuarit. Prandaj, mvarësisht nga lloji i shpërblimit të dëmit kthehet deri te ajo gjendje natyrale ose gjendje materiale e cila ka qenë para se të shkaktohet dëmi.

Shpërblimi i dëmit material në themel ka funksionin riparues, pasi që çon drejt mënjanimin të pasojave të dëmshme të paraqitura nga veprimi i dëmshëm. Por, në masë ta caktuar ka edhe funksion preventiv, pasi që “kanosja” se dëmi do të shpërblehet në mënyrë të caktuar ka ndikim ndaj personave si dëmtues potencial që të përmbahen nga veprime me të cilat personave të tjerë do t’ju shkaktojnë dëm.

Si regull kompenzimin e dëmit e kryen dëmtuesi si person përgjegjës. Në raste të caktuara kompenzimi i dëmshpërblimit mund ti përçohet tjetërkujt. Kështu në bazë të kontratës për sigurim, në vend të dëmtuesit dëmin është i obliguar ta kopenzojë siguruesi. Në këtë mënyrë, nëse mund të thuhet ashtu vjen deri te socijalizimi i rezikut: përgjegjësia në rast të realizimit të rastit të siguruar përçohet nga dëmtuesi i vërtetë në kompaninë e sigurimit si sigurues, i cili as nuk e ka shkaktuar dëmin me veprimet e veta, e as nuk është fajor për dëmin e shkaktuar. Megjithatë në raste të caktuara dëmshpërblimin që siguruesi ia paguan të dëmtuarit mundet në procedurë për regres ta kompenzojë nga i siguruari si dëmtues i vërtetë.⁵⁵

⁵⁵ Për më tepër shih dispozitat e kontratës për sigurim të rregulluara në Ligjin mbi marrëdhënjet detyrimore.

2.1. Mënyrat e realizimit të shpërblimit të dëmit material

Dëmi material kompenzohet materijalisht me çka mund të kryhet në dy mënyra, edhe atë:

- Duke kthyer pronën në gjendje në të cilën ka qenë para së dëmi të shkaktohet (i njohur si restitucion natyral)
- Duke kthyer pasurinë në atë gjendje të vlefshme në të cilën ka qenë para se dëmi të shkaktohet (i njohur si restitucion në të holla).

Kthimi në gjendjen e mëparshme është në mënyrë të caktuar regull i cili është i paraparë edhe në Ligjin për marrëdhënjet detyimore të Republikës së Maqedonisë Veriore. Kështu në dispozitën e paraparë të këtij ligji thuhet: Personi i përgjegjshëm është i obliguar ta kthejë gjendjen në atë mënyrë që ka qenë para se të shkaktohet dëmi. Përderisa kthimi në gjendjen e mëparshme nuk e eliminon dëmin pjesërisht, personi i përgjegjshëm është i obliguar që pjesën tjetër të dëmit ta kompenzojë në të holla. Kur kthimi në gjendjen e mëparshme nuk është i mundur, ose gjygi llogarit se nuk është i domosdoshëm atë ta bëjë personi i përgjegjshëm, gjygi do të caktojë që ti paguhet të dëmtuarit sumë e caktuar të hollash në emër të kompensimit të dëmit. Gjygi do të gjykojë të dëmtuarit kompenzim në të holla kur ai e kërkon atë, vetëm nëse rethanat në rastin e caktuar e arsyetojnë kthimin në gjendjen e mëparshme.⁵⁶

Duke u nisur nga alinea 2 e nenit të lartëpërmendur do të sqarojmë se ajo është kështu pasi që ajo shkon deri në atë pikëpamje sa dëmshpërblimi natyral çon deri te kthimi i plotë në gjendjen e mëparshme në sferën pronësore të të dëmtuarit e cila ka qenë para se të shkaktohet dëmi, e cila është qëllim i vetë shpërblimit të dëmit.

Kështu sipas alines 3 dhe 4 deri te zëvendësimi i restitucionit natyral me restitucion në të holla mund të vijë:

- a) Kur nuk është i mundshëm restitucioni natyral
- b) Kur gjygi do ta përcaktojë se restitucioni natyral nuk është i domosdoshëm, dhe
- c) Kur atë e kërkon i dëmtuari, vetëm në rastet kur rethanat e rastit të caktuar e arsyetojnë kthimin në gjendjen e mëparshme.

⁵⁶ LMD, Neni 174.

Kthimi në gjendjen e mëparshme (kthimi natyror): Kthimi në gjendjen e mëparshme siç përmendëm edhe më lartë, paraqet kthimin e pasursë së të dëmtuarit në atë gjendje në të cilën ka qenë para se dëmi ti shkaktohet (restitucion-kthim natyral). I tillë është rasti p.sh. me shkatërimin e gardhit të oborit të të dëmtuarit, me që e njëjta mundet dhe duhet të rregullohet. Rregullimin mund ta bëjë dëmtuesi vetë ose mund ta bëjë tjetërkush në emër të dëmtuesit por në llogati të tij (p.sh.personi tjetër mund të jetë mjeshtri me të cilin dëmtuesi është marë vesh dhe të cilin e ka paguar).

Me kthim natyral mund të dëmshpërblehet vetëm dëmi i thjeshtë por jo edhe fitimi i humbur. Kur dëmi është shkatuar me prishjen ose shkatërimin e sendit, i cili është sipas llojit i pëcaktuar, kthimi në gjendjen e mëparshme mund të bëhet me rregullimin e sendit ose me dhënjen e sendit tjetër të llojit të njëjtë dhe sasisë së njëjtë (nëse të dëmtuarit i prishet kompjuteri, duhet nga ana e dëmtuesit ose ti rregullohet ose ti jepet tjetër me performansa të njëjta dhe lloj të njëjtë). Dispozita e nenit 174 e Ligjit mbi marrëdhënjet detyimore për shpërblimin e dëmit me kthim në gjendje e mëparshme paraqet plotësim të normës dispositive juridike. Prandaj, ai dispozicion do të aplikohet nëse i dëmtuari dhe dëmtuesi nuk janë marë vesh ndryshe.⁵⁷

Shpërblimi i dëmit në të holla (vlera e restitucionit – kthimi në të holla): Shpërblimi në të holla paraqet sjelljen e pasurisë së të dëmtuarit në atë gjendje në të cilën ka qenë menjëherë para shkakimit të dëmit. Ajo mund të arihet me kompenzim të menjëhershëm të dëmit në para në sasi të caktuar parash, me dhënje të afatizuara-me datë të cilat paraqiten si rentë në të holla, me pagesën e dëmit kontraktual dhe me pagesë të interesit penal.

Shpërblimi në të holla kryhet ose me dhënje të njëhershme në sumë të caktuar të hollash gjithmonë kur është e mundur në momentin e shpërblimit të dëmit të vërtetohet lartësia e saj e shprehur në të holla. Kështu Ligji mbi marrëdhënjet detyimore parasheh se shpërblimi i dëmit të tillë, bëhet: Nëse sendi që është marë në mënyrë të palejuar nga pronari i vet është shkatëruar nga fuqia madhore, personi i përgjegjshëm është i obliguar ta kompënzojë në të holla.⁵⁸ Kështu ligjit mbi marrëdhënjet detyimore gjithashtu parasheh që Në rast të vdekjes, dëmtimeve fizike, ose dëmtimeve të shëndetit, kompenzimi në të drejtë caktohet në formë të rentës në të holla, përjetësisht ose në kohë të caktuar. Kësti në të holla i cili është gjykuar në emër

⁵⁷ G. Galev, J. D.Anastasovska, Obligaciono pravo, Shkup, 2012, fq.746.

⁵⁸ LMD, Neni 176.

të kompensimit të dëmit paguhet çdo muaj, nëse gjygi nuk cakton ndonjë mënyrë tjetër. Kontraktuesi ka të drejtë të kërkojë sigurimin e pagesës së kështit, nëse përveç saj, sipas rethanave të rastit, nuk do të ishte e arsyeshme. Nëse i kontraktuari nuk e jep siguresën që do ta caktojë gjygi, kontraktuesi ka të drejtë të kërkojë në vend të rentës ti paguhet një sumë e caktuar, lartësia e të cilës përcaktohet në bazë të rentës mujore dhe mundësisë së zgjatjes së kohëgjatjes së jetës së kontraktuesit, më marrjen e penaleve adekuate.⁵⁹

Kur ekzistojnë arsye të caktuara serioze, i dëmtuari mundet dhe në raste tjera të kërkojë, menjëherë ose më vonë, në vend të kështit mujor ti paguhet një shumë totale e caktuar. Shpërblimi i dëmit me pagesë të interesit penal është rast kur debitori bie në vonesë me kthimin e borxhit kryesor i cili përbëhet në sumë të caktuar parash. Në këtë rast, me pagesën e interesit penal, mes tjerash kompensohet edhe dëmi që kreditori e ka pësuar për shkak të vonesës së debitorit. I njëjtë është rasti edhe me dënimin kontraktual, me atë dallim që ajo paguhet në rast se debitori vonohet me përmbushjen e borxhit jomaterial (p.sh. është vonuar me dhënjën e shtëpisë të cilën ka marrë përsipër që ta ndërtojë dhe t'ia dorëzojë blerësit në afat të caktuar).

2.2. Procedura e realizimit të shpërblimit të dëmit material.

Shpërblimi për dëmin e shkaktuar material realizohet në kontestin e veçantë civil para gjykatës kompetente. Ekzistimi i përgjegjesisë juridiko civile për dëmin e shkaktuar është shpërblimi i dëmit duke mos marrë parasysh lartësinë e dëmshpërblimit. Në procedurë gjygjësore juridiko-civile për palën e dëmtuar e cila në këtë rast është në pozitën e kreditorit paraqitet një e drejtë, kurse për palën që e ka shkaktuar dëmin gjegjësisht dëmtuesin i cili në këtë rast është debitor në këtë rast kjo për të është obligim. Realizimi i të drejtës së dëmshpërblimit, pa marrë parasysh se kush është përgjegjës për dëmin e shkaktuar, gjegjësisht kush është i detyruar ta shpërblejë dëmin, bëhet nëse plotësohen prezumimet procedurale juridike. Kështu personi i dëmtuar nuk do të mund ta realizojë të drejtën për shpërblim të dëmit me vetë faktin se dëmi i është shkaktuar, por ai duhet të parashtrojë kërkesë për shpërblimin e dëmit. Kjo për shkak të asaj se realizimi i një të drejtë të kështillë bëhet në gjykatë dhe inicimi i një procesi të tillë gjygsor, bëhet vetëm me kërkesën e palës së interesuar, në këtë rast palës së dëmtuar. Të shpeshta janë rastet kur për dëmet e shkaktuara me vlerë më të vogël, palët gjegjësisht dëmtuesi dhe i dëmtuari meren vesh që dëmi të kompenzohet në mënyrë jashtëgjygjësore me marrëveshje jashtëgjygjësore.

⁵⁹ LMD, Neni 177.

Në raste të tilla palët meren vesh sizakonisht në vendngjarje, duke u marur vesh që të heqin dorë nga e drejta për të inicuar procedurë gjyqësore.

Në rast se dëmi është pasojë e veprës penale, gjykata penale mund ta shqyrtojë çështjen e dëmshpërblimit. Përveç në rastet kur vërtetimi i dëmit dhe caktimi i lartësisë së tij do ta zgjasë punën e gjykatës penale, kjo gjykatë mund ta udhëzojë të dëmtuarin në kontestin civil me qëllim të realizimit të kërkesës për dëmshpërblim. Në rastin e shqyrtimit të kërkesës për shpërblimin dëmit të shkaktuar me vepër penale, gjykata civile është e lidhur me vendimin e gjykatës penale, lidhur me veprën penale dhe përgjegjësinë penale por jo edhe sa i përket ekzistimit të deliktit civil dhe përgjegjësisë juridiko civile.⁶⁰

Ekziston situatë tjetër kur gjykata penale e liron të akuzuarin nga përgjegjësia penale për atë vepër penale, por gjykata civile nuk do të jetë e lidhur me vendimin e gjykatës penale dhe nëse vërteton se plotësohen kushtet e përgjegjësisë juridiko civile, do ta detyrojë për shpërblimin e dëmit material. Në kontestet për shkak të dëmit vendosin gjykatat e kompetencës së përgjithshme reale, varësisht nga lartësia e kërkesës juridike-pasurore. Kështu sipas dispozitave të ligjit mbi procedurë civile të Republikës së Maqedonisë veriore- Për gjykime në konteste për detyrim jontuktual për dëm, përveç gjyqit me kompetencë vendore të përgjithshme, kompetent është edhe gjyqi në rajonin e të cilit është kryer veprimi i dëmshëm, ose gjyqi ku kanë pasuar veprimet e dëmshme. Nëse dëmi është shkaktuar për shkak të vdekjes ose lëndimeve të rënda trupore, përveç gjyqit nga alinea (1) e këtij neni, kompetent është edhe gjyqi në rajonin e të cilit i padituri ka vendbanimin ose vendqënrimin. Dispozitat e alineve (1) dhe (2) të këtij neni do të aplikohen edhe në konteste kundër kompanive të sigurimit për shpërblim të dëmit të personave të tretë në bazë të principit për përgjegjësisë indirekte të kompanisë së sigurimit, kurse dispozita e alinesë (1) të këtij neni dhe në konteste për kërkesa për regres në bazë të shpërblimit të dëmit kundër debitorit regresor.⁶¹

Me dispozitën e alinesë 1 të këtij neni është shkruar kompetencë e zgjedhur (elektive) tek kontestet për shpërblim të dëmit jontuktual, sipas vendit ku është shkaktuar dëmi (forum delicti comisii), sepse supozohet se në atë mënyrë më lehtë do të vërtetohet gjendja faktike në lidhje me veprimin e dëmshëm. Edhe kompetenca që është përshkruar në alinenë 2 të këtij ligji

⁶⁰ LPC, neni 11.

⁶¹ LPC, neni 44.

është e shkruar për shkak të mbrojtjes së të paditurit. Si paditës këtu mund të paraqiten: i dëmtuari, nëse ka pësuar lëndime të rënda trupore, por edhe prindët e tij, fëmijët dhe bashkëshorti, në rast të invaliditetit të rëndë. Në rast të vdekjes së një personi, si paditës mund të paraqiten personat nga neni 190 të LMD, më kërkesë për kompenzim adekuat të dëmit për dhimbjet e tyre shpirtërore, por edhe persona tjerë për shkak të fitimit të humbur dhe harxhimet për mjekim dhe varim të të vdekurit (neni 182 i LMD), për kompenzim të humbjes së mbajtjes (neni 183 i LMD) etj. Për ekzistimin e kësaj kompetence teritoriale, paditësi, gjegjësisht personi përgjegjës nuk është e domosdoshme të jenë i gjykuar penalisht.

Kështu realizimi i shpërblimit të dëmit të shkaktuar realizohet në procedurë juridiko-civile, në atë mënyrë që i dëmtuari parashtron kërkesën për shpërblim të dëmit kundër subjektit përgjegjës në gjykatë. Kështu në raste të tilla zbatohen regullat e përgjithshme të përgjegjesisë së dëmit të shkaktuar. Kërkesa për realizim të dëmshpërblimit ngrihet vetëm kundër subjektit përgjegjës, mëqë dëmi i shkaktuar nga ky subjekt paraqet bazë për ngritjen e kërkesëpadisë. Kështu në rast të tillë gjykata është e lidhur për kërkesën e palës, dhe të njëjtën mund ta shqyrtojë deri në kufijtë e kërkesës që është parashtruar në kërkespadi. Kushte tjera që duhet të plotësohen janë kushtet dhe baza e përgjegjesisë juridiko civile për dëmin e shkaktuar, që do të thotë që i dëmtuari ta ketë kryer veprën e caktuar penale me të cilën dëmi është shkaktuar kurse paditësi të vërtetojë se nga vepra e caktuar i është shkaktuar dëmi si rezultat i veprimeve të të paditurit.

Palët ashtu siç i krijonë marrëdhënjet juridiko-civile me vullnetin e tyre të lirë, poashtu e kanë edhe obligim që me vullnetin e tyre të lirë ti përmbushin obligimet që dalin nga një marrëdhënie juridiko-civile. Mirëpo mund të ndodhë në praktikë që njëra apo pala tjetër të mos e përmbush obligimin e marë, kështu që palës tjetër i shkaktohet dëm nga mospërmbushja e tillë. Për këtë arsye, rëndësi të veçantë në marrëdhënjet juridiko-civile i përkushtohet edhe institucionit të parashkrimit. Parashkrimi si institucion juridik gjithmonë i shkon në favor debitorit, meqë ky mund të mos jetë i interesuar që ta përmbushë obligimin (pa marë parasysh se përballat me parimin e ndërgjegjshmërise dhe parimin e mosshkaktimit të dëmit). Ekzistenca e këtij institucioni arsyetohet për shkak të stabilitetit në qarkullimin juridik. Kjo për shkak të asaj se me kalimin e kohës zbehen ngjarjet, dëmtohen ose humbasin provat, zhduken dokumentet, ndodh që ndonjëri nga dëshmitarët të vdesë në ndërkohë ose të ndrojë vendbanim ose vendqëndrim,

kujtimet për ngjarjen që ka ndodhur harohen. Në këtë mënyrë zhvillimi i kontestit dhe vendimmarje vështirësohen, për arsye se rëndohet argumentimi i fakteve në të cilat bazohet e drejta e kërkuar.⁶² Në legjislaturën tonë gjegjësisht në Ligjin për marrëdhënjet detyrimore të Republikës së Maqedonisë Veriore ky institucion është paraparë në nenet 349 – 382.

Kështu parashkrimi afatizon nga pikëpamja kohore dhe ka të bëjë me realizimin e ndonjë të drejtë të caktuar nga ana e gjykatës apo organeve tjera shtetërore brenda periudhës kohore të caktuar. Elementet thelbësore të parashkrimit janë: rrjedha apo kalimi i kohës dhe vullneti i njeriut. Rjedha e kohës apo kalimi i kohës i paraparë me ligj nënkupton afatin e parashkrimit-vjetërsimit i cili fillon të rrjedhë nga momenti kur subjektit i ka lindur e drejta e padisë,⁶³ kurse vullneti i njeriut është faktor i cili mundëson që ngjarja faktike të fitojë përmbajtje juridike dhe e njëjta të shëndrohet në të drejtë për të dëmtuarin.

Gjatë procedurës gjyqësore, gjykatësi nuk e ka për obligim që ex officio në ndjekë çështjen e parashkrimit. Ai e ka parasysh parashkrimin vetëm nëse pala thiret në vjetërsim të kërkesës, p.sh. i padituri thiret në atë se e drejta e paditësit është e vjetërsuar meqë ka kaluar afati për kërkesëpadi. Moment nga i cili nisën të rrjedh afati i parashkrimit është dita e parë nga e cila kreditori fiton të drejtën të kërkojë përmbushjen e detyrimit, dhe e kundërta nëse kemi të bëjmë me detyrime që konsistojnë në mosbërje apo në durim, parashkrimi fillon të rrjedhë nga dita e parë nga e cila debitori nuk e ka përmbushur detyrimin.

Afatet e parashkrimit të së drejtës së dëmit janë dy: afati subjektiv dhe afati objektiv.

Të drejtën për dëmshpërblim pala e dëmtuar e realizon në gjykatat kompetente, dhe e njëjta realizohet me sjelljen e vendimit të plotëfuqishëm meritore për shpërblim të dëmit. Gjykata civile në raste të tilla zbaton normat materiale dhe procedurale juridike për përgjegjësinë civile për dëmin e shkaktuar. Gjykata posaçërisht kujdes të veçantë i kushton vendimit që shpërblimi i dëmit t'i përgjigjet në mënyrë adekuate pasojës që i dëmtuari e ka pësuar. Vendimi për dëmshpërblim nuk duhet të paraqes pasurim për të dëmtuarin, e as varfërim të subjektit që e ka shkaktuar dëmin. Vendimi gjyqësor pasqyron qëllimin e shpërblimit të dëmit, evitimin e pasojave të dëmshme dhe krijimin e gjendjes që ka ekzistuar te i dëmtuari para se dëmi ti

⁶² N.Dauti, vepër e cituar.

⁶³ LMD, neni 350, alinea 1.

shkaktohet. Shpërblimi i dëmit material duhet sa më shumë ti afrohet ekuivalencës së lartësisë së pasojës së shkaktuar, kjo në mënyrë precize është e shkruar në dispozitivin e aktgjykimit. Varësisht nga dëmi i shkaktuar material gjykata vendos që shpërblimi i dëmit material të realizohet ose me kthim në gjendjen e mëparshme, ose me shpërblim të dëmit në të holla. Gjatë vedosjes për shpërblimin e dëmit gjykata posaçërisht ka parasysh rethanat e rastit në të cilin dëmi është shkaktuar, vëllimin e dëmit që është shkaktuar, fajin, shkallën e dëmit, sa ka ndikuar i dëmtuari që dëmi ti shkakatohet, gjendjen pasurore të dëmtuesit dhe në bazë të krejt këtyre rethanave duke bërë analizë të tërësishme të fakteve dhe provave të cilat palët i nxerin para gjykatës, gjykata vendos për shpërblimin e dëmit të shkaktuar me aktgjykim me të cilin obligohet dëmtuesi që tia shpërblejë dëmit të dëmtuarit.

3. SHPËRBLIMI I DËMIT JOMATERIAL

Shpërblimi i dëmit jomaterial paraqitet me lëndim të të drejtave personale të të dëmtuari.

Ligji mbi marrëdhënjet detyrimore i Republikës së Maqedonisë Veriore parasheh se: Çdo person fizik dhe juridik, përveç mbrojtjes së të drejtave pronësore, gëzon edhe mbrojtje të të drejtave të veta personale në përputhshmëri me ligjin. Si të drejta personale, në bazë të këtij ligji llogariten të drejtat në jetë, shëndet fizik dhe psiqik, nder, reputacion, dinjitet, emër personal, privatësi të jetës personale dhe familjare, liri, krijimtari intelektuale si dhe të drejta tjera personale. Personat juridik i kanë të gjitha të drejtat e lartëpërmendura, përveç atyre lidhur me natyrën biologjike të personit fizik, posaçërisht të drejtat në emër të mirë dhe reputacion, emër gjegjësisht kompaninë, sekretin profesional, liri të parablerjes dhe të drejta tjera personale të këtyre persnave.⁶⁴

Për të drejtat personale karakteristike është ajo se ata janë kategori të cilat rëndë definojnë juridikisht, kurse edhe më rëndë materialisht. Kështu për shembull që të shprehet materialisht se çfarë rëndësie ka për një sportist kur e then këmbën, ose për një kompani tregtare shkresa në shtypin ditor se nuk i respekton partnerët e saj të konsumimit dhe të biznesit. Prej këtuj, parashtrrohet pyetja si do të shpërblehet diçka që nuk mund të shprehet materialisht. Ligji mbi marrëdhënjet detyrimore përshtatet në ligjet moderne të cilat lejojnë shpërblim të dëmit jomaterial.

64 LMD, Neni 9-a.

Kështu Ligjit mbi marrëdhënjet detyimore parasheh që: Dëmi jomaterial të kompenzohet jomaterialisht (satisfakcion moral) dhe materialisht (satisfakcion material) në raste të caktuara me ligj. Si rregull, dëmi jomaterial kompenzohet jomaterialisht, edhe pse në raste të caktuara gjykohet kompenzim gjithpërfshires monetar. Në teori, kryesisht potencohet se kush nuk ka të drejtë në dëmshpërblim, por në satisfakcion- mundësim të disa të mirave tjera për shkak të lëndimeve të mara. Dëmshpërblimi mund ta përfshij edhe dëmin e paraqitur (më të ndodhur) por edhe shpërblimin e dëmit në të ardhmen.⁶⁵

2.1. Kushtet

Si kushte me rëndësi për shpërblimin e dëmit jomaterial janë:

- Që dëmi i shkaktuar ti cënojë vlerat personale të njeriut
- Të egzistojë faji i dëmtuesit
- Të egzistojë intensiteti dhe kohëzgjatja e përjetimit të dhembjeve dhe
- Gjendja materiale e dëmtuesit

Dëmi jomaterial mund të jetë si pasojë e veprës penale, e veprimit deliktor dhe si pasojë e cënimit të kontratës. Gjykata gjatë vendosjes lidhur me kërkesën për shpërblimin e dëmit jomaterial, si dhe lartësinë e shpërblimit të tij, duhet të ketë parasysh rëndësinë e vlerës së cënuar dhe qëllimin të cilit i shërben ai shpërblim, por edhe për atë që me atë të mos u kontribuojë tendencave që nuk janë në përputhshmëri me natyrën dhe qëllimin shoqëror të tij.⁶⁶

Individit që ka pësuar dëm jomaterial i gjykohet shpërblim me para dhe me këtë ndërmjetësim ndikohet në zbutjen e tronditjeve subjektive të shkaktuara në personalitetin e viktimës. Shpërblimi i dëmit jomaterial me para të dëmtuarit i gjykohet jo se paratë paraqesin çmimin për dhembjen e përjetuar ose paraqiten si substitucion i vlerës materiale në vend të dëmit të pësuar, por ka për qëllim që të dëmtuarit t'i mundësohet rivendosja e ekuilibrit psikik-emocional që ka realizuar para veprimit të dëmtuesit. Funkcioni i tillë i shpërblimit të dëmit jomaterial quhet satisfakcion dhe ka karakter subjektiv.⁶⁷

⁶⁵ LMD, Neni 187-a.

⁶⁶ LMD, Neni 189, alinea 2.

⁶⁷ N. Dauti, E Drejta e detyrimeve, (pjesa e përgjithshme dhe e veçantë), Prishtinë, 2001, fq.202.

3.2.Qëllimi

Shpërblimi i dëmit jomaterial fillon të paraqitet në forma të ndryshme, nën ndikimin e humanitetit, kur fillon të fitojë në vlefshmëri jeta e njeriut, paprekshmëria e saj si dhe palënkueshmëria e saj.

Mendimi për shpërblimin e dëmit jomaterial apo thënë ndryshe dëmit moral, ose edhe siç thuhet ndryshe dëmit joekonomik, në teorinë juridike duhet të jetë në plan të parë, për vetë faktin se definim preciz i dëmit jomaterial pothuajse nuk është i mundur, prandaj për atë shkak edhe rëndë përcaktohet. Kjo për shkak të asaj se dëmi jomaterial nuk mund të mënjanohet as me kthimin në gjendjen e mëparshme as me kompensim në të holla. Edhe pse shpesh kompensimi shprehet në sumë në të holla, ajo është një lloj satisfakcioni i cili të dëmtuarit do ti mundësojë të blejë ndonjë të mirë materiale e cila do ti mundësojë kënaqësi tjetër.⁶⁸

Formën kornizë të dëmit jomaterial e parasheh edhe Ligji mbi marëdhënjet detyrimore ku thuhet – Dëmi është zvogëlim i pasurisë së dikujt (dëm i thjeshtë) dhe ndalim i zmadhimit të saj (fitimi i humbur), si dhe lëndim i të mirave personale (dëmi jomaterial).⁶⁹

Qëllimi i shpërblimit të dëmit është që t'i mënjanojë pasojat e dëmshme të dëmit të shkaktuar. Ai parimisht ka qëllim të krijojë gjendjen që ka ekzistuar tek i dëmtuari para se dëmi të jetë i shkaktuar. Shpërblimi i dëmit në të drejtën bashkëkohore ka karakter preventiv. Shpërblimi i dëmit jomaterial ka qëllim satisfakcionin e të dëmtuarit, e jo të arihet ndonjë qëllim lukrativ që nuk është në pajtim me qëllimin shoqëror të këtij shpërblimi, sepse nuk mund të komercializohen vlerat morale.⁷⁰

Shpërblimi jomaterial i dëmit jomaterial akoma quhet edhe satisfakcion moral, sepse siç theksohet në teorinë juridikë, të dëmtuarit i jepet kënaqësi e caktuar morale.

Satisfakcioni moral në legjislaturën tonë si duket se është mënyra primare e mënyrës së shpërblimit të dëmit jomaterial. Më tej në Ligjin mbi marëdhënjet detyrimore parashihet që: Në rast të dëmtimit të të drejtave personale i dëmtuari mund të kërkojë, kurse gjygi mund të urdhërojë në harxhim të dëmtuesit, shpalljen e aktgjykimit, gjegjësisht përmisimit, tërheqjen e deklaratës me të cilën është shkaktuar lëndimi, ose diçka tjetër me të cilën do të mund

⁶⁸ Kompenzimi i dëmit jomaterial, material seminarik, Agjensionin Akademik, Shkup, Maj, 2000.

⁶⁹ LMD, Neni 142.

⁷⁰ M. Vulovic, vepër e cituar, fq.270.

të arihet qëllimi me të cilin arihet deri te shpërblimi adekuat i dëmit me të holla.⁷¹ Qëllimi i ligjdhënësit është që përeç përmbushjes së kushteve me paraqitjen e marëdhënjeve detyrimore me shkaktim dëmi, kusht tjetër të mos mund të vëndohet. Kështu satisfakcioni moral përbëhet nga ajo që është më lartë e përshkruar në dispozitën ligjre të Ligjit mbi marëdhënjet detyrimore të Republikës së Maqedonisë Veriore.

Shpërblimi i dëmit jomaterial si lloj i satisfakcionit moral, shpesh herë është rëndë i realizueshëm. Nëse atë e kuptojmë si lloj i kthyerjes në gjendjen e mëparshme, ajo shpesh nuk do të arihet. Kështu p.sh. satisfakcioni moral është gjykuar për shkak se personi A me deklaratën e tij e ka cënuar nderin e personit B, aktgjykimin ose përmisimin i cili është shpallur, ndoshta nuk do ta lexojnë të gjithë ose personat e njëj të cilët kanë qenë të njohtuar me cënimin e të mirës personale, gjegjësisht me të drejtat e personalitetit të dëmtuar, për shkak të asaj se aktgjykimi i shpallur ose përmisimi nuk mund të menjanojnë plotësisht çdo dyshim në lidhje me të dëmtuarin. Por edhe përkaj kësaj, në këtë mënyrë shpërblimi i dëmit jomaterial ka kuptim të madh për shkak të asaj se pas saj ka autoritetin e gjyqjit. Nga këtu, satisfakcioni moral, nuk duhet të kuptohen si krijim të qindpërqinshëm të situatës ashtu siç ka qenë para se dëmi jomaterial të shkaktohet, por krijimin e përgjithshëm të situatës së drejtë e cila për të dëmtuarin ka ekzistuar para se dëmi të shkaktohet.⁷²

Shpërblimi material i dëmit jomaterial, (satisfakcioni material) përbëhet në obligimin e dëmtuesit që të paguajë sumë të caktuar të hollash- kompensim gjithpërfshirës monetar.

Për kompensimin në të holla të dëmit jomaterial, në praktikën gjyqsore dhe në teorinë juridikë ka dy pikpamje të kundërta. Sipas njërës, dëmi jomaterial nuk mund të kompenzohet në të holla, kurse sipas tjetrës, ajo mundet dhe duhet të kompenzohet në të holla. Kundërshtarët e kompenzimit në të holla, në qëndrimin e vet shprehen se të mirat personale, në rast lëndimi, janë të mbrojtura me të drejtën penale, dhe nuk është e nevojshme edhe mbrojtja juridiko-civile. Sipas tyre, mbrojtja juridiko-civile e të drejtave personale, në kuptim të shpërblimit në të holla të dëmit jomaterial, paraqet komercializim të këtyre të mirave. Të mirat personale, sipas kësaj pikpamje, nuk janë të matshme me të holla, dha prandaj për këto nuk mund

⁷¹ LMD, Neni 188.

⁷² G. Galev, J. D. Anastasovska, Obligaciono pravo, Shkup, 2012, fq.754.

të gjykohet dëmshpërblim në të holla, por përderisa bëhet kjo nuk mundet në mënyrë adekuate të vlerësohet lartësia e dëmshpërblimit.

Argumentimi i pikëpamjes së dytë e cila e pranon dëmshpërblimin në të holla në dëmit jomaterial bazohet në arsyet në vijim: mbrojtjen juridiko-penale e gëzojnë edhe të mirat pronësore, por ato gëzojnë edhe mbrojtje civilo-juridike, dhe dhënja e mbrojtjes penalo-juridike për mbrojtje të të drejtave personale do të nënkuptonte se të drejtat pronësore janë më mirë të mbrojtura se të drejtat personale e cila nuk është mirë; mbrojtja juridiko-civile e të drejtave personale, në kuptim të shpërblimit material të dëmit jomaterial, nuk paraqet komercializim të këtyre të mirave sepse qëllimi primar i shpërblimit të dëmit nuk është që të jepet kompenzim për ato të mira, por në mënyrë të caktuar të mundësohet realizim i një satisfakcioni e cila e favorizon të dëmtuarin,⁷³ pamundësia e vlerësimit adekuat të shpërblimit të dëmit të shkaktuar jomaterial nuk është arsye që ky lloj i dëmit të mos shpërblehet në të holla, sepse në raste të shkaktimit të dëmit material nuk mund të llogaritet kompenzim adekuat material (shkatërimi i sendit të përcaktuar individualisht), por megjithatë ajo bëhet, dhe në fund në lidhje me të mirat personale ekzistojnë kritere të përcaktuara të tërthorta në bazë të të cilave mund të përcaktohet kompenzimi në të holla, në lidhje me dëmin e shkaktuar jomaterial në rast kur janë të dëmtuara këto të mira.

Ajo që parashtrohet si pyetje të dëmshpërblimi në të holla i dëmit jomaterial nuk është tek fakti se a do të mundësohet apo jo, se padyshim duhet, por në çfarë vëllimi dhe në cilën lartësi ajo duhet të bëhet. Sipas kuptimit të legjislaturës tonë, në teori dhe praktikë, gjygyji duke i vlerësuar rethanat e rastit, e posaçërisht kohëzgjatjen dhe intenzitetin e lëndimit, si dhe pasojat e saj, gjykon kompensim të drejtë monetar, pa marrë parasysh shpërblimin e dëmit material, si dhe në mungesë të tij. Kështu gjygyji në veçanti llogaritën për domethënjen e të mirës së lënduar dhe për qëllimin që do të shërbejë ai dëmshpërblim, por edhe për atë që me atë të mos ndikojë në aspiratat të cilat nuk kanë lidhshmëri me lidhjen e saj. Kështu në dispozitat ligjore të ligjit mbi marrëdhënjet detyrimore gjygyjit i jepen udhëzime të qarta se çfarë duhet të ketë parasysh kur të përcaktojë lartësinë e shpërblimit të dëmit jomaterial. Gjatë përcaktimit të kërkesës për shpërblim adekuat në të holla gjygyji do të llogarit për fuqinë dhe kohëzgjatjen e lëndimit me të cilin janë shkaktuar dhembje fizike, dhembje shpirtërore dhe frikë, si dhe për qëllimin për të cilin shërben

⁷³G. Galev, J. D. Anastasovska, Obligaciono pravo, Shkup, 2012, fq.755.

dëmshpërblimi, por edhe për atë që kompenzimi të mos jetë në kundërshtim me aspiatat që nuk kanë lidhshmëri me natyrën e saj si dhe qëllimit të përgjithshëm.⁷⁴

Si persona të cilët kanë të drejtë në shpërblim të dëmit jomaterial, paraqiten personat fizik dhe personat juridik si mbajtës të të drejtave personale, të cilat të drejta personale janë në mënyrë direkte të lënduara me veprimin e dëmtuesit. Kështu për shembull, personit fizik të cilit në aksident në komunikacion rrugor i është thyer krahu do të ketë të drejtë në shpërblim të arsyeshëm në të holla për shkak të lëndimit të të drejtës së tij të integritetit trupor. Njëjtë edhe personi juridik të cilit i është dëmtuar nderi dhe reputacioni kanë të drejtë në shpërblim të dëmit jomaterial për dëmin që e pëson me atë lëndim të emrit personal. Por, lëndimi direkt i të drejtave personale të një personi fizik, mundet, në mënyrë indirekte të çojë edhe te shkaktimi i dëmit jomaterial personave të afërm të tij. Ligji këtë e lidh me shkaktimin e vdekjes ose invaliditet të rëndë të një personi.

Kështu në Ligjin mbi marëdhënjet detyrimore parashihet që: Në rast të vdekjes ose invaliditetit të rëndë të një personi, gjygi mundet që të gjykojë të afërmeve të tij më të ngushtë (bashkëshort, fëmijë dhe prind), shpërblim të arsyeshëm të dëmit jomaterial. Shpërblim i tillë i dëmit mund tju gjykohet edhe vëllezërve dhe motrave, gjyshërve dhe gjysheve, nipërve dhe shokut jashtëmartesor, nëse mes tyre dhe personit të vdekur, gjegjësisht të dëmtuarit ka pasur bashkësi të përhershme jetësore. Të drejtë në dëmshpërblim në të holla kanë edhe prindët e fëmijës së ngjizur, por të palindur.⁷⁵

Ligji në rast të veçantë e ndan shpërblimin e dëmit jomaterial për dëmin e shkaktuar më lëndimin e të mirave materiale të personit të cilit i është shkaktuar vepër penale kundër lirisë gjinore dhe moralit.

Gjithashtu Ligjit mbi marëdhënjet detyrimore parasheh që: Të drejtë në shpërblim adekuat të dëmit jomaterial ka edhe personi të cilit me mashtrim, me shtërngim, ose me keqpërdorim të ndonjë marëdhënjeje nënshtruese ose mvarshmërie është kryer vepër penale kundër lirisë së gjinisë ose moralit gjinor.⁷⁶

⁷⁴ LMD, Neni 189.

⁷⁵ LMD, Neni 190.

⁷⁶ LMD, Neni 191.

Ligji parasheh mundësi të shpërblimit të dëmit të ardhshëm jomaterial, duke përcaktuar se gjygi do të gjykojë shpërblim në të holla, edhe për dëmin e ardhshëm jomaterial, nëse sipas rjedhës së punëve është e sigurtë se do të zgjasë edhe në të ardhmen.

Kështu ligji mbi marrëdhënjet detyimore parasheh që: Gjygi, në kërkesë të të dëmtuarit, do të gjykojë shpërblim të arsyeshëm në të holla edhe për dëmin e ardhshëm jomaterial, nëse sipas rjedhës është e sigurtë se ajo do të zgjasë edhe në të ardhmen.⁷⁷

Kjo dispozite ligjore për shpërblim të dëmit të ardhshëm jomaterial është si pasojë e disa rethanave: Rethana e parë i referohet asaj se te shpërblimi i dëmit jomaterial shpërblimi i dëmit nuk është instrument juridik, i cili e kthen gjendjen që ka qenë para se të ndodhë dëmi, siç është rasti të shpërblimi i dëmit material. Shpërbimi i dëmit jomaterial, siç u theksua edhe më lartë paraqet kënaqësi vetanake-satisfakcion të të dëmtuarit, me qëllim që ai më lehtë ti bartë pasojat e dëmit. Rethana e dytë përbëhet në atë që te shpërblimi i dëmit jomaterial nuk hynë në llogari ndikimet infaltore dhe ndryshimet e vlerës së valutës monetare, për të cilat sizakonisht mbahet llogari te shpërblimi i dëmit material. Dhe rethana e tretë, i referohet asaj se te dëmi jomaterial nuk është e mundur të realizohet me kompensim të dëmit me përfitim, pasi që nuk përgjigjet me vetë natyrën e dëmit jomaterial nga i cili i dëmtuari mund të realizojë fitim. Për shkak të gjithë kësaj, shpërblimi i caktuar i dëmit jomaterial është në mënyrë të caktuar i ndryshueshëm, po gjykimi i dëmshpërblimit për dëmin e ardhshëm në mënyrë të caktuar është korekor i kësaj pandryshueshmërie, kur sipas rjedhës së punëve është e sigurtë se i dëmtuari edhe në të ardhmën do të pësojë dëm jomaterial.

Kur jemi të shpërblimi i dëmit jomaterial parashtrahet pyetja për realizueshmërinë ((qarkullueshmërinë e të drejtës në kompenzim) (transferimin)) e të drejtës për shpërblim dëmi gjegjësisht për mundësinë e trashëgimisë dhe tërheqjes nga kërkesa. Ligji mbi marrëdhënjet detyimore në lidhje me këtë pyetje përgjigjen e jep në dispozitat ligjore ku thuhet se:- Kërkesa e shpërblimit të dëmit jomaterial kalon në trashëgimtarët vetëm nëse është e pranuar me vendim të plotëfuqishëm gjyqsor ose me marrëveshje me shkrim. Nën kushtet e njëjta kërkesa e tillë mund të jetë edhe lëndë e dorëheqjes, kthimit ose ekzekutimit të dhunshëm.⁷⁸

⁷⁷ LMD, Neni 192.

⁷⁸ LMD, Neni 193.

Në lidhje me pyetjen e përgjegjesisë së ndarë të dëmtuesit dhe të dëmtuarit, si dhe zvogëlimin të shpërblimit të dëmit, në përgjegjësinë për dëmin jomaterial aplikohen rregullat e përgjegjesisë për dëmin material. Kështu në Ligjin mbi marrëdhënjet detyimore thuhet: -Dispozitat për përgjegjësinë e ndarë dhe për zvogëlimin e shpërblimit të dëmit që vlejnë për dëmin material do të aplikohen njëkohësisht edhe te dëmi jomaterial.⁷⁹

Në kontekst me të lartëpërmendurën për dëmin jomaterial dhe shpërblimin e saj në lloj të dëmshpërblimit në të holla vlen të përmendet edhe dispozita e nenit 192-a të ligjit mbi marrëdhënjet detyimore ku thuhet: (1) Përgjegjësia për pagesë të arsyeshme të dëmshpërblimit në të holla arin për plotësim ditën kur sillet aktgjykimi i shkallës së parë me të cilin është përcaktuar lartësia e këtij dëmshpërblimi. (2) Gjatë përcaktimit të lartësisë së arsyeshme të dëmshpërblimit në të holla, gjyqi do të ketë parasysh dhe kohën që ka kaluar nga momenti kur është shkaktuar dëmi deri në momentin kur është sjellur vendimi gjyqsor, nëse kohezgjatja e pritjes së satisfacionit dhe rethanat tjera e arsyetojnë atë.

Nga gjithë që përmendëm më lartë për shpërbimin e dëmit jomaterial dhe material, por edhe më gjërë për dëmit jomaterial në përgjithsi, vlen që si përfundim të flasim edhe për natyrën e dëmit jomaterial. Nëse nisemi nga formulacioni ligjor i nenit 142 të Ligjit mbi marrëdhënjet detyimore e cila ekzistonte deri në vitin 2008, në bazë të cilit ky lloj i dëmit definohet si paraqitje e dhimbjeve fizike ose dhimbjeve shpirtërore si dhe frikës, mund të thuhet se ligji atë e mer si kategori subjektive. Mirëpo në Novelën nga viti 2008 ky koncept definitivisht është lëshuar. Kjo në atë kuptim se ligji tani dëmin jomaterial e kupton pastër objektiv në mënyrë që për të thuhet se paraqet lëndim të të drejtave personale të të dëmtuarit, në të cilat përveç të drejtave të personave fizik të drejta të njëjta ose të ngjashme gëzojnë edhe personat juridik. Kuptuar kështu dëmi jomaterial është më i pranueshëm pasi që mundëson mbrojtje të plotë të të drejtave personale edhe atë si të personave juridik, poashtu edhe të personave fizik. Reth kategorive subjektive edhe atë: dhembje fizike ose dhembje shpirtërore ose frikë, të cilat e përbëjnë thelbin e dëmit jomaterial, të gjitha ata marrë në kontekst të përgjithshëm të konceptit objektiv të dëmit jomaterial (si lëndim i të drejtave personale), më nuk paraqesin lloj të veçantë të lëndimit të drejtave personale, por vetëm paraqiten si fakte, ose më mirë me thënë si kritere specifike, të cilat bashkë me rethanat tjera të rastit do të ndikojnë në vlerësimin e gjyqit a është

⁷⁹ LMD, Neni 194.

lënduar në atë shkallë ndonjë e drejtë e caktuar personale, dhe ajo nga ana e vet kërkon edhe i dëmtuari edhe materialisht të jetë i dëmshpërblyer me pagesë të sumës adekuate të caktuar. Këtë më mirë ligjdhënësi e ka paraparë në nenin 189 al. 2 ku thuhet: Gjatë përcaktimit të kërkesës për shpërblim adekuat në të holla gjygi do të llogarit për fuqinë dhe kohëzgjatjen e lëndimit me të cilin janë shkaktuar dhembje fizike, dhembje shpirtërore dhe frikë, si dhe për qëllimin për të cilin shërben dëmshpërblimi, por edhe për atë që kompenzimi të mos jetë në kundërshtim me aspiratat që nuk kanë lidhshmëri me natyrën e saj si dhe qëllimit të përgjithshëm.

4.KRITERET PËR CAKTIMIN E LARTËSISË SË DËMIT MATERIAL

Kriteret më të rëndësishme që i mer parasysh gjykata me rastin e caktimit të lartësisë së shpërblimit të dëmit janë: lartësia e dëmit, shkalla e fajit, kontributi i dëmtuesit apo të dëmtuarit që dëmi të shkaktohet dhe me të edhe pasojat e dëmshme si dhe gjendja materiale e dëmtuesit dhe të dëmtuarit.

Vëllimi i dëmit është kriteri dhe rethana vendimtare që mer parasysh gjykata me rastin e caktimit të shpërblimit me para të dëmit material. Lartësia e dëmit caktohet duke pasur parasysh kriterin objektiv dhe subjektiv. Për kriterin objektiv meret parasysh vlera objektive e sendit të dëmtuar, të asgjësuar - **pretium commune**, kurse për kriterin subjektiv vlerësimi i dëmit bëhet sipas vlerës së posaçme individuale - **pretium affectionalis**, **pretium singulare** (vlerë e sendit të të dëmtuarit ndaj të cilit i dëmtuari ka pasur dashuri të veçantë p.sh. sendi i dhuruar për kujtim). Shpërblimi i dëmit material për vlerën afeksionare të sendit të dëmtuar, i caktohet të dëmtuarit në rast se dëmi është shkatuar me vepër penale me dashje.

Gjatë vlerësimit të dëmit në kontestin civil, gjykata duhet të kërkojë mendimin profesional të ekspertëve, që ka ndikim të rëndësishëm⁸⁰ në caktimin e lartësisë së dëmit, e sidomos kur është çështja e vlerësimit të sendit të dëmtuar. Këtu të dëmtuarit duhet ti pranohet vlera e sendit të rri. Lartësia e shpërblimit të dëmit caktohet sipas çmimeve në kohën kur meret vendimi gjygjësor.

⁸⁰ N.Dauti, E drejta e detyrimeve, (pjesa e përgjithshme dhe e veçantë), Prishtinë, 2001.

4.1. Lartësia e dëmit

Kur përcaktohet komenzimi i dëmit material dy rethana janë posaçërisht të rëndësishme:

- Në cilën sasi duhet të kompenzohet dëmi dhe
- Sa është lartësia që duhet të kompenzohet.

Ligji i marëdhëneve detyrimore jep përgjigje të këtyre dy pyetjeve:

Pyetja për sasinë e shpërblimit të dëmit material, është pyetje se cili dëm duhet të jetë i kompenzuar. Në Ligjin mbi marëdhënet detyrimore të Republikës së Maqedonisë Veriore është paraparë që: “I dëmtuari ka të drejtë si në shpërbilm të dëmit të thjeshtë, poashtu edhe në shpërbilm të fitimit të humbur.”⁸¹ Kjo në përgjithsi ka domethënje të shpërblimit të dëmit në tërësi.

Përcaktimi i dëmit të thjeshtë është relativisht i thjeshtë, por kur bëhet fjalë për fitimin e humbur, që të vërtetohet se deri te ai me të vërtetë ka ardhur, duhet të jenë të plotësuar dy kushte:

- I dëmtuari të ketë pasur qëllim që fitimi i humbur të realizohet
- Të ketë pasur mundësi reale që ai fitim të realizohet.

Prandaj, qëllimi i të dëmtuarit që ta realizojë dobinë supozohet ku bëhet fjalë për dobi që realizohet gjatë procesit të punës profesionale të dëmtuarit. Në raste të caktuara, me përjashtim, sasia e shpërblimit të dëmit material don të thotë shpërbilm i dëmit të plotë, shpërbilm i dëmit të thjeshtë, të fitimit të humbur dhe dëmit që i dëmtuari e ka pësuar për shkak të paraqitjes së rethanave të caktuara pas shkaktimit të dëmit të thjeshtë dhe fitimit të humbur. (për shembull, dëmin që do ta pësojë për shkak të inflacionit pasi që ti jetë gjykuar por nuk i është paguar shpërblimi i dëmit të thjeshtë dhe fitimi i humbur). Në atë rast për shpërblimin e tillë për dëmin e shkaktuar hiqen të gjitha pasojat e dëmit të shkaktuar. Prandaj, ku shpërbilm i dëmit paraqet

⁸¹LMD, Neni 178.

kompenzim të plotë ose siç është i përcaktuar në ligjin mbi marrëdhënjet detyrimore “kompenzim i përgjithshëm”.⁸²

Në raste të caktuara mund të vijë edhe te ajo që shpërblimi i dëmit të zvogëlohet me çka do të duhet të jenë të plotësuara kushtet e parapara në nenin 180 të Ligjit mbi marrëdhënjet detyrimore edhe atë: dëmi të jetë i shkaktuar me qëllim ose me pakujdesi të plotë; gjendja materiale e personit përgjegjës të jetë e keqe, për shkak të së cilës nëse shpërblimi i dëmit të shkaktuar nuk kompenzohet në shumë të zvogëluar, do ta sjellë atë në gjendje të mjerushme; dhe gjendja materiale e të dëmtuarit të jetë e tillë që do ta përballojë zvogëlimin e dëmshpërblimit. Përderisa janë të plotësuara kushtet e lartpërmendura, vendim për këtë zvogëlim sjell gjyqji kompetent me kërkesë të personit përgjegjës. Deri të zvogëlimi i dëmshpërblimit mund të vijë edhe në raste kur dëmi e ka shkaktuar dëmtuesi duke kryer punë në shërbim të të dëmtuarit. Në këtë rast, me kërkesë të të dëmtuarit, në bazë të kërkesës së dëmtuesit gjyqji do të vendosë për zvogëlim të dëmshpërblimit duke llogaritur për faktin se i dëmtuari gjatë kryerjes së punëve duke punuar në favor të dëmtuesit ka vepruar ashtu siç vepron kur punon sizakonisht duke kryer punët e veta. Të dy rastet paraqesin tërheqje nga parimi i ekuivalencës, në njërin anë, dhe nga ana tjetër nga parimi i barazisë në barë të palës së dëmtuar. Deri të zvogëlimi i shpërblimit të dëmit mund të vijë edhe në situatë kur i dëmtuari ka kontribuar që dëmi të shkaktohet ose të jetë më i madh se çka do të ishte. Kontributi i dëmtuesit mund të përbëhet nga ajo se ai me sjelljen e vet i ka mundësuar dëmtuesit që dëmin ta shkaktojë ose nuk i ka marrë masat e duhura që ta ndalojë ose ta ndalojë vëllimin e dëmit të shkaktuar. Në raste të tilla sipas nenit 181 alinea 1 të Ligjit mbi marrëdhënjet detyrimore i dëmtuari ka të drejtë vetëm në zvogëlim proporcional të shpërblimit të dëmit. Përderisa nuk mund të vërtetohet kontributi i dëmtuesit, në përputhshmëri me nenin 181 alinea 2 të ligjit mbi marrëdhënjet detyrimore gjyqji do të gjykojë dëmshpërblim duke pasur parasysh rethanat e rastit.⁸³

Kur flasim për lartësinë e shpërbimit të dëmit material duhet të ceket se ajo (lartësia) përcaktohet vetëm si bërje kur kompenzimi kryhet vetëm me të holla. Kështu, mënyra e përcaktimit të lartësisë së dëmshpërblimit është i ndryshëm në mvarshmëri nga ajo se a kompenzohet dëmi i thjeshtë apo fitimi i humbur. Ligji mbi marrëdhënjet detyrimore parasheh që - Lartësia e kompenzimit të dëmit të thjeshtë përcaktohet sipas çmimeve në kohën kur sillet vendimi

⁸² LMD, Neni 179.

⁸³ G. Galev, J. D. Anastasovska, Obligaciono pravo, Shkup, 2012, fq.749.

gjyqsor, përderisa me ligj nuk është ndryshe e përcaktuar.⁸⁴ Përderisa dëmi i thjeshtë është shkaktuar me prishjen ose shkatërimin e sendit më vepër penale të kryer me paramendim, me kërkesë të dëmtuarit, gjygi sasinë e dëmit të tillë të shkaktuar mund të përcaktojë edhe më lartë se sasia reale e dëmit të shkaktuar. Kjo praktikisht domethënë se ajo duhet të jetë e përcaktuar sipas vlerës që sendi e ka pasur personalisht për të dëmtuarin, gjegjësisht sipas të a.q vlerë subjektive e sendit.⁸⁵ Në rastin e parë çmimet janë objektivisht të dhëna, dhe ato më shpesh janë çmime të tregut, por në mungesë të tyre ato mund të jenë çmime kalkuluese. Në rastin e dytë çmimet janë të dhëna subjektive, dhe për shkak të asaj përcaktohen sipas vlerësimit të cilin i dëmtuari e ka pasur për sendin e dëmtuar ose të shkatëruar si posedues personal si i dëmtuar.

Kur bëhet fjalë për lartësinë e dëmshpërblimit të fitimit të humbur, atëherë lartësia e dëmshpërblimit përcaktohet sipas lartësisë se fitimit që i dëmtuari nuk e ka realizuar, por të cilën do ta realizonte po të mos i ishte shkaktuar dëmi (kjo është e paraparë në nenin 178 alinea 3 e Ligjit mbi marëdhënjet detyrimore të Republikës së Maqedonisë Veriore). Rast i tillë për shembull kur për shkak të mallit që nuk është dërguar, i dëmtuari ka mund të përfitojë nëse mallin do ta kishte vënduar në treg.

4.2. Vlerësimi i dëmit sipas vlerës së posaçme individuale

Pjesëmarësit në qarkullim lirshëm i rregullojnë marëdhënjet e tyre kontraktuese në përputhshmëri me Kushtetutën, ligjet dhe zakonet e mira.⁸⁶

Me dispizitat e lartëpërmendura ligjore të nenit tre është rregulluar e ashtuquajtura “autonomi e vullnetit të palëve”, dhe kjo don të thotë se pjesëmarësve në qarkullim juridik ju lihet hapësirë që në raste të caktuara lirshëm të rregullojnë marëdhënjet kontraktuale, me çka nënkuptohet se ekziston një lëmi më e madhe ose më e vogël ku vullneti i pjesëmarësve formalisht, lirshëm qarkullon dhe rregullohet. Megjithatë, kjo liri e rregullimit të marëdhënjeve detyrimore lëviz në kufij të caktuar, duron kufizime të caktuara, e cila shfaqet në mendimin se marëdhënjet kontraktuale të rregullohen në përputhshmëri me kushtetutën, ligjet dhe zakonet e mira. Përndryshe kufizimet e tilla të lirisë së rregullimit të marëdhënjeve kontraktuale, të paraqitura janë ende në materijen e palejueshmërisë së lëndës dhe bazës së obligimit kontraktual

⁸⁴ LMD, Neni 178, alinea 2.

⁸⁵ Shih më tepër Nenin 178, alinea 4, LMD.

⁸⁶ LMD, Neni 3.

(neni 41, 43), te pavlefshmëria e kontratave (neni 95 e më tej), si dhe te kushtet e palejueshme të kontratës (neni 67).

Fusha e obligacioneve gati se në çdo sistem juridik paraqet lëmi, në të cilën të mjaftueshme janë mundësitë vetë palët me vullnetin e vet ti rregullojnë raportet e tyre, por në të drejtën bashkëkohore, ka më tepër dispozita të cilat kanë karakter të caktuar imperativ. Sipas kësaj mund të llogaritet se ajo liri megjithatë nuk është absolute, por lëviz në kufij të caktuar. Gjithsesi, ato kufij nuk vëndohen në mënyrë arbitrare nga ana e ligjdhënësit, por objektivisht janë të përcaktuara sipas kushteve konkrete të jetës në një shoqëri të caktuar, kurse të përcaktuara sipas shkallës së zhvillimit ekonomik, moral, filozofik dhe emancipimit politik në shoqërinë e caktuar.

Liria e rregullimit të marrëdhënjëve kontraktore përbëhet nga ajo që pjesëmarësit pamvarësisht dhe me vullnet të lirë të vendosin a do të krijojnë raport në caktuar kontraktual-juridik, me cilin do ta lidhin kontrantën, me çfarë lloj kontrate dhe me çfarë përmbajtje dhe forme do të lidhet kontrata, si dhe të drejtën që ta ndryshojnë kontratën, dhe ta shkëputin atë raport juridiko-kontraktual. Megjithatë, në dispozitat e nenit tre të ligjit mbi marrëdhënjet detyrimore ka edhe ndalesa të përgjithshme të lirisë së tillë të rregullimit të marrëdhënjëve kontraktuale, të cilat në vete përmbajnë ndalesa konkrete. Kështu, para së gjithash, me rregullimet e tilla të marrëdhënjëve kontraktuale nuk guxojnë ti shkelin normat e detyruara, mes të cilave, gjithsesi në radhë të parë janë normat e Kushtetutës. Të shumta janë marrëdhënjet tek të cilat mund të bëhet shkelje direkte të dispozitave të Kushtetutës, p.sh. kontrana më të cilën lidhet skllavëria. Ndalesat e tilla dhe kufizimet, kryesisht ndodhen në dispozitat ligjore, kurse më rallë në akte nënligjore. Normat e tilla detyrimore të cilat nuk goxon të shkelen, zakonisht njihen nga sanksionet e tyre. Sanksioni i cili parashihet për shkelje të ndonjë norme detyrimore, paraqet pasojë e cila përbëhet nga pavlefshmëria e kontratës ose të një pjese të saj. Nganjëherë norma detyrimore shprehet në atë mënyrë që parasheh sjellje të caktuar me shprehjen “detyrimisht”.

Si norma të detyrueshme, të parapara në vetë ligjin mbi marrëdhënjet detyrimore të Republikës së Maqedonisë Veriore, do të mund të llogariten normat e tilla me të cilat rregullohen disa nga parimet bazë të atij ligji, të cilat më pas konkretizohen nëpër dispozita të përcaktuara ligjore. Kështu për shembull, ato janë dispozitat me të cilat potencohet dhe rregullohet principi i barazisë së palëve në marrëdhënjen kontraktuale (neni 4); parimi i vlerës së barabartë të të drejtave të ndërsjella (neni 8); principi me të cilin ndalohet keqpërdorimi i të drejtës (neni 6); si dhe

principi me të cilin parashihet se palët në marrëdhënjet kontraktuale janë të detyruar ti përmbahen principit të ndershmërisë dhe ndërgjegjshisë (neni 5), çka konkretizohet në disa dispozita tjera të ligjit mbi marrëdhënjet detyrimore p.sh. në materjen e zgjerimit të përgjegjshisë kontraktuale (neni 253); mbarimi dhe ndryshimi i kontratës për shkak të rethanave të ndryshuara (neni 124,125), te kontrata për ndërmjetësim (neni 872), me përshkrimin e fikcioneve për shfaqjen e kushtit (neni 76), aftësia (neni 46), të azgjësimi i kontratës për shkak të mashtrimit (neni 53), te pasojat nga pavlefshmëria (neni 96), te fitimi pa bazë (neni 199), cesioni (neni 431) etj.

Liria e rregullimit të marrëdhënjeve kontraktuale në kuptim të asaj se a do të lidhet apo nuk do të lidhet kontratë e caktuar, gjithashtu, në kuptim të caktuar është i kufizuar edhe me nenin 19, me të cilin përshkruhen rastet e lidhjes së domosdoshme dhe përmbajtjes së domosdoshme të kontratës.

Kufizim i caktuar i lirisë së kontraktimit paraqet edhe të dejtën primare të blerjes e cila është e caktuar me ligj.

Gjithashtu rregulla imperative paraqesin edhe ata me të cilat është përshkruar lartësia e çmimit, por edhe lartësia e kamatës.

Llogaritet se kufizimi faktik i lirisë së kontraktimit egziston edhe tek kontratat formulare, gjegjësisht kontratat e aneksit, te të cilat, në pikpamje të përmbajtjes së kontratës njëra nga palët, për shkak të gjendjes më të dobët ekonomike është e kufizuar, gjegjësisht nuk mund të ankohet për përmbajtjen e kontratës.

Kur flasim për kufizimin e lirisë së rregullimit të marrëdhënjeve kontraktuale për shkak të zakoneve, duhet të kemi parasysh se zakonet e mira gjithashtu nuk paraqesin koncept preciz juridik, por janë lëndë e gjërë diskutimi, si në teorinë juridike, poashtu edhe në ligjshmërinë. Zakonet e mira janë rregulla të tilla të cilat një shoqëri e caktuar, në periudhë të caktuar të zhvillimit të saj i pranon si rregulla të pranueshme të sjelljes në marrëdhënjet e ndërmjetshme të sjelljes së subjektëve juridik. Ato rregulla, si juridike të padetyrueshme, janë në kundërshtim me normat juridike të cilat juridikisht janë të sanksionuara – pas të cilave qëndron aparati shtetror i detyrueshëm. Shkelja e zakoneve të mira ka si pasojë dënimin shoqëror.

Nganjëherë, zakonet e mira janë të pranuar në ndonjë tekst ligjor, dhe si të tilla bëhen normë ligjore, si p.sh. ndalimi i kontratës kamatore. Megjithatë zakonet e mira, si rregull,

nuk janë dhe nuk është e domosdoshme të jenë të shprehura në ndonjë tekst ligjor që të jenë juridikisht relevante dhe që të kenë veprim juridik. Duke pasur parasysh se edhe LMD thirret te ato në raste të caktuara, ata atëherë janë të siguruara me sanksion dhe shkelja e tyre sanksionohet kështu që gjygi kontratën eventuale me të cilin bëhet shkelje e tyre e shpall të pavlefshme. Në këtë mënyrë, në përgjithsi, zakonet e mira “legalizohen” dhe veprojnë në lëminë e vlerësimit të vlefshmërisë së kontratave, gjithashtu fuqishëm si dhe normat juridike imperative. Kështu, në kundërshtim me zakonet e mira do të ishin kontratat me të cilën personit të gjinisë femërore i premtohet shpërblim nëse lidhet në bashkësi jashtmartesore me ndonjë person të gjinisë mashkullore, ose kontrata me të cilën kryhet shitje e literaturës pornografike etj.

Duhet të kihet parasysh se termi “zakonet e mira” është fleksibil dhe relativ dhe si i tillë me rjedhën e kohës ose me ndryshimin e kushteve të përgjithshme ndryshohet. Në këtë mënyrë, kontratat të cilat dikur janë llogaritur si amorale, ata kontrata të zakoneve të mira, sot mund të llogariten si të plotfuqishme, dhe në një periudhë të ardhshme mund të jenë kontrata të cilat do të ishin në kundërshtim me zakonet e mira. Kështu p.sh. kontratat për ndërmjetësim për gjetjen e partnerit për martesë. Sot formohen agjensione të numërta të cilat kryejnë ndërmjetësim në gjetjen e partnerit martesor dhe ndërmjetësimi i tillë llogaritet si i ndaluar.⁸⁷

4.3. Shkalla e fajit

Që nga koha e të drejtës romake në trashëgim na kanë ngelur shprehjet qëllim (dolus) dhe pakujdesi (culpa), të kuptuara në atë kuptim të shprehjes së fajit si bazë për përgjegjësi për dëmin e shkaktuar nga ana e dëmtuesit. Teoria juridike nga ajo kohë, edhe pse ka bërë tentime që ta sqarojë fajin si kategori juridike, përsëri, asnjëherë nuk ka aritur në atë shkallë që ta përcaktojë nocionin e saj.⁸⁸ Kur flitet për të drejtën objektive, posaçërisht atë nga shekulli 18 (Kodi i përgjithshëm i Prusisë), si dhe të mëvonshmit (Kodi i Francës, Austrisë, i Sërbisë, Kodi civil Gjerman etj) të cilët në sasi të madhe paraqesin recepcion të së drejtës romake, direkt ose indirekt preken me pyetjen e fajit, por jo edhe me definimin e tij. Gjegjësisht te ato Kode, njëjt si edhe në të drejtën romake, ngjeshemi me kategoritë dolus dhe culpa, të kuptuara në një kuptim qëllimi ose pakujdesi, pa u përcaktuar nocioni. Për dallim nga e drejta objektive, teoria juridike

⁸⁷ Komentar na ZOO, K.Çavdar, K.Çavdar, Akademik, Shkup, 2012.

⁸⁸ Shif nenin 141, LMD.

tenton të vijë deri te nocioni i fajit, edhe pse jo gjithmonë i suksesshëm mundohet të ofrojë nocion të pranueshëm për të.⁸⁹

Sipas një mendimi faji paraqet lëndim të ndonjë obligimi të mëparshëm i cili del nga ligji, por në rast në ekzistimit të kontratës edhe nga vetë kontrata. Ai i cili nuk do ta respektojë atë obligim llogaritet si fajtor, dhe prandaj edhe është i obliguar që ta kompenzojë dëmin e shkaktuar nga ajo shkelje ligjore gjegjësisht obligimit kontraktual (teoria e unitetit të fajit).⁹⁰

Sipas mendimit tjetër faji lidhet me veprimin e kundërligjshëm gjegjësisht barazohet me të. Thënë me fjalë tjera, faji paraqet marjen e veprimit të caktuar kundërligjor (në lloj të ndonjë veprimi gjegjësisht mosveprimi). Në këtë rast përzihen dy gjëra të ndryshme: kundërligjshmëria si kategori objektive dhe faji si kategori subjektive. Kundërligjshmëria si kategori objektive është e lidhur me lëndimin e urdhëresës së caktuar ose normës së ndaluar (e njohur si imperative). Lëndimi i këtij lloji të normës mund të jetë i lidhur me ekzistimin e fajit të dëmtuesi, por nuk është e domosdoshme (rast për shembull me shkaktimin e dëmit me send të rezikshëm ose veprimtari të rezikshme ku faji si kategori subjektive është irrelevant).⁹¹ Në çdo rast, që të mund dëmtuesi të tregohet së është fajtor më parë duhet të vërtetohet se ai a ka vepruar në mënyrë të kundërligjshme objektivisht (se ka bërë shkelje të normës së caktuar imperative).

Faji si kategori subjektive nuk e apstrahon kundërligjshmërinë nga veprimi i dëmshëm. Megjithatë, sa është faji i kupruar si kategori subjektive që të manifestohen nëpërmjet veprimit të kundërligjshëm, prap se prap nuk mund të pranohet se ajo paraqet sjelljen fizike të personit ndaj atij veprimi, por vetëm sjelljen psikike të tij. Me fjalë të tjera, për atë mund të thuhet se e shpreh marëdhënjen e vënduar psikike të dëmtuesit me veprimin e tij të dëmshëm dhe pasojat që dalin nga ai veprim. Në këtë mënyrë të kuptuar faji qartë tregon në atë se si marëdhënje psikike shprehet nga përcaktimi psikik (shpirtëror) të vendos të marë veprim të caktuar dhe të pranohen pasojat nga ai veprim. Në pikpamje të tillë të kësaj marëdhënje, qartë del se i dëmtuari nuk është fajtor për atë fakt se dëmtuesi i ka shkaktuar dëm, por është fajtor se ka marë vendim psikik (shpirtëror) si dhe e ka rezlizuar me shkaktimin e këtij dëmi. Këtu do të themi se dëmtuesi nuk përgjigjet sipas principeve të përgjegjesisë subjektive për shkak të asaj se e ka thyer xhamin e

⁸⁹ G. Galev, J. D. Anastasovska, Obligaciono pravo, Shkup, 2012, fq.664.

⁹⁰ M. Konstatinovic, Beograd, 1957, fq.101-103.

⁹¹ Shih Nenin 141, alinea 2 nga LMD.

veturës të shokut të tij, por përgjigjet për shkak të asaj se ka marrë vendim të tillë dhe e ka realizuar. Megjithatë, vendimi i tij nuk është ai që medoemos çdo herë të jetë e drejtuar nga paraqitja e pasojës së përcaktuar ligjore. Por, nganjëherë mund të shfaqet edhe duke e pranuar pasojën nga veprimi i dëmshëm, edhe pse ajo fillimisht nuk ka qenë qëllimi i veprimit të marrë të dëmshëm. Në rast tjetër, edhe vetë veprimi i lëshimit të shkallës së caktuar të vëmendjes, që është dashur ta ketë personi kur ka marrë veprim të caktuar nga i cili është paraqitur dëmi paraqet lloj të caktuar të veprimit. Përkundër kësaj për shkak se marrësi i veprimit e ka kujdesin e duhur, e cila sipas rjedhës së punës në rastin e caktuar nga ai është pritur, pasoja e dëmshme nga ai veprim do të mundogonte. Sidoqoftë, zgjedhja përfundimtare do të ishte se për ekzistimin e fajit në anën e dëmtuesit gjithmonë do të jetë e novjshme ekzistimi i vendimit përfundimtar, qoftë edhe indirekt. Thjeshtë në mugesë të vendimit të tillë edhe nuk është e mundur të vijë deri te marja e veprimeve faktike të kundërligjshme, përsëri janë të mundshme pasojat e ndalura nga ai veprim. Nga këtu në teorinë juridike, do të hasim se faji si marëdhënje psikike, gjegjësisht si vendim psikik “i paraprin veprimit fizik, e inkurajon dhe me atë drejton.” Në kontekst të kësaj autor të caktuar theksojnë se:” Veprimi fizik si veprim vetanak paraqet vetëm qëllim të fajit, manifestim të tij në botën e jashtme.”⁹² E fundit është vërtetim më tepër për përfundimin e thënë më sipër se dëmtuesi nuk përgjigjet pse të dëmtuarit i ka shkaktuar dëm, por përgjigjet për shkak të asaj se është fajtor për dëmin që është shkaktuar. Fajtor në kontekst të asaj që ndodhet në marëdhënjen psikike (intelektuale) me veprimin e kundërligjshëm të cilin e mer dhe pasojës që del nga ai veprim (dëmi). Me një fjalë është fajtor për shkak të asaj se i vetëdijshëm mer veprim të caktuar të kundërligjshëm gjegjësisht për shkak të mundësisë së humbur ti hiket veprimit të tillë, dhe gjithsesi për shkak të dëshirës nga ai veprim të paraqitet pasojë juridike konkrete ose për shkak të lëshimit të vëmendjes së duhur që në rast të caktuar është dashur ta ketë, dhe për shkak të asaj ka ardhur deri tek pasoja e caktuar e dëmshme. Ose thënë ndryshe, fajtor është për shkak të asaj se në rethanat e caktuara nuk ka vepruar në mënyrë të duhur. Kështu, në kuptim më asprakt, paraqet lartësim të asaj që e paraqet thelbin e dëmit, (e cila e përfshin edhe qëllimin, edhe pakujdësinë, si dy forma të saj zhvilluese).⁹³ Nga këtu, në teorinë juridike edhe haset definim i tillë i fajit. Por jo vetëm në teorinë juridike por edhe në Skicen e Ligjit mbi detyrimet dhe kontratat të prof. M.Konstatinoviç nga viti 1969 në nenin 127 i titulluar “Kur egziston faji”, do të lexojmë se:”

⁹² J. Radisiç, op. cit. fq.194.

⁹³ G. Galev, J. D.Anastasovska, Obligaciono pravo, Shkup, 2012, fq.666.

Gjatë vendimit a është fajtor apo jo personi që e ka shkaktuar dëmin d.m.th a është sjellur si duhet, gjygi llogarit për rjedhën e punëve dhe për atë që nga personi i vetëdijshëm dhe i vëmendshëm a do të ishte i pritshëm veprimi i tillë në rastin e caktuar.”

Pranimi i fajit si kategori psikike detyrimisht na çon në pyetjen për marëdhënjen e saj me afësinë për të gjykuar. Aftësia për të gjykuar është fenomen natyror të cilin çdo person fizik (përveç atyre që kanë ngecje në zhvillimin psikik gjegjësisht të sëmurëve shpirtëror), e fiton me aritjen e nivelit të caktuar të pjekurisë psikofizike. Tek ne ajo ndodh me mbushjen e moshës 14 vjeçare te personat fizik.⁹⁴ Vetëm personi i aftë për të gjykuar mund të sjell vendime relevante juridike në pikpamje të sjelljes së tij në rethana të caktura dhe kushte të caktuara. Kështu, nëse nga sjellja (aktive ose pasive) e personit të caktuar në situata të caktuara dhe rethana dalin pasojat të caktuara të dëmshme të cilat e çënojnë sferën e pasurisë dhe personalitetin e personit tjetër atëherë për atë person do të themi se është fajtor dhe nga këtu, është i obliguar që ti mënjanojë pasojat e dëmshme. Në marëdhënie të tillë ndërmjet aftësisë për të gjykuar dhe fajit, është e qartë se aftësia për të gjykuar i paraprin fajit dhe e kushtëzon egzistimin e saj. Radhazi kuptuar në atë kuptim që marja e veprimit të kundërligjshëm mund ti shkruhet në faj ndërmarrësit vetëm nëse ai është i aftë për të gjykuar dhe më tej si i tillë të jetë përgjegjës ti mënjanojë pasojat e dëmshme nga veprimi i atij. Përkundër kësaj, nëse ndërmarrësi nuk është i aftë që të gjykojë, bie faji i tij për marjen e veprimeve të kundërligjshme dhe me atë edhe përgjegjsia për pasojën e dëmshme. Në vërtetim të asaj flasin edhe vendimet juridike në të drejtën tonë, por edhe vendimet nga kodifikimet e ndryshme civile sipas të cilave, për shkak të mungesës së aftësisë për të gjykuar, përsoneat me ngecje psikike (idiotë, imbecil dhe debil) ose me sëmundje shpirtërore nuk përgjigjen për pasojat e dëmshme që dalin nga veprimi i tyre i kundërligjshëm.⁹⁵ Nuk përgjigjen për shkak të asaj se te ato mungon aftësia për të gjykuar, dhe me atë edhe faji si marëdhënie subjektive te ata ndaj veprimit të dëmshëm dhe dëmit si pasojë nga veprimi i tillë. Me këtë kategori të njerëzve janë të barazuar edhe personat e moshës shtatë vjeçare. Duke pasur parasysh moshën e tyre të hershme llogariten si absolutisht të paaftë për të gjykuar. Nga këtu ata nuk mund të jenë fajtor për veprimet që i marin e as po të përgjigjen për pasojat nga ai veprim.⁹⁶ I njëjtë është rasti edhe me personat të cilët pa fajin e tyre janë të sjellur në gjendje të paaftësisë kalimtarë për të gjykuar në të

⁹⁴ LMD, Neni 147.

⁹⁵ LMD, Neni 146.

⁹⁶ Shih nenin 147 LMD.

cilin rast me veprimin e vet kanë shkaktuar dëm personit të tretë. Në këtë rast përgjegjsia për dëmin bie te personat për faj të të cilëve ka ardhur dëmtuesi në gjendje të tillë. Kur flasim për aftësinë për të gjykuar te personat juridik, e cila gjithashtu përgjigjet për dëmin që do tia shkaktojë personit të tretë, në këtë kontekst vetëm do të përmendim se te ata si krijime të përgjithsuara, si faji ashtu edhe aftësia për të gjykuar janë nxjerur nga aftësia për të gjykuar e personave fizik të punësuar në personin juridik gjegjësisht nga aftësia për të gjykuar e organeve të personit juridik (direktorit, bordi i drejtorëve etj. të cilët janë njëkohësisht edhe persona fizik).

Egzistojnë dy lloje themelore të dëmit edhe atë: qëllimi dhe pakujdesia.⁹⁷ Duhet të theksojmë se i njëjtë është rasti edhe me kodifikimet më të vjetra edhe me kodifikimet më të reja të të drejtës civile. Edhe te ato i takojmë këta dy lloje themelore të dëmit. Në korniza të këtyre dy llojeve themelore të dëmit egzistojnë më tepër nënlloje, për të cilat do të flasim me poshtë.

Qëllimi(dolus) si lloj i veçantë i fajit sipas radhitjes së tij ndaj dëmtuesit shikuar hierarkisht qëndron më lartë. Me fjalë të tjera, ai paraqet llojin më të rëndë të fajit. Kjo për shkak të asaj se te ajo qortimi që i vëndohet dëmtuesit është ngushtë i lidhur me personalitetin e tij. Kështu në këtë kuptim dëmtuesi intelektualisht (i përgjegjshëm) është ngushtë i lidhur në raportin me verpimin e dëmshm të tij pasoja e paraqitur e dëmshme nga ai veprim i cili del si pasojë e atij veprimi (dëmi). Intelektualiteti kuptuar si një element themelor i qenies së qëllimit si lloj i dëmit, tregon në prani të vetëdijes, në ndërgjegjsimin e dëmtuesit për kundërligjshmërinë e veprimit që e mer gjegjësisht që përmbahet ta mer (kur atë nuk ka guxuar ta bëjë), si dhe në prani të vetëdijës së tillë të paraqitur si pasojë e saj. Elementi vullnetar, si element i dytë themelor i qenies së qëllimit si lloj i fajit, përsëri, tregon në raportin e dëmtuesit që si kryes i veprimit të kundërligjshëm e ka pasë me vet atë veprim edhe ndaj dëmit të shkaktuar si pasojë e saj, shikuar në aspekt të vullnetit të tij. Me një fjalë këtu dëmtuesi, përveç se është i vetëdijshëm për atë që e bën gjegjësisht nuk e bën, ai edhe e don atë ose vetëm pajtohet me paraqitjen e pasojave nga ai veprim ose mosveprim. Në çdo rast, e përbashkëta te këta dy elemente të qëllimit (vetëdija dhe vullneti) është karakteri subjektiv i tyre, ajo e para, dhe e dyta, e përbashkët është ajo se vetëm ekzistimi i tyre kumulativ nuk çon në ekzistimin e qëllimit si lloj më i rëndë i fajit. Në të kundërtën, mungesa e cilitdo prej këtyre d.m.th edhe mungesë e qëllimit si lloj i dëmit. Kështu, këto dy elemente: intelektual dhe

⁹⁷ LMD, Neni 145.

vullnetar në rast konkret a ekzistojnë nga ana e marësit të veprimeve të caktuara apo jo, është pyetje që do të duhet të vërtetohet. Bara e vërtetimit këtu bie në anën e palës së dëmtuar. Gjithë kjo tregon në faktin se kur bëhet fjalë për qëllimin si lloj më i rëndë i fajit ekzistimi ose mosekzistimi i tij nuk vërtetohet apstrakisht (që përndryshe do të shohim se si rregull, është rasti të pakujdesia), por ajo vlerësohet konkretisht në çdo rast të vetëm. Me fjalë të tjera, për atë edhe nuk është e mjaftueshme njohuria e përgjithshme se nga sjellja e caktuar e subjekteve mund të paraqitet ndonjë pasojë negative, por nga çdo rast i vetëm kërkohet që të vërtetohet se në rastin e caktuar konkret ka dashur që me veprimin e caktuar në mënyrë të ndërgjegjshme të shfaqet konkretisht pasoja e dëshiruar. Kështu në teorinë juridike edhe do të hasim se paraqet faj konkret ose shprehur latinisht *dolus in concreto*. Posaçërisht përsëri reth elementit vullnetar, vlen të theksohet se në mvarshmëri nga shkalla e pranueshmërisë së saj mund të paraqitet si direkte dhe indirekte (eventuale). Qëllimi direkt ekziston kur dëmtuesi qëllimisht ka dashur që me veprimin e tij të dëmshëm ti shkaktohet dëm tjetërkujt (të dëmtuarit). Kështu definimi i qëllimit qartë tregon në ekzistimin e vetëdijes nga ana e dëmtuesit, për atë që e bën se është e palejueshme, e kundërligjshme, se rezultati i saj është shkaktimi i pasojave të dëmshme, dhe dëshira deri te ajo të vije. Kështu d.m.th qëlli i i dëmtuesit ka qenë që me marjen e veprimit të dëmshëm t'ia shkaktojë të dëmtuarit pasojën e dëshiruar të dëmshme. Për dallim prej kësaj te qëllimi eventual dëmtuesi nuk ka pasur qëllim paraprak që me veprim të caktuar ti shkaktojë dëm të dëmtuarit. Megjithatë edhe pse nuk ka dashur përsëri ai ka pranuar si të mundur, eventuale pasojën që nga verimi i tij ose nëse ajo është paraqitur ai është pajtuar me atë. Shkurt thënë, qëllimi direkt dhe eventual së bashku paraqesin dëshirë të vetëdijshme që me veprim të dëmshëm ti shkaktohet tjetrit dëm i caktuar (qëllim direkt) ose pajtim që me dëmin e shkaktuar eventual edhe pse nuk ka qenë qëllim i atij veprimi (qëllim eventual). Sidoqoftë ndarja në qëllim direkt dhe eventual nuk ka ndonjë domethënjë në të drejtën obligatore. Njëlloj përgjigjet për dëmin e shkaktuar, pa marrë parasysh a është paraqitur me qëllim direkt ose indirekt. Për dallim prej kësaj në të drejtën penale përgjegjsia është më e rreptë kur vepra penale është shaktuar me qëllim (paramendim).⁹⁸

Pakujdesia (culpa) është lloj më i lehtë i fajit. Për atë mund të thuhet se paraqet lëshim të kujdesit të duhur të cilin në rethana të caktuara është dashur të ketë kryesi i veprimit të kundërligjshëm. Prandaj, në mvarshmëri nga shkalla e kujdesit që kërkohet, kurse në rethana të caktuara ka qenë e lëshuar, për cilin shkak edhe ka ardhur deri te pakujdesia nga ana e

⁹⁸ G. Galev, J. D. Anastasovska, Obligaciono pravo, Shkup, 2012, fq.671.

shkaktuesit të veprimit të kundërligjshëm, pakujdesia mund të paraqitet në tre grupe: pakujdesi e plotë-culpa lata, pakujdesi e rëndomtë(lehtë) – culpa levis dhe pakujdesi si në punët e rëndomta.

Pakujdesia e plotë -culpa lata ekziston kur dëmtuesi me veprimin e caktuar nuk ka pasur as atë shkallë të kujdesit që pritet nga ndonjë njeri mesatar (njeri të cilit nuk është e duhur çfarëdolloj diturie ose përvojë). Në rastin konkret bëhet fjalë për vëmendje të pritur të zakonshme të cilën sipas natyrës e ka çdo njeri me vetëdije të zhvilluar normale dhe aftësi për të gjykuar. Mungesa e kësaj shkalle të vogël të vëmendjes gjatë marjes së veprimit të caktuar (ose përmbajtjes nga ai) supstituhet tek vepruesi me pakujdesinë e tij të plotë, për shkak të cilës ai është fajtor dhe prej këtu edhe përgjegjës për dëmshpërblim të dëmit që është pasojë e sjelljes së tij joshembullore. Kjo lloj pakujdesie është shumë afër me qëllimin si lloj i fajit, e cila posaçërisht shihet edhe nëpërmjet vëllimit të kompenzimit të dëmit.

Pakujdesia e lehtë-culpa levis ekziston atëherë kur dëmtuesi gjatë marjes së vendimit të caktuar (ose përmbajtjes nga ai) e ka humbur atë shkallë të kujdesit i cili kërkohet nga ai si njeri i kujdesshëm, aftësia e të cilit dhe vëmendja janë mbi nivel (jo të zakonshme). Në këtë rast bëhet fjalë për shkallën standarde të kujdesit, të njohura në teorinë juridike si: kujdes si tregtar i mirë, gjegjësisht kujdes si shtëpiak i mirë dhe kujdes si profesionist i mirë.⁹⁹ Këto lloje të kujdesit, gjithsesi janë larg nga kujdesi mesatar i pranueshëm të njeriut normal. Ajo në atë kuptim se shkalla e ndërgjegjës dhe vetedijes te ata janë posaçërisht të shprehura. Vetëm lëshimi nga ndonjë nga standardet e lartëpërmendura të shkallëve të kujdesit në raste të caktuara e sjellin në veprim të sjelljes së caktuar të veprimit me pakujdesi të lehtë. Ky lloj i pakujdesisë është shkallë më e lehtë e pakujdesisë dhe nga këtu është shumë i përafërt me veprimet normale. Për shkak të saj ndonjëherë është shumë rëndë edhe që të përcaktohet kufiri mes sjelljes së lejuar normale me sjelljet e palejuara matur me standardet e shtëpiakut të mirë gjegjësisht tregtarit të mirë ose profesionistit të mirë.¹⁰⁰

Pakujdesia si me sendet e veta: në raste të caktuara, edhe pse të ralla, si masë a ka vepruar dikush me kujdes ose me pakujdesi miret kujdesi që e ka pasur gjatë kryerjes së punëve të veta- diligenda quam in suis rebus. Duke u nisur nga vëmendja vetanake si masë përcaktohet: i kujdesshëm do të ishte veprimi i personit të caktuar në lidhje me sende të huaja kur në raport me

⁹⁹ Shih Nenin 11, LMD.

¹⁰⁰ G. Galev, J. D. Anastasovska, Obligaciono pravo, Shkup, 2012, fq.671-672.

ta kishte kujdesin që e ka ndaj sendeve të veta. E kundërta e kësaj: kur ai person në raport me sendet e huaja nuk e ka paraqitur edhe kujdesin më të vogël që e ka ndaj sendeve të veta atëherë llogaritet se ka vepruar me pakujdesi. Në drejtim të kësaj flasin edhe dispozitat e ligjit mbi marrëdhënjet detyrimore ku thuhet: Pranuesi i depozitit është i obliguar që ta rruajë sendin si pronë të tij.¹⁰¹ Prandaj kjo shkallë e kujdesit kërkohet vetëm në raste kur depoziti është bëmirës (ruajtja është pa pagesë). Përkundër kësaj nëse depoziti është më kompensim pranuesi i depozitit është i obliguar që ta ruaj si tregtar i mirë gjegjësisht si shtëpiak i mirë. Në rastin e parë nëse ruajtësi i ka shkaktuar dëm të caktuar sendit, për shkak të asaj se sendin e ka ruajtur për interes të dëmtuarit gjyqji në rast kontesti mund ti caktoj dëmshpërblim më të vogël duke pasur parasysh ndërgjegjen që dëmtuesi e tregon ndaj sendeve personale.

Vërtetimi i pakujdesisë apstrakte dhe konkrete: si rregull ekzistimi i pakujdesisë vërtetohet apstrakisht. Sjellja e marësit të veprimit ose përmbajtja e tij nga ai veprim nuk vlerësohet sipas raportit subjektiv të dëmtuesit ndaj tij dhe nga pasoja që del nga ai veprim por a është sjellja e tij në pajtim me sjelljen e vërtetuar më parë si tipar apstrakt i atij personi. Ky person në ralitet nuk ekziston, por paramendohet gjegjësisht meret si shembull si masë për vërtetimin e sjelljes se dikujt që ka marë veprim të caktuar real. Me fjalë të tjera, sjellja e marësit të veprimeve të caktuara, matet sipas sjelljes ideale standarde të tipit apstrakt të paramenduar të personit. Për të tillë në të drejtë llogaritet: shtëpiaku i mirë gjegjësisht tregtari i mirë ose profesionisti i mirë si dhe personi mesatar, e si i tillë llogaritet çdo njeri me ndërgjegje dhe vullnet të zhvilluar. Nëse gjatë vlerësimit të sjelljes së personit të caktuar konstatohet se te ai në situatë të caktuar dhe në rethana të caktuara ka ardhur deri te lëshimi i vemëndjes standarde (vemëndje e shtëpiakut të mirë), për atë do të thuhet se ka vepruar me pakujdesi, për atë se do të jetë përgjegjës për pasojën e dëmshme. Prandaj, nga lloji i kujdesit të lëshuar, pakujdesia e saj mund të paraqitet si përfundimtare ose pakujdesi i thjeshtë abstrakte – *culpa in abstracto*. Gjatë vërtetimit të llojit të tillë të pakujdesisë pronat personale, dijenitë dhe përvoja janë irelevante. Ajo praktikisht d.m.th se dëmtuesi nuk ka mundësi ta hjek përgjegjësinë nga vetja me bindjen se ka bërë gjithçka është në domenin e mundësive të tij. Kjo qartë tregon se në këtë mënyrë pakujdesia e vërtetuar nga terreni subjektiv përçohen në terrenin objektiv. Sa të jetë ajo e saktë përsëri mbisundon teoria sipas së cilës pakujdesia apstrakte është më e pranueshme. Si argument për këtë theksohet fakti se përderisa niset nga vlerësimi subjektiv i kryesit të veprimit i cila llogaritet si i drejtë, thuajse edhe

¹⁰¹ Shif Nenin 770 alinea 1, LMD.

nuk do të vinte në situatë dikush të përgjigjet për veprimet e veta. Prandaj më e pranueshme është regulla apstrakte sipas së cilës vërtetohet çfarë veçorish kryesi duhet të ketë pasur, e jo çfarë ka pasur personalisht. Por sado që të duket apstrakte kjo regull, prapë se prapë edhe sipas saj vlerësimi i sjelljes së dëmtuesit nuk gjendet duke bërë dallimin me sjelljen e personit tjetër i cili është shtëpiak i mirë, por si të ndonjë personi tjetër me karakteristika në thelb të njejta më karakteristikat e kryesit. Kjo nuk do të thotë se gjatë kushteve të njejta dhe rethanave të njejta nga çdokush kërkohet që të sillet si edhe çdo njeri tjetër që do të ndodheshte në ata kushte dhe rethana.

Përskaj pakujdesisë apstrakte – culpa in abstracto e cila si rregull është e pranuar edhe në të drejtën tonë, në shkencën juridike dhe praktikën gjyqësore, me përjashtim e drejta jonë njih edhe pakujdesinë konkrete – culpa in concreto. Ai është rast me rregullin – Nëse dëmtuesi shkaktonte dëm duke punuar diçka në favor të të dëmtuarit, gjygi mundet të përcaktojë kompenzim më të vogël të dëmit duke pasur parasysh përgjegjësinë që e ka pasur dëmtuesi dhe e ka treguar gjatë kryerjes së punëve të veta.¹⁰² Nga kjo qartë del se në këtë rast gjatë vërtetimit të fajit të dëmtuesit paraqitet nga ajo se si ai konkretisht është sjellur duke punuar për të dëmtuarin. Prandaj, masë bazë me të cilën vërtetohet ekzistimi gjegjësisht mosekzistimi i kujdesit të duhur të dëmtuesit është shkalla e ndërgjegjshmërisë që e ka treguar me punët personale.

Gjatë ekzistimit të dëmtuesit të aftë për të gjykuar, i cili ka marrë veprim të caktuar të kundërligjshëm (si bërje ose përmbajtje), nga i cili është shkaktuar pasoja e caktuar e dëmshme (dëmi), parashtrrohet pyetja: te ata ekzistimi i dëmit a supozohet apo vërtetohet? Përgjigjja e kësaj pyetje mvaret nga ajo se për cilin lloj të dëmit bëhet fjalë. Edhe pse siç do të shohim më poshtë, e drejta jonë por jo edhe vetëm ajo, si rregull pajtohet me paragjykim të dëmit.

Përkundër të drejtës penale, sipas së cilës faji i kryesit të veprës penale duhet të vërtetohet, pa përjashtim, kurse në të kundërtën humb përgjegjsia për të në të drejtën obligatore ekzistimi i saj në raste të caktuara supozohet. Nga kjo kemi edhe dispozitat e Ligjit mbi marrëdhënjet detyrimore ku thuhet “ekziston faj” kur ai dëmin e ka shkaktuar “me qëllim ose pakujdesi”. Kështu e rregulluar kjo pyetje sikur tregon na atë se ekzistimi i fajit të dëmtuesit duhet të vërtetohet. Kështu në këtë kontekst kur “dëmi është shkaktuar me pakujdesi të thjeshtë ose shkallë tjetër më e vogël të papërgjegjshisë “ nga dëmtuesi nuk kërkohet që të vërtetohet ta tregojë

¹⁰² LMD, Neni 180, al.2.

ekzistimin e saj. Përkundër kësaj nga supozimi se ata ekzistojnë për shkak të asaj parashihet se dëmtuesit të cilit i është dhënë mundësi ta vërtetojë të kundërtën ose si potencohet në vendimin ligjor se “ ta vërtetojë se ata nuk kanë ekzistuar.”¹⁰³ Kështu qartë tregohet se në rast se bëhet fjalë për supozim të paraparë e cila është relative, dhe jo e natyrës absolute. Kështu e rregulluar pyetja për vërtetimin e ekzistimit të fajit, në çdo rast në situatë më të mirë e len të dëmtuarin, për shkak të asaj se e liron nga bara e vërtetimit për ekzistimin e fajit të dëmtuesi. Ai vetëm duhet të vërtetojë se dëmi që e ka pësuar është si pasojë e veprimit të dëmshëm dhe të kundërligjshëm të dëmtuesit. Me fjalë të tjera ta vërtetojë kauzalitetin (ekzistimin e lidhjes shkakore) ndërmjet veprimit të dëmshëm si arsye dhe dëmi e shkaktuar të dëmtuarit, si pasojë nga ajo arsye. Si ky përcaktim në të drejtën tonë, kemi në dispozitat e Ligjit Mbi marrëdhënjet detyrimore. Kështu sipas nenit 151 të LMD supozohet ekzistimi i fajit të personit i cili në bazë të ligjit, vendim të organit kompetent ose kontratë ka qenë i detyruar ta mbikqyrë dëmtuesin i cili ka qenë i sëmure shpirtërisht apo ka ngecje në zhvillimin psikik ose për shkaqe tjera nuk ka qenë i aftë që të gjykojë. Në rast të tillë kryesi i mbikqyrjes mund të lirohet nga përgjegjsia nëse arin ta vërtetojë se e ka kryer mbikqyrjen për të cilën ka qenë i obliguar dhe se dëmi do të shkaktohej edhe gjatë mbikqyrjes së kujdesshme nga ana e kujdestarit. I supozuar është edhe faji i prindërve për dëmi që do ta shkaktojë fëmija i tyre shtatë vjeçar, përveç nëse e vërtetojnë se nuk ka faj nga ana e tyre.¹⁰⁴ Kështu edhe në dispozitat tjera ligjore hasim për fajin e supozuar ku parashihet se: Për dëmin që i punësuari në punë ose në lidhje me punën do t’ia shkaktojë personit të tretë përgjigjet punëdhënësi tek i cili ka qenë i punësuar punëtori në momentin e shkakimit të dëmit, vetëm nëse vërtetohet se punëtori në rethanat e dhëna nuk ka vepruar ashtu siç është dashur.¹⁰⁵ I njëjtë është rasti edhe me përgjegjsinë të personat juridik për dëmin që do ta shkaktojë organi i tij personit të tretë gjatë kryerjes ose në lidhje me kryerjen e funksioneve të veta.¹⁰⁶ Te përgjegjsia kontraktuale për dëmin e shkaktuar hasim raste të fajit të supozuar. Gjatë mospërbushjes së plotë ose të pjesërishtme të obligimit të marrë kontraktual kreditori përveç përbushjes, ka të drejtë nga kreditori që të kërkojë edhe dëmshpërblim për dëmin që e ka pësuar për shkak të asaj mospërbushje. Në këtë rast kërkesa e tij bazohet në fajin e supozuar të debitorit. Ky mund të lirohet nga obligimi i tij vetëm në rast se e hedh poshtë supozimin për fajin e tij. Kështu Ligji mbi

¹⁰³ Shih LMD, Nenin 145.

¹⁰⁴ Shih Nenin 154, LMD.

¹⁰⁵ Neni 157, al.1, LMD.

¹⁰⁶ Shih Nenin 158, al.1, LMD.

marëdhënjet detyrimore parasheh që: nëse vërtetohet se nuk ka mundur ta plotësojë obligimin e vet, gjegjësisht se është vonuar me plotësimin e obligimit për shkak të rethanave të shfaqura pas mbushjes së kontratës të cilat nuk ka mundur ti ndal, hjek apo t'ju hik.¹⁰⁷

Kështu e rregulluar pyetja për fajin e supozuar qartë tregon se fusha e saj është reativisht e kufizuar. Kjo në kuptim të asaj se supozohen llojet më të lehta të pakujdesisë, e veçanërisht pakujdesia e thjeshtë, e kuptuar si lëshim standard i sjelljes që kërkohen nga shtëpiaku i mirë, tregtari i mirë ose profesionisti i mirë,¹⁰⁸ por jo edhe pakujdesia përfundimtare, gjegjësisht qëllimi si lloj më i rrëndë i fajit. Duke pasur parasysh pasojat deri te të cilat mund të arihet te ky lloj i pakujdesisë edhe për llojet tjera të pakujdesisë kërkohet nga subjektët gjatë marjes së veprimeve të caktuara nga ana e tyre dhe veprimeve të sillen sipas standardit të kërkuar të kujdesit, e cila nga ana e vete, është e pritshme se do të ketë rjedhë pozitive. Megjithatë nëse dorëhiqet nga lloji i kërkuar i vëmendjes, dhe për shkak të asaj mund të vije në pasoja të dëmshme të cilat do ta atakojnë njërin subjekt të së drejtës, atëherë njëri, pa pasur obligim që ta vërtetojë pakujdesinë e marësit të veprimit të caktuar të kundërligjshëm, ka të drejtë të kërkojë pasojat e tilla të mënjanohej. Kjo në këtë rast nismën e ka nga supozimi se pasojat e tilla janë rezultat nga vëmendja e pritshme e duhur e lëshuar (vëmendja e shtëpiakut të mirë, gjegjësisht tregtarit të mirë ose vëmendja e profesionistit të mirë ose vëmendje tjetër më lehtë e pritur), për shkak se subjekti i cili e ka bërë lëshimin edhe është përgjegjës që ti mënjanojë pasojat e përmendura. Duke pasur parasysh se supozimi për ekzistimin e fajit nga ana e marësit të veprimit të kundërligjshëm është e rëzueshme nëse ai e vërteton të kundërtën: se ka vepruar në korniza të vëmendjes së standardizume, ose se për dëmin është fajtor personi i tretë ose përsëri së ajo është shfaqur për shkak të rethanave të jashtme të cilat ai nuk ka mundur ti parashohë, ndaloj apo ndërpres, atëherë do ti hikë përgjegjësisë për dëmin e shkaktuar.

Për dallim nga pakujdesia e thjeshtë e cila siç pamë supozohet, qëllimi dhe pakujdesia përfundimtare si lloje më të rënda të fajit, vërtetohen. Në konotacion të kësaj kemi edhe dispozitat e Ligjit mbi marëdhënjet detyrimore ku thuhet: Nëse dëmi është shkaktuar më qëllim ose me pakujdesi përfundimtare, dëmtuesi duhet ta vërtetojë ekzistimin e tyre.¹⁰⁹ Kështu nga kjo del qartë se bara e vërtetimit, bie në krahë të të dëmtuarit. I tillë është rasti me dëmin të

¹⁰⁷ LMD, Neni 252.

¹⁰⁸ Shih Nenin 18, LMD.

¹⁰⁹ LMD, Neni 145, al.2.

cilin punëtori i caktuar i personit juridik me qëllim ose pakujdesi përfundimtare do ti shkaktojë personit të tretë gjatë kryerjes së punëve të veta ose në lidhje me punën. Gjegjësisht në këtë rast personi i tretë si i dëmtuar do të arrijë që me kërkesë të tijën dëmi ti kompenzohet vetëm me kusht të arrijë ta vërtetojë se dëmtuesi (punëtori) me qëllim ose pakujdesi përfundimtare i'a ka shkaktuar dëmin.¹¹⁰ I tillë është rasti gjatë kufizimit të kontraktuar të shpërblimit të lartësisë së dëmit deri te i cila ka ardhur për shkak të pamundësisë për përmbushje të obligimit nga kontrata përkatëse. Gjegjësisht, kufizimi i tillë si rregull është i lejueshëm, por vetëm nëse pamundësia për përmbushje të detyrimit është paraqitur për shkak të pakujdesisë së thjeshtë. Megjithatë, kur kreditori do ta vërtetojë se deri në atë situatë ka ardhur për shkak të qëllimit ose pakujdesisë përfundimtare të debitorit, atëherë ai ka të drejtë në shpërblim të plotë të dëmit.¹¹¹ Në bazë të fajit të vërtetuar, edhe atë qëllimit dhe pakujdesisë përfundimtare, do të përgjigjet deportuesi për dëmin që e shkakton i cili është paraqitur nga humbja ose dëmtimi i dërgesës në të cilën ka pasur gjëra të vlefshme, letra me vlerë ose sende tjera të vlefshme.¹¹² Në linjë me këtë është edhe vendimi i nenit 780 alinea 3 e Ligjit mbi marrëdhënjet detyimore ku thuhet për përgjegjësinë e pakufizuar të hotelierisë është e nevojshme të vërtetohet faji i tij dhe faji i personit që përgjigjet për atë. Në rast të tillë, nevoja për vërtetim të ekzistimit të fajit ekziston çdo herë ndaj personit me mashtrim, me dhunë ose me keqpërdorim të ndonjë marrëdhënie mvarshmërie ose varshmërie është kryer vepër penale kundër lirisë gjinore morale.¹¹³ Shembull vetanak të fajit të vërtetuar hasim edhe në vendimin e nenit 155 të Ligjit mbi marrëdhënjet detyimore. Shembujt e lartëpërmednur qartë tregojnë se gjatë shkaktimit të dëmit me qëllim ose pakujdesi të rëndë i dëmtuari, përveç ekzistimit të lidhjes shkakore ndërmjet veprimit të dëmshëm dhe dëmit të shkaktuar nga ai veprim, ende është i obliguar që ta vërtetojë edhe ekzistimin e qëllimit gjegjësisht pakujdesisë përfundimtare. Nevoja për vërtetimin e këtyre dy llojeve më të rënda të fajit është edhe i kuptueshëm nëse e kemi parasysh faktin se ekzistimi i tyre te dëmtusi supozohet se ai në mënyrë drastike ka hekur dorë nga sjellja e tij, krahasuar me sjellje që pritet nga ai si njeri me ndërgjegjshmëri normale të zhvilluar dhe vullnet ose thënë ndryshe nga njeri me aftësi normale ose mesatare. Kështu në një rast konkret kemi sjellje të tillë ose mënyrë më të ashpër të sjelljes

¹¹⁰ Shih Nenin 157, al.2 dhe 4, LMD.

¹¹¹ Shih Nenin 254, al.4, LMD.

¹¹² LMD, neni 728, al.1.

¹¹³ Shih Nenin 191, LMD.

(rast me qëllimin), nuk është i mundur të supozohet, por ai i cili do ta pretendojë atë duhet edhe ta vërtetojë.

Kur jemi të vërtetimi i fajit, ngel që në fund të tregojmë se përveç vërtetimit të detyrueshëm të qëllimit dhe pakujdesisë përfundimtare nga ana e të dëmtuarit, në raste të caktuara, kur e kërkon ligji, vërtetimi i fajit mund të bjerë në barë të personave tjerë. Në radhën e atyre personave mund të jetë edhe dëmtuesi vetë të i cili bie bara për dëmin e shkaktuar në bazë të ekzistimit të fajit të supozuar (pakujdesia e thjeshtë). Ai mes tjerash faji me të cilën rëndohet mund ta hjek prej vetes më vërtetimin se ai nuk është fajtor për dëmin, por së për atë është fajtor i dëmtuari, dikush tjetër ose se përsëri faji është i ndarë (mes tij dhe të dëmtuarit).¹¹⁴

Shkalla e fajit është rethanë me rëndësi për shpërblimin e dëmit. Kur dëmi material shkaktohet me dashje (dolus) dhe nga pakujdesia (culpa lata), shpërblimi i dëmit përfshin dëmin e vërtetë (damnum emergens) dhe fitimin e humbur (lucrum cessans). Qysh në të drejtën romake ishte formuar si rregull (ciupa lata dolo aequiparatur), kurse kur dëmi shkaktohet nga pakujdesia e rëndomtë – culpa levis, culpa levis in concreto, culpa levis in abstracto, shpërblehet dëmi i vërtetë.¹¹⁵

2.4. Gjendja pasurore e dëmtuesit dhe të dëmtuarit

Gjendja pasurore e dëmtuesit dhe të dëmtuarit është një kriter tjetër me rëndësi, i cili meret parasysh me rastin e caktimit të dëmit material. Shpërblimi i dëmit material nuk duhet të sjellë dëmtuesin në pozitë të rëndë që të mos ketë mjete për mbajtjen e familjes. Ky është ai moment social i cili e shtyn gjykatën që të caktojë lartësi më të ulët të shumës së shpërblimit të dëmit të të dëmtuarit. Duhet theksuar se këtu gjykata duhet të ketë parasysh edhe gjendjen materiale të të dëmtuarit: sjellja e të dëmtuarit, p.sh. a është shkaktuar dëmi me dolus ose me culpa lata, si dhe fajin e të dëmtuarit, sa ka kontribuar ai në shkaktimin e dëmit. Subjekti që e ka shkaktuar dëmin me dashje ose nga pakujdesia e rëndë nuk meriton që nga ky shkak t'i zvogëlohet shuma e shpërblimit të dëmit.¹¹⁶

¹¹⁴ G. Galev, J. D. Anastasovska, Obligaciono pravo, Shkup, 2012, fq.679.

¹¹⁵ N. Dauti, E drejta e Detyrimeve, (Pjesa e përgjithshme dhe e veçantë), Prishtinë, 2001, fq.199

¹¹⁶ Shih LMD, Neni 180.

KREU III

RASTET E VEÇANTA TË SHPËRBLIMIT TË DËMIT

1. RASTET E VEÇANTA TË REALIZIMIT SHPËRBLIMIT TË DËMIT MATERIAL

Dëmi material mund të paraqitet në rast të vdekjes, lëndimit trupor dhe dëmtimit të shëndetit, e kjo domethënë në rast të lëndimit të të dejtave personale të njeriut, lidhur me ekzistimin e integritetit trupor, por vetëm kur ai lëndim ka pasoja materialo-juridike të cilat paraqiten si dëm material.¹¹⁷

1.1.Shpërblimi i dëmit material për shkak të lëndimit trupor dhe dëmtimit të shëndetit

Me lëndim trupor dhe dëmtim të shëndetit kuptohet çrregullimi i integritetit trupor ose psikik (shpirtëror) të një subjekti që ka për pasojë dëmin material.

Ky lloj i dëmit përbëhet nga harxhimet që i dëmtuari i ka pasur për mjekim dhe harxhimet tjera lidhur me mjekimin, si dhe të ardhurat e humbura për shkak të pamundësisë për punë gjatë kohës sa ka zgjatur mjekimi. Por, nëse i dëmtuari, për shkak të humbjes së plotë apo të pjesërishtme të aftësisë për punë e humb fitimin ose nevojat i janë përgjithmonë të ritura, ose mundësitë për zhvillim të mëtejshëm dhe përparim janë humbur ose të zvogëluara, personi përgjegjës është i obliguar që të dëmtuarit ti paguajë kompenzim të përcaktuar si rentë në të holla, si dëmshpërblim.¹¹⁸

Në këto shpenzime hyjnë: barërat, intervenimet mjekësore, furnizimi me proteza, shpenzimet për qëndrimin për shërim në spitale, për shërim klimatike (në banjo), shpenzimet për mjetet ortopedike, shpërblimi për personin që i shërben të dëmtuarit, shpenzime tjera për kujdesin dhe shpenzimet e transportit.¹¹⁹

Rentën në të holla në rast mosmarëveshje e përcakton gjygi kompetent. Gjygi mundet edhe ta zmadhojë lartësinë e rentës në të ardhmen me kërkesë të dëmtuarit, por mundet

¹¹⁷ G. Galev, J.D. Anastasovska, Obligaciono pravo, Shkup 2012

¹¹⁸ LMD, Neni 184.

¹¹⁹ N. Dauti, E drejta e detyrimeve, Prishtinë, 2001.

edhe ta zvogëlojë edhe plotësisht ta shfuqizojë, me kërkesë të dëmtuesit, nëse rënjësisht ndërohen rethanat të cilat gjygi i ka pasur parasysh kur e ka sjellë vendimin e parë.¹²⁰

E drejta në shpërblim dëmi e gjykuar si lloj i rentës në të holla nuk mund të përçohet në person tjetër.¹²¹ Kuptuar kështu ajo paraqet të drejtë që nuk përçohet. Megjithatë, sumat e aritura të kompenzimit mund ti transferohen tjetërkujt me kusht që shpërblimi i dëmit të jetë i përcaktuar me marrëveshje të nënshkruar ose me vendim gjygjësor të plotëfuqishëm.

1.2.Shpërblimi i dëmit material për shkak të vdekjes

Ky lloj i dëmit paraqitet në rast të vdekjes pa marrë parasysh a është vdekja pasojë e drejtpërdrejtë e veprimit të dëmshëm e cila ka pësuar menjëherë pas kryerjes së atij veprimi, ose pas kalimit të një kohe të caktuar me të shkurtë ose më të gjatë, pas kryerjes së veprimit të dëmshëm. Në rastin e parë dëmi material i shkaktuar me vdekjen e atij personi përbëhet nga harxhimet për varimin e tij; humbja e përkujdesjes ose ndihmesës që personi e ka pasur nga i vdekuri i cili është përkujdesur ose e ka ndihmuar, si dhe nga përkujdesja e humbur e personit që sipas ligjit ka pasur të drejtë të kërkojë përkujdesje nga i vdekuri. Në rastin e dytë, reth dëmit material të përmednur shtohen edhe harxhimet për mjekim dhe harxhimet tjera lidhur me mjekimin, si dhe përfitimin i cili është i humbur për shkak të humjes së aftësisë për punë të vdekurit.¹²²

Harxhimet në lidhje me varosjen paraqesin dëm material, të shkaktuara me vdekjen e dikujt vetëm nëse ata janë harxhime të zakonshme. Prandaj gjygi çdo herë mer parasysh çfarë është e përcaktuar në vend, por edhe sipas zakoneve fetare, i cili është harxhim i zakonshëm për varim.

Harxhimet e bëra për mjekim dhe harxhimet që kanë lidhshmëri me mjekimin paraqiten si dëm material në këto raste: ato janë të bëra për mjekimin e lëndimeve të mara nga veprimi i dëmshëm; dhe janë të nevojshme dhe të arsyeshme për zbatimin e mjekimit (shoqërimin e të sëmurit deri në vendin e shërimit, shfrytëzimi i protezave medicinale etj).

Fitimi i humbur për shkak të paaftësisë për punë është dëm material për fitimin e porealizuar nga momenti i lëndimit deri në vdekjen e personit. Fitimi i humbur është dëm material

¹²⁰ LMD, Neni 185.

¹²¹ LMD, Neni 166.

¹²² LMD, Neni 182.

edhe atëherë kur i vdekuri ka mbajtur dikend ose me ligj ka qenë i obliguar që të mbajë ndonjë person. Ndihma e humbur, është dëm material atëherë kur i vdekuri ka ndihmuar ndonjë njeri përderisa ka qenë gjallë. Ky dëm kompenzohet me pagesë të rentës në të holla.¹²³ Lartësia e rentës në të holla llogaritet sipas rethanave të dhëna të rastit, i cili nuk mund të jetë më i madh nga ai që i dëmtuari do ta kishte marur nga i vdekuri po të ishte gjallë.

1.3. Shpërblimi i dëmit material të shkaktuar me cënimin e dinjitetit

dhe përhapjes së fakteve të pavërteta

Dëmi material mund të shkaktohet edhe me cënimin e dinjitetit dhe përhapjen e fakteve të pavërteta për ndonjë person. Përhapja e fakteve të pavërteta përbëhet në thënjën apo përçimin e punëve të pavërteta për të kaluarën, dijeninë, aftësinë apo diçka tjetër. Kusht përhapja e këtyre fakteve është të çojë deri te shpërblimi i dëmit për personin përgjegjës (atë që i ka përhapur faktet e pavërteta) është që ai të ketë ditur ose medoemos ta ketë ditur se janë të pavërteta dhe nga ata shkaktohet dëm material.¹²⁴ Çfarë don të thotë kjo? Personi A dhe personi B janë dy advokatë të cilët punojnë në lagjen e njëjtë dhe në materie të njëjtë. Që ta zvogëlojë konkurrencën personi A fillon njerëzve të lagjes tju rëfejë për ditët studentore të personit B, me çka i potencon dhe i zmadhon dështimet e tij. Mbi të gjitha shton se ai regullisht proceset gjyqësore i humb dhe se palët e tij janë gjithmonë të pakënaqur. E gjithë kjo nuk është e saktë. Si rezultat i kësaj, puna e personit B dukshëm bie dhe ai ngadalë i humb klientët dhe me atë edhe fitimin. Personi B e padit personin A dhe e fiton procedurën për shpërblim të dëmit.¹²⁵

Përgjegjsi për dëmin e shkaktuar në rast të përhapjes së fakteve të pavërteta, nuk ka kur ai që i ka interpretuar nuk e ka ditur se nuk janë të pavërteta ato që i interpreton, me kusht që ai ose atij të cilit i'a ka interpretuar ka pasur në atë interes serioz. Prandaj, në rast mosmarëveshje, ekzistimin e interesit serioz e vërteton gjygi kompetent, duke llogaritur rethanat konkrete të rastit të dhënë.

¹²³ LMD, Neni 183, alinea 2.

¹²⁴ LMD, Neni 187.

¹²⁵ G. Galev, J.D. Anastasovska, Obligaciono pravo, Shkup, 2012, fq.751-752.

1.4. Shpërblimi i dëmit material kur dëmin e shkaktojnë më shumë subjektë

Në raste të caktuara më shumë subjektë marín pjesë në aktin e shkakimit të dëmit si kryes (shkaktues) të drejtpërdrejtë të dëmit, ose si nxitës, ndihmës të dëmtuesit. Kur më tepër subjektë shkaktojnë dëm material të dëmtuarit, ata solidarisht përgjigjen për shpërblimin e dëmit. Kur njëri nga shkaktuesit e dëmit i ka paguar shpërblimin e dëmit të dëmtuarit, ai ka të drejtë të kërkojë prej pjesmarësve tjerë që kanë kontribuar në shkaktimin e dëmit që t'ia paguajnë atë që e ka paguar për ata. Dëmtuesi që e ka paguar borxhin solidar ka të drejtë ndaj pjesmarësve të tjerë në dëm. Gjykata vërteton se në çfarë mase ka kontribuar çdonjëri prej dëmtuesëve apo secili prej dëmtuesve nëse ka më tepër kontribut në shkaktimin e dëmit dhe sa është pesha e fajit e secilit prej tyre në shkaktimin e dëmit.

2. RASTET E VEÇANTA TË REALIZIMIT TË SHPËRBLIMIT

TË DËMIT JOMATERIAL

Rastet kryesore të shpërblimit të dëmit jomaterial janë: cënimi i autoritetit, nderit, lirisë, frika, dhimbja fizike, vuajtja psikike, shëmtimi, vdekja e të afërmeve, zvogëlimi i aktivitetit jetësor.

2.1. Shpërblimi i dëmit jomaterial gjatë shkakimit të dhimbjeve fizike

Dhimbjet fizike janë formë e dëmit jomaterial dhe manifestim më i shpeshtë i cënimit të integritetit trupor të të dëmtuarit. Si dhimbje fizike paraqiten ndjenjat e ndryshme të pakënaqësisë p.sh paaftësia fizike, deformiteti i rëndë estetik, zhdukja e aftëssë riprodhuese, të cilat manifestohen si vuajtje, brengosje, frikëse, çfarëdo ndjenje tjetër. Kushtet thelbësore për gjykimin e shpërblimit me para të dëmit jomaterial për shkak të dhimbjeve fizike janë: kohëzgjatja dhe intensiteti i lartë i përjetimit të tyre nga i dëmtuari të cilat i konstaton eksperti. Për dhimbjet fizike me kohë të shkurtër dhe me intensitet të dobët nuk duhet të caktohet shpërblim i dëmit jomaterial. Të drejtë kërkesë për shpërblimin e dëmit ka vetëm personi i dëmtuar, pra kjo e drejtë është e lidhur ngushtë me personalitetin e personit të dëmtuar.

2.2. Shpërblimi i dëmit jomaterial për shkak të shkaktimit të frikës

Frika është formë e dëmit jomaterial dhe manifestim më i shpeshtë i cënimit të integritetit trupor dhe dëmtimit të shëndetit. Frika është përjetim psikik i brendshëm, i pakëndshëm i të dëmtuarit e shkaktuar me veprim deliktor të dëmtuesit në fatkeqësi të trafikut në lëndime që shkaktohen në vendin e punës ose që kanë të bëjnë me punën.¹²⁶

Frika mund të jetë parësore, dytësore, e drejtpërdrejtë, e tërthortë, frika për jetë dhe frika gjatë shërimit. Për tu realizuar kërkesa për shpërblimin e dëmit jomaterial për shkak të frikës, duhet të plotësohen këto kushte:

- a) që subjekti i dëmtuar të ketë pësuar frikë
- b) që frika të jetë e intensitetit të lartë
- c) që frika të jetë me kohëzgjatje të caktuar
- d) që frika të shkaktojë pasoja të dëmtuarit
- e) që i dëmtuari të paraqesë në gjykatën kompetente kërkesën për realizimin e shpërblimit të dëmit të tillë.

Kushtet e lartëpërmendura duhet të plotësohen në mënyrë kumulative. Shkallën e intensitetit, kohëzgjatjen, pasojat e frikës i konstaton eksperti gjygsor. Çregullimi i drejtpeshimit psikik që rrjedh si pasojë e tyre varet nga rrethanat e rastit konkret, varësisht nga lëndimi trupor, gjendja shëndetsore e të dëmtuarit, mosha, gjinia, gjendja familjare etj.¹²⁷ Këto rrethana ndikojnë në caktimin e lartësisë së shpërblimit të dëmit për frikën e pësuar. Rrethanat e tilla gjykata i vlerëson sipas vlerësimit të lirë duke shfrytëzuar autorizimin procedural të dhënë në ligjin e procedurës kontestimore. Në praktikën gjyqsore ekzistojnë vendime të shumta gjygsore në të cilat gjykata duke pasur parasysh shkallën e lëndimit trupor, kohëzgjatjen e frikës, intensitetin e përjetimit, i gjykon të dëmtuarit shpërblimin me para.

Shpërblimi i dëmit jomaterial me para për shkak të frikës ka për qëllim satisfakcionin për të dëmtuarin, e jo të arrihet ndonjë qëllim lukrativ që nuk është në pajtim me

¹²⁶ N.Dauti, E drejta e detyrimeve, Prishtinë, 2001, fq.203.

¹²⁷ J. Jerkovic, Zastarenost potrazivanje naknade stete prouzrokovano uotrebom motornog vozila, G.A.K.br.7/8, Novi Sad, 1797, fq.15.

qëllimin shoqëror të këtij shpërblimi, sepse nuk mund të komercializohen vlerat morale.¹²⁸ E drejta e kërkesës për shpërblimin e dëmit jomaterial për shkak të frikës është ngushtë e lidhur me personalitetin e subjektit që ka pësuar frikën e caktuar.

Në ligjin mbi marrëdhënjet detyimore janë ta parapara dy afate të parashkrimit të drejtës për shpërblim të dëmit jomaterial për shkak të frikës edhe atë: a) afati subjektiv prej 3 vjetësh i cili është ngushtë i lidhur me dy rrethana edhe atë me njoftimin e të dëmtuarit me dëmin dhe me subjektin që e shkakton dëmin; dhe b) afati objektiv (absolut) fillon të rrjedhë pa marrë parasysh njoftimin e të dëmtuarit për dëmin dhe dëmtuesin duke llogaritur objektivisht nga çasti kur shkaktohet dëmi.

2.3. Shpërblimi i dëmit material për shkak të vuajtjeve psikike

Vuajtja psikike paraqet bazë të veçantë për shpërblimin e dëmit jomaterial. Vuajtjet psikike paraqesin një ndjenjë, përkatësisht përjetim të pakëndshëm si rrjedhim i faktorëve të natyrës psikike, i impulsive vitale dhe sociale e që pasqyrohet si dëmtim i jetës shpirtërore, si çregullim i jetës psikike emocionale të personit të caktuar. Vuajtjet psikike më vështirë mund të konstatohen, sepse në masë të madhe varen nga konstitucioni psikik dhe dispozicionet e të dëmtuarit, nga mentaliteti dhe rethanat tjera. Në ligjin për marrëdhënjet detyimore parashihen që për vuajtjet psikike të pësura, gjykata nëse e gjen se rethanat e rastit e veçanërisht intensiteti kohëzgjatja atë e arsyetojnë do të gjykojë shpërbim të drejtë në të holla pavarësisht nga shpërblimi i dëmit material apo në mungesë të tij. Në rast të shkaktimit të vdekjes apo invaliditetit të rëndë të ndonjë subjekti, gjykata mund të gjykojë bashkëshortit, fëmijëve dhe prindërve shpërblimin e drejtë për vuajtje psikike. Kjo e drejtë i takon edhe bashkëshortit jashtë martesor nëse ndërmjet tij dhe personit të dëmtuar ka ekzistuar bashkësia jashtë martesore për kohë të gjatë.¹²⁹

¹²⁸ N.Dauti, E drejta e detyrimeve, Prishtinë, 2001, fq.204.

¹²⁹ Shih Nenin 190, LMD.

2.4. Shërblimi i dëmit jomaterial gjatë shkaktimit të shëmtimit

Shëmtimi është formë e dëmit jomaterial që paraqitet si pasojë e cënimit të integritetit trupor të subjektit të dëmtuar. Shëmtimi paraqet prishjen e pamjes së jashtme të trupit të njeriut ose të ndonjë pjese të tij, përkatësisht, prishjen e pamjes së jashtme të ndonjë funksioni trupor. Rasti më i shpeshtë i shëmtimit është ndryshimi i fytyrës për shkak të varrëve të mëdha, deformimi i hundës, syve, këputja ose lëndimi qenësor i ekstremiteteve ose pjesëve të tjera të jashtme të trupit të njeriut. Shëmtimi si formë e dëmit jomaterial manifestohet në prishjen e ekuilibrit psikik të të dëmtuarit për shkak të ndjenjës së vlerës së ulët, gjendjes depressive, pengimi i përparimit më të mirë të dëmtuarit në jetën e mëtejme të tij.¹³⁰

Dominon mendimi që të dëmtuarit duhet t'i gjykohej shpërblimi i dëmit me para, nëse shëmtimi ka ndikuar negativisht te ai. Këtu duhet të miret parasysh gjinia, mosha, orientimi profesional sepse shëmtimi nuk manifestohet në mënyrë të njëjtë në kushte dhe rethana jetësore te të gjithë personat. Shkallën e shëmtimit të trupit të të dëmtuarit e konstaton eksperti përkatës. Për realizimin e këtij shpërblimi të dëmit duhet të shkaktohet shëmtimi, deformimi trupor i subjektit të dëmtuar, dhe shëmtimi të shkaktojë vuajtje shpirtërore me intensitet dhe kohëzgjatje të caktuar. Edhe në këtë rast duhet theksuar se kjo e drejtë është personale dhe nuk u kalon trashëgimtarëve të të dëmtuarit.¹³¹

¹³⁰ M. Brkic, Naknada stete usled telesne povrede P.zivot, br.5/1971, fq.56.

¹³¹ N.Dauti, E drejta e detyrimeve, Prishtinë, 2001, fq.206.

KREU IV

TË DHËNA STATISTIKORE NË LIDHJE ME SHPËRBLIMIN E DËMIT NGA PRAKTIKA GJYQËSORE NË GJYKATËN CIVILE SHKUP

1.Regjistrat ku bëhet regjistrimi i lëndëve

Në gjykatën civile në Shkup, për shkak të numrit të madh të lëndëve, si dhe për shkak të kompetencës së zgjerur të gjykatës, evidentimi i lëndëve bëhet në regjistra të ndryshëm varësisht nga baza juridike. Në vazhdim po prezantojë të gjitha regjistrat ku bëhet regjistrimi i lëndëve në momentin e dorëzimit në gjykatë.

Në Gjykatën civile Shkup evidentohe lëndë në këta regjistra:

	Regjistri	Shenja	Emërtimi i kërkuesit	Emërtimi i palës së kundërt
1	Regjistri për konteste pronësore	P1	Paditës	I paditur
2	Regjistri për konteste civile me vlerë të vogël	MALVP	Paditës	I paditur
3	Regjistri për lëndë jashtëkontestimore	VPP	Propozues	Kundërshtar
4	Lëndë trashëguese deri te noterët	ON	I vdekur	Propozues
5	Lëndë të ndryshme civile	R	Propozues	Kundërshtar
6	Regjistrime të shoqërive të qytetarëve dhe fondacione	REGZEG	Kërkues	Pala e kundërt
7	Regjistri për ndihmë juridike jashtë vendit	POM-SEK	Propozues	Person
8	Regjistri për urdhëragesa të pjesëshme	PLP	Paditës	I paditur
9	Regjistri i vetëm gjygsor për kisha	REG.C	Kërkues	Pala e kundërt
10	Lëndë ekzekutuese-tregtare	SI	Kreditor	Debitor

11	Regjistri për falimentim	ST	Propozues	Debitor i falimentimit
12	Regjistri për likuidim	L	Propozues	Debitor
13	Regjistri i vetëm gjygjësor për bashkësi fetare	REG.VZ	Kërkues	Pala e kundërt
14	Regjistri për ankesat dhe parashtrës	03POP	Kërkues	Person
15	Regjistri për përsëritjen e procedurës në kontestet pronësore	PPOV	Paditës	I paditur
16	Regjistri për urdhërpagesa me propozim	PL	Paditës	I paditur
17	Njoftime të ndryshme për administratën gjyqësore	SU	Kërkues	Pala e kundërt
18	Regjistër i besueshëm për administratën gjyqësore	SU-DOV	Kërkues	Pala e kundërt
19	Regjistër strikt i besueshëm për administratën gjyqësore	SU-STR-DOV	Kërkues	Pala e kundërt
20	Regjistër për evidencën e ankesave dhe parashtrësve	UPP	Kërkues	Pala e kundërt
21	Regjistër për mbrojtjen nga veprimet e kundërligjshme	ZND	Kërkues	Pala e kundërt
22	Regjistër për regjistrimin e partive politike	RPP	Kërkues	Pala e kundërt
23	Regjistër për kundërshtesat kundër kundërligjshmërisë gjatë ekzekutimit	PPNI	Kreditor	Debitor
24	Regjistër për ndihmë juridike	POM	Person	Pala e kundërt
25	Regjistër për lëndën për marrjen e aftësisë për të vepruar dhe mbajtjen në institucion shëndetsor për kurim dhe ruajtje të sëmurëve shpirtëror	ODS	Propozues	Pala e kundërt
26	Regjistri për vërtetim të kontratave	ZAV	Lënës/marës	Marës/dhënës

27	Regjistër për vërtetim dokumentesh për nëvojë jashtë shtetit	ZAV-S	Kërkues	Pala e kundërt
28	Regjistër për vërtetimin e dokumenteve në kuptim të Konventës për shkëputjen e nevojës për legalizim të dokumenteve të huaja publike APOSTIL	ZAV-S	Kërkues	Pala e kundërt
29	Regjistër për pranimin e vendimeve të huaja gjygsore	PSO	Kërkues	Pala e kundërt
30	Regjistër për kontestet tregtare pronësore	TS	Paditës	I paditur
31	Regjistër për konteste me vlerë të vogël ndërmjet personave juridik	MALV-TS	Paditës	I paditur
32	Regjistër për kontestet në marrëdhënie pune	RO	Paditës	I paditur
33	Lëndë të ndryshme civile-Masa të përkohshme	RVRM	Propozues	Pala e kundërt
34	Lëndë të ndryshme civile-ekzekutuese nga OS1	RI1	Kreditor	Debitor
35	Regjistri për leje të dhëna veprime ekzekutuese në banesën e debitorit	IDS	Kreditor	Debitor
36	Të ndryshme- Vërtetime	RAZNO	Kërkues	Pala e kundërt
37	Regjistër për vërtetim të kontratave jashtë gjyqit	ZAV1	Propozues	Pala e kundërt
38	Dhuna familjare	SN	Paditës	I paditur
39	Urdhërpagesa tregtare	PLS	Paditës	I paditur
40	P-Përsëritje nga OS1	P-POV1	Paditës	I paditur
41	RO-Përsëritje nga OS1	RO-POV1	Paditës	I paditur
42	TS-Përsëritje nga OS 1	TS-POV 1	Paditës	I paditur
43	PL- Përsëritje nga OS 1	PL-POV 1	Paditës	I paditur
44	Regjistër për shqiptim të dënimeve në të holla	IPK	Kreditor	Debitor

45	Regjistër për lëndë të ndryshme tregtare	RTS	Paditës	I paditur
46	Regjistër për lëndë të ndryshme nga mardhënia e punës	RRO	Paditës	I paditur
47	Të ndryshme- Falimentuse	R-ST	Parashtrues	Debitor
48	Regjistër për lëndë të ndryshme nga urdhër pagesa	RPL	Paditës	I paditur
49	Regjistër për kërkesa për lëndë trashëgimore	O	I ndjerë	Parashtrues
50	Urdhërpagesa 1	PL 1	Paditës	Ipaditur
51	Regjistër për kundërshtim për lëndë trashëgimore	O1	I ndjerë	Parashtrues
52	Regjistër për lëndë familjare	P 2	Parashtrues	Kundërshtar
53	Regjistër për këshill falimentues	STS	Parashtrues	Debitor falimentues
54	Kontestimi gjygsor-Përsëritje	P-POV	Paditës	I Paditur
55	Regjistër për përsëritje të procedurës për lëndë tregtare	TSPOV	Paditës	I Paditur
56	Regjistër për përsëritje të procedurës nga vlera e vogël	MVPOV	Paditës	I paditur
57	Regjistër për përsëritje të procedurës nga urdhër pagesa	PLPOV	Paditës	I paditur
58	Trashëgimi përsëritje	O-POV	I ndjerë	Parashtrues
59	Egzekutose përsëritje	I-POV	Parashtrues	Pala e kundërt
60	Regjistër për njohje të vendimeve të huaja gjygsore me kundërshtim	PSO1	Kërkues	Pala e kundërt
61	Regjistër i vetëm gjygsor për grupet religjioze	REG RG	Parashtrues	Pala e kundërt
62	Regjistër i vetëm i partive politike	ERPP	Parashtrues	Pala e kundërt
63	Regjistër për lëndë të ndryshme kontestimore	RP	Paditës	I paditur
64	Regjistër për përsëritje të procedurës kontestimore vlera e vogël për subjekte juridike	MVTSPPOV	Paditës	I paditur

65	Regjistër për konteste pronsore të fitura në martesë	PZ	Patitës	I paditur
66	Legalizim të traktorëve	R-L	Parashtrues	Kundërshtar
67	Konteste detyrimore	P4 a	Parashtrues	Pala e kundërt
68	Vendime dhe korenspondencë të administratorit gjygsor	SU 07	Parashtrues	Pala e kundërt
69	Regjistër nga urdhërpagesa me kundërshtim	PL1-P	Paditës	I paditur
70	Regjistër nga urdhërpagesa me kundërshtim me palë juridike	PL1-TS	Paditës	I paditur
71	Komunikim me të besuarin e gjyqit	SU-06	Parashtrues	Pala e kundërt
72	Vendime të kryetarit për marëdhënjet e punës	SU-04	Parashtrues	Pala e kundërt
73	Vendime të kryetarit dhe komisionit për furnizim public	SU-02	Parashtrues	Pala e kundërt
74	Dorzim të raporteve statistikore	SU-01	Parashtrues	Pala e kundërt
75	Regjistër për lëndë kontenstimore nga vlera e vogël-falimentim	ST-MALAVP	Paditës	I paditur
76	Regjistër për lëndë kontenstimore nga vlera e vogël mes palëve jrudike- falimentim	ST-MALAVTS	Paditës	I paditur
77	Regjistër për lëndë pronsore- falimentim	ST-P1	Paditës	I paditur
78	Regjistër për lëndë detyrimore- falimentim	ST-P4	Paditës	I paditur
79	Regjistër për urdhërpagesa me kundërshtim	ST-PL1 P	Paditës	I paditur
80	Regjistër për urdhërpagesa me kundërshtim me palë juridike	ST-PL1 TS	Paditës	I paditur
81	Regjistër për lëndë nga marëdhënia e punës- falimentim	ST-RO	Paditës	I paditur
82	Regjistër për lëndë tregtare pronësore- falimentim	ST-TS	Paditës	I paditur
83	Regjistër për lëndë të ndryshme jashtëkontestimore	RVPP	Parashtrues	Pala e kundërt

84	Pagesa e detyrueshme e harxhimeve në dobi të RM TS	PNT TS	Parashtrues	Pala e kundërt
85	Regjistër për egzekutim të pronës dhe sendeve të konfiskuara- marja e sendeve	IOIP-MB	Parashtrues	Pala e kundërt
86	Regjistër për egzekutim të pronës dhe sendeve të konfiskuara- konfiskim dhe tatim	IOIP-PD	Parashtrues	Pala e kundërt
87	Regjistër për shqiptim për denim në të holla të debitorit	IPKD	Parashtrues	Pala e kundërt
88	Regjistër për përsëritjen e procedurës nga mardhënia e punës	ROPOV	Paditës	I paditur
89	Regjistër për urdhër pagesa me propozim me palë juridike	PL-TS	Paditës	I paditur
90	Falimentim- Përsëritje	ST-POV	Parashtrues	Pala e kundërt
91	Regjistër konteste detyrimore	P4	Paditës	I paditur
92	Përjashtim të gjykatësve dhe kryetarit	SU-IZZ	Parashtrues	Pala e kundërt
93	Regjistër të ankesave të urdhër pagesave kundër vendimeve të notarit	PLZH	Paditës	I paditur
94	Korespodencë e kryetarit të gjyqit me organe tjera dhe persona tjerë	SU-03	Parashtrues	Pala e kundërt
95	Lëndë trashëgimore nga Noteri	ON nov	I ndjeri	Parashtrues
96	Regjistër nga kontabiliteti	SU-05	Parashtrues	Pala e kundërt
97	Regjistër për qasje të lirë deri tek informatat	SPI	Parashtrues	Pala e kundërt
98	Regjistër për kontestet detyrimore tregtare	TS1	Paditës	I paditur
99	Regjistër për lënde për ndarje fizike	VPP1	Parashtrues	Kundërshtues
100	Regjistër për lëndë për propozim për sigurim të provave dhe masave të përkohshme	VPP2	Parashtrues	Pala e kundërt

101	Regjistër për lutje në gjyqjeve të huaja dhe të vendit për dërgimin e shkresave jashtë shtetit dhe ndihmë juridike	ZAM-S	Parashtrues	Person
102	Regjistër për kërkesat për ekzekutim nga ligji për familje	IZS	Parashtrues	Pala e kundërt
103	Regjistër për lëndët me vlerë të vogël- urdhërpagesa	MALVPL-1P	Paditës	I paditur
104	Regjistër për lëndët me vlerë të vogël ndërmjet personave juridik- urdhërpagesa	MALVP-1-TS	Paditës	I paditur
105	Regjistër për lëndë të kthyer nga noteri për jokompetencë	ONAD	I ndjerë	Parashtrues
106	Regjistër për propozime kundër ekzekutimit	PI	Parashtrues	Pala e kundërt
107	Regjistër për regjistrimin e kishave, shoqatave fetare dhe grupeve fetare	RSVZRG	Parashtrues	Pala e kundërt
108	Regjistër për shpifje dhe fyerje	P5	Paditës	I paditur
109	Të ndryshme VPP	R-VPP	Parashtrues	Pala e kundërt
110	Pagesa detyrimore e harxhimeve në favor të RSM PL	PNT PL	Parashtrues	Pala e kundërt
111	Mardhënje obligatorë shpifje dhe fyerje	P4-ak	Paditës	I paditur ¹³²

¹³² Të dhëna të mara nga Rregullorja e gjykatës

2.Të dhëna statistikore në lidhje me realizimin e instituteve të ndryshme juridiko civile në vitin 2015

Regjistri P4-Marëdhënje detyrimore, është rregjistër në të cilin regjistrohen lëndët kontestimore në lidhje me marëdhënjet detyrimore. Sipas statistikave në vitin 2015 janë të gjithsej të regjistruara 2002 lëndë edhe atë:

	Baza juridike	Numri i lëndëve të pranauara
1.	Shpërblim i dëmit material	397
2.	Shpërblim i dëmit jomaterial	574
3.	Shpërblim i dëmit nga autopërgjegjsia	93
4.	Shpërblim i dëmit në rast të vdekjes, lëndimit trupor dhe cënimit të shëndetit	4
5.	Shpërblim i dëmit nga veprimi i avokatit	1
6.	Borxh	383
7.	Regres	67
8.	Fitimi pa bazë	117
9.	Kthimi i huasë	1
10.	Dënimi i kontraktuar	4
11.	Kundërshitimi i veprimeve juridike te debitorit	15
12.	Anulimi i përfundimit për shitje	2
13.	Pagesa e qirasë	3
14.	Përmbushja e kontratës	31
15.	Anulimi i kontratës	46
16.	Anulimi i kontratës për mbajtje të përhjetshme	4

17.	Shkëputja e kontratës	117
18.	Shkëputja e kontratës për mbajtje të përhjetshme	6
19.	Vërtetimi i pavlefshmërisë së kontratës	105
20.	Pavlefshmëria e kontratës në formë të Aktit Noter	6
21.	Pavlefshmëria e zgjedhjes gjygsore	2
22.	Lloje tjera të marëdhënjeve detyrimore	23
23.	Pa bazë	1 ¹³³

Siç mund të shohim nga tabela e lartëpërmendur lëndët e marëdhënjeve kontestimore me vlerë të madhe gjatë vitit 2015 në gjykatën civile Shkup gjithsej janë pranuar 2002 lëndë. Nga tabela e lartëpërmendur shihet se dominon numri i lëndëve ku si bazë juridike është shpërblimi i dëmit jomaterial ku janë të pranuar 574 lëndë, si dhe shpërblim i dëmit material ku janë të pranuar 397 lëndë. Pastaj vijon numri i lëndëve ku si bazë juridike është borxhi, dhe pastaj kemi fitimin e pabazë ku janë të evidentuara 117 lëndë si dhe shkëputjen e kontratës ku janë të regjistruara 117 lëndë. Viojnë lëndët ku si bazë juridike është shpërblimi i dëmit nga autopërgjegjsia ku në gjykatë janë të pranuar gjithsej 93 lëndë, lëndë ku bazë juridike është regresi janë të pranuar 67 lëndë, lëndët ku bazë juridike kemi anulimin e kontratës ku janë të pranuar 46 lëndë si dhe lëndët ku bazë juridike është përmbushja e kontratës janë të pranuar në gjykatë gjithsej 31 lëndë. Në vijim kemi lëndët ku bazë juridike kemi kundërshtimin e veprimeve juridike të debitorit ku janë të pranuar gjithsej 15 lëndë, lëndët ku si bazë juridike është shpërblimi i dëmit në rast të vdekjes, lëndimit trupor dhe cënimit të shëndetit janë të pranuar 4 lëndë. Mund të konstatojmë se e dhëna e fundit nuk është edhe aq e saktë meqë në sistemin gjygsor Akmis nga edhe janë marë këto të dhëna statistiore rastet ku kërohet shpërblim i dëmit në rast të vdekjes, lëndimit trupor dhe cënimit të shëndetit në raste më të shpeshta regjistrohet si dëmshpërblim jomaterial pa u shkruajtur kualifikimi se pwr çfarw dwmsHPwrbliimi bëhet fjalw, kështu që mund të konstatojmë se ky numër nuk është edhe aq i saktë duke pasur parasysh se në punë kemi më tepër lëndë të tilla.

¹³³ Të dhëna statistikore të mara nga Gjykata Civile Shkup për vitin 2015 për lëndet obligatore

Kemi të pranuar 4 lëndë ku bazë juridike është anulimi i kontratës për mbajtje të përjetshme, gjithashtu janë të pranuar edhe 4 lëndë me bazë juridike dënimi i kontraktuar. Gjatë vitit 2015 në gjykatë është pranuar një lëndë ku bazë juridike janë shpërblimi i dëmit nga veprimet e advokatit dhe një lëndë ku si bazë juridike është kthimi i huasë.

Siç shihet nga e lartpërmendura dominojnë lëndët ku shfaqet elementi i demshpërblimit për dëmin e shaktuar, kurse këto dëmshpërblime në të shumtën e rasteve janë nga dëmet e shkaktuara në komunikaconin rrugor.

Lëndët me numër më të madh janë edhe lëndët ku si pasojë është borxhi i cili në raste më të shpeshta kërkohet si borxh në bazë të kontratave ku një person i ka dhënë tjetrit të holla borxh dhe nuk e ka respektuar afatin e kontraktuar për kthim të borxhit si dhe raste të shpeshta kur kreditori nuk e kthen kreditin që e ka marrë në bankën e caktuar dhe banka e padit për borxh bë bazë të kontratës për kredit. Borxhi kërkohet edhe në raste kur kemi kontrata për qira.

Lëndët tek të cilat bazë juridike është fitimi i pabazë janë lëndë të tilla dhe në raste më të shpeshta paditës është Elektrodistribucioni i Maqedonisë ku vërtetohet më parë se dëmtuesi e ka vjedhur rymën elektrike në mënyrë kundërligjore dhe është dënuar më aktgjykim të plotëfuqishëm gjyqësor të gjykatës penale për vepër penale vjedhje, dhe si pasojë e kësaj meqë vërtetohet periudha kohore se kur është shkaktuar vepra penale e tillë për atë periudhë edhe është aktpadia.

Lëndë të cilat dalin si pasojë e dëmit të shkaktuar nga komunikacioni rrugor janë edhe lëndët ku si bazë juridike është regresi, mirëpo këto janë lëndë të natyrës tjetër.

Regjistri MALVP-konteste nga vlera e vogël, - në këtë regjister regjistrohen lëndët me vlerë të vogël. Kështu në vitin 2015 gjithsej janë të regjistruara 2097 lëndë edhe atë:

	Baza juridike	Numri i lëndëve të pranuar
1.	Shpërblim i dëmit material	461
2.	Shpërblim i dëmit jomaterial	194
3.	Shpërblim i dëmit nga autopërgjegjsia	39

4.	Borxh	1253
5.	Fitimi pa bazë	125
6.	Vërtetimi i kërkesës	1
7.	Pagesa e qirasë	2
8.	Përbushja e kontratës	22 ¹³⁴

Nga tabela më lartë shihet se në vitin 2015 tek lëndët me vlerë të vogël të cilat njëkohësisht janë lëndë të karakterit obligator ku më së tepërmi kemi lëndë ku bazë juridike është borxhi. Këtu mund të cekim se edhe te lëndet me vlerë të vogël borxhi kërkohet në baza të ndryshme siç janë kontrata për kredit, kontrata e huasë, mospagesa e taksave komunale nga ana e qiraxhive në banesë, etj.

Më pas dominojnë lëndët ku kërkohet shpërblim i dëmit material ku shihet se janë pranuar në gjykatë 461 lëndë dhe lëndët për shpërblim të dëmit jomaterial ku shihet se janë regjistruara 194 lëndë. Burim i paraqitjes së lëndëve të tilla përsëri do të themi se janë aksidentet nga komunikacioni rrugor dhe në raste të ralla mund të ketë bazë tjetër juridike shpërblimi i dëmit. Lëndët me vlerë të vogël që kanë lidhshmëri me dëmin e shkaktuar në komunikacionin rrugor janë edhe lëndët ku kërkohet shpërblim i dëmit nga autopërgjegjsia.

¹³⁴ Të dhëna statistikore të mara nga Gjykata Civile Shkup për vitin 2015 për lëndet me vlerë të vogël ku kemi të regjistruata edhe lënde me karakter obligator, mirëpo janë me vlerë të vogël

3.Të dhëna statistikore në lidhje me realizimin e instituteve të ndryshme juridiko civile në vitin 2016

Regjistri P4-Marëdhënje detyrimore, është rregjistër në të cilin regjistrohen lëndët kontestimore në lidhje me marëdhënjet detyrimore me vlerë të madhe. Sipas statistikave në vitin 2016 janë të gjithsej të regjistruara 1263 lëndë edhe atë:

	Baza juridike	Numri i lëndëve të pranauara
1.	Shpërblim i dëmit material	230
2.	Shpërblim i dëmit jmaterial	322
3.	Shpërblim i dëmit nga autopërgjegjsia	68
4.	Shpërblim i dëmit në rast të vdekjes, lëndimit trupor dhe cënimit të shëndetit	1
5.	Shpërblim i dëmit nga veprimet e përmbaruesit	2
6.	Shpërblimi i dëmit në rast të cenimit të nderit dhe reputacionit dhe përhapjes së fakteve të pavërteta	4
7.	Borxh	163
8	Regres	27
9.	Fitimi pa bazë	93
10.	Kthimi i huasë	1
11.	Dënimi i kontraktuar	1
12.	Kundërshtimi i veprimeve juridike të debitorit	20
13.	Anulimi i përfundimit për shitje	6
14.	Pagesa e qirasë	2
15.	Përmbushja e kontratës	16

16.	Anulimi i kontratës	49
17.	Anulimi i kontratës për mbajtje të përhjetshme	2
18.	Shkëputja e kontratës	117
19.	Shkëputja e kontratës për mbajtje të përhjetshme	8
20.	Vërtetimi i pavlefshmërisë së kontratës	100
21.	Pavlefshmëria e kontratës në formë të Aktit Noter	9
22.	Pavlefshmëria e transakcioneve	1
23.	Lloje tjera të marëdhënjeve detyrmore	33 ¹³⁵

Nga të dhënat statistikore të Gjykatës mund të shihet se në vitin 2016 për dallim nga viti 2015 janë pranuar numër më i vogël i lëndëve. Kjo për arsye se njerëzit mundohen që në mënyrë jashtëgjyqësore me marëveshje jashtëgjyqësore ti rregullojnë raportet e tyre kontestimore që tu hikin harxhimeve gjyqësore duke pasur parasysh se në vitin 2016 hasi ndryshim Tarifa për shpërblim dhe kompenzim për punën e advokatëve të Republikës së Maqedonisë ku tarifa e advokatëve për përgatitjen e akteve ligjore dhe për përfaqësim në gjykatë dukshëm u zmadhua. Do të shohim se në vitet në vijim kemi zvogëlim të lëndëve të pranura në gjyqi.

Nga tabela e mësipërme mund të konkludojmë se lëndët që janë inicuar ku kërkohet dëmshpërblim dominojnë. Kështu për shpërblim të dëmit material në vitin 2015 në gjykatë janë pranuar 322 lëndë, kursë për shpërblim të dëmit jomaterial janë pranuar 230 lëndë, për shpërblim të dëmit nga autopërgjegjsia janë kërkuar 68 lëndë si dhe për shpërblim të dëmit për shkak të vdekjes, lëndimit rpor dhe cënimit të shëndetit është regjistruar 1 lëndë. Gjthashtu në këtë grup të lëndëve ku kërkohet dëmshpërblim hyjnë edhe lëndët ku kërkohet shpërblim i dëmit në rast të cënimit të nderit dhe reputacionit dhe përhapjes së fakteve të pavërteta ku janë pranuar gjithsej 4 lëndë. Mund të konstatojmë se sikurse te rastet kur kërkohet për shkak të vdekjes poashtu edhe për rastet e fundit të dhënat e fundit nuk janë edhe aq të sakta meqë në

¹³⁵ Të dhëna statistikore të mara nga Gjykata Civile Shkup për vitin 2016 për lëndët obligatore

sistemin gjygjësor Akmis nga edhe janë marë këto të dhëna rastet ku kërohet shpërblim i dëmit në rast të cënimit të nderit dhe reputacionit dhe përhapjes së fakteve të pavërteta në raste më të shpeshta regjistrohet si dëmshpërblim jomaterial, kështu që mund të konstatojmë se ky numër nuk është edhe aq i saktë duke pasur parasysh se në punë kemi më tepër lëndë të tilla.

Për bazë juridikë borxh në vitin 2015 në gjykatë janë regjistruar gjithsej 163 lëndë. Siç përemedna edhe më lartë borxhi çdo herë kërkohet në baza të ndryshme juridike. Vlen të ceket se kohëve të fundit advokatët për përfaqësimin e tyre që ua bejnë paleve në gjykatë dhe të cilët nuk paguhen nga pala që e kanë përfaqësuar për punën që e kanë bërë drejtohen me aktpadi në gjykatë dhe kështu për punën e kryer meqë nuk ngrejnë aktpadi në gjykatë që të realizojnë të drejtat e veta.

Tek lëndët ku kërkohet shpërblimi i kontratës në gjykatë janë të pranuar 100 lëndë. Shpërblimi i kontratës çdo herë kërkohet në rast të mospërbushjes nga ndonjëra nga palët, kur pala që e inicon procedurën gjygjësore për shpërblim të kontratës vlerëson se kontrata ka ndonjë mangësi, kur kontrata është e lidhur me kanosje ose mashtrim etj. Lëndë të tilla janë edhe lëndët ku kërkohet vërtetimi i pavlefshmërisë së kontratës ku janë ta pranuar 100 lëndë si dhe lëndët ku kërkohet anulimi i kontratës për mbajtje të perjetshme ku janë të pranuar 8 lëndë. Këto të fundit sizakonisht i inicon pala e cila ka interes juridik por njëkohësisht edhe mendon se kontrata e tillë nuk i përmban të gjitha elementet e parapara ligjore.

Lëndë ku aplikohen dispozitat ligjore nga Ligji mbi marrëdhënjet obligatore lidhur me kontrata janë edhe lëndët ku kërkohet përbushja e kontratës ku gjithsej janë të pranuar 16 lëndë, lëndët ku kërkohet anulimi i kontratës ku gjithsej janë pranuar 49 lëndë.

Lëndë ku kemi elemente edhe të borxhit edhe të kontratës janë lëndët ku kërkohet pagesa e qirasë e cila çdo herë kërkohet si borxh në bazë të kontratës për qira të cilën paditësi e lidh me qiraxhiun i cili kur formohet lënda në gjykatë mer statusin e të paditurit, si dhe lëndët ku kërkohet kthimi i huasë ku shihet se është pranuar në vitin 2016 në gjykate një lëndë.

Obligimi i detyruar për sigurim të veturave nga autopërgjegjësia për fajtorin gjegjësisht për pjesëmarësin që ka drejtuar veturën pa leje për vozitje, në gjendje të dehur dhe të paregjistruar i cili në bazë të ligjit çdo herë është fajtor për aksidentin e shkaktuar dhe në këtë mënyrë për dëmin që kompania e sigurimit ia kompenzon të dëmturit, atë dëm ku personi që në

mënyrë ta paaautorizuar ka drejtuar automjetin automatikisht ndaj kompanise së sigurimit është borxhli regresi. Kështu në gjykatë lëndët ku bazë juridike është regresi gjithsej në vitin 2016 janë të regjistruara 27 lëndë në regjistrin me vlerë të madhe.

Fitimi i pabazë kërkohet në baza të ndryshme, për vitin 2016 në gjykatë lëndët ku bazë juridike është fitimi i pabazë gjithsej janë të regjistruara 93 lëndë. Si fitim i pabazë në lëndët gjyqësore çdo herë kërkohet kur i padituri e mban pa bazë juridike sendin e paditësit gjegjësisht e përdor sendin e paditësit pas kalmit të afatit kontraktual dhe pa kërkuar nga paditësi që të lidh kontratë të re apo ti paguajë për atë fakt që e mban sendin e tij, siç përmendëm edhe më lartë lëndet ku konstatohet vjedhje e energjisë elektrike për periudhën që është konstatuar vjedhja kërkohet fitim i pabazë etj.

Regjistri MALVP-konteste nga vlera e vogël, gjithsej në vitin 2016 në regjistrin e kontesteve me vlerë të vogël janë të regjistruara 2502 lëndë edhe atë:

	Baza juridike	Numri i lëndëve të pranauara
1.	Shpërblim i dëmit material	792
1.	Shpërblim i dëmit jomaterial	311
3.	Shpërblim i dëmit nga autopërgjegjsia	82
4.	Borxh	1083
5.	Fitimi pa bazë	220
6.	Përmbushja e kontratës	9
7.	Pagesa e qirasë	3
8.	Marëdhënje tjera	2 ¹³⁶

Zhvillimi i ekonomisë në vend, rrogat e vogla të qytetarëve gjithnjë e me shumë detyron qytetarët që të lidhin kontrata për borxh, të cilin e marin dhe nuk mund ta kthejnë edhe

¹³⁶ Të dhëna statistikore të mara nga Gjykata Civile Shkup për vitin 2016 për lëndët me vlerë të vogël ku kemi të regjistruata edhe lënde me karakter obligator, mirëpo janë me vlerë të vogël

atë vlera të vogla të parave nga ku mund të shohim se edhe në vitin 2016 dominojnë lëndët me vlerë të vogël ku bazë juridike është borxhi ku gjithsej janë të pranuar 1083 lëndë.

Me pas vijnë lëndët ku kërkohet dëmshpërblim edhe atë siç shihet lëndët ku kërkohet shpërblim i dëmit material dominojnë siç mund të vërehet gjithsej janë pranuar 792 lëndë, më pas vijnë lëndët ku kërkohet shpërblim i dëmit jomaterial ku gjithsej janë të regjistruara 311 lëndë, si dhe lëndët ku kërkohet shpërblim i dëmit nga autopërgjegjsia ku gjithsej kemi të regjistruara 82 lëndë.

Në vijim mund të cekim se kemi numër të mjaftueshëm të lëndëve ku kërkohet fitimi i pabazë ku gjithsej janë të regjistruara 220 lëndë i cili kërkohet në baza të ndryshme.

4. Të dhëna statistikore në lidhje me realizimin e instituteve të ndryshme juridiko civile në vitin 2017

Regjistri P4-Marëdhënje detyrimore, është rregjistër në të cilin regjistrohen lëndët kontestimore në lidhje me marëdhënjet dëyrimore me vlerë të madhe. Sipas statistikave në vitin në vitin 2017 janë të gjithsej të regjistruara 1143 lëndë edhe atë:

	Baza juridike	Numri i lëndëve të pranauara
1.	Shpërblim i dëmit material	169
2.	Shpërblim i dëmit jomaterial	333
3.	Shpërblim i dëmit nga autopërgjegjsia	101
4.	Shpërblim i dëmit nga veprimet e përmbaruesit	1
5.	Borxh	123
6.	Regres	40
7.	Dënimi i kontraktuar	1
8.	Fitimi pa bazë	53
9.	Pagesa e qirasë	2
10.	Kthimi i huasë	1
11.	Kthimi i kaparit	1
12.	Përmbushja e kontratës	39
13.	Shkëputja e kontratës	78
14.	Shkëputja e kontratës për mbajtje të përhjetshme	3
15.	Anulimi i kontratës	32
16.	Anulimi i kontratës për mbajtje të përhjetshme	5
17.	Anulimi i përfundimit për shitje	2

18.	Pavlefshmëria e kontratës në formë të Aktit Noter	32
19.	Kundërshitimi i veprimeve juridike te debitorit	7
20.	Lloje tjera të marrëdhënjëve detyrimore	49
21.	Vërtetimi i nulitetit të kontratës	71 ¹³⁷

Nga tabela e lartë mund të shohim një numër të vogël të zvogëluar të lëndëve të pranuara, kështu për dallim nga viti 2016, në vitin 2017 janë gjithsej të pranuar 1143 lëndë kontestimore me vlerë të madhe. Siç shihet dominojnë lëndët ku kërkohet dëmshpërblim për dëmin e shkaktuar edhe atë si shpërblim i dëmit jomaterial ku janë të evidentuara 333 lëndë, shpërblim i dëmit material ku janë të gjithsej të evidentuara 169 lëndë, shpërblim i dëmit nga autopërgjegjësia ku janë të evidentuara 101 lëndë. Siç mund të shohim në vitin 2017 kemi rritje të numrit të lëndëve ku kërkohet shpërblim i dëmit nga autopërgjegjësia. Gjithashtu për dallim nga viti 2016 kemi zvogëlim të lëndëve ku bazë juridike është borxhi ku shihet janë të regjistruara 123 lëndë, kurse është i rritur numri i lëndëve ku kërkohet regres ku në vitin 2016 kishim të pranuar 27 lëndë në vitin 2017 kemi të pranuar 40 lëndë që shihet se numri i lëndëve ku kërkohet regres gati se është dyfishuar. Gjithashtu për dallim nga viti 2016 në vitin 2017 kemi zvogëlim të lëndëve u kërkohet shpërblim i dëmit nga autopërgjegjësia. Gjithashtu për dallim nga viti 2016 në vitin 2017 kemi zvogëlim të lëndëve ku kërkohet vërtetimi i nulitetit të kontratës në vitin 2017 janë të regjistruara 71 lëndë, dhe 39 lëndë të regjistruara kemi ku kërkohet përmbushja e kontratës. Lëndët ku kërkohet anulimi i kontratës për dallim nga viti 2016 janë në ulje kështu në vitin 2017 kemi të pranuar gjithsej 32 lëndë.

Për dallim nga viti 2016 në vitin 2017 kemi rritje të numrit të lëndëve ku kërkohet pavlefshmëria e kontratës në formë të aktit noter kështu përderisa në vitin 2016 janë të pranuar vetëm 9 lëndë ku kemi kërkesë të tillë në vitin 2017 kemi të pranuar gjithsej 32 lëndë.

Gjithashtu kemi edhe zvogëlim të numrit të lëndëve ku kërkohet shpërblim i dëmit nga autopërgjegjësia. Gjithashtu kemi edhe zvogëlim të numrit të lëndëve ku kërkohet anulimi i kontratës për mbajtje të përjetshme ku në vitin 2017 kemi të pranuar vetëm tre lëndë.

¹³⁷ Të dhëna statistikore të mara nga Gjykata Civile Shkup për vitin 2017 për lëndët obligatore

Regjistri MALVP-konteste nga vlera e vogël, në vitin 2017 në regjistrin ku regjistrohen lëndët me vlerë të vogël gjithsej janë të regjistruara 2169 lëndë edhe atë:

	Baza juridike	Numri i lëndëve të pranauara
1.	Shpërblim i dëmit material	479
2.	Shpërblim i dëmit jomaterial	446
3.	Shpërblim i dëmit nga autopërgjegjsia	106
4.	Borxh	994
5.	Fitimi pa bazë	139
6.	Përmbushja e kontratës	1
7.	Vërtetimi i kërkesës	1
8.	Marëdhënje tjera	3 ¹³⁸

Në vitin 2017 edhe lëndët me vlerë të vogël janë në numër me të vogël për dallim nga viti 2016 dhe siç shihet në vitin 2017 kemi të regjistruara 2169 lëndë me vlerë të vogël për dallim nga viti 2016 ku kemi të regjistruara 2502 lëndë.

Edhe tek lëndë me vlerë të vogël dominon numri i lëndëve ku kërkohet dëmshpërblim kështu lëndet ku kërkohet shpërblim i dëmit material janë 479 lëndë, kurse lëndët ku kërkohet shpërblim i dëmit jomaterial janë gjithsej të evidentuara 446 lëndë, në vijim janë lëndët ku kërkohet shpërblim i dëmit nga autopërgjegjsia ku janë të evidentuara 106 lëndë. Nga e lartpërmendura mund të konludojmë se gjithsej 1231 lëndë janë lëndë të evidentuara ku kërkohet shpërblim i dëmit, kurse në vitin 2016 janë të regjistruara gjithsej 1186 lëndë ku kërkohet shpërblim i dëmit.

¹³⁸ Të dhëna statistikore të mara nga Gjykata Civile Shkup për vitin 2017 për lëndët me vlerë të vogël ku kemi të regjistruara edhe lëndë me karakter obligator, mirëpo janë me vlerë të vogël

**5.Të dhëna statistikore në lidhje me realizimin e instituteve të ndryshme juridiko civile
në vitin 2018**

Regjistri P4-Marëdhënje detyrimore, është rregjistër në të cilin regjistrohen lëndët kontestimore në lidhje me marëdhënjet detyrimore me vlerë të madhe. Sipas statistikave në vitin në vitin 2018 janë të gjithsej të regjistruara 1082 lëndë edhe atë:

	Baza juridike	Numri i lëndëve të pranuar
1.	Shpërblim i dëmit material	143
2.	Shpërblim i dëmit jomaterial	382
3.	Shpërblim i dëmit nga autopërgjegjësia	84
4.	Shpërblimi i dëmit në rast të vdekjes, lëndimit trupor dhe të shëndetit	1
5.	Borxh	103
6.	Regres	38
7.	Kthimi i borxhit	6
8.	Fitimi pa bazë	45
9.	Pagesa e qirasë	2
10.	Ndalimi i diskriminimit	2
11.	Kundërshtimi i veprimeve juridike të debitorit	11
12.	Përmbushja e kontratës	16
13.	Shkëputja e kontratës	51
14.	Shkëputja e kontratës për mbajtje të përhjetshme	7
15.	Anulimi i kontratës	24
16.	Anulimi i kontratës për mbajtje të përhjetshmë	2

17.	Vërtetimi i nulitetit të kontratës	98
18.	Pavlefshmëria e kontratës në formë të Aktit Noter	18
19.	Nuliteti i transaksioneve	1
20.	Lloje tjera të marrëdhënjëve detyrimore ¹³⁹	48

Nga të dhënat statistikore të vitit 2018 mund të vërehet se nga viti në vit edhe atë duke filluar nga viti 2015 lëndët të cilat janë të regjistruara në gjykatë shkojnë duke u zvogëluar. Kështu numri i lëndëve të pranuar në gjykatë nga marrëdhënjet kontraktuale me vlerë të madhe në vitin 2018 është 1082 lëndë të regjistruara. Nga statistikat shihet se edhe në vitin 2018 dominon numri i lëndëve ku kërkohet shpërblim i dëmit kështu lëndë ku kërkohet shpërblim i dëmit jomaterial ka gjithsej të regjistruara 382 lëndë kurse lëndë ku kërkohet shpërblim i dëmit material gjithsej janë të regjistruara 143 lëndë, më pas kemi lëndët ku kërkohet shpërblimi i dëmit nga autopërgjegjësia ku janë të evidentuara 84 lëndë si dhe ka një lëndë të regjistruar ku kërkohet shpërblim i dëmit në rast të vdekjes, lëndimit trupor dhe të shëndetit. Gjithashtu mund të vërejmë se kemi edhe dy lëndë të regjistruara ku kërkohet ndalim i diskriminimit.

Numër të konsiderueshëm të lëndëve kemi lëndët ku kërkohet kthimi i borxhit ku janë të evidentuara 103 lëndë si dhe dominojnë lëndët ku kërkohet vërtetim i nulitetit të kontratës ku kemi të evidentuara 98 lëndë. Për dallim nga viti 2017 kemi zvogëlim të numrit të lëndëve ku kërkohet shkëputja e kontratës ku në vitin 2018 kemi të regjistruara 51 lëndë, lëndët ku kërkohet anulimi i kontratës kemi të regjistruara 24 lëndë, dhe lëndët ku kërkohet përmbushja e kontratës kemi gjithsej të regjistruara 16 lëndë.

Lëndët ku kërkohet shkëputja e kontratës për mbajtje të përhjetshme është në rritje kështu në vitin 2018 kemi të regjistruara 7 lëndë të tilla kurse kemi më pak lëndë të pranuar për dallim nga viti 2017 ku kërkohet anulimi i kontratës për mbajtje të përhjetshme ku në vitin 2018 janë të regjistruara 2 lëndë të tilla.

¹³⁹ Të dhëna statistikore të mara nga Gjykata Civile Shkup për vitin 2018 për lëndët obligatore

Gjithashtu është i zvogëluar numri i lëndëve ku kërkohet pafeshmëria e kontratës në forma të aktit noter ku siç mund të shohim në vitin 2018 kemi të pranuar 18 lëndë për dallim nga viti 2017 ku kemi të pranuar 32 lëndë.

Edhe lëndët ku kërkohet regres në vitin 2018 janë në numër më të vogël për dallim nga viti 2017 kështu në vitin 2018 lëndë të tilla të pranuar janë 38. Në numër më të vogël për dallim nga viti 2017 janë edhe lëndët ku bazë juridike është fitimi i pabazë ku në vitin 2018 kemi të pranuar 45 lëndë për dallim nga viti 2017 ku kishim të pranuar 53 lëndë. Për kthim borxhi në vitin 2018 kemi të evidentuara gjithsej 6 lëndë.

Regjistri MALVP-konteste nga vlera e vogël, gjithsej janë të regjistruara 2564 lëndë edhe atë:

	Baza juridike	Numri i lëndëve të pranuar
1.	Shpërblim i dëmit material	474
2.	Shpërblim i dëmit jomaterial	711
3.	Shpërblim i dëmit nga autopërgjegjsia	78
4.	Borxh	1175
5.	Fitimi pa bazë	110
6.	Përmbushja e kontratës	3
7.	Dorëzimi në pronësi të sendit të lëvizshëm ose patundshmërisë	11
8.	Marëdhënje tjera	1
9.	Kompenzime nga marëdhënjet e punës	1 ¹⁴⁰

Për dallim nga viti 2017, në vitin 2018 lëndët me vlerë të vogël janë në ritje kështu në vitin 2018 në gjykatë janë gjithsej të pranuar 2564 lëndë me vlerë të vogël. Siç shihet dominojnë edhe këtu lëndët ku kërkohet shpërblim i dëmit kështu që për shpërblim të dëmit kemi

¹⁴⁰ Të dhëna statistikore të mara nga Gjykata Civile Shkup për vitin 2018 për lëndët me vlerë të vogël ku kemi të regjistruara edhe lënde me karakter obligator, mirëpo janë me vlerë të vogël

të evidentuara gjithsej 1263 lëndë nga të cilat 711 lëndë për shpërblim të dëmit jomaterial, 474 lëndë për shpërblim të dëmit material dhe 78 lëndë për shpërblim të dëmit nga autopërgjegjsia.

Mund të konkludojmë se dominon numri i lëndëve ku bazë juridike është borxhi ku kemi gjithsej të regjistruara 1175 lëndë, dhe më pas vijnë lëndët ku kërkohet fitimi i pabazë ku janë të regjistruara 110 lëndë, kurse lëndët që kanë baza tjera juridike janë dukshëm në numër më të vogël.

6. RASTE NGA PRAKTIKA GJYGJËSORE KU ËSHTË VENDOSUR PËR SHPËRBLIMIN E DËMIT TË SHKAKTUAR NË KOMUNIKACIONIN RRUGOR

6.1. Rasti i parë-Aktgjykim i shpallur në vitin 2016

NË EMËR TË QYTETARËVE TË REPUBLIKËS SË MAQEDONISË

GJYKATA THEMELORE SHKUPI 2 SHKUP, si gjykatë civile e shkallës së parë, nga gjykatësi J. S. - kryetar i këshillit, dhe gjykatësit porotë L.B. dhe L.H.P - anëtarë të këshillit, duke vepruar në punën juridike të paditurit B. L nga Shk rr. F... nr.3, kundër paditësit KA S...R... M... - V... I... G... Shk rr. 11 nr.25, për shpërblim të dëmit, vlera 220.195,00 denarë, pas mbajtjes së seancës kryesore, publike dhe gojore më datë 10.10.2016, në prani të përfaqësusit të paditurit advokat Igor Micev nga Shkupi dhe përfaqësuesit të paditësit Borçe Zafirovski i punësuar të paditësi, kurse në ditë 17.10.2016 e solli dhe e shpalli këtë:

A K T G J Y K I M

Kërkesëpadia e paditësit B.. L.. nga Shk për shpërblim të dëmit jomaterial dhe material **PJESËRISHT PRANOHET.**

OBLIGOHET paditësi KA S...R... M.....-V.... I.... G.... Shk, që ti paguajë të paditurit B.L në emër të shpërblimit të dëmit jomaterial për cënim të të drejtave personale (shëndet shpirtëror dhe trupor), sumë në lartësi prej 75.000,00 denarë edhe atë: për dhimbje të shkaktuara fizike sumë prej 24.750,00 denarësh, për frikë sumë prej 18.750,00 denarë, për dhimbje të shkaktuara shpirtërore për shkak të aktivitetit të zvogëluar jetësor sumë prej 31.500,00, me kamatë të ndëshkuar ligjore nga dita e shpalljes së aktgjykimit 17.10 viti 2016, deri në pagesën finale, në lartësi të shkallës së referencës së Bankes Popullore të Republikës së

Maqedonisë e cila çdo gjysëmvetor ka vlejtur në ditën e fundit të gjysmëvetorit e cila i ka parapri gjysmëvetorit në vijim të ritur për 8% pikë.

Kërkesëpadia më e madhe e paditësit për shpërblim të dëmit jomaterial për cënim të të drejtave personale (shëndët shpirtëror dhe trupor), për dallin nga suma e aktgjykuar prej 75.000,00 denarë deri te suma e kërkuar prej 112.500.00 denarë edhe atë: për dhimbje të shkaktuara fizike nga suma e aktgjykuar prej 24.750,00 denarë deri te suma e kërkuar 37.500,00 denarë, për frigë nga suma e aktgjykuar prej 18.750,00 denarë deri te suma e kërkuar prej 30.000,00 denarë, si dhe për dhimbje të shkaktuara shpirtërore për shkak të aktivitetit të zvogëluar jetësor nga suma e aktgjykuar prej 31.500,00 denarë, deri te suma e kërkuar prej 45.000,00 denarë **HUDHET SI E PABAZË.**

OBLIGOHET paditësi KA S...R... M...-V... I... G... Sh..., që ti paguajë të paditurit B... L... në emër të shpërblimit të dëmit material për harxhime për mjekim sumë prej 129,00 denarë, me kamatë të ndëshkuar ligjore nga dita e shpalljes së aktgjykimit 17.10 viti 2016, deri në pagesën finale, në lartësi të shkallës së referencës së Bankës Popullore të Republikës së Maqedonisë e cila çdo gjysëmvetor ka vlejtuar në ditën e fundit të gjysmëvetorit e cila i ka parapri gjysmëvetorit në vijim të ritur për 8% pikë.

Kërkesëpadia më e madhe e paditësit që të obligohet i padituri KA S...R... M...-V... i...G... Shk... që ti paguajë të paditurit B. L. në emër të dëmit material harxhime për mjekim sumë prej 173,00 denarë, me kamatë të ndëshkuar ligjore nga dita e shpalljes së aktgjykimit 17.10 viti 2016, deri në pagesën finale, në lartësi të shkallës së referencës së Bankës Popullore të Republikës së Maqedonisë e cila çdo gjysëmvetor ka vlejtuar në ditën e fundit të gjysmëvetorit e cila i ka parapri gjysmëvetorit në vijim të rritur për 8% pikë, **HUDHET SI E PABAZË.**

OBLIGOHET paditësi KA S...R... M...-V... I... G... Sh..., që ti paguajë të paditurit B. L. në emër të shpërblimit të dëmit material për harxhime për dëmtimin e automjetit “Mercedes” sumë prej 26.236,00 denarë, me kamatë të ndëshkuar ligjore nga dita e shpalljes së aktgjykimit 17.10 viti 2016, deri në pagesën finale, në lartësi të shkallës së referencës së Bankës Popullore të Republikës së Maqedonisë e cila çdo gjysëmvetor ka vlejtur në ditën e fundit të gjysmëvetorit e cila i ka parapri gjysmëvetorit në vijim të ritur për 8% pikë.

Kërkesëpadia më e madhe e paditësit që të obligohet i padituri KA S...R... M...-V... I... G... Sh... që ti paguajë të paditurit B.L. në emër të dëmit material harxhime për dëmtimin e automjetit tip “Mercedes” sumë prej 34.982,00 denarë, me kamatë të ndëshkuar ligjore nga 13.03 viti 2012, deri në pagesën finale, në lartësi të shkallës së referencës së Bankës Popullore të Republikës së Maqedonisë e cila çdo gjysëmvetor ka vlejtuar në ditën e fundit të gjysmëvetorit e cila i ka parapri gjysmëvetorit në vijim të ritur për 8% pikë, **HUDHET SI E PABAZË.**

OBLIGOHET paditësi që tia kompenzoje harxhimet e shkaktuara procedurale të paditurit sumë totale prej 130.646,00 denarë, në afat prej 15 ditësh nga dita e pranimi të aktgjykimit, në frikë të ekzekutivit të detyrueshëm.

Kërkesa më e madhe e autorizuesit të paditësit për kompenzim të harxhimeve procedurale për dallim nga suma e gjykuar 130.646,00 denarë, deri tek suma e kërkuar prej 170.031,00 denarë **HUDHET SI E PABAZË.**

A r s y e t i m i

Më datë 30.04.2014, paditësi B. L. prej Shk... i përfaqësuar nga i autorizuari i tij advokat Igorçe Micev nga Shkupi, lëshoi kërkesëpadi, kundër të paditurit KA S...R... M...-V... I... G... Shk..., për dëmshpërblim të dëmit, vlera 220.195,00 denarë.

Në kërkesëpadi tha se në ditë 01/02.11.2011, në aksidentin e trafikut që ndodhi në kryqëzimin e rr. Krste Misirkov dhe rr.102 në Shkup si drejtues i automjetit tip Mercedes me targa SK-279-TZ, lëndime trupore mori paditësi B.L. nga Shk....

Tha se siç shihet në procesverbalin nga vendi i ngjarjes deri tek aksidenti ka ardhur në mënyrë që personi V.V. nga Shk... e cila ka qenë duke vozitur veturë të tipit Ford Eskort me targa SK-633-MI, duke lëvizur nga rr.102 nga kryqëzimi me rr. Krste Misirkov kur ka aritur para kryqëzimit ka marë veprim që të kthejë në të djathtë, dhe menjëherë pas asaj e ka lëvizur veturën të vijën e mesme dhe pastaj në vijën e majtë të komunikacionit me çka ka kdodhur aksidenti me vtrurën e tipit Mercedes të drejtuar nga paditësi. Vetura e tipit Ford Eskort me targa SK-633-MI ka qenë e siguruar tek paditësi me polisë nr. 010148812.

Theksoi se sipas ekspertizës së komunikacionit, të përgatitur nga ana e ekspertit Peco Naumçeski, detalisht është e përshkruar situata e rrezikshme e komunikacionit. Gjegjësisht aksidenti i komunikacionit ka ndodhur në atë mënyrë që vozitësi i veturës së tipit Ford Eskort nuk është renditur me kujdes gjegjësisht para se të hyjë në anën e majtë ka qenë i obliguar që ta opservojë që pastaj të mer veprim të tillë gjegjësisht të kalojë nga njëra anë e rrugës në anën tjetër, pa mos e rrezikuar apo penguar komunikacionin. Mëqë vozitësi i veturës Ford Eskort siguruesi i paditësit nuk ka vepruar si duhet, eksperti i komunikacionit Peco Naumçevsi thekson se me hyrjen e pakujdesshme në krosinë e komunikacionit me përparsi kalimi, e ka shkaktuar situatën e rrezikshme dhe ajo paraqet shkak bazë për shkaktimin e aksidentit të komunikacionit. Vozitësi i veturës Ford Eskort ka vepruar në kundërshtim me nenin 42 alineë 4 e Ligjit për siguri të komunikacionit në rrugë i cili parasheh se Vozitësi i cili me veturrë hynë në rrugë që me shenjë rrugore është shënuar si rrugë me përparsi kalimi, është i obliguar që ti lëshojë të kalojnë veurat tjera që janë në lëvizje në atë rrugë.

Theksoi se në aksidentin konkret të komunikacionit paditësi B. L. ka pësuar lëndime trupore të diagnostifikume si kontuzione (shtypje) të kokës, kontuzione (shtypje) të qafës dhe kontuzione (shtypje) të trupit, detalisht të vërtetuara në dokumentacionin adekuat mjekësor.

Thotë së si pasojë e aksidentit të komunikacionit paditësit i janë cënuar të drejtat personale për shkak të cënimit trupor dhe shpirtërorë. Me lëndimin e të drejtave personale, paditësi ka pësuar dëm jomaterial për shkak të shkaktimit të dhimbjeve fizike, frikës dhe dhimbjeve shpirtërore për shkak të aktivitetit të zvogëluar jetësor.

Tha se paditësi për shkak të lëndimeve të mara trupore pikë së pari ka ndjerë dhimbje fizike intensive në pjesën e kokës, qafës dhe trupit. Dhimbjet kanë qenë të shoqëruara me maramendje, jostabilitet dhe pamundësi për ta lëvizur lirshëm qafën për shkak të së cilës e ka pasur qafën të imobilizuar me kravatën Shanc. Në periudhën e ardhshme gjatë gjithë kohës ka qenë në qetësi. Si pasojë e aksidentit të trafikut dhe lëndimeve të cilat i ka marrë, paditësi së pari ka ndjerë frikë primare intensive e cila ka kaluar në frikë sekondare. Frika sekondare intensive është paraqitur si pasojë e dhimbjes së madhe fizike për shkak të së cilës ka menduar se e ka thyer kokën. Menjëherë pas lëndimit, paditësi ka ndjerë dhimbje shpirtërore për shkak të shkallës së lartë të aktivitetit të zvogëluar jetësor, e cila në periudhën e ardhshme gradualisht shkon duke u zvogëluar. Në këtë periudhë paditësi nuk ka qenë në gjendje që vetë të marrë pjesë në

komunikacionin rrugor si para lëndimit, i ka kryer vetëm aktivitetet e domosdoshme, nuk ka shkuar në fakultet, nuk është marë me sport shkak për të cilin i është zvogëluar kualiteti jetësor. E gjithë kjo ia ka ndruar planet dhe e ka penguar që të kryejë obligimet studentore duke pasur parasysh se paditësi është student i fakultetit të edukatës fizike i cili kërkon përgatitje të veçantë fizike dhe aktivitete të përditshme fizike.

Tha se si pasojë e aksidentit të trafikut i është shkaktuar edhe dëm material për shkak të prishjes së veturës Mercedes me targa SK-279-TZ në pronësi të paditësit. I padituri ka përgatitur procesverbal komisioni për shikimin dhe vlerësimin e veturës së dëmtuar sipas së cilit dëmtimi i automjetit është vlerësuar si dëmtim total me çmin në lartësi prej 139.930,00 denarë. Pas vërtetimit të lartësisë së dëmit material i padituri ka përcaktuar se paditësi ka kontribut prej 50% nga ana e tij që aksidenti të shkaktohet dhe në datë 19.04.2012, ka paguar vetëm gjysmën e dëmit të shkaktuar gjegjësisht sumë prej 69.965,00 denarë, në emër të dëmit të shkaktuar material për shkak të prishjes së veturës.

Autorizuesi i paditësit në seancën e mbajtur kryesore gjyqësore theksoi se qëndron në kërkesëpadi dhe në precizim të kërkesëpadisë. Në fjalën përfundimtare propozoi të pranohet plotësisht. Gjygyji ta ketë parasysh ekspertizën e vetme mjekësore e cila nuk është kontestuar nga ana e të paditurit, të ketë parasysh se paditësi është person i moshës së re i cili ka pësuar me tepër lëndime trupore, gjegjësisht shtypje të kokës, shtypje të qafës dhe shtypje në tërë trupin. Kërkesëpadia është e parashtruar realisht kështu duke pasur parasysh intenzitetin dhe kohëzgjatjen e kriteriumeve kualifikatore të përshkruara detalisht në ekspertizën neuropsihjatrike të Dr. Zora Mitiq.

Prova propozoi. Harxhime procedurale kërkoi.

I autorizuari i të paditurit theksoi se e konteston kërkesëpadinë e paditësit, dhe llogarit se ashtu e precizuar është shumë e lartë, duke pasur parasysh llojin dhe karakterin e lëndimeve se punohet për lëndime trupore. Në fjalën përfundimtare propozoi që gjygyji ta hedhë kërkesëpadinë plotësisht.

Prova propozoi.

Gjygyji i lëshoi dhe shpalosi provat e propozuara edhe atë: procesverbal për shikimin në vendin e ngjarjes nr.3570 nga data 28.02 viti 2012 me legend dhe skicë nga vendi i

ngjarjes, deklaratë nga specialisti na Qendra univerzitare për sëmundje hirurgjike Shën Naum Ohridski nga data 01.11 viti 2011, fletëpagesa për rengen kontrollë nga Qendra univerzitare për sëmundje hirurgjike Shën Naum Ohridski nga data 01.11 viti 2011, me deklaratë specialistike rengenologjike, ekspertizë medicinale e përgatitur nga ekspert mejsoro ligjor dr. Zora Mitiq specialist neuropsikijatër, kërkesë për shpërblim të dëmit të shkaktuar nga autopërgjegjsia e dërguar dëri të S... M... V...I....G..., fotokopje nga llogaria fiskale në sumë prej 230,00 denarë e dhënë nga QKU Shën Naum Ohridski Shkup, vertëtim nr. 074316, procesverbal komisioni për kontrollin dhe përcaktimit e vlerës së veturës së prishur për dëm nr. 6200000292/2012 nga SHA S...R... K... M..., njoftim nga data 18.04 viti 2012, deklaratë llogarie nga data 01.03 viti 2012 deri në datë 20.04 viti 2012 nga Stopanska Banka SHA Shkup, ekspertizë e përgatitur nga eksperti ligjor Orce Gjorgjievski inzhinjer i diplomuar i komunikacionit, mendim plotësues nga eksperti gjygsor Peco Naumçevski inzhinjer i diplomuar i komunikacioniot, ekspertizë e përgatitur nga Instituti për ekspertizë SHPKNJP Shkup SV.nr.49/16 përgatitur nga ekspertët Dejan Trpeski, Dejan Zdravevski dhe mr.Beti Jankovska Jovanovska, shikim në shkkresat e lëndës penale K.nr. 2903/10 të Gjykatës themelore Shkup 1 Shkup, dhe duke i vlerësuar të gjitha provat mëvetësish si dhe si një tërësi provash sipas nenit 8 të Ligjit për procedurë kontestimore e vërtetoi këtë gjendje faktie:

Në ditë 02.11.2011, në kruqëzimin e bul. Krste Misirkov dhe rr.102 në ora 00.10, në Shkup, ka ndodhur aksident trafiku mes pjesëmarësve V.V. nga Shk. e cila në momentin kritik ka qenë duke vozitur veturë të tipit Ford Eskort me targa SK 633 MI, në pronësi të L.V. me vlefshmëri të lejes për vozitje deri me datë 17.04 viti 2012, e siguruar në SHA K... M..., dhe pjesëmarësit B.L. nga Shk i cili në momentin kritik ka qenë duke vozitur veturë të tipit Mercedes në pronësi të tij, me vlefshmëri të lejes për vozitje deri më 20.06.2012, të siguruar na SHA V... Pjesëmarësi L.V. në momentin kritik ka kthyer në të djathtë, dhe menjëherë pas saj nga ana e djathtë e rrugës e ka lëvizur veturën në anën e mesme dhe më pas të majtë, përderisa pjesëmarësi B.-tani paditës e ka mbajtur drejtimin e vet të lëvizjes. Në veturën e tipit Ford Eskort bashkëudhëtarë ka qenë M. E. nga Shk., kurse në veturën e tipit Mercedes bashkëudhëtarë kanë qenë M.Ç. dhe A. B. të dy nga Shk...

Nga procesverbali për shikim në vendngjarje nr.3570 del se kryqëzimi është i pashëm, i ndritshmëm me drita rrugore në të cilën komunikacioni është i rregulluar me shenjë

komunikacioni “kryqëzim me rrugë më përparësi në kalim” i cili është i vënduar në rr.102 dhe horizontalisht është i shënuar në të njëjtin para se të lidhet me bul. Krste Misirkov.

RR.102 është e drejtë dhe e pashme, e rregulluar me konstrukcion me trotuare me bazë betoni e cila gjatë kohës së aksidentit dhe gjatë kryerjes së shikimit në vendngjarje ka qenë e thatë, me gjërësi prej 6,00m. Në pjesën mesme para kryqëzimit me bulevarin Krste Misirkov me vijë të gjatë të plotë të bardhë është e ndarë në dy krosi komunikacioni. Në rrugë komunikacion ka pasur në të dy anët.

Bulevari Krste Misirkov është i drejtë dhe i pashëm, i ndritshëm me drita rrugore, i rregulluar me konstrukcion me trotuare me bazë betoni i cili gjatë kohës së aksidentit dhe gjatë kryerjes së shikimit në vendngjarje është i thatë. Në mes me zhardinjerë betoni është i ndarë në dy krosi komunikacioni, kurse krositë e komunikacionit janë të ndara me vija të gjata të ndërprera, kurse para kryqëzimit me rr.102 me vija të plota të bardha janë të ndara në nga tre krosi komunikacioni. Nga bulevari komunikacioni është zhvilluar me intenzitet të lartë në një drejtim.

Nga bul.Krste Misirkov në drejtim nga jugu ndërmjet krosisë se mesme dhe të djathtë pas kryqëzimit me rr.102 shihet e ndalur veturë e tipit Ford Eskort me targa SK 633 MI me pjesën e parme të kthyer në drejtim veriperëndimor, kurse me pjesën parme të rrotës së pjesës së majtë në krosinë e komunikacionit të larguar për 6.10m, kurse me pjesën e pasme të rrotës së pjesës së njëjtë të larguar për 4.50m. Duke shikuar në të njëjtën para kësaj veture në krosinë e majtë dhe të mesme shihen shenja luhatjeje në gjatësi prej 16,30m të lëna në rrugë nga rrotat e veturës së njëjtë. Shikuar në drejtim të njëjtë pas kësaj veture në krosinë e mesme shihet e ndalur veturë e tipit Mercedes me targa SK 279 TZ, me pjesën e parme të kthyer në drejtim jugor, kurse me rrotën e parme të djathtë në pjesën e majtë të krosisë së komunikacionit të larguar për 5.70m. Nga kjo veturë në krosinë e majtë dhe të mesme të komunikacionit shihen të lëna shenja luhatjeje në gjatësi prej 77.50m, kurse të matura nga fillimi i shenjës së luhatjes nga pjesa e majtë e krosisë së komunikacionit distanca është 0.90m. Shikuar në drejtim të njëjtë para fillimit të shenjave të luhatjes në anën e majtë të zhardineve të betonit të venduara mes dy krosive të bulevarit shihet dëm në gjatësi prej 7.80m të shaktuara nga goditja e veturës së tipit Mercedes në të njëjtat.

Si pikë qëndresë është marë qosh nga kryqëzimi i përshkruar më lartë dhe është matur nga pika qëndruese deri të rrota e parme e djathtë e veturës së tipit Ford Eskort distanca është 37.40m.

Nga aksidenti lëndime trupore ka pësuar paditësi si pesëmarës në aksidentin e komunikacionit rrugor.

Sipas ekspertizës mjeksoro ligjore të pregatitur nga eksperti mjeksoro ligjor dr. Zora Mitiq ku janë të theksuara lloji dhe karakteri i lëndimeve që ka pësuar paditësi të cilat janë klasifikuar si shtypje të kokës, qafës dhe trupit, dhe këto lëndime praqesin lëndime trupore në aspekt mjeksoro ligjor.

Dhimbja si fenomen special senzitiv paraqet reaktion të pakëndshëm, spontan dhe provokativ të karakterit dhe intenzitetit të ndryshëm, e cila mvaret nga natyra e lëndimit, vëllimi, qëlizës që është lënduar nga njëra anë si dhe vetë personi që është lënduar gjegjësisht struktura psikologjike, mosha si dhe rethanat specifike në të cilat ndodhet nga ana tjetër, kualiteti dhe intenziteti i dhimbjeve gjatë lëndimit mvaret nga lokalizimi i intervenimeve që do të ndërmeren nga pasojat e shkaktuara apo nga numri i receptorëve të dhimbjes.

I padituri nga aksidenti ka marë shtypje të kokës, qafës dhe trupit. Një ditë ka pasur dhimbje me intenzitet të lartë. Dhimbjet kanë qenë të shoqëruara me maramendje dhe jostabilitet. Nuk ka mundur ta lëvizë qafën lirshëm, dhe gjatë javës në vijim ka pasur dhimbje me intenzitet të mesëm. Tërë javën ka ndejtur shtrirë dhe nuk ka dalur prej shtëpie. Ka mbajtur kravatë imobilizuese Shancë. Ka pranuar tableta ketanol dhe ka vënduar peceta në qafë. Më pas dhimbjet janë zvogëluar në nivel të dhimbjeve të lehta por edhe më pas nuk ka mundur ta lëvizë lirshëm qafën, ka pasur rrëdësi dhe ka mundur se do të alivanoset. Dhimbje të shkallës së lehtë ka pasur në dhjetë ditët në vijim. Prandaj për atë kohë ka dalur vetëm për punë të domosdoshme, nuk ka shkuar në fakultet dhe nuk është marur me aktivitete sportive.

Frika si reaktion emocional ose gjendje emocionale paraqet formë më të komplikuar të manifestimit psikologjik dhe është një nga arsyet kryesore për parehatinë e njeriut. Gjatë lëndimeve trupore frika është element shoqërues dhe intenziteti i tij mvaret nga natyra e lëndimeve, mënyra e shkaktimit të lëndimit, si dhe nga mosha (përvojat e mëparshme), si dhe specifikat e strukturës psikologjike të të lënduarit. Ekzistojnë dy lloje të frikës edhe atë frika primare dhe sekundare. Frika primare paraqitet menjëherë pas situatës në të cilën është e rrezikuar jeta dhe integriteti trupor i njeriut me lëndim të njëkohësishëm. Frika sekondare është frikë e tillë e cila është paraqitur për shkak të traumës trupore të organizmit të njeriut dhe manifestohet si frikë, shqetësim, mendim në lidhje me rrjedhën e mjekimit të vetë lëndimit.

Në rastin konkret i lënduari, në momenti kur e ka parë se vetura ka marrë kahjen nga ai dhe se do të pësojë aksident ka përjetuar frikë primare. Frika primare është gjegjësisht frikë nga vdekja, e cila sizakonisht zgjat disa sekonda dhe çdo herë është me intenzitet të lartë. Është frikur për jetën e vete dhe pastaj ka përjetuar frikë për gjendjen e vete shëndetësore si pasojë e lëndimeve të mara në kokë dhe qafë. Kjo frikë sekondare me intenzitet të lartë ka zgjatur në ditë. Pas inçizimeve RTG të qafës dhe kokës dhe më pas barnave për dhimbje si është zvogëluar dhimbja është zvogëluar edhe frika në shkallën mesatare. Si e tillë ka zgjatur javën në vijim, gjegjësisht përderisa ka pasur dhimbje me intenzitet mesatar dhe ka qenë i detyruar të rijë shtrirë. Si janë qetësuar dhimbjet ashtu edhe frika është zvogëluar. Këtë frikë e ka përjetuar sepse nuk ka mundur në mënyrë të rregullt të funksionojë. Ka pasur maramendje dhe nuk ka mundur të ulet dhe nuk ka mundur lirshëm ta lëvizë qafën dhe ka menduar se do të ketë pasoja shëndetësore.

Aftësia e përgjithshme jetësore shpreh aftësi tek njeriu që ti kënaq nevojat e përgjithshme jetësore dhe për vete të përfitojë kënaqësi të veçanta për jetën. Zvogëlimi i aftësisë jetësore paraqet zvogëlim të funksionit të organizmit e cila paraqitet si humbje e ndonjë aftësie jetësore ose përpjekje të përforcuara gjatë kryerjes së ndonjë aktiviteti jetësor. Zvogëlimi i aktivitetit jetësor në shkallë më të lartë apo më të ulët ekziston atëherë kur për shkak të ndonjë lëndimi të shkaktuar tek personi i lënduar do të paraqitet pamundësi ose zvogëlim i mundësisë për funksionim të organizmit ose të ndonjë pjese të tij. Zvogëlimi i aftësisë së përgjithshme jetësore shihet në nevojën për përpjekje të përforcuara në ndonjë pjesë.

Te paditësi si pasojë e lëndimeve të mara edhe atë shtypje të kokës, qafës dhe trupit ka pasur tepër të dëmtuar aftësinë për aktivitet jetësor nga dita e parë e lëndimit. Simptomet si kokëdhimbje, dhimbje të qafës, maramendje pastaj dhimbjet e trupit dhe mbajtja e kravatës imobilizuese Shanc nuk i ka lejuar që normalisht ti kryejë funksionet elementare jetësore. Për atë ka pasur nevojë për përpjekje të përforcuara. Aktiviteti jetësor elementar ka qenë i zvogëluar në shkallë të mesme në javët në vijim. Për atë kohë nuk ka shkuar në shkollë, nuk është marrë më aktivitete sportive edhe qëndrimi ulur për një kohë më të gjatë i ka shkaktuar rëndësi. Kjo ia ka prishur planet dhe i ka ndikuar që të mos mund ti realizojë planet studentore si dhe obligimet dhe detyrat studentore. Pastaj vërehet dëmtim i lehtë i aftësisë jetësore për të vepruar, në dhjetë ditët në vijim. Në atë kohë te i dëmtuari ekziston dhimbje shpirtërore e cila sipas intenzitetit është

adekuate me dëmtimin e aftësisë së përgjithshme jetësore, kurse me shuarjen e aftësisë së përgjithshme jetësore shuhet edhe dhimbja shpirtërore.

Paditësi ka përjetuar lëndime trupore në aksidentin e komunikacionit edhe atë shtypje të kokës, qafës dhe trupit. Për shkak të lëndimit paditësi ka përjetuar dhimbje intensive, dhimbje të mesme intensive dhe dhimbje të lehta. Paditësi ka përjetuar frikë primare, më pas frikë sekundare në shkallë të mesme dhe më pas në shkallë të lehtë.

Paditësi ka pasur zvogëlim të aftësisë së përgjithshme jetësore për shkak të lëndimeve të pësura nga shkalla e rëndë, në shkallë të mesme e më pas në shkallë të lehtë për shkak të të cilave ka pësuar dhimbje shpirtërore.

Nga superekspertiza e përgatitur nga Instituti për ekspertizë Shkup SV III 49/2016, e përgatitur nga ekspert ligjor Dejan Trpevski inzh. i dipl. komun., Dejan Zlatevski inzh. i dipl. komun. dhe Beti Jankovska Jovanovska del se:

Shoferi i veturës së tipit Ford Eskort e ka drejtuar veturën me shpejtësi e cila ka qenë në suaza në shpejtësisë së lejuar për lëvizje në vendin kritik, por e njëjta nuk ka qenë e sigurt për kushtet e rrugës, gjegjësisht nuk ka qenë e sigurtë për hyrje në krosi të bulevardit të rr.102.

Shoferi i veturës së tipit Mercedes e ka drejtuar veturën e tij me shpejtësi më të madhe se e lejuara për lëvizje në vendngjarje në vendin kritik për 50%.

Aksidenti i trafikut ka ndodhur në rrugë të thatë në kushte nate me drita rrugore, që çon në përfundim se ka pasur kushte për zhvillim të sigurtë të komunikacionit.

Komunikacioni në kryqëzimin rrugor është i rregulluar me shenjë të vënduar komunikacioni, kryqëzim me rrugë me përparsi në kalim, i vënduar në anën e djathtë të rr.102. Vozitësi i veturës së tipit Ford Eskort ka pasur obligim të hyjë në kryqëzim me kthim në të djathtë në anën e fundit të krosisë së komunikacionit, e më pas në lëvizje të lidhet në krosinë e mesme dhe në fund të hyjë në krosinë e majtë. Vozitësi i veturës së tipit Ford Eskort ka bërë lëshim në drejtim të automjetit sepse gjatë hyrjes në kryqëzim në vend se të hyjë me kthim në të djathtë në anën e fundit të krosisë së djathtë kjo veturë ka hyrë gati se drejtë dhe ka filluar menjëherë të lidhet në zonën e kryqëzimit.

Vozitësi i veturës Ford Eskort ka bërë lëshim gjatë drejtimit të veturës sepse në kryqëzim ka hyrë me kthim në të djathtë më shpejtësi të papërshtatshme, gjegjësisht me shpejtësi me të cilën nuk ka mundur në kohë ta ndalë veturën në rast reziku, dhe gjatë kësaj nuk e ka respektuar shenjë vertikale të komunikacionit, gjegjësisht nuk e ka respektuar të drejtën në kalim të veturës së tipit Mercedes.

Vozitësi i veturës së tipit Mercedes ka bërë lëshim gjatë drejtimit të automjetit sepse veturën e ka drejtuar me shpejtësi e cila ka qenë më e madhe se maksimalisht e lejuara për lëvizje në vendin kritik. Me këtë veprim vozitësi i veturës së tipit Mercedes ka lëshim në veprimet e veta pasi që ka pasur mundësi ti zvogëlojë pasojat nga aksidenti i trafikut. Vozitësi i veturës Mercedes edhe po ta kishte drejtuar veturën në shpejtësinë maksimale të lejuar 60 km/h nuk do të kishte mundësi që ta ndalë veturën e tij para se të aksidentohet me veturën e tipit Ford Eskort por në rast të tillë aksidenti do të ishte me shpejtësi shumë më të vogël.

Sipas analizës së bërë, rasti i rezikshëm është paraqitur si pasojë e hyrjes së veturës së tipit Ford Eskort në krosinë e bulevardit Krste Misirkov në mënyrë të palejuar me prerje të kryqëzimit në vend ku hyrja ka qenë e lejuar në anën e fundit të djathtë të krosisë, pastaj në kryqëzim ka hyrë me shpejtësi të paadaptuar për të hyrë në kryqëzim. Vozitësi i veturës së tipit Ford Eskort ka pasur të drejtë të hyjë në krosinë e djathtë të bulevardit, por gjatë lidhjes në krosinë e majtë të komunikacionit është dashur që ti lëshojë të gjitha veturat që kanë qenë duke lëvizur në krosinë e mesme të komunikacionit dhe në krosinë e majtë të komunikacionit, dhe më pas të vazhdojë me lidhjen e saj në krosinë e majtë. Vozitësi i veturës së tipit Ford Eskort gjatë hyrjes në kryqëzim nuk ka mundur të vlerësojë shpejtësinë me të cilën drejton veturën vozitësi i veturës së tipit Mercedes për të cilin shkak edhe ka filluar me operacionin e lëvizjes së veturës së vete në të majtë. Vozitësi i veturës së tipit Mercedes ka kontribuar që të shkaktohet aksidenti i trafikut, në aspekt të zvogëlimit të pasojave nga i njëjti, sepse i njëjti ka drejtuar veturën më shpejtësi të pasiguruar, me çka në kushte nate, vozitësi i veturës së tipit Ford Eskort nuk ka qenë në mundësi që ta vlerësojë shpejtësinë e veturës së tipit Mercedes, nga edhe del se vozitësi i veturës së tipit Mercedes në mënyrë direkte ka kontribuar për vendimet e joadekuate-të gabara të vozitësit të veturës së tipit Ford Eskort.

Për shkak të lëshimeve të lartëpërmendura nga ana e të dy drejtuesve të autmjeteve në aksidentin e komunikacionit rrugor, ekspertet konstatojnë se për shkaktimin e aksidentit të

komunikacionit ka kontribut nga ana e të dy pjesëmarësve në aksident edhe atë vozitësi i veturës së tipit Ford Eskort ka kontribut prej 75%, kurse vozitësi i veturës së tipit Mercedes ka kontribut prej 25%.

Gjendja e tillë faktike e vërtetuar del nga faktet e prezantuara dhe elaboruara gjatë procedurës kontestimore.

Kështu nga procesverbali për shikim në vendin e ngjarjes gjygi konstatoi për mënyrën, rethanat dhe kushtet në të cilat ka ndodhur aksidenti i trafikut. Gjithashtu nga procesverbali për shikim në vendin e ngjarjes gjygi konstatoi se pjesëmarësit në aksidentin e trafikut kanë pësuar lëndime trupore, si edhe faktin se nga aksidenti janë të dëmtuara veturat e pjesëmarësve gjegjësisht vetura e tipit Mercedes drejtuar nga paditësi dhe vetura e tipit Ford Eskort drejtuar nga pjesëmarësi V.V..

Nga dokumentacioni medicinal si dhe nga ekspertiza mjekësoro-ligjore e përgatitur nga ekspert dr. Zora Mitiq, gjygi konstatoi për lëndimet të cilat i ka marur paditësi nga aksidenti i shkaktuar i komunikacionit, llojin dhe karakterin e lëndimeve si dhe dhimbjen që ka përjetuar, frikën si dhe dhimbjen shpirtërore të cilën paditësi e ka përjetuar si pasojë e aksidentit.

Nga ekspertiza e përgatitur nga eksperti Dejan Trpeski inzhinjer i diplomuar i komunikacionit, Dejan Zlateski inzhinjer i diplomuar i komunikacionit si dhe mr. Beti Janovska Jovanovska nga Instituti për ekspertizë Shkup, gjygi konstatoi për kontributin e pjesëmarësve në aksidentin e komunikacionit.

Nga kërkesa për shpërblimin e dëmit e adresuar deri te i padituri gjygi konstatoi se paditësi që ti dëmshpërblehet dëmi i është drejtuar të paditurit që t'ia dëmshpërblejë dëmin e shkaktuar material dhe jomaterial, meqë për përcaktimin e lartësisë së dëmit material paditësi në ditë 12.03 viti 2012 ka përgatitur procesverbal komisioni për shikimin dhe vlerësimin e veturës së dëmtuar dhe ka konstatuar se dëmi material që i është shkaktuar paditësit është suma prej 139.930.00 denarë, dhe me lajmërim paditësi është lajmëruar se i padituri llogarit se paditësi ka kontribut prej 50% në aksidentin e komunikacionit dhe se padotësit do i paguajë sumë për dëmin e pësuar material prej 69.965.00 denarë, e cila sumë paditësit i është paguar e cila shihet nga certifikata e llogarisë prej datës 01.03 viti 2012 deri në 20.04 viti 2014.

Nga provat e lartëpërmednura gjygi padiskutim e vërtetoi gjendjen faktike, kështu vijon që të vendoste si në dispozitivin e këtij aktgjykimi, dhe krejt kjo sipas nenit 174 dhe nenit 189 të LMD.

Sipas nenit 174 të LMD (1) Personi i përgjegjshëm është i obliguar ta kthejë gjendjen në atë mënyrë që ka qenë para se të shkaktohet dëmi. (2) Përderisa kthimi në gjendjen e mëparshme nuk e eliminon dëmin pjesërisht, personi i përgjegjshëm është i obliguar që pjesën tjetër të dëmit ta kompenzojë në të holla. (3) Kur kthimi në gjendjen e mëparshme nuk është i mundur, ose gjygi llogarit se nuk është i domosdoshëm atë ta bëjë personi i përgjegjshëm, gjygi do të caktojë që ti paguhet të dëmtuarit sumë e caktuar të hollash në emër të kompensimit të dëmit. (4) Gjygi do ti gjykojë të dëmtuarit kompenzim në të holla kur ai e kërkon atë, vetëm nëse rethanat në rastin e caktuar e arsyetojnë kthimin në gjendjen e mëparshme.

Sipas nenit 189 të LMD (1) Në rast të lëndimit të të drejtave personale gjygi nëse e gjen se rëndësia e lëndimit dhe rethanat e rastit e arsyetojnë atë, do të aktgjykojë sumë adekuate në të holla, pa marrë parasysh shpërblimin e dëmit material, si dhe në mungesë të tij. (2) Gjykata gjatë vendosjes lidhur me kërkesën për shpërblimin e dëmit jomaterial, si dhe lartësinë e shpërblimit të tij, duhet të ketë parasysh rëndësinë e vlerës së çënuar dhe qëllimin të cilit i shërben ai shpërblim, por edhe për atë që me atë të mos u kontribuojë tendencave që nuk janë në përputhshmëri me natyrën dhe qëllimin shoqëror të tij.

Gjygi duke pasur parasush dispozitat ligjore të lartëpërmendura, si dhe faktin se paditësi në aksidentin konkret të trafikut ka pësuar si dëm material për shkak të prishjes së veturës poashtu edhe dëm jomaterial nga lëndimet e mara, vijonte që të vendosë si në dispozitivin e këtij aktgjykimi.

Gjygi gjatë vendosjes për përcaktimin e lartësisë së dëmit të kërkuar jomaterial dhe material kishte parasysh edhe kontributin e paditësit në aksidentin e trafikut dhe të njëjtat i zvogëloi sipas kontributit të paditësit në aksidentin e komunikacionit për 25%.

Sipas nenit 148 të Ligjit për procedurë civile gjygi vendosi që i padituri paditësitia konpenzojë harxhimet procedurale në sumë prej 130.646,00 denarë të cilat janë për: përbërje të autorizimit sumë prej 1.300,00 denarë, për përbërje të kërkesëpadisë sumë prej 3.900,00 denarë, për përbërje të kërkesës për shpërblim të dëmit me paushall prej 30% sumë prej 3.900,00 denarë,

për përbërje të nënshtrimit të paarsyetuar që daton nga 22.01 viti 2016 shumë prej 1.300,00 denarë, për përbërje të nënshtrimit të arsyetuar të dorëzuar në seancën gjyqësore në datë 06.09.2016 shumë prej 5.600,00 denarë, për përbërje të raportit për shpenzime shumë prej 1.300,00 denarë, për përfaqësim në dy seanca gjyqësore shumë nga 7.800,00 denarë plus 18% TVSH në këta suma shumë prej 14.346,00 denarë, për ekspertizë mjekësore shumë prej 8.000,00 denarë, për ekspertizë komunikacioni shumë prej 8.000,00 denarë, për superekspertizë shumë prej 11.800,00 denarë, taksa për kërkespadi shumë prej 4.404,00 denarë dhe taksa për aktgjykim shumë prej 4.404,00 denarë.

Gjyngji gjatë vendimit për harxhimet procedurale kishte parasysh se një pjesë e veprimeve të mara gjatë procedurës janë marur para se të hyjë në fuqi Vendimi për ndryshim dhe plotësim të tarifës për punën dhe kompenzimin e harxhimeve për punën e avokatëve prej datës 01.korik viti 2016 dhe të njëjtat i gjykoi sipas tarifës që ka vlejtur deri më datë 01.korik viti 2016, kurse veprimet tjera procedural që janë marur pas ditës kur ka hy në fuqi Vendimi për ndryshim dhe plotësim të tarifës për punën dhe kompenzimin e harxhimeve për punën e avokatëve i aktgjykoi sipas tarifës së avokatëve që është në fuqi.

GJYKATËN THEMELORE SHKUP II SHKUP

5 P4-764/14 në ditë 17.10.viti 2016

Kryetari e këshillit-Gjykatësi

J...S...

6.2. Rasti i dytë-Aktgjykim i shpallur në vitin 2017

NË EMËR TË QYTETARËVE TË REPUBLIKËS SË MAQEDONISË

GJYKATA THEMELORE SHKUPI 2 SHKUP, si gjykatë civile e shkallës së parë, nga gjykatësi J. S. si gjykatës i individual, duke vepruar në punën juridike të paditurës A.H. nga J... f.sh.O... rr.101 pn, nëpërmjet të autorizuarit Shoqëri avokatie B.K -Sh- rr. A.P. nr.1/1 mezanin 6 kundër të paditurit SHA S...R... M.S – V...I...G... rr.11 tetori nr.25 Sh..., për dëmshpërblim të dëmit, vlera 551.700,00 denarë, pas mbajtjes së seancës kryesore, publike dhe gojore më datë 04.05.viti 2017, në prani të përfaqësusit të paditësit advokat L.T advokat nga zyra e avokatisë B.K nga Sh. dhe përfaqësuesit të paditur B.Z. i punësuar te i padituri , kurse në ditë 12.05 viti 2017 e solli dhe e shpalli këtë:

A K T G J Y K I M

Kërkesëpadia e paditëses A.H. nga J., **PJESËRISHT PRANOHET.**

OBLIGOHET i padituri SH.A. M...S...-V...I...G..., që ti paguajë të paditurit në emër të shpërblimit të dëmit jomaterial për cënim të të drejtave personale (shëndet shpirtëror dhe trupor), sumë prej 131.700,00 denarë edhe atë: për dhimbje të shkaktuara fizike sumë prej 30.000,00 denarë, për frikë sumë prej 15.000,00 denarë, për dhimbje të shkaktuara shpirtërore për shkak të aktivitetit të zvogëluar jetësor sumë prej 50.000,00 denarë si dhe dhimbje të shkaktuara shpirtërore për shkak të shëmtimit sumë prej 35.000,00 denarë me interes të ndëshkuar ligjor, në lartësi të shkallës së referencës së Bankës Popullore të Republikës së Maqedonisë e cila çdo gjysëmvetor ka vlejtuar në ditën e fundit të gjysmëvetorit e cila i ka parapri gjysmëvetorit në vijim të ritur për 8% pikë, llogaritur nga dita e shpalljes së aktgjykimit 12.05 viti 2017 deri në pagesën finale, si dhe dëm material sumë prej 1.700,00 denarë me interes të ndëshkuar ligjor, në lartësi të shkallës së referencës së Bankës Popullore të Republikës së Maqedonisë e cila çdo gjysëmvetor ka vlejtuar në ditën e fundit të gjysmëvetorit e cila i ka parapri gjysmëvetorit në vijim të ritur për 8% pikë, llogaritur nga dita e ngritjes së aktpadisë 15.03 viti 2016 deri në pagesën finale, si dhe t’ia kompenzojë paditëses harxhimet procedurale në sumë prej 75.102,00 denarë në afat prej prej 8 ditësh nga dita e pranimi të aktgjykimit.

Kërkesëpadia më e madhe e paditëses për shpërblim të dëmit jomaterial për cënim të të drejtave personale (shëndet shpirtëror dhe trupor), për dallim nga suma e kërkuar prej

550.000,00 denarë nga të cilat për dhimbje të shkaktuara fizike 150.000,00 denarë, për frikë suma prej 80.000,00 denarë si dhe për dhimbje të shkaktuara shpirtërore për shkak të aktivitetit të zvogëluar jetësor sumë prej 220.000,00 denarë si dhe për dhimbje të shkaktuara shpirtërore për shkak të shëmtimit sumë prej 100.000,00 denarë, me interes të ndëshkuar ligjor, në lartësi të shkallës së referencës së Bankës Popullore të Republikës së Maqedonisë e cila për çdo gjysëmvetor ka vlejtur në ditën e fundit të gjysmëvetorit e cila i ka parapri gjysmvetorit në vijim të ritur për 8% pikë, për dallimin, llogaritur nga dita e shpalljes së aktgjykimit-12.05.2017 deri në pagesën finale, si dhe për shpërblim të dëmit material për harxhime procedurale nga suma e gjykuar deri në sumën e kërkuar prej 113.146,00 denarë **HUDHET SI E PABAZË.**

AKTVEDNIM

Kundërshtimi i të paditurit se punohet për punë të aktgjykuar **HUDHET SI I PABAZË.**

A r s y e t i m i

Paditësja nëpërmjet të autorizuarit lëshoi kërkesëpadi, në gjygj në ditë 15.03 viti 2016 kundër të paditurit, për dëmshpërblim të dëmit, vlera 551.000,00 denarë.

Në kërkespadi tha se në ditë 18.12.viti 2008, në autostradën Tetovë-Jazhincë në afërsi të shtëpisë së Z. S. në fsh.Xh..., para SHT Bitel për në f.sh.Xh... ka ndodhur aksidenti komunikacioni në të cilin paditësja ka pësuar lëndime të rënda trupore si këmbësor. Deri te aksidenti ka ardhur për shkak të fajit të vetëm nga ana e vozitësit të veturës tip Jugo Florida me targa TE 476 AL, i cili në vendin kritik ka qenë duke e drejtuar veturën me shpejtësi prej 80 km/h, e cila shpejtësi nuk ka qenë e përshtatshme me kushtet dhe gjendjen e rrugës- rrugë e lagët dhe e rrëshqitshme. Për shkak të shpejtësisë së papërshtatshme nuk ka qenë në gjendje që në kohë ta ngadalësojë veturën dhe para çdo pengese që në kushte të caktuara ka mundur ta parasheh dhe se me anën e djathtë të veturës e ka goditur paditësen e cila në momentin kritik si këmbësor ka qenë duke e kaluar rrugën nga e majta në të djathtë shikuar në drejtim të lëvizjes së veturës. Për aksidentin e komunikacionit në fjalë më parë në këtë gjygj është udhëhequr procedurë e cila ka qenë e regjistruar si P.nr..../09, për shpërblim të dëmit, e cila plotëfuqishëm ka mbaruar me aktgjykim të kësaj gjykate P.nr..../09 të datës 17.03 viti 2011 dhe aktgjykim të gjykatës së Apelit në Shkup GZH nr..../11 të datës 05.04 viti 2012, tek të cilat ka qenë e vërtetuar se nuk ka faj nga

ana e paditëses. Si pasojë e aksidentit paditësja ka pësuar lëndime të rënda trupore për shkak të të cilave ka qenë në intervenim operativ edhe atë: stabilizim i fragmenteve frakturale me implantim të materialit osteosintetik T-pllakë dhe vidha. Në datë 18.01 viti 2013 paditësja i është nënshtruar intervenimit të rri operativ për heqjen e materialit osteosintetik i cili është në lidhje kauzale-shkakore direkte me lëndimet e para që i ka marrë paditësja në aksidentin e komunikacionit që ka ndodhur në datë 08.10 viti 2008. Për shkak të intervenimit të kryer operativ në datë 18.01 viti 2013 paditësja ka pësuar si dëm material poashtu edhe dëm jomaterial, dhe për këtë arsye ka dërguar kërkesëpadi.

Në seancën gjyqësore si dhe në shkresat e dërguara në gjyq paditësja nëpërmjet të autorizuarit ngeli në tërësi në kërkesëpadi me propozim që e njëjta të pranohet plotësisht. I kontestoi thënjet e të paditurit se në rastin konkret kërkespadia është e vjetërsuar dhe se paditësi nuk ka legitimacion pasiv me arsyetim se sipas normave të LPK, aktgjykimi ka veprim ndaj palëve prej ditës kur e njëjta dërgohet te palët që do të thotë së afati për lëshim të kësaj kërkesëpadie sipas nenit 379 aline 2 të LMD fillon të rjedhë prej ditës kur aktgjykimi është i dërguar te palët gjegjësisht kur pala ka kuptuar se aktgjykimi është i plotëfuqishëm, gjegjësisht në rastin konkret aktvendimi. Reth kontestit për mospasje të legitimacionit pasiv nga ana e të paditurit tha se legitimacioni pasiv i të paditurit del nga neni 58 në lidhje me nenin 61 të Ligjit për sigurim të detyrueshëm në trafik. Edhe reth bazës së kërkesëpadisë duke vendosur për vendimin është fakt që dëmi që e ka pësuar paditësja për shkak për intervenimit të ndërmarë operativ është direkt në lidhje kauzale shkakore me lëndimin që e ka marrur në aksidentin e komunikacionit si dhe ndoshta edhe fakti se ky dëm nuk i është dëmshpërblyer paditëses gjatë vedosjes me aktgjyimin e parë, e as gjyqi nuk e ka pasur parasysht kur ka vendosur.

Prova propozoi. Harxhime procedurale kërkoi.

I padituri në përgjigje të kërkesëpadisë të datës 06.04 viti 2016, e kontestoi kërkesëpadinë e paditëses në tërësi duke theksuar se i padituri ka vepruar sipas aktgjykimit P-..../09 të këtij gjyqi dhe paditëses në tërësi ia ka shpërblyer si dëmin e aktgjykuar material poashtu edhe dëmin e aktgjyuar jomaterial, të shkaktuar në aksidentin e komunikacionit në datë 18.12 viti 2008. Theksoi kundërshtim të legitimacionit pasiv të të paditurit, sepse në aksident ka marrë pjesë veturë e cila nuk ka qenë e siguruar tek i padituri. Theksoi se ekspertiza e lëshuar nga ana e paditëses është nga Shoqëria për ekspertizë Veshtje e cila nuk është e regjistruar në regjistrin

për ekspert. Theksoi se kërkesëpadia është e vjetërsuar sepse ka kaluar kohë më e gjatë që kur ka ndodhur aksidenti, gjegjësisht ka kaluar afati normativ në të cilin paditësja mund të kërkojë mbrojtje gjyqësore.

Në seancën kryesore paditësi nëpërmjet të autorizuarit ngeli në tërësi në përgjigje të kërkesëpadisë dhe argumentet e dhëna dhe propozoi që kërkesëpadia të hudhet si e pabazë. Theksoi se kërkesëpadia është punë e aktgjykuar dhe se paditësja është në tërësi e dëmshpërblyer në bazë të aktgjykimit të sjellë nga ky gjyq në të cilin aktgjykim në tërësi është e vërtetuar gjendja faktike dhe llogaritur shpërblyer për dëmin e pësuar. Reth vjetërsimit tha se letër lëshimi është provë e vetme në të cilën bazohet kjo kërkesëpadi dhe i njëjti është nga ata 18.03 viti 2013, nga e cila provë del se paditësja të njëjtën ditë është pranuar dhe lëshuar. Kërkesëpadia e parë e cila poashtu ka qenë e lëshuar në këtë gjyq daton nga 14.11 viti 2013, në afat sipas nenit 365 aline 1 të LMD. Në aktvendim 12P4-.../13 të kësaj gjykate kërkesëpadia e paditësës është e hudhur, kundër të cilit aktvendim paditësja është ankuar mirëpo Gjykata e Apelit Shkup ankesën e paditësës e ka hudhur si të pabazë, kurse aktvendimin e shkallës së parë e ka vërtetuar me aktvendim GZH-.../15 të datës 11.12 viti 2015, që do të thotë vendimi i shkallës së parë në datë 11.12 viti 2015 është bërë i plotfuqishëm. Meqë është irelevante kur vendimet e shkallës së dytë marini klauzulën e plotfuqishmërisë, data e pranimi të vendimit të shkallës së dytë ndikon në atë se kur vendimi do të marrë klauzulë ekzekutive, që don të thotë se ndikimi i pranimi të vendimeve të shkallës së parë është kryesor pasi vetëm kundër të njëjtave mund të ngrenë palët ankesë të rregullt juridike. Në bazë të kësaj vlerëson se lëshimi i kërkesëpadisë së re sipas së cilës gjyqi tani vepron dhe e cila është e pranuar në gjyq në datë 15.03 viti 2016 nuk kemi ndalesë të vjetërsimit sipas nenit 379 sepse aktvendimi i shkallës së dytë ka qenë i plotfuqishëm në datë 11.12 viti 2015, kurse kjo kërkesëpadi është lëshuar në gjyq në datë 15.03 viti 2016 që don të thotë pas kalimit të 3 muajve dhe 4 ditë. Neni 379 i LMD lejon ngritje të kërkesëpadisë e cila do të inicojë ndalesë të vjetërsimit mirëpo nëse e njëjta dërgohet në gjyq në afat prej 3 muajve nga plotfuqishmëria e vendimit i cili ka qenë hudhur. Sipas kësaj nëse operacioni ka qenë i kryer në datë 18.01 viti 2013, kërkesëpadia në këtë gjyq është lëshuar në datë 15.03 viti 2016 që don të thotë kanë kaluar 3 vite 2 muaj dhe 28 ditë nga dita e intervenimit kirurgjikal prej kur paditësja ka kuptuar dhe e ka ditur se është nxjerur material osteosintetik, dëri në lëshimin e kërkesëpadisë, dhe sipas nenit 365 aline 1 të LMD, kërkesëpadia është e vjetërsuar.

Prova propozoi. Harxhime procedurale kërkokoi.

Gjygyji i lëshoi dhe shpalosi provat e propozuara edhe atë: Çertifikatë kurorëzimi për komunën Jegunovce qyteti Tetovë e cila evidentohet në librin amë të të kurorëzuarve për vendin f.sh Orashe në nr.arh.1 për vitin 2014, procesverbal për shikimin në vendin e ngjarjes nr.379 nga MPB SPB për qytetin Tetovës me legendë dhe skicë nga vendi i ngjarjes, aktgjykim i gjykatës themelore Tetovë K.nr..../2009 nga data 26.06 viti 2009, aktgjykim i gjykatës themelore Shkupi 2 Shkup 34P.../09 nga data 17.03 viti 2011, aktgjykim i gjykatës së Apelit Shkup GZH.../11 nga data 05.04 viti 2012, fletëlëshim nga Klinika për traumatologji Shkup me numër amë 1759/08, deklaratë nga specialisti-subspecjalisti nga data 15.02 viti 2009, që është regjistruar në regjistrin mjekësor në nr 12, deklaratë nga specialisti-subspecjalisti nga SHPSH klinika univerzitare për traumatologji nr.4042 nga data 13.02 viti 2009, vërtetim për nevojë për ndihmesë ortopedike nga Spitali klinik Tetovë nga 02.02 viti 2009, ekspertizë mjekësore e përgatitur nga ekspert dr. Toni Taleski specialist ortoped, vërtetim nr.03962 nga data 25.01.2013, me fotokopje të letërnjoftimit, kërkesëpadi e pranuar në gjykatën themelore Shkupi 2 Shkup në datë 14.11 viti 2013, aktvendim i Gjykatës themelore Shkupi 2 Shkup P.../13 nga data 19.06.2014, aktvendim i Gjykatës së Apelit Shkup GZH -..../15 nga data 11.12 viti 2015, kërkesë e dërguar deri të SHASR K.. M.. Shkup, shkresë nga i autorizuari i kërkuesit deri te SHASR K.. M.. nga data 25.02 viti 2013, procesverbal nga data 16.12.2014 për sencë gjygjësore të mbajtur në Gjykatën themelore Shkup 2 Shkup për lëndë P4.../14, aktgjykim i Gjykatës themelore Shkup 2 Shkup 38P1-..../11 nga data 09.04 viti 2012, shikim në shkresat e lëndës 12P4-..../13, dhe në bazë të nenit 7 dhe 8 të Ligjit për procedurë civile e vërtetoi gjendjen faktike në vijim:

Në ditë 18.12 viti 2008, në rrugën regjionale Tetovë -Jazhincë në afërsi të shtëpisë së Z. S. nga fsh X..., para ShA Bitel nga fsh.Xh... ka ndodhur aksident komunikacioni në të cilin vetura e tipit Jugo Florida me targa TE 476 AL, në pronësi të S. M., kurse drejtuar nga Z. M. nga fsh.Përshofc, ka goditur paditësen si këmbësor. Të njëjtën ditë persona të autorizur në detyrë në MPB SPB Tetovë kanë dalur në vendngjarje dhe kanë përpiluar procesverbal për shikim në vendngjarje nr.30.2-1116/1. Deri të aksidenti ka ardhur për faj të vozitësit të veturës PMV Jugo Florida me targa TE 476 AL i cili në vendin kritik ka qenë duke e drejtuar veturën në shpejtësi prej 80km/h, e cila shpejtësi nuk ka qenë e përshtatshme me kushtet dhe gjendjen e rrugës- rrugë e lagur dhe e rëshqitshme. Për shkak të shpejtësisë së papërshtatshme nuk ka qenë në gjenje në kohë

ta ndalë veturën dhe para çdo pengese që në kushte të caktuara ka mund ti parasheh kështu që me anën e djathtë të veturës ka goditur paditësen e cila në momentin kritik si këmbësor e ka kaluar rrugën nga e majta në të djathtë në drejtim të lëvizjes së veturës.

Si pasojë e aksidentit të komunikacionit paditësja ka marë lëndime të rënda trupore në lloj të frakturës së qafës të ashtit të sipërm të djathtë, frakturë të ashtit ishijaldik dhe pubik-pjesë të anës së mesme të djathtë të ripit të legenit dhe shtypje të gjoksit.

Në procedurë e cila ka qenë e inicuar me kërkesëpadi të paditëses kundër të paditurit, për lëndimet e mara nga aksidenti i komunikacionit, më aktgjykim të këtij gjygji 34P-..../09 nga data 17.03 viti 2011 pjesërisht është pranuar kërkesëpadia e paditëses dhe i padituri është i obliguar ti paguajë sumë adekuate në të holla paditëses në emër të dëmshpërblimit të dëmit jomaterial për lëndim të të drejtave personale të shëndetit trupor dhe shpirtëror, sumë totale prej 930.000,00 denarë nga të cilat për dhimbje të shkaktuar fizike sumë prej 230.000,00 denarë, për frikë të shkaktuar sumë prej 180.000,00 denarë dhe për dhimbje të shaktuara shpirtërore për zvogëlim të aktivitetit të përgjithshëm jetësor sumë prej 520.000,00 denarë, si dhe në emër të dëmit material sumë prej 3.700,00 denarë me kamatë ligjore të dënueshme duke llogaritur nga dita e shpalljes së aktgjykimit 17.03 viti 2011 deri në pagesën finale. Me të njëjtin aktgjykim është e hudhur si e pabazë kërkesëpadia më e madhe e paditëses për dallim nga suma e gjykuar deri në sumën e kërkuar edhe atë për dhimbje të shkaktuara fizike deri në sumën e kërkuar prej 450.000,00 denarë, për frikë deri në sumën e kërkuar prej 320.000,00 denarë si dhe për dhimbje të shkaktuara psiike për shkak të aktivitetit të zvogëluar jetësor deri në sumën e kërkuar prej 750.000,00 denarë si dhe për dhimbje të shkaktuara shpirtërore për shkak të shëmtimit deri në sumën e kërkuar prej 150.000,00 denarë, me kamatë të ndëshkuar ligjore, në këto suma. Aktgjykimi i përmendur është i plotëfuqishëm që nga data 05.04 viti 2012 me aktgjykim të Gjykatës së Apelit në Shkup GZH-..../11.

Si pasojë e fateqësisë paditësja ka pësuar lëndime të rënda trupore të shprehura si frakturë të qafës (pjesa e sipërme) në ashtin e sipërm të djathtë, frakturë të ashtit ishijaldik dhe pubik – pjesë e anës së djathtë të mesit të rrypit të legenit dhe shtypje të gjoksit dhe barkut. Për shkak të lëndimeve të para paditësja i është nënshtruar intervenimit kirurgjikal operativ edhe atë: stabilzim i gjakderdhjes në fragmentet e frakturuara me vendosje të materialit osteosintetik

Pllakë-T dhe vidha. Si pasojë e lëndimeve paditësja ka përjetuar dhimbje fizike, frikë dhe dhimbje shpirtërore.

Në intervenimin kirurgjikal në pjesën e sipërme në ashtit pas aksidentit të komunikacionit paditëses i është plasuar material osteosintetik (Pllakë -T dhe vidha), për stabilizim të fragmenteve ashtnore të pjesës së sipërme të djathtë. Paditësja në periudhën kur ka ndodhur aksidenti i komunikacionit ka qenë në moshë kur ende nuk janë të mbyllura të a.q zona kërcore në ritje me të cilat ashtet e gjata riten në gjatësi. Për shkak të mbylljes së tërësishme të zonave të ritjes, me ndjekje të ritjes gjatësore të ashtit të afektuar gjë e cila ndodhën kur mbushen 18 vjet, te paditësja ka qenë i vendosur indikator për nxjerjen e materialit osteosintetik të vendosur. Pasi kanë kaluar 4 vjetë dhe më ka ardhur në stabilizim dhe forcim të unazës ashtnore (ashti i riformuar në vendin e frakturës) ka qenë i indikim nxjerje e pllakës dhe vidhave të cilat më nuk kanë pasur funksionalitet, posaçërisht se me qëndrim të kohëzgjatshëm në trup si trupa të huaj siç janë pllakat dhe vidhat, mund të vijë deri në gjendje të lëshimit të tyre, me reaktionin përreth me qelizat biologjike me të a.q mealoze. Për këto shkaqe paditësja si rast elektiv ka qenë e operume me akt të radhës operativ me indikacion medicinal për nxjerje gjatë intervenimit operativ me qëndrim të shkurtë spitalor në Klinikën për traumatologji. Prej këtui del se në mënyrë direkte është lidhja shkakore kauzale e operacionit të dytë i cili daton nga 18.01 viti 2013 me lëndimet primare të cilat paditësja i ka marur gjatë aksidentit të komunikacionit që ka ndodhur në datë 18.12 viti 2008 dhe periudhën e gjatë të mjekimit të paditëses jashtë.

Pas intervenimit operativ me nxjerje të materialit osteosintetik, paditësja ka pësuar dhimbje fizike me shkallë të mesme të rëndë në dy javët e para, pas operacionit, kurse për shkak të mbylljes së plagës operative nëpër shtresa në strukturave të buta qelizore mbi asht të cilat janë të pasura me nerva dhe prandaj janë dhimbshëm të ndjeshme. Ne gjashtë javët në vijim, pas operacionit, dhimbjet kanë qëndruar në shkallë të lehtë.

Te paditësja, e cila përndryshe ka qenë e vetëdijshme se do të ketë edhe një intervenim operativ, ka qenë prezent frika paraoperative sekundare në shkallë të lartë për shkak të pasojave të mundshme nga komplikimet operative, perderisa pas mbarimit të intervenimit frika është zvogëluar në frikë me shkallë të mesme dhe si e tillë ka qëndruar deri në fund të muajit të tretë. Pas kësaj periudhe frika ka qenë në shkallë të lehtë.

Aftësia e përgjithshme jetësore te paditësja ditën e parë ka qenë e zvogëluar në shkallë të rëndë, kur paditësja ka qenë e hospitalizuar në Klinikën për raumatologji, ku ka qenë e stacionume pasive në krevet e shtrirë dhe qetësi strikte, posaçërisht për shkak të anestezionit të marë. Në dy javët në vijim aktiviteti i përgjithshëm jetësor te paditësja ka qenë i zvogëluar në shkallë të mesme, dhe deri në fund të muajit të tretë ka qenë në shkallë të lehtë.

Si pasojë e lëndimeve të paditësja është manifestuar invaliditet i rëndë, posaçërisht për shkak të faktit se për shkak të lëndimit të marë të rëndë në pjesën e legenit, është e sigurt nevoja për plasim të protezës plastike jonatyrle në regjionin e ijes (artikullacionit koksofemural). Invaliditeti te paditësja është i përhershëm dhe përbëhet nga kontraktura, gjegjësisht ka ngurtësi të nyjeve të prekura të shpatullës së djathtë, shërim i ashteve të legenit me dislokacion dhe sasi të reduktume të lëvizjeve në amplitude maksimale në legenin e djathtë të cilat pa problem ka mund ti kryejë para marjes së lëndimeve nga aksidenti i komunikacionit. Për shkak të kontrakturës postraumatike të qëndrueshme në nyjet e prekshme, paditësja përjeton invaliditet trupor.

Te paditësja ekziston edhe shëmtim për shkak të vijave operative të cilat janë të paraqitura pas intervenimeve postoperative në anën ashtnore të djathtë dhe janë të natyrës estetike, por edhe paraqesin dhimbje shpirtërore të shkallës së lartë për paditësen duke pasur parasysh se e njëjta është femër e moshës së re dhe për shkak të shenjave të mara e njëjta ndjen turp dhe pakujdesi kur del në publik, dhe për shkak të asaj se ecja e saj nuk është si duhet paditësja shumë lehtë ndahet nga grupi i shoqërisë, shkak për të cilin dhimbja shpirtërore është e intenzitetit të lartë.

Meqë paditësja si pasojë e intervenimit kirurgikal operativ të kryer ne datë 18.03 viti 2013, ka pësuar dëm material dhe jomaterial i cili nuk është i përfshirë në aktgjykimin e plotëfuqishëm 34 P-.../09 që daton nga 17.03 viti 2011, në ditë 14.11 viti 2013 paditësja nëpërmjet përfaqësuesit të vetë në këtë gjygj ka dërguar kërkespadi për shpërblim të dëmit e cila në gjygj është e regjistruar si 12P4.../13 për shpërblim të dëmit të shkaktuar si pasojë e intervenimit kirurgjikal të datës 18.01.2013, vlera e kërkesëpadisë-551.700,00 denarë.

Me aktvendim 12P4 .../13 të datës 19.06 viti 2014 ky gjygj, kërkesëpadinë e paditëses e ka hudhur, kurse veprimet e mara të paditëses nëpërmjet të autorizuarit janë shfuqizuar, për shkak i cili nuk është për qëllimin e bazës juridike, gjegjësisht për arsye se i autorizuari i paditëses nuk ka pas autorizim të rregullt që ta përfaqësojë pditësen dhe nuk ka

dorëzuar autorizim në gjykatë në afatin e caktuar. Aktvendimi i lartëpërmendur është bërë i plotëfuqishëm me aktvendim të Gjykatës së Apelit në Shkup GZH nr..../15 të datës 11.12 viti 2015 të cilin paditësja e ka pranuar në datë 23.12 viti 2015.

Paditësja nëpërmjet autorizuesit deri të ky gjygj kërkespadinë e kësaj lënde për shpërblim të dëmit, vlera e kërkesëpadisë 551.700,00 denarë e ka dërguar në datë 15.03 viti 2016.

Si pasojë e lëndimeve paditësja ka pësuar edhe dëm material në emër të harxhimeve për mjekim shumë totale prej 1.700,00 denarë.

Gjendjen e tillë faktike të vërtetuar gjygyji e vërtetoi nga provat e shpalosura gjatë procedurës, të propozuara nga palët në këtë kontest, kurse sipas barës së vërtetimit sipas nenit 205 nga Ligji për procedurë civile.

Mes palëve nuk është e kontestueshme baza juridike në lidhje me vendin kohën dhe mënyrën se si ka ndodhur aksidenti i komunikacionit si dhe përgjegjsia e siguruesit të të paditurit dhe të njëjtat dalin nga procesverbali për shikim në vendgjarje nr.30.2-1116/1 nga data 18.12 viti 2008 dhe aktgjykimi 34P.nr..../09 të datës 17.03 viti 2011 të këtij gjygyji.

Nuk është e kontestueshme kurse del edhe nga aktgjykimi i këtij gjygyji 34P.nr..../09 të datës 17.03 viti 2011 e plotëfuqishme në ditë 02.04 viti 2012 me aktgjykim të gjykatës së Apelit në Shkup GZH nr..../11 se me të njëjtën paditëses i është paguar në emër të shpërblimit të dëmit të shkaktuar jomaterial shumë prej 930.000,00 denarë dhe dëm material shumë prej 3.700,00 denarë.

Për zgjidhje të pyetjes së kontestueshme pas intervenimit kirurgjikal të kryer ndaj paditëses në ditë 18.03 viti 2013, gjegjësisht pas sjelljes së aktgjykimit të plotëfuqishëm të këtij gjygyji 34P..../09 të datës 17.03 viti 2011, është në lidhje kauzale shkakore me aksidentin e komunikacionit, gjygyji gjatë vedosjes u udhëhoq me ekspertizen mjeksoro ligjore të përgatitur nga ekspert dr. Toni Taleski nëpërmjet Agjensionit për ekspertiza Veshto, nga e cila del se intervenimi operativ i cili i është kryer paditëses në ditë 18.03 viti 2013 është në lidhje direkte kauzale-shkakore me lëndimet e para të mara të paditëses në aksidentin e komunikacionit që ka ndodhur në datë 18.12 viti 2008 dhe periudhës gjatë mjekimit të paditëses jashtë. Gjegjësisht eksperti sqaron se intervenimi i kryer në ashtin e gjatë të anës së djathtë pas aksidentit të komunikacionit paditëses i është vënduar material osteosintetik (pallakë T dhe vidhe) për stabilizim

dhe përforsim të grupit të ashtnave (ashtin e riformuar në vendin e frkturuar) ka qenë e indikuar heqje e pllakës dhe vidheve të cilat nuk kanë funksionalitet, psaçërisht me pjesëmarje të gjatë si trupa të huaj në organizëm siç janë pllakat dhe vidhat, mund të vijë në lirim të tyre, dhe reaktion reth qelizave biologjike me të a.q. Mataloza. Gjatë vërtetimit të gjendejes faktike në këtë pjesë gjygi kishte parasysh se i padituri nuk propozoi asnjë provë relevante në këtë rethanë, edhe pse gjatë procedurës e kontestoi.

Nga ekspertiza e lartëpërmendur gjygi vërtetoi për faktet për llojin dhe karakterin e lëndimeve të cilat i ka marrë paditësja si dhe pasojat nga lëndimet, në kuptim të intenzitetit dhe kohëzgjatjes së dhimbjeve fizike, frikës dhe dhimbjeve shpirtërore për shkak të zvogëlimit të aktivitetit të përgjithshëm jetësor. Gjatë vërtetimit të gjendjes faktike në këtë pjesë gjygi udhëhiqeshte nga ekspertiza e lartëpërmendur, duke pasur parasysh se i padituri nuk propozoi ekspertizë relevante reth kësaj çështjeje, edhe pse e kontestoi ekspertizen e dhënë nga ana e paditëses dhe në atë kuptim, lartësinë e kërkesëpadisë në aspekt të dëmit jomaterial.

E padiskutueshme është por del edhe nga shkresat e lëndës 12P4-.../13se në datë 14.11 viti 2013 paditësja nëpërmjet autorizuesit ka dërguar kërkesëpadi në gjygi e cila është e regjistruar në numër gjygjësor 12P4.../13, për dëmshpërblim të dëmit të shkaktuar si pasojë e intervenimit kirurgjikal të datës 18.01 viti 2013, vlera e kontestit 551.700,00 denarë, i cili dëm nuk është i përfshirë në aktgjykimin e plotëfuqishëm 34P.nr.../09 të këtij gjygi të datës 17.03 viti 2011. Nga kjo provë u vërtetua se me aktvendim 12P4.../13 të datës 19.06 viti 2014 të këtij gjygi kërkesëpadia e paditëses ka qenë e hudhur, kurse veprimet e mara nga ana e të autorizuarit të paditëses të shfuqizuara, për shkak se nuk është për bazën e punës juridike por për shkak të asaj se i autorizuari i paditëses nuk ka dërguar autorizim për paditësen në gjygi në afat të caktuar. Shikuar nga shkresat e lëndës aktvendimi i lartëpërmendur është i plotëfuqishëm në ditë 11.12 viti 2015, me aktvendim të Gjykatës së Apelit të Shkupit, kurse paditësja të njëjtën e ka pranuar në datë 23.12 viti 2015.

Padyshim është kurse del edhe nga vula pranuese e gjygjit se paditësja përmes autorizuesit në këtë gjygi kërkesëpadinë në fjalë kundër të paditurit, për shpërblim të dëmit, vlera e kontestit 551.700,00 denarë, e ka dërguar në ditë 15.03 viti 2016.

Lartësia për shpërblim të dëmit material për paditësen për harxhime për mjekim është në lartësi prej 1.700,00 denarë, dhe e njëjta del nga vërtetimi nr.039612 nga data 25.01 viti 2013, me fotokopje të llogarisë fiskale.

Në bazë të gjendejs së tillë të vërtetuar faktike dhe provave të shpalosura dhe të analizuara gjyqi vlerësoi se kërkespadia e paditëses është pjesërisht e pranueshme.

Baza juridike për obligim të të paditurit për shpërblim të dëmit të shkaktuar del nga Ligji për sigurim të detyrueshëm të komunikacionit (Gazeta Zyrtare e RM nr.88/05).

Sipas nenit 14 të këtij ligji, poseduesi gjegjësisht shfrytëzuesi i veturës motorike ose veturës së bashkangjitur është i obliguar që të lidhë kontratë për sigurim nga përgjegjësia nga dëmet që do të shkaktohen me përdorim të mjetit motorik për shkak të vdekjes, lëndimeve trupore, dëmtim të shëndetit, prishjen ose shkatërimin e sendeve, përveç nga përgjegjësia për sendet që i merë për transport.

Sipas nenit 141 të Ligjit mbi marrëdhënjet detyrimore (Gazeta zyrtare e RM nr.18/2001, 78/2001, 04/2002, 59/2002, 05/2003, 54/2008, 81/2009 dhe 161/2009) ai që me faj do të shkaktojë dëm tjetrit është i obliguar që tia dëmshpërblejë.

Sipas nenit 142 të ligjit të lartëpërmendur dëmi është zvogëlimi pasurusorisë së dikujt (dëmi i thjeshtë), dhe ndalim i zmadhimit të daj (Fitimi i humbur), si dhe shkaktim i lëndimit të të drejtave personale (dëmi jomaterial).

Sipas nenit 9-a alinea 1 të Ligjit për ndryshim dhe përmbushje të ligjit mbi marrëdhënjet detyrimore (Gazeta zyrtare e RM nr.88/08 nga 11.07.2008), çdo person fizik, përveç mbrojtjes të të drejtave pronsore ka edhe të drejtë të mbrojtjes së të drejtave të veta personale sipas ligjit. Sipas alinesë 2 të këtij neni si të drejta personale në kuptim të këtij ligji janë e drejta në jetë, shëndet trupor dhe shpirtëror, nder, reputacion, emër personal, privatësi të jetës personale dhe familjare, liri, shpikje intelektuale dhe të drejta tjera personale.

Sipas nenit 189 al. 1 dhe 2 të LMD (Gazeta Zyrtare e RM nr. 84/11 prej datës 11.07.2008) Në rast të lëndimit të të drejtave personale gjyqi nëse e gjen se rëndësia e lëndimit dhe rethanat e rastit e arsyetojnë atë, do të aktgjykojë sumë adekuate në të holla, pa marrë parasysh shpërblimin e dëmit material, si dhe në mungesë të tij. Gjykata gjatë vendosjes lidhur me

kërkesën për shpërblimin e dëmit jomaterial, si dhe lartësinë e shpërblimit të tij, duhet të ketë parasysh rëndësinë e vlerës së cënuar dhe qëllimin të cilit i shërben ai shpërblim, por edhe për atë që me atë të mos u kontribuojë tendencave që nuk janë në përputhshmëri me natyrën dhe qëllimin shoqëror të tij.

Duke u udhëhequr me normat ligjore të lartëpërmendura dhe nga ekspertiza mjeksore ligjore e ekspertit dr. Toni Taleski gjygi i gjykoi paditëses shpërblim të dëmit jomaterial për dhimbje të pësuar fizike sumë prej 30.000,00 denarë. Gjatë përcaktimit të lartësisë për dhimbje të pësuar fizike, gjygi kishte parasysh se pas intervenimit operativ me nxjerje të materialit osteosintetik, paditësja ka përjetuar dhimbje fizike të rënda në shkallë të mesme në dy javët e para, pas operacionit, kurse në gjashtë javët në vijim pas operacionit dhimbjet kanë qenë të shkallës së lehtë. Kërkesëpadia më të madhe për këtë kriterium nga suma e gjykuar deri të suma e kërkuar prej 150.000,00 denarë, sipas këtij gjygi është shumë lartë e vendosur.

Gjatë përcaktimit të lartësisë për dëmshpërblimin për frikën e shkaktuar, gjygi kishte parasysh se paditësja e cila ka qenë në vetëdije se do të vijojë intervenim kirurgjikal, ka pasur frikë paraoperative sekondare me intenzitet të fuqishëm për shkak të pasojave të mundshme nga komplikimet operative, kurse pas mbarimit të intervenimit frika është zvogëluar deri në frikë me shkallë të mesme dhe si e tillë ka qëndruar deri në fund të muajit të tretë, përderisa pas kësaj periudhe frika ka qenë prezente në shkallë të lehtë. Prej këtyre arsyetimeve gjygi gjykoi sumë në lartësi prej 15.000,00 denarë. Kërkesëpadia më të madhe për këtë kriterium nga suma e gjykuar deri të suma e kërkuar prej 80.000,00 denarë, për gjygin është lartë e përcaktuar.

Për dhimbjet e pësuar shpirtërore për shkak të zvogëlimit të aktivitetit të përgjithshëm jetësor gjygi i gjykoi paditëses sumë prej 50.000,00 denarë. Gjatë përcaktimit të lartësisë për këtë dëmshpërblim gjygi kishte parasysh se ditën e parë ka qenë e në shkallë të rëndë, kur paditësja ka qenë e hospitalizuar në Klinikën për raumatologji, ku ka qenë e stacionume pasive në krevet e shtrirë dhe qetësi strikte, posaçërisht për shkak të anestezionit të marë. Në dy javët në vijim aktiviteti i përgjithshëm jetësor të paditësja ka qenë i zvogëluar në shkallë të mesme, dhe deri në fund të muajit të tretë ka qenë në shkallë të lehtë. Pastaj gjygi kishte parasysh se si pasojë e lëndimeve të paditësja është manifestuar invaliditet i rëndë, posaçërist për shkak të faktit se për shkak të lëndimit të marë të rëndë në pjesën e legenit, është e sigurt nevoja për plasim të protezës plastike jonatyrë në regjionin e ijës (artikullacionit

koksofemural). Invaliditeti te paditësja është i përhershëm dhe përbëhet nga kontraktura, gjegjësisht ka ngurtësi të nyjeve të prekura të shpatullës së djathtë, shërim i ashteve të legenit me dislokacon dhe sasi të reduktume të lëvizjeve në amplitude maksimale në legenin e djathtë të cilat pa problem ka mund ti kryejë para marjes së lëndimeve nga aksidenti i komunikacionit. Për shkak të kontraktës postraumatike të qëndrueshme në nyjet e prekshme, paditësja përjeton invaliditet trupor. Kërkesëpadia më të madhe e paditëses për këtë kriterium nga suma e gjykuar deri të suma e kërkuar prej 220.000,00 denarë, sipas vlerësimit të këtij gjygji është shumë lartë e përcaktuar.

Për dhimbjet shpirtërore për shkak të shëmtimit gjygji gjykoi sumë prej 35.000,00 denarë. Gjatë përcaktimit të lartësisë së dëmshpërmbimit për këtë kriterium gjygji kishte parasysh se te paditësja ekziston edhe shëmtim për shkak të vijave operative të cilat janë të paraqitura pas intervenimeve postoperative në anën ashtnore të djathtë dhe janë të natyrës estetike, por edhe paraqesin dhimbje shpirtërore të shkallës së lartë për paditësen duke pasur parasysh se e njëjta është femër e moshës së re dhe për shkak të shenjave të mara e njëjta ndjen turp dhe pakujdesi kur del në publik, dhe për shkak të asaj se ecja e saj nuk është si duhet paditësja shumë lehtë ndahet nga grupi i shoqërisë, shkak për të cilin dhimbja shpirtërore është e intenzitetit të lartë. Kërkesëpadia më e madhe e paditëses për këtë kriterium nga suma e gjykuar deri të suma e kërkuar prej 100.000,00 denarë, sipas vlerësimit të këtij gjygji është shumë lartë e përcaktuar.

Gjygji gjykoi edhe interes të ndëshkimit ligjor në sumat e gjykuara nga dita e shpalljes së aktgjykimit -12.05 viti 2017 deri në pagesën finale, sipas nenit 266-a dhe nenit 192-a si në dispozitivin e këtij aktgjykimi.

Sipas nenit 266-a të Ligjit për ndryshim dhe plotësim të ligjit mbi marrëdhënjet detyrimore (gazeta Zyrtare e RM nr.161/2009) norma e interesit të ndëshkuar përcaktohet për çdo gjysmëvjetor edhe atë në lartësi të normës së interesit të instrumentit bazë të tregut të hapur të BPRM (norma referente), e cila ka vlejtur në ditën e fundit të gjysmëvjetorit i cili i ka parapri viti në vijim, e zmadhuar për 10% pikë në kontratat e tregut dhe kontratat mes tregtarëve dhe personave në të drejtën publike, gjegjësisht e zmadhuar për 8% pikë në kontratat në të cilat së paku njëra palë nuk është tregtar (normë e interesit të dënuar).

Sipas nenit 192-a të LMD përgjegjsia për pagesë të dëmshpërblimit adekuat arin më ditën kur gjykata e shkallës së parë e shpall vendimin më të cilin është përcaktuar lartësia e këtij dëmshpërblimi.

Si pasojë e të lartëpërmendurës gjygji e hudhi si të pabazë kërkesëpadinë më të madhe të kërkuar të paditëses për shpërblim të dëmit jomaterial nga sumat e gjykuara deri të sumat e kërkuara, si dhe kërkesën për interesin e dënuar ligjor për dallimin, llogaritur nga dita e aktgjykimit 12.05 viti 2017 deri në pagesën finale si në dispozitivin e këtij vendimi.

Sipas nenit 184 alina 1 të LMD, ai që di ti shkaktojë tjetrit lëndime trupore ose do t'ia dëmtojë shëndetin, është i obliguar që t'ia kompenzojë harxhimet rreth mjekimit dhe harxhimet tjera të nevojshme në lidhje me atë, si dhe fitimin e humbur për shkak të paaftësisë për punë gjatë kohës së mjekimit.

Si pasojë e lëndimeve paditësja ka pësuar edhe dëm material në emër të harxhimeve për mjekim në shumë prej 1.700,00 denarë, të cilën shumë i padituri ka përgjegjisi t'ia paguajë paditëses. Gjygji gjykoi edhe interes të ndëshkimit ligjor në sumat e gjykuara nga dita e ngritjes së kërkesëpadisë -15.03 viti 2016 deri në pagesën finale, sipas nenit 266-a të LMD si në dispozitivin e këtij aktgjykimi.

Gjatë vendosjes gjygji kishte parasysh kundërshtimin e të paditurit se në rastin konkret është punë e gjykuar, megjithatë vlerësoi se i njëjti është i pabazë dhe e hudhi si të tillë, për arsye se edhe pse punohet për palë të njëjta për ngjarje të njëjtë të dëmshme për të cilin ka vendim gjygsor të plotëfuqishëm P.nr.../09 i datës 17.03 viti 2011, në rastin konkret lëndë e kërkesëpadisë është kërkesë për shpërblim të dëmit për dëmin që nuk është i përfshirë me kërkesëpadinë për të cilën më parë është sjellur aktgjykim i plotëfuqishëm gjygsor, gjegjësisht për faktin se punohet për pasoja të dëmshme që janë paraqitur pas sjelljes së vendimit të plotëfuqishëm gjygsor dhe të cilat nuk janë të përfshira me të njejtën.

Gjatë vendosjes gjygji i vlerësoi edhe kundërshtimet e të paditurit për mospasje të legitimacionit pasiv, por për të njëjtat gjeti se janë të pabaza duke pasur parasysh faktin se legitimacioni pasiv i paditësit padyshim është i vërtetuar në aktgjykimin e plotëfuqishëm dhe ekzekutiv të këtij gjygji 34P.nr.../09 të datës 17.03 viti 2011, nga e cila del se shkaktar për shkaktimin e aksidentit të komunikacionit është vozitësi i veturës Jugo Florida me targa TE 476 AE e cila në ditën kur është shkaktuar aksidenti i komunikacionit nuk ka qenë e regjistruar. Në këtë kuptim, legitimacioni pasiv i të paditurit në rastin konkret del nga normat ligjore të nenit 58 alinea 1 të Ligjit për sigurim të obligueshëm të trafikut. Sipas nenit 58 alinea 1 të ligjit të lartpërmendur Byroja nacionale për është e obliguar të formojë Fond Garantues që shërben për

pagesën e dëmeve të shkaktuara në teritorin e Republikës së Maqedonisë nga mjete motorike të pasiguruara dhe të paregjstruara, rimorkio dhe anije të pasiguruara dhe anije motorike si dhe mjete ajrore të pasiguruara. Sipas nenit 61 alinea 2 të ligjit të njëjtë personi i dëmtuar që ka pësuar dëm sipas nenit 58 alinea 1, i cituar më lartë ka të drejtë të çojë kërkesë për shpërblim të dëmit nga Byroja, gjegjësisht kompania e sigurimit, nëse në afat prej tre muajve nga dita kur e dërgon kërkesën për shpërblim të dëmit nuk i paguhet dëmshpërblimi. Nga përmbajtja e normave ligjore të cituara del dispozitiviteti i të drejtës që personi i dëmtuar që ka pësuar dëm në rastin konkret paditësja. Nga vullneti i paditëses mvaret se kërkesën për dëmshpërblim ku do ta adresojë, gjegjësisht a do ta adresojë në Byronë nacionale direkt ose do ta adresojë në ndonjërin nga kompanitë e sigurimit të cilat janë anëtare të Byrosë. Në rastin konkret paditësja sipas vullnetit të vet ka vendosur që kërkesën për shpërblim të dëmit ta adresojë direkt të i padituri si palë me legitimacion pasiv për të qenë palë në këtë procedurë.

Gjatë vendosjes gjyqj e kishte parasysh edhe kundërshtimin për vjetërsim të kërkesëpadisë por vlerësoi se i njëjti është i pabazë dhe nuk e pranoi si faktor për vendim të ndryshëm në këtë procedurë. Vlerësimin e tillë gjyqj e themeloi në faktin se paditësja ka kuptuar për dëmin në ditën kur i është kryer intervenimi kirurgjikal, gjegjësisht në datë 18.01 viti 2013. Paditësja në afatin ligjor prej 3 vjetëve ka ngrëjtur kërkesëpadi në këtë gjyqj kështu që me ngritjen e kërkesëpadisë është paraqitur ndalesë e vjetërsimit. Sipas nenit 379 alinea 1 të LMD nëse kërkesëpadia kundër debitorit është e hudhur për shkak të jokompetencës së gjyqjit ose për ndonjë shkak tjetër i cili nuk është në lidhje me bazën e punës juridike, kështu kreditori përsëri ngren kërkesëpadi në afat prej tre muajve nga dita kur është bërë i plotëfuqishëm vendimi i shkallës së parë me të cilin është hudhur kërkesëpadia, llogaritet se kemi ndërprerje të vjetërsimit. Nga këtu duke pasur parasysh faktin se kërkesëpadia është ngritur në gjyqj në datë 14.03 viti 2013, dhe me vendim P4-.../13 të datës 19.06 viti 2014 gjyqj e ka hudhur pohtë për shkak i cili nuk ka lidhje me punën juridike, dhe duke pasur parasysh se vendimi GZH-.../15 i Gjykatës së Apelit të Shkupit me të cilin vërtetohet vendimi i shkallës së parë të cilin paditësja e ka pranuar në 23.12 viti 2015, del se në rastin konkret nuk kemi vjetërsim të kërkesëpadisë, nëse kemi parasysh faktin se kërkesëpadia e kësaj lënde është ngritur në datë 15.03 viti 2016, gjegjësisht para kalimit të afatit të paraparë në normativin e nenit 379 të LMD më lartë të cituar.

Në bazë të lartëpërmendurës gjyqj vendosi si në dispozitivin e këtij aktgjykimi.

Sipas lartësisë së kërkesës që paditësja fitoi në kontest dhe kërkesës së të autorizuarit të paditëses, kurse në bazë të nenit 148 dhe 149 të Ligjit për procedurë civile gjyqji vendosi që i padituri paditëses t'ia konpenzojë harxhimet procedurale në sumë totale prej 75.102,00 denarë: edhe atë për përpilim të autorizimit sumë prej 1.534,00 denarë me 18% TVSH të llogaritur meqë i autorizuari i paditëses është pagues tatimor, për përpilim të kërkesëpadisë sumë prej 4.602,00 denarë me 18% TVSH të llogaritur, për përpilim të shkresës së arsyetuar sumë prej 4.602,00 denarë me 18% TVSH të llogaritur, për përpilim të shkresës së arsyetuar prej 11.01.2017 sumë prej 7.670,00 denarë me 18% TVSH të llogaritur, për përpilim të raportit për shpenzime sumë prej 1.534,00 denarë me 18% TVSH të llogaritura, për përfaqësim në dy seanca sumë prej 18.408.00 denarë, për taksë për kërkesëpadi sumë prej 11.034,00 denarë, për taksë për vendim sumë prej 11.034,00 denarë, si dhe harxhime për ekspertizë mjeksore ligjore sumë prej 14.684,00 denarë.

Gjyqji e hudhi si të pabazë kërkesën më të madhe të paditëses për kompenzim të harxhimeve procedurale nga harxhimet e gjykuara deri te harxhimet e kërkuara në sumë prej 113.146,00 denarë, duke mos gjykuar harxhime për përfaqësim në seancë gjyqësore në datë 04.07 viti 2016 sepse kjo seancë u anulua për shkak se administrata e gjykatës ishte në grevë, për seancë në datë 06.02 viti 2017 për shkak se nuk ishte marë lënda në shikim dhe për përpilim të nënshtresës së paarsyetuar për arsye se me parashtrësën i autorizuari i paditëses dërgoi në gjyq provë për taksë të paguar të kërkesëpadisë.

Gjatë përcaktimit të lartësisë së harxhimeve procedurale gjyqji udhëhiqeshte me normat e Tarifës për shpërblim dhe kompenzim të harxhimeve të avokatëve e cila ka qenë në fuqi në momentin kur janë marë veprimet procedurale.

GJYKATA THEMELORE SHKUP II SHKUP

5 MALVP-...../16 në ditë 12.05.viti 2017

Gjykatësi

J .S.

6.3. Rasti i tretë-Aktgjykim i shpallur në vitin 2018

NË EMËR TË QYTETARËVE TË REPUBLIKËS SË MAQEDONISË

GJYKATA THEMELORE SHKUPI 2 SHKUP, si gjykatë civile e shkallës së parë, nga gjykatësi J. S. si gjykatës individual, duke vepruar në punën juridike të paditëses N. G. nga Shk. rr.Shandor Petifi nr.12A, nëpërmjet të autorizuarit Paskal Filipovski- advokat nga Shkupi kundër paditësit K... S... U... SHA Shk. bul VMRO nr.3, nëpërmjet të autorizuarit Zyrë avokati Despodovski rr.1737 nr.24/11, për dëmshpërblim të dëmit, vlera 600.000,00 denarë, pas mbajtjes së seances kryesore, publike dhe gojore më datë 16.01.viti 2018, në prani të përfaqësusit të paditësit advokat Paskal Filipovski nga Shkupi dhe përfaqësuesit të paditësit Kristijan Panevski – advokat nga Shkupi me autorizim zëvendësuses nga Vlatko Despodovski advokat nga Shkupi, kurse në ditë 24.01 viti 2018 e solli dhe e shpalli këtë:

A K T G J Y K I M

Kërkesëpadia e paditëses N.G. nga Shk., **PJESËRISHT PRANOHET.**

OBLIGOHET paditësi K... S... U... SHA Shk..., që ti paguajë të paditurit në emër të shpërblimit të dëmit jomaterial për cënim të të drejtave personale (shëndet shpirtëror dhe trupor), sumë prej 300.000,00 denarë edhe atë: për dhimbje të shkaktuara fizike sumë prej 67.500,00 denarë, për frikë sumë prej 45.000,00 denarë, për dhimbje të shkaktuara shpirtërore për shkak të aktivitetit të zvogëluar jetësor sumë prej 187.500,00 denarë, me kamatë të ndëshkuar ligjore, në lartësi të shkallës së referencës së Bankës Popullore të Republikës së Maqedonisë e cila çdo gjysëmvetor ka vlejtur në ditën e fundit të gjysmëvetorit e cila i ka parapri gjysmëvetorit në vijim të ritur për 8% pikë, llogaritur nga dita e shpalljes së aktgjykimit 24.01 viti 2018 deri në pagesën finale, si dhe dëm material për harxhime për mjekim sumë prej 4.077,00 denarë me kamatë të ndëshkuar ligjore, në lartësi të shkallës së referencës së Bankës Popullore të Republikës së Maqedonisë e cila çdo gjysëmvetor ka vlejtur në ditën e fundit të gjysmëvetorit e cila i ka parapri gjysmëvetorit në vijim të ritur për 8% pikë, llogaritur nga dita e ngritjes së aktpadisë 10.02 viti 2017 deri në pagesën finale, në afat prej prej 8 ditësh nga dita e pranimit të aktgjykimit.

Kërkesëpadia më e madhe e paditëses për shpërblim të dëmit jomaterial për cënim të të drejtave personale (shëndet shpirtëror dhe trupor), për dallim nga suma e kërkuar prej

554.000,00 denarë nga të cilat për dhimbje të shkaktuara fizike 120.000,00 denarë, për frikë suma prej 84.000,00 denarë si dhe për dhimbje të shkaktuara psiqike për shkak të aktivitetit të zvogëluar jetësor sumë prej 350.000,00 denarë me kamatë të ndëshkuar ligjore, në lartësi të shkallës së referencës së Bankës Popullore të Republikës së Maqedonisë e cila për çdo gjysëmvetor ka vlejtur në ditën e fundit të gjysmëvetorit e cila i ka parapri gjysmëvetorit në vijim të rritur për 8% pikë, për dallimin, llogaritur nga dita e shpalljes së aktgjykimit deri në pagesën finale, si dhe për shpërblim të dëmit material për harxhime për mjekim nga suma e aktgjykuar deri te suma e kërkuar prej 5.744,00 denarë me kamatë të ndëshkuar ligjore, në lartësi të shkallës së referencës së Bankës Popullore të Republikës së Maqedonisë e cila çdo gjysëmvetor ka vlejtur në ditën e fundit të gjysmëvetorit e cila i ka parapri gjysmëvetorit në vijim të ritur për 8% pikë, llogaritur nga dita e ngritjes së aktpadisë deri te pagesa finale

HUDHET SI E PABAZË.

OBLIGOHET i padituri, që paditëses në emër të harxhimeve të shkaktuara procedurale ti kompenzojë sumë totale prej 63.764,00 denarë, në afat prej 8 ditësh nga dita e pranimi të aktgjykimit.

Kërkesa më e madhe e autorizuesit të paditëses për kompenzim të harxhimeve procedurale për dallim nga suma e gjykuar 63.764,00 denarë, deri tek suma e kërkuar, **HUDHET SI E PABAZË.**

A r s y e t i m i

Paditësja nëpërmjet të autorizuarit lëshoi kërkesëpadi, në gjygj në ditë 10.02 viti 2017 kundër të paditurit, për dëmshpërblim të dëmit, vlera 600.000,00 denarë.

Në kërkesëpadi tha se në ditë 03.02.viti 2016, në ora 19:50 minuta në rr. Justinijani i parë në Shkup në afërsi të diskont Gigo Trejd, si udhëtarë, duke e kaluar rrugën në drejtim nga jugu në veri, paditësen e ka goditur vetura e tipit Folksvagen Pasat me targa SK 585 SS, e siguruar tek i padituri, kurse ka qenë duke vozitur personi S. D. nga fshati Studeniçan Shkup. Si pasojë e aksidentit paditësja ka pësuar lëndime të rënda trupore për shkak të të cilave ka qenë e detyruar që të shërohet një kohë të gjatë, gjëgjësisht ka pësuar si dëm jomaterial poashtu edhe dëm material për harxhime për mjekim. Paditësja në mënyrë jashtgjygsore me kërkesë jashtgjygsorë është drejtuar te i padituri për shpërblim të dëmit të pësuar, por nuk kanë aritur

që të lidhin marrëveshje jashtëgjyqësore për dëmshpërblim të dëmit, dhe për atë arsye paditësja është drejtuar në gjyq më kërkesëpadinë e shprehur.

I autorizuari i të paditurit në përgjigje të kërkesëpadisë të pranuar në gjyq në 03.03. viti 2017, e kontestoi kërkesëpadinë si për bazë poashtu edhe për lartësi, por e kontestoi edhe ekspertizën e komunikacionit të dhënë në gjyq nga paditësi, duke theksuar se kontribut për shkaktimin e aksidentit të trafikut ka vetëm nga ana e paditësit i cili nuk ka vepruar përkatësisht gjatë kalimit të rrugës sepse nuk u ka kushtuar kujdes të mjaftueshëm veturave të cilat kanë qenë duke u afruar nga ana e saj e majtë, rrugën e ka kaluar në vend ku nuk ka të përcaktuar shenjë sinjalizuese vizëbardha-zebra, por edhe vetë paditësja ka deklaruar se ka filluar ta kalojë rrugën duke shikuar në anën e saj të djathtë. Në këtë rethanë propozoi ekspertizë komunikacioni. Gjithashtu e kontestoi edhe lartësinë e kërkesëpadisë, duke theksuar se është shumë lartë e përcaktuar dhe se lartësi adekuate në emër të dëmit jomaterial për paditësen është suma prej 210.000,00 denarë me kontribut prej 30%, e cila shumë paditëses i është ofruar edhe në procedurë jashtëgjyqësore. E kontestoi edhe kërkesëpadinë për dëmshpërblim të dëmit material, saktësisht për ushqim të forcuar dhe rroba të dëmtuara, duke theksuar se paditësja nuk ka prova relevante për këtë rethanë dhe se nuk është e qartë mënyra se si paditësja e ka përcaktuar lartësinë e këtyre harxhimeve. Theksoi se reth dëmit material e pranon shumën në lartësi prej 3.436,00 denarë, e cila shumë është e bazuar në prova relevante edhe atë llogari fiskale për harxhime për mjekim, gjegjësisht shumë prej 2.405,00 denarë më llogaritje të kontributit prej 30%. Theksoi se paditësi nuk ka të drejtë në harxhime për mjekim në institute private, si dhe vërtetimet e pabazuara me llogari fiskale gjyqi nuk duhet ti marrë parasysh, e as ti pranojë, sepse paditësja nuk ka dhënë prova se të njëjtat i ka paguar. Nga shkaqet e lartëpërmendura propozoi që pjesërisht të pranohet kërkesëpadia e paditëses.

Paditësja përmes të autorizuarit në seancën gjyqësore kryesore të datës 16 janar viti 2018 ngeli në kërkesëpadi dhe kërkesëpadinë e parashtuar, theksoi se nuk pajtohet me atë se paditësja ka kontribut prej 20% në shkaktimin e aksidentit të komunikacionit.

Prova propozoi. Harxhime procedurale kërkoi.

I padituri përmes të autorizuarit në seancën gjyqësore kryesore të datës 16 janar viti 2018 theksoi se ngel në përgjigjen e shkruar të kërkesëpadisë, kurse reth kontributit tha se është pyetje juridike për të cilën gjyqi duhet të vendosë. Propozoi që gjyqi pjesërisht ta pranojë

kërkesëpadinë në sumë që do ta zvogëlojë sipas kontributit të paditëses, kurse propozoi që tërësisht ta hudhë kërkesëpadinë si të pabazë për dëm material për ushqim të forcuar dhe rroba të dëmtuara, si dhe për harxhimet tjera të cilat nuk janë të provuara me prova adekuate për pagesa të kryera.

Prova propozoi. Harxhime procedurale kërkoi.

Gjygi i lëshoi dhe shpalosi provat e propozuara edhe atë: procesverbal për shikimin në vendin e ngjarjes nr.379 nga MPB SPB për qytetin Shkup njësi organizative për siguri të përgjithshme dhe SPNJO njësia për siguri në trafikun rrugor reparti për shikim të aksidenteve të komunikacionit nr.28.8.1/9-379 nga data 02.07 viti 2016 me legendë dhe skicë nga vendi i ngjarjes, llogari fiskale gjithsej 10, vërtetime gjithsej 8, kartelë për terapi fizikale nga SHPSH Shtëpi shëndetsore Shkup reparti për terapi fizikale Shkup, certifikatë mjekësore nga Shoqata e mjekësore e Maqedonisë Shkup nr. i regjistrit të shoqatës mjekësore 07-1500/2 prej 05.08 viti 2016, me urdhërpagesë, deklaratë nga specialisti nga SHPSH dr. Stavre Gramov prej datës 25.04 viti 2016, deklaratë nga specialisti nga SHPSH dr. Stavre Gramov prej datës 25.07 viti 2016, deklaratë nga specialisti-subspecjalisti nga poliklinika Jane Sandanski e datës 03.05 viti 2016, deklaratë nga specialisti-subspecjalisti nga poliklinika Jane Sandanski e datës 06.04 viti 2016, deklaratë nga specialisti-subspecjalisti na Qendra univerzitare për sëmundje hirurgjike Shën Naum Ohridski nga data 13.02 viti 2016, deklaratë nga specialisti-subspecjalisti na Qendra univerzitare për sëmundje hirurgjike Shën Naum Ohridski nga data 02.03 viti 2016, deklaratë – mendim radiodiagnostik Qendra univerzitare për sëmundje hirurgjike Shën Naum Ohridski nga data 09.03 viti 2016, deklaratë nga specialisti-subspecjalisti nga Qendra univerzitare për sëmundje hirurgjike Shën Naum Ohridski nga data 30.03 viti 2016, deklaratë nga specialisti-subspecjalisti nga Qendra univerzitare për sëmundje hirurgjike Shën Naum Ohridski nga data 25.05 viti 2016, deklaratë nga specialisti nga SHPSH dr.Stavre Gramov nga data 17.11 viti 2016, kërkesë për shpërblim të dëmit e dërguar deri të U... SHA Shkup, pranuar në U... SHA Shkup në datë 01.09 viti 2016, dërgesë e marëveshjes për shërblim të dëmit jomaterial e nënshkruar nga SHA U... Shkup, marëveshje për shpërblim të dëmit jomaterial për dëmin nr.100011001473/2016 nga data 18.10 viti 2016, e panënshkruar, kërkesë për kthimin e dokumentacionit original e dërguar deri të SHA U... Shkup, kurse e pranuar në SHA U... Shkup në datë 03.11 viti 2016, ekspertizë e përgatitur nga Instituti për ekspertize SHPKNJP Shkup SV nr. 04/17 përgatitur nga ekspert Dejan

Trpeski inzhinjer i diplomuar i komunikacionit, ekspertizë e përgatitur nga dr. Aleksandar Marcikiq, ekspertizë e përgatitur nga Grupacioni nacional për ekspertiza gjygsore SV III.130/17 e përgatitur nga ekspert Ile Cvetanovski inzhinjer i diplomuar i komunikacionit, lexohet pajtim e ekspertizave për lëndë të Gjykatës themelore Shkup 2 Shkup nga ekspert Dejan Trpesi nga Instituti për ekspertiza SHPKNJP Shkup pranuar në gjykatë në datë 30.11 viti 2017, dhe në bazë të nenit 7 dhe 8 të Ligjit për procedurë civile u vërtetua gjendjen faktike në vijim:

Në ditë 13.02.2016, në Shkup, në rr. Justinijani i parë në afërsi të diskontit Gigo Trejd ka ndodhur aksident komunikacioni në të cilën paditësja si këmbësor ka pësuar lëndime trupore.

Në të njëjtën ditë, persona të autorizur në detyrë në MPB SP për SSR Shkup kanë dalur në vendngjarje dhe kanë përpiluar procesverbal për shikim në vendngjarje nr.379 të regjistruar në numër arhivor 28.8.1/9-379 nga data 02.07 viti 2016. Në procesverbal është konstatuar se në aksidentin e komunikacionit pjesëmarës kanë qenë vetura e tipit Folksfagen Pasat me targa SK 585 SS, drejtuar nga personi S.D nga f. S...i Shk..., e siguruar te paditësi dhe paditësja si këmbësor.

Aksidenti i trafikut ka ndodhur në kushte nate me drita rrugore dhe krosi të lagur kështu që pjesëmarësit në trafik kanë qenë të obliguar të lëvizin me vëmendje të zmadhuar. Vozitësi i veturës Foksfagen Pasat ka pasur mundësi teknike që ta vërej këmbësorin, gjegjësisht paditësen edhe në trotoar edhe kur ka filluar të ece nëpër rrugë. Vozitësi i veturës Folsfagen Pasat ka bërë lëshim gjatë drejtimit të automjetit të vet pasi që nuk i ka kushtuar vëmendje të mjaftueshme paditëses si këmbësor dhe nuk e ka lëshuar që ta kalojë rrugën, edhe pse ka pasur mundësi të mjaftueshme që të vërejë se e njëjta ka filluar ta kalojë rrugën dhe gati se ka aritur ta kalojë tërë krosinë e komunikacionit te e cila ka qenë duke lëvizur vetura. Rasti i rezikshëm është paraqitur si pasojë e drejtimit të pakujdesshëm të veturës nga ana e vozitësit të veturës Folksfagen Pasat. Goditja në paditësen si këmbësor ka qenë me anën e majtë të veturës, kurse vetura ka pasur mundësi dhe kohë të reagojë në kohë me drejtimin e veturës së tij në të djathtë, gjë që tregon qartë se veturën e ka vozitur me vëmendje të mangët. Sipas kësaj, lëshimi i bërë është në lidhje direkte kauzalo-shkakore me shkaktimin e aksidentit të trafikut. Paditësja si këmbësor e cila ka pasur qëllim që ta kalojë rrugën në vend ku ka të shënuar rrugëkalim për këmbësor, nuk është dashur që ta shkel rrugën, nëse me veprimin e tillë e ka penguar lëvizjen normale të komunikacionit, në

kushte kur nga ana e majtë e paditëses reth 14 metra ka pasur veturë e cila ka qenë në lëvizje dhe ka qenë duke u afruar te paditësja. Para se ta shkel rrugën paditësja ka qenë e obliguar veçanërisht ti kushtojë vëmendje largësisë dhe shpejtësisë së veturave që kanë qenë duke u afruar nga ajo, si nga ana e majtë poashtu edhe nga ana e djathtë, si dhe drejtë ta vlerësojë shpejtësinë e lëvizjes së veturave. Duke mos vepruar në mënyrë të tillë, paditësja ka bërë lëshim i cili është shkak për shkaktimin e aksidentit.

Si pasojë e aksidentit paditësja ka marrë lëndime trupore të shprehura në lloj si frakturë e padislokuar e ashtit tibijal të këmbës së majtë- bipi i math i nëngjujnit.

Paditësja në dhjetë ditët e para në pjesën e këmbës së majtë gjegjësisht gjunjit të majtë ka përjetuar dhimbje me intensitet të mesëm kur ka ndejtur por edhe të intensitetit të lartë gjatë lëvizjes me këmbën e lënduar dhe përpjekje për tu ndalur në këmbën e majtë dhe më pas dhimbja ka qenë e shoqëruar me ëjtje dhe lëvizje të kufizuar në gjunjnin e majtë. Nga dita e njëmbëdhjetë deri në fund të muajit të dytë pas ngjarjes, dhimbja në pjesën e gjunjnit të majtë ka qenë spontane me intensitet të lehtë dhe dhimbje me intensitet të mesëm kur ka shkelur në këmbën e majtë dhe lëvizje të gjunjnit të majtë. Muajin e tretë paditësja ka përjetuar dhimbje të përkohshme sponatne dhe dhimbje gjatë lëvizjes pa rëndësi më intensitet të lehtë dhe dhimbje me intensitet të mesëm gjatë lëvizjes dhe ngarkesës së këmbës së majtë. Gjatë muajit të tretë paditësja ka shkuar edhe në terapi fizikale e cila ka ndikuar në reduktim të lehtë të dhimbjeve. Gjatë muajit të katërt deri në muajin e gjashtë paditësja ka përjetuar dhimbje me intensitet të mesëm vëtem gjatë ngarkësës së këmbës së majtë dhe lakim të fundshëm të këmbës në nyjen gjunjore, kurse nga muaji i shtatë deri sot paraqitet dhimbje kohëshkurte me intensitet të lehtë gjatë ndryshimeve klimatike.

Duke u gjendur në situatë ku ka qenë i cënuar shëndeti dhe jeta e saj, paditësja ka përjetuar frikë të shkurtë primare me intensitet të lartë i cili është paraqitur në atë moment kur e ka vërejtur veturën dhe gjatë kohës kur e ka përjetuar goditjen dhe pas saj edhe 10 sekonda, kurse pastaj ka kaluar në frikë sekondare i cili me intensitet të lartë ka qenë prezent gjatë tërë ditës pasi ka ndodhur aksidenti. Nga dita e dytë në dy ditët e para dhe gjys muaji frika sekondare është zvogëluar në frikë me intensitet të mesëm, në të cilin kanë ndikuar faktet se në këtë periudhë paditësja çdo ditë ka përjetuar dhimbje dhe ka pasur vështirësi në kryerjen e aktiviteteve të përditshme jetësore. Nga gjysma e dytë e muajit të tretë deri në fund të muajit të gjashtë, paditësja

ka përjetuar frikë sekondare më intenzitet të lehtë. Nga muaji i shtatë deri sot dhjetë muaj dhe dhjetë ditë nga ngjarja është paraqitur frikë e përkohshme e shkallës së lehtë në situata të cilat paditësen a asocojnë në aksidentin e përjetuar.

Aftësia e përgjithshme jetësore të paditësjës ka qenë e zvogëluar si pasojë e lëndimit të cilin e ka marrë nga aksidenti i komunikacionit. Gjatë dy muajve të parë pas ngjarjes paditësja ka bërë përpjekje të mesme gjatë kryerjes së aktiviteteve elementare jetësore dhe lëvizje nëpër shtëpi dhe përpjekje të mëdha gjatë lëvizjeve jashtë shtëpisë. Gjatë muajit të tretë dhe të katërt paditësja ka bërë përpjekje të lehta gjatë aktiviteve dhe lëvizjeve nëpër shtëpi dhe përpjekje të mesme gjatë lëvizjeve jashtë shtëpisë. Nga fillimi i muajit të katërt deri në fund të muajit të gjashtë paditësja ka bërë përpjekje të mesme gjatë ngarkesës së këmbës së majtë, si dhe gjatë ecjes dhe qëndrimit, përderisa nga muaji i shtatë është stabilizuar aftësia e përgjithshme e paditëses. Paditësja ka përjetuar edhe mërzi dhe ndryshime të disponimit për shkak të ndryshimeve shëndetësore të shaktuara nga lëndimet edhe atë gjatë tre muajve të parë në intenzitet të mesëm dhe prej muajit të katërt deri në fund të muajit të gjashtë me intenzitet të lehtë.

Si pasojë e lëndimeve, paditësja ka pësuar edhe dëm material në emër të harxhimeve për mjekim në shumë totale prej 5.436,00 denarë.

Paditësja deri te paditësi ka dërguar kërkesë për shpërblim të dëmit të shkaktuar, por në procedurë jashtëgjyqësore nuk kanë aritur marrëveshje.

Gjendjen e tillë faktike të vërtetuar gjyqësi e vërtetoi nga provat e shpalosura gjatë procedurës, të propozuara nga palët në këtë kontest, kurse sipas barës së vërtetimit sipas nenit 205 nga Ligji për procedurë civile.

E padiskutueshme është se në ditë 13.02 viti 2016 në Shkup në rr. Justinijani i parë në afërsi të diskontit Gigo trejd ka ndodhur aksident trafiku në të cilin kanë marrë pjesë vetura e tipit Folksvagen Pasat me targa SK 585 SS drejtuar nga S.D. nga f. S... Shk..., e siguruar te i padituri dhe paditësja si këmbësor, në të cilin aksident paditësja si këmbësor ka përsosur lëndime trupore. Faktet e tilla dalin edhe nga procesverbali për shikim në vendngjarje.

Përmes palëve nuk ishte e kontestueshme për arsyet dhe përgjegjësinë për aksidentin e trafikut dhe në atë kuptim dhe kontributin e pjesëmarrësve në shkaktimin e aksidentit të trafikut.

Sipas ekspertizës së komunikacionit të propozuar nga paditësja, kurse e përgatitur nga Instituti për ekspertiza SHPKNJP Shkup, situata e rezikshme është paraqitur si pasojë e vozitjes së pavëmendshme të veturës së tipit Folsvagen Pasat nga ana e vozitësit.

Nga ana tjetër sipas ekspertizës së komunikacionit të propozuar nga i padituri, kurse e përgatitur nga ekspert Ile Cvetanovski, të dy pjesëmaësit në aksident kanë bërë lëshime për shfaqjen e të njëjtës edhe atë vozitësi i veturës Folksvagen Pasat për shkak të asaj se veturën e ka vozitur me vëmendje të pamjaftueshme edhe pse ka qenë i detyruar të përqëndrohet tek këmbësorët për arsye se ka hyrë në rrugë ku ka stacione autobusi në të dy anët e rrugës, shikuar në atë anë të lëvizjes së veturës për shkak të të cilit ka kontribut prej 70%-80%, përderisa paditësja para se ta shkelë rrugën, ka qenë e obliguar posaçërisht ti kushtojë vëmendje largësisë dhe shpejtësisë së veturave të cilat janë në afrim e sipër, si në anën e majtë poashtu edhe në anën e djathtë, si dhe drejtë ta vlerësojë shpejtësinë e lëvizjes së veturave që janë në lëvizje, kurse duke mos vepruar në këtë mënyrë paditësja ka kontribut prej 20%-30% në shkaktimin e aksidentit të trafikut.

Meqë doli nevoja që të bëhet tentim për pajtësë të ekspertizave të lartëpërmendura në pjesën e përcaktimit të kontributit të pjesëmarësve në aksident, gjyqji i dërgoi shkresat e lëndës MALVP-231/14 në Institutin për ekspertiza SHPKNJP Shkup me qëllim që të bëhet pajtim i ekspertizave të përgatitur nga ekspert Ile Cvetanovski, dhe për shkak të asaj se ekspertet u pajtuan, gjyqji nuk veproi sipas nenit 246 al.2 dhe 3 nga LPK dhe nuk caktoi superekspertizë.

Në pajtesën e ekspertizave të përgatitur na Instituti për ekspertiza SHPKNJP Shkup ekspert Dejan Trevski inzh. i dipl. i traf nga data 30.11 viti 2017 ka theksuar se përcaktimi i kontributit paraqet pyetje juridikë që duhet të meret në bazë të llojit dhe madhësisë së lëshimeve nga ana e pjesëmarësve, por mund të pranohet se kontribut nga ana e paditëses ka së paku 20% në bazë të konstatimit se rrugën e ka kaluar jashtë shenjave për kalim për këmbësorë, dhe në situatë të tillë nuk është dashur ta pengojë lëvizjen e veturave.

Faktin për llojin dhe karakterin e lëndimeve të cilat i ka marë paditësja, si dhe faktet për pasojat e lëndimeve, në aspekt të intenzitetit dhe zgjatjes së dhimbjeve fizike, frikës dhe dhimbjeve shpirtërorë për shkak të zvogëlimit të aktivitetit të përgjithshëm jetësor gjyqji i vërtetoi nga ekspertiza mjekoro ligjore e propozuar nga paditësja, kurse përgatitur nga ekspert dr. Aleksandar Marcikiq-neuropsihijatër. Gjatë vërtetimit të gjendjes faktike në këtë pjesë gjyqji e

pranoi ekspertizën e përmendur për shkak së është e përgatitur nga ekspert ligjor i cili ka njohuri profesionale dhe përvojë në këtë lëmi, dhe duke pasur parasysh faktin se paditësi nuk propozoi ekspertizë në këtë rethanë, edhe pse e kontestoi kërkesëpadinë e paditësit reth dëmshpërblimit të dëmit jomaterial.

Lartësia e dëmit material për paditësin për harxhime për mjekim është sumë në lartësi prej 5.436,00 denarë, e cila del nga vërtetimet e dhëna dhe llogaritë fiskale.

Padyshim është se paditësja dëri tek paditësi ka dërguar kërkesë për shpërblim të dëmit, dhe se në procedurë jashtëgjyqësore nuk është aritur marrëveshje, dhe kjo del nga kërkesa për shpërblim të dëmit prej datës 01.09 viti 2016, dhe marrëveshja e panënshkruar për shpërblim të dëmit nga 18.10 viti 2016.

Në bazë të gjendjes së tillë faktike të vërtetuar dhe provave të shpalosura gjygi vërtetoi se kërkespadia është pjesërisht e pranueshme.

Baza juridike për detyrim të të paditurit për shpërblim të dëmit del nga Ligji mbi obligimin e detyrueshëm në komunikacion (Gazeta Zyrtare e RM nr.88/05).

Sipas nenit 14 të këtij ligji, poseduesi gjegjësisht shfrytëzuesi i veturës motorike ose veturës së bashkangjitur është i obliguar që të lidhë kontratë për sigurim nga përgjegjësitë nga dëmet që do të shkaktohen me përdorim të mjetit motorik për shkak të vdekjes, lëndimeve trupore, dëmtim të shëndetit, prishjen ose shkatërimin e sendeve, përveç nga përgjegjësia për sendet që i ka marë për transport.

Sipas nenit 141 të Ligjit mbi marrëdhënjet detyrimore (Gazeta zyrtare e RM nr.18/2001, 78/2001, 04/2002, 59/2002, 05/2003, 54/2008, 81/2009 dhe 161/2009) ai që me faj do të shkaktojë dëm tjetrit është i obliguar që tia dëmshpërblejë.

Sipas nenit 142 të ligjit të lartëpërmendur dëmi është zvogëlim i pasururisë së dikujt (dëmi i thjeshtë), dhe ndalim i zmadhimit të daj (Fitimi i humbur), si dhe shkaktimi i lëndimit të të drejtave personale (dëmi jomaterial).

Sipas nenit 174 të alineës 1 e ligjit të lartëpërmendur personi i përgjegjshëm është i obliguar ta kthejë gjendjen në atë mënyrë që ka qenë para se të shkaktohet dëmi.

Sipas nenit 189 alinea 1 të ligjit të lartëpërmendur Në rast të lëndimit të të drejtave personale gjygi nëse e gjen se rëndësia e lëndimit dhe rethanat e rastit e arsyetojnë atë, do të aktgjykojë sumë adekuate në të holla, pa marrë parasysh shpërblimin e dëmit material, si dhe në mungesë të tij.

Në rastin konkret nga provat e elaboruara detalisht u vërtetua se të dy pjesëmarrësit në aksidentin e trafikut kanë përgjegjësi për shkaktimin e aksidentit dhe pasojat nga i njëjti, edhe atë paditësja ka kontribut për shkaktimin e aksidentit të komunikacionit prej 25% për shkak të faktit se para se të shkelë në rrugë, ka qenë e obliguar kryesisht ti kushtojë vëmendje largësisë dhe shpejtësisë së veturave të cilat kanë qenë duke u afruar nga paditësja, si nga ana e majtë poashtu edhe nga ana e djathtë, si dhe në mënyrë të drejtë ta vlerësojë shpejtësinë e lëvizjes së veturave, kurse vozitësi i veturës Volksfagen Pasat ka kontribut prej 75% në shaktimin e aksidentit të trafikut sepse ka bërë lëshim gjatë drejtimit të veturës së tij nuk i ka kushtuar vëmendje të duhur paditëses si këmbësor dhe nuk e ka lëshuar që ta kalojë rrugën, edhe pse ka pasur mudësi që ta vërejë se e njëjta ka filluar ta kalojë rrugën e cila gati se ka aritur ta kalojë në tërësi rrugën nëpër të cilën ka qenë duke lëvizur vetura.

Reth dëmit material dhe lartësinë e të njëjtës, gjygi udhëhiqeshte nga ekspertiza mjeksore e dorëzuar nga ana e paditëses, kurse e përgatitur nga ekspert dr. Aleksandar Marcikiq-neuropsihijatër.

Sipas nenit 9-a alinea 1 dhe 2 të Ligjit për ndryshime dhe përmbushje të ligjit mbi marrëdhënjet detyrimore (Gazeta zyrtare e RM nr.88/08 nga 11.07.2008), çdo person fizik, përveç mbrojtjes së të drejtave pronsore ka edhe të drejtë të mbrojtjes së të drejtave të veta personale sipas ligjit, kurse si të drejta personale në bazë të këtij ligji, nënkuptohen e drejta në jetë, shëndet trupor dhe shpirtëror, nder, reputacion, emër personal, privatësi të jetës personale dhe familjare, liri, shpikje intelektuale dhe të drejta tjera personale.

Sipas nenit 189 al.1 dhe 2 të LMD (Gazeta Zyrtare e RM nr. 84/11 prej datës 11.07.2008) Në rast të lëndimit të të drejtave personale gjygi nëse e gjen se rëndësia e lëndimit dhe rethanat e rastit e arsyetojnë atë, do të aktgjykojë sumë adekuate në të holla, pa marrë parasysh shpërblimin e dëmit material, si dhe në mungesë të tij. Gjykata gjatë vendosjes lidhur me kërkesën për shpërblimin e dëmit jomaterial, si dhe lartësinë e shpërblimit të tij, duhet të ketë parasysh rëndësinë e vlerës së cënuar dhe qëllimin të cilit i shërben ai shpërblim, por edhe për atë

që me atë të mos u kontribuojë tendencave që nuk janë në përputhshmëri me natyrën dhe qëllimin shoqëror të tij.

Si pasojë e aksidentit të komunikacionit paditësja ka pësuar lëndime trupore të shprehura në karakteristikë si shtypje të gjujnit të majtë.

Sipas nenit 194 të LMD, normat për përgjegjësinë e ndarë dhe për zvogëlim të dëmshpërblimit që vlejné për dëmin material njëkohësisht gjen aplikim edhe për dëmin jomaterial.

Duke u udhëhequr me dispozitat e lartërmendura dhe nga ekspertiza e dr. Aleksandar Marcikiq-neuropsihijatër gjygi paditëses për dëmshpërblim të dëmit material i gjykoi sumë prej 90.000,00 denarë, duke pasur parasysh intenzitetin dhe kohëzgjatjen e dhimbjeve fizike të cilat paditësja i ka përjetuar si pasojë e lëndimit. Për këto arsye gjygi përcaktoi dëmshpërblim në lartësi prej 90.000,00 denarë. Kërkespadinë më të madhe të kërkuar nga ana e paditëses për këtë kriterium nga suma e gjykuar deri të suma e kërkuar prej 120.000,00 denarë, sipas vlerësimit të gjygit është shumë lartë i përcaktuar. Megjithatë për shkak të asaj se gjygi vërtetoi se paditësja ka kontribut prej 25% në shkaktimin e pasojave nga aksidenti në pikëpamje të dëmit jomaterial, këtë sumë e zvogëloi për kontributin e vërtetuar të paditëses prej 25% dhe gjykoi dëmshpërblim prej 67.000,00 denarë.

Gjatë përcaktimit të lartësisë për dëmshpërblimin për frikën e shkaktuar, gjygi kishte parasysh se paditësja ka përjetuar frikë të shkurtër primare me intenzitet të lartë i cili është paraqitur në momentin kur e ka vërejtur veturën dhe përderisa e ka ndjerë goditjen dhe menjëherë pas saj në kohëzgjatje prej 10 sekonda, kurse më pas ka kaluar në frikë sekondare e cila me intenzitet të lartë ka zgjatur në pjesën e mëtejme të ditës pas aksidentit, se nga dita e dytë në dy muajt e gjys të para frika sekondare është zvogëluar deri në frikë me intenzitet të mesëm, në të cilin kanë ndikuar faktet se në këtë periudhë paditësja çdo ditë ka ndjerë dhimbje dhe ka pasur rëndësi në kryerjen e aktiviteteve themelore jetësore, se nga gjysma e muajit të tretë deri në fund të muajit të gjashtë paditësja ka përjetuar frikë sekondare me intenzitet të lehtë, dhe se prej muajit të shtatë deri sot nëntë muaj dhe dhjetë ditë pas ngjarjes është paraqitur frikë e përkohshme e shkallës së lehtë në situata ta cilat paditësen e kanë asocuar në aksidentin e pësuar. Prej këtyre arsyetimeve gjygi gjykoi sumë prej 60.000,00 denarë si sumë adekuatë në përputhshmëri me dispozitat e lartëpërmendura. Kërkesëpadia më e madhe për dëmshpërblim nga suma e kërkuar

prej 84.000,00 denarë, për gjygin është lartë e përcaktuar. Për shkak se gjygi vërtëtoi kontribut prej 25% të paditëses në shkaktimin e pasojave të dëmshme nga aksidenti në pikëpamje të dëmit jomaterial, ky gjygi këtë shumë e zvogëloi sipas kontributit të paditëses prej 25% dhe gjykoi shumë prej 45.000,00 denarë.

Për dhimbjet e pëjetuara shpirtërore për shkak të aktivitetit të përgjithshëm jetësor të paditëses, gjygi përcaktoi shumë prej 250.000,00 denarë. Kërkesëpadia më e madhe për dëmshpërblim nga suma e kërkuar prej 350.000,00 denarë, për gjygin është shumë lartë e përcaktuar. Për shkak se gjygi vërtëtoi kontribut prej 25% të paditëses në shkaktimin e pasojave të dëmshme nga aksidenti në pikëpamje të dëmit jomaterial, ky gjygi këtë shumë e zvogëloi sipas kontributit të paditëses prej 25% dhe gjykoi shumë prej 187.000,00 denarë.

Gjygi gjykoi edhe interes të ndëshkimit ligjor në sumat e gjykuara nga dita e shpalljes së aktgjykimit -16.01 viti 2018 deri në pagesën finale, sipas nenit 266-a dhe nenit 192-a si në dispozitivin e këtij aktgjykimi.

Sipas nenit 266-a të Ligjit për ndryshim dhe plotësim të ligjit mbi marrëdhënjet detyrimore (gazeta Zyrtare e RM nr.161/2009) norma e interesit të ndëshkuar përcaktohet për çdo gjysmëvjetor edhe atë në lartësi të normës së interesit të instrumentit bazë të tregut të hapur të BPRM (norma referente), e cila ka vlejtur në ditën e fundit të gjysmëvjetorit i cili i ka parapri viti në vijim, e zmadhuar për 10% pikë në kontratat e tregut dhe kontratat mes tregtarëve dhe personave në të drejtën publike, gjegjësisht e zmadhuar për 8% pikë në kontratat në të cilat së paku njëra palë nuk është tregtar (normë e interesit të dënuar).

Si pasojë e të lartëpërmendurës, duke pasur parasysh kontributin e paditëses në aksidentin konkret prej 25%, dhe me atë edhe dëmin jomaterial dhe duke vlerësuar se është shumë lartë e përcaktuar gjygi e hudhi si të pabazë kërkesëpadinë më të madhe të paditëses për dëm material nga sumat e gjykuara deri të sumat e kërkuara edhe atë për dhimbje fizike deri në shumë prej 120.000,00 denarë, për frikë deri në shumë prej 84.000,00 denarë dhe për zvogëlim të aktivitetit të përgjithshëm jetësor deri në shumë prej 350.000,00 denarë, si dhe kërkesën për interes të dënuar normativ për dallimin, duke llogaritur nga dita e aktgjykimit 16.02 viti 2018, deri në pagesën finale, si në dispozitivin e këtij vendimi.

Sipas nenit 141 alinea 1 të LMD , ai që me faj do ti shkaktojë dëm tjetrit është i obliguar që ta dëmshpërblejë.

Sipas nenit 184 alinea 1 të LMD, ai që di ti shkaktojë tjetrit lëndime trupore ose do t'ia dëmtojë shëndetin, është i obliguar që t'ia kompenzojë harxhimet reth mjekimit dhe harxhimet tjera të nevojshme në lidhje me atë, si dhe fitimin e humbur për shkak të paaftësisë për punë gjatë kohës së mjekimit.

Si pasojë e lëndimeve paditësja ka pësuar edhe dëm material në emër të harxhimeve për mjekim në shumë prej 5.436,00 denarë. Megjithatë, duke pasur parasysh kontributin e paditëses prej 25% në pikëpamje të aksidentit, kurse me atë edhe në dëmin material për harxhime për mjekim gjygi e hudhi si të pabazë kërkesëpadinë më të madhe të paditëses për shpërblim të dëmit material për harxhime për mjekim duke gjykuar shumë prej 4.077,00 denarë.

Në shumën e gjykuar gjygi gjykoi edhe interes normativ dënues nga dita e ngritjes së aktpadisë – 10.02 viti 2017 deri në pagesën finale, sipas nenit 266-a të LMD.

E pabazë është kërkesëpadia e paditëses për shpërblim të dëmit material për ushqim të përforcuar dhe roba të dëmtuara, sepse sipas normave të lartëpërmendura paditëses i takon shpërblim i dëmit material vetëm për harxhime për mjekim, dhe për këtë shkak gjygi e hudhi si të pabazë kërkesëpadinë më të madhe të paditëses nga suma e aktgjykuar deri te suma e kërkuar prej 46.000.00 denari.

Në bazë të lartpërmendurës gjygi vendosi si në dispozitivin e këtij aktgjykimi.

Sipas lartësisë së kërkesës që paditësja fitoi në kontest dhe kërkesës së të autorizuarit të paditëses, kurse në bazë të nenit 148 dhe 149 të Ligjit për procedurë civile gjygi vendosi që i padituri paditëses t'ia kompenzojë harxhimet procedurale edhe atë për taksë për kërkesëpadi shumë prej 6.082,00 denarë, për përbërje të kërkesëpadiisë shumë prej 7.800,00 denarë, për ekspertizë mjekësore shumë prej 8.000,00 denarë, për ekspertizë komunikacioni shumë prej 7.080,00 denarë, për përfaqësim në dy seanca shumë prej 18.720,00 denarë, për çdonjërin nga 9.360,00 denarë dhe taksë për vendim shumë prej 6.082,00 denarë, ose gjithsej 53.764,00 denarë.

Gjygi e hudhi si të pabazë kërkesën më të madhe të paditëses për kompenzim të harxhimeve procedurale nga harxhimet e gjykuara deri te harxhimet e kërkuara në shumë prej

65.560,00 denarë, duke mos gjykuar harxhime për përfaqësim në seancë gjyqësore në datë 12.06 viti 2017 sepse kjo seancë u anulua në kërkesë ta autorizuesit të paditëses, për përpilim të dy nënshtresave të paarsyetuara për arsye se në gjygj ishte e dorëzuar vetëm një parashtrësë në datë 14.06 viti 2017 me të cilën i autorizuari i paditëses ka dërguar në gjykatë zëvendësim të autorizimit për senacën gjyqësore për datë 12.06 viti 2017, kurse të njëjtën ka pasur mundësi ta dërgojë në seancë, si dhe për taksë për vendim dhe kërkesëpadi në sumat e caktuara, duke pasur parasysh se në atë rethanë takojnë harxhime sipas lartësisë së sumës që do të fitohet në kontest.

GJYKATA THEMELORE SHKUP II SHKUP

5 MALVP-.../14 në ditë 24.01.viti 2018

Kryetari e keshillit-Gjykatësi

J...S...

PËRFUNDIMI

Nga e lartpërmendura mund të konkludojmë se në praktikën gjyqësore në vitet në vijim edhe atë duke filluar nga viti 2015 e këndeje, lëndët ku kërkohet shpërblimi i dëmit që është shkaktuar në komunikacionin rrugor janë lëndët më të shpeshta që hasen në praktikën gjyqësore dhe bazë juridike të lëndët e tilla është shpërblimi i dëmit material, shpërblimi i dëmti jomaterial, shpërblimi i dëmit nga autopërgjegjsia, shpërblimi i dëmit në rast të vdekjes, lëndimit trupor dhe cënimit të shëndetit, shpërblimi i dëmit jomaterial për shkak të shëmtimit, si dhe shpërblimi i dëmit material për shkak të invaliditetit.

Shpërblimi i dëmit material sizakonisht në praktikë kërkohet kur i dëmtuari ka pasur harxhime për mjekim si pasojë e lëndimeve që i ka marur nga dëmi që e ka pësuar gjatë aksidentit të shkaktuar në komunikacionin rrugor. Rast tjetër kur kërkohet shpërblim i dëmit material është për shkak të veturës që është dëmtuar i dëmtuari kërkon nga dëmtuesi-kompania e sigurimit ku dëmtuesi e ka pasur veturën e suguruar që t'ia kompenzojë dëmin e shkaktuar. Për shkak të sigurimit të obligueshëm të veturave nga rastet e rezikut dëmshpërblimet e tilla çdo herë kërkohen nga kompania e sigurimit ku dëmtuesi e ka pasur të siguruar veturën në momentin kur ka ndodhur aksidenti rrugor.

Shpërblimi i dëmit jomaterial që kërkohet, kërkohet për atë dëm që të dëmtuarit i është shkaktuar nga marja e lëndimeve gjatë aksidentit rrugor. Kriteriumet për caktimin e lartësisë së dëmit të shkaktuar ku si pasojë kemi lëndime trupore të mara në aksidenti rrugor mvaren nga faktorë të shumtë edhe atë: llojet e lëndimeve që i dëmtuari i ka marë të cilat gjithmonë klasifikohen nga mjek ekspert i lëmisë së caktuar – ekspert mejkoro-ligjor. Kështu në fillim shifet se për çfarë lëndimesh bëhet fjalë, gjegjësisht janë lëndime të lehta apo lëndime të rënda trupore, apo vetëm lëndime trupore, shihet që lëndimet nëse janë të rënda të çfarë llojit janë gjegjësisht a janë lëndime që kanë si pasojë invaliditetin apo jo, a është ai invaliditet i përkohshëm apo i përhershëm, pasojat që i ka pasur i dëmtuari gjatë lëndimeve që i ka marur. Gjithashtu meret parasysh kohëzgjatja e dhimbjeve që i ka pasur i dëmtuari si pasojë e lëndimeve trupore edhe atë si dhimbjeve fizike poashtu edhe dhimbjeve shpirtërore për shkak të aktivitetit të kufizuar jetësor, këtu bën pjesë edhe stresi që e ka pësuar i dëmtuari. Gjithashtu gjatë përcaktimit të lartësisë së shpërblimit të dëmit të shkaktuar si pasojë e aksidentit të shkaktuar në komunikacion rrugor meret

parasysh a ka pësuar shëmtim personi i dëmtuar apo jo dhe a kërkon dëmshpërblim për atë dëm të shkaktuar apo jo.

Baze kryesore për atë se të dëmtuarit a i takon shpërblim i dëmit të tillë është lidhja kauzale-shkakore mes aksidentit të ndodhur dhe lëndimeve të mara, gjegjësisht duhet të vërtetohet se lëndimet e tilla janë pasojë e aksidentit.

Gjatë përcaktimit të lartësisë së dëmit të shkaktuar të dëmtuarit gjithashtu meret parasysh edhe fakti se sa i dëmtuari ka kontribuar me veprimet e veta që dëmi i caktuar ti shkaktohet, gjë që gjithmonë caktohet nga ekspertet e teknikut të komunikacionit, dhe në bazë të asaj se sa ka kontribuar i dëmtuari që dëmi i caktuar ti shkaktohet dëmshpërblimi që do ti takonte po të mos kishte kontribuar që dëmi i caktuar ti shkaktohet zvogëlohet për atë përqindje sa ka kontribuar i dëmtuari që dëmi i caktuar ti shkaktohet.

Kur kërkohet shpërblim i dëmit material si lloj i harxhimeve për mjekim çdo herë meren parasysh llogarit fiskale që i dëmtuari i bie si fakte në bazë të të cilave e këron shpërblimin e dëmit të tillë. Kur kërkohet shpërblim i dëmit material për shkak të veturës së prishur lartësia e shpërblimit të dëmit të tillë vërtetohet në bazë të ekspertizës makinerike që cilën e vërtetojnë ekspert të makinerisë. Edhe këtu kur gjykohet shpërblimi i dëmit të tillë çdo herë meret parasysh se sa i dëmtuari ka kontribuar që dëmi konkret ti shkaktohet apo mos ti shkaktohet.

Vendimet për dëmshpërblim të dëmit jomaterial çdo herë sjellen në bazë të vendimit të lirë të gjykatësit që e ka lëndën në punë duke pasur parasysh kriteriumet e lartpërmendura si dhe dispozitat ligjore të ligjit mbi marrëdhënjet detyrimore ku në mënyrë të qartë dhe precize parashihet se për çfarë lloj dëmi çfarë kompensimi i takon apo nuk i takon të dëmtuarit.

BIBLIOGRAFIA

- ALIU Abdulla**, E drejta sendore(pronësia), Prishtinë, 2004.
- ALIU Abdulla**, Burimet e së drejtës civile në Kosovë, Prishtinë, 1999.
- ALIU Abdulla**, Kontrata për Licencë, komentar-ligji për marrëdhëniet e detyrimeve, libri II, Prishtinë, 2013.
- ALIU Abdulla**, Kontrata për ndërmjetësimin e udhëtimeve, komentar-ligji për marrëdhëniet e detyrimeve, libri II , Prishtinë, 2013, fq. 555.
- ALISHANI Alajdin**, Parimet themelore të ligjit mbi marrëdhëniet e detyrimeve, Prishtinë, 2000.
- ALISHANI Alajdin**, E drejta e detyrimeve(pjesa e përgjithshme), Prishtinë,1985.
- DAUTI, Nerxhivan**, E drejta e detyrimeve, Prishtinë, 2001.
- GALEV Gale, JADRANKA Daboviq**, Obligacioni pravo, Skopje, 2009.
- GAMS Andrija**, Hyrje ne te drejten civile, Prishtine, 1986.
- JASHARI Adnan**, Responsibility on Environmental Damage with a View in the Republic Of Macedonia, International Journal of Scientific & Engineering Research Volume 3, Issue 4, April-2012
- JASHARI, Adnan**,E drejta afariste kontraktore, Tetove, 2017
- PUHAN Ivo**, E drejta romake, Prishtinë, 1980.
- STATOVCI Ejup**, E drejta e pengut, Prishtinë,1988.
- STATOVCI Ejup**, Zastita Svojine, Prishtinë,1980

Ligje dhe burime tjera:

1. Ligji për marrëdhëniet e detyrimeve të Republikës së Maqedonisë.
2. Ligji per pergjegjesi civile per ofendime dhe shpifje i Republikës së Maqedonisë
3. Kodi Civil i Republikes se Shqiperis i Miratuar me ligjin nr.7850, datë 29.7.1994
4. Ligji mbi marrëdhëniet e detyrimeve, aprovuar nga Kuvendi RSFJ, 1978.
5. Ligji për marrëdhëniet e detyrimeve të Republikës së Kosovës;
6. Ligji për siguri të trafikut në rrugë i Republikës së Maqedonisë;
7. Ligji për notariat i Republikës së Maqedonisë;
8. Konventa për mbrojtjen e të drejtave të njeriut dhe lirive themelore”, e Këshillit të Europës;

9.Konventa Europiane për shpërblimin e viktimave nga krimet e dhunës”;

Revistat shkencore:

1..Aleksiej Duma, Aleksandra Gutevska (mjek në Institutin për mjekësi ligjore dhe kriminaliztike, Fakulteti i mjeksisë, Shkup), “Ekspertiza mjeko-ligjore për pasojat e lëndimeve trupore në kuadër të të drejtës civile”, “Dëmi jomaterial”, Revistë shkencore “**AKADEMIK**” – Shkup,2006.

2.Marjana Pop-Taleska, “Dëmet ndërkombëtare bazuar në kartonin e gjelbërt”, Sigurimi Vardar sh.a., Dëmi jomaterial, Revistë shkencore “**AKADEMIK**” – Shkup, tetor 2006.

3. Peco Popovski, (gjykatës i Gjykatës së Apelit në Manastir), “Parashkrimi i së drejtës për të kërkuar përmbushjen e detyrueshme të detyrimit, posaçërisht të dëmit jomaterial” Revistë shkencore “**AKADEMIK**” – Shkup, tetor 2006.

Burimet nga interneti:

1. www.drejtesia.gov.al
2. <http://www.pravda.gov.mk/>
3. <https://bks-ks.org/>
4. www.academia.edu
5. www.pravdiko.mk
6. www.healthrights.mk
7. www.juristi.info
8. <http://www.gjykataelarte.gov.al/>
9. <http://drejtesia.shqiptare.com>
10. <https://studioligjore.wordpress.com/>
11. <http://njohligjin.al/>
12. www.humanrights.coe.int